



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

PROVIMI I SHTETIT
FONDI I PYETJEVE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË
VETERINERIT

1. Komunikimi Veterinar

Pyetja 1

Çfarë është komunikimi në mjekësinë veterinare?

- A) Imponim i mendimit mjekësor
- B) Elokuencë ndërveprimi verbal
- C) Proces i të kuptuarit dhe ndarjes së mendimit
- D) Shqiptim fjalësh

Pyetja 2

Në mardhënien veteriner – klient – pacient, cila bisedë konsiderohet më efikase?

- A) Konsumizëm
- B) Partneritetit
- C) Bisedë e lirë
- D) Paternalist

Pyetja 3

Në procesin e vendimmarrjes mjekësore këshillohet t'i lihet më shumë hapësirë:

- A) Vendimit të klientit
- B) Vendimit të veterinerit
- C) Duke parë e duke bërë
- D) Mirëkuptimit të ndërsjellë

Pyetja 4

Çfarë nënkupton komunikimi jo verbal?

- A) Një bisedë me shumë xheste trupore
- B) Veprimet flasin më shumë se fjalët
- C) Mungesë vëmendje ndaj tjetrit
- D) Komunikim në distancë

Pyetja 5

Çfarë nënkupton komunikimi verbal?

- A) Komunikim me xheste
- B) Komunikim me zë të lartë
- C) Aftësinë për të dëgjuar

D) Aftësinë për të bërë pyetje

Pyetja 6

Cila lloj pyetje i jep më shumë hapësirë klientit për të komunikuar?

A) Pyetja reflektuese

B) Pyetja e fokusuar

C) Pyetja e hapur

D) Pyetja hetimore

Pyetja 7

Dëgjimi me vëmendje i anamnezës që jep pacienti kontribuon në sa % të vendosjes së diagnozës?

A) Pak

B) Rreth 50%

C) Rreth 85%

D) 100%

Pyetja 8

Cilët njerëz janë dëgjues më të mirë?

A) Ato që janë shumë të duruar

B) Ato që kanë më shumë shprehje teknike

C) Ato që shpesh karakterizohen nga ndjenja e ankthit

D) Personat e mbyllur

Pyetja 9

Pasi keni marrë anamnezën dhe keni përfunduar ekzaminimin klinik, si do t'ia shprehni konkluzionet pronarit në lidhje me kafshën?

A) Do të lini pronarin ta marrë vetë vendimin

B) Do t'i ofroni opsionet me avantazhet dhe disavantazhet

C) I thuhet me autoritet çfarë duhet të bëjë

D) Duke parë e duke bërë

Pyetja 10

Gjatë një konsulte si duhet t'ia ofroni informacionin klientit?

A) Të jetë i gjatë, i detajuar dhe shterrues

B) Të mbështetemi kryesisht në fletë-palosje

C) Duke përdorur sa më shumë terminologji mjekësore

D) Të ndarë në pjesë të vogla duke veçuar prioritetet

Pyetja 11

A duhet dhënë “konsensusi i informuar” para procedurave të tilla si ndërhyrjet kirurgjikale?

A) Nuk është i rëndësishëm

B) Tremb dhe largon klientin

C) Është i rëndësishëm

D) E paraqet veterinerin jo kompetent

Pyetja 12

Çfarë është konsensusi i nënkuptuar?

- A) Detyrim ligjor me shkrim
- B) Detyrim ligjor për informim
- C) E njëjta gjë si konsensusi i informuar
- D) Procedura pranohet si e mirëqenë

Pyetja 13

Cili nga veprimet e mëposhtme mund të rrisë ndjenjën e fajit tek pronari gjatë kryerjes së një eutanazie?

- A) T'i kërkohet atij ndihma aktive për të gjetur venën
- B) Japim sqarime mbi mundësinë e reagimeve fiziologjike
- C) E lejojmë pronarin që t'i prekë dhe mbajë kokën kafshës së tij
- D) Konfirmimi verbal i vdekjes së kafshës

Pyetja 14

Si do ta jepnit ju nje lajm të keq mbi prognozën e kafshës?

- A) Ja thoni atë klientit në një mjedis me njerëz
- B) Duke zvogëluar implikimet për të ulur reagimin
- C) E ndani informacioni në pjesë të vogla dhe jeni të vërtetë
- D) T'i dilni para çdo të papriture duke zmadhuar pak implikimet

Pyetja 15

Cili është perceptimi i pronarëve të kafshëve të shoqërimit për profesionin e veterinerit?

- A) I duan vërtetë kafshët
- B) Janë të nënpaguar
- C) Njerëz të mirë
- D) I intereson fitimi monetar

Pyetja 16

Si ndikon dhënia e një fature me të gjitha kostot, para fillimit të procedurave?

- A) Largon klientin
- B) Krijon besim
- C) Krijon konflikte
- D) Nuk ka asnjë ndikim

Pyetja 17

Nëse përballë kemi një klient të zemëruar si duhet të reagojmë që ta bëjmë atë të ndjehet mirë?

- A) T'i përgjigjemi me ton të ftohtë
- B) Të tregohemi imponues në mendimin tonë
- C) Të zbulojmë pritshmëritë e tij
- D) T'i shmangemi takimit me të

Pyetja 18

Si duhet të përballemi me gabimet mjekësore?

- A) Të mundohemi t'i minimizojmë efektet e gabimit
- B) T'i fshehim ato
- C) Të përdorim një qasje dashamirëse, jo mohuese
- D) Të mbrohemi

Pyetja 19

Cila do të ishte pjesa kryesore për të punësuar një anëtar të ri në klinikë?

- A) Kërkesa e një CV-je të detajuar
- B) Intervista në formë bashkëbisedimi me të gjithë anëtarët
- C) Intervistë personale vetëm me drejtuesin e klinikës
- D) Vlerësimi i referencave nga puna e mëparshme

Pyetja 20

Çfarë periodiciteti konsiderohet optimal për të bërë vlerësimin e punës së stafit të klinikës?

- A) Në fund të çdo muaji
- B) Çdo tre muaj
- C) Çdo gjashtë muaj
- D) Një herë në vit

Pyetja 21

Cila është pyetja më normale që i bëhet punonjësit që po largohet nga puna?

- A) Sa do ta doje rrogën që të vazhdoje të rrije
- B) Çfarë do të rregulloje ti nëse do të ishe drejtuesi i klinikës
- C) Arsyeja e largimit
- D) Ku synon të punësohesh

Pyetja 22

Si do të veproni me një klienti i cili nuk është i juaji, por që për shkak të një urgjence paraqitet tek ju?

- A) Nuk e marr përsipër rastin
- B) Kryej shërbimin dhe insistoj ta tërheq klientin nga vetja
- C) Kryej shërbimin dhe e këshilloj që të vazhdojë tek klinika nga erdhi
- D) I shërbej me një cilësi sa për të kaluar radhën

Pyetja 23

Në rastin se ju si veteriner praktik duhet të përçoni një mesazh në median publike, cila do të ishte e saktë?

- A) Të modifikoni faktet për të qenë sa më tërheqës
- B) T'i mëshoni opinioneve personale
- C) Mesazhet t'i përshtaten asaj që ka më shumë dëshirë të dëgjojë audiencia
- D) Mesazhet të jenë fakte korrekte

Pyetja 24

Nga pikëpamja e stresit në punë, si konsiderohet profesioni i mjekut veterinar?

- A) Profesioni me pak stres për shkak të punës me kafshë
- B) Njëlloj si të gjitha profesionet
- C) Ndër profesionet më risk të lartë për shkak të stresit në punë
- D) Stresi nuk luan rol

Pyetja 25

Cila opsion është tregues i një “simptome të sjelljes” nga stresi në punë?

- A) Abuzim me alkoolin
- B) Shqetësime në stomak
- C) Ankth
- D) Rrahje zemre

Pyetja 26

Cili nga elementët e listuar është burim më i fortë stresi në punën e një veterineri praktik?

- A) Kërkesa për rrogë më të lartë
- B) Klientë të vështirë ose kërkues
- C) Problemet në familje
- D) Largësia nga vendi i punës

Pyetja 27

Aftësia e komunikimit efektiv në një klinikë veterinarë synon?

- A) Më pak stres në punë
- B) Rënie në shpërblim
- C) Rezultate klinike më të mira
- D) Fshehjen lehtë të ndonjë gabimi

Pyetja 28

Cilin do të vlerësonit si moment më të përshtatshëm për të rekomanduar eutanazinë e një kafshe?

- A) Kur pronari e kërkon me insistim
- B) Kur sëmundja ka avancuar dhe kafsha ka më shumë ditë të këqija sesa të mira
- C) Kur je në vështirësi për t'i zgjidhur një problem shëndetësor
- D) Kur pronari nuk ka mjaftueshëm para për t'ju paguar

Pyetja 29

Si do të vepronit ju me një klient të informuar që vjen me një diagnozë të vënë nga vetë ai?

- A) Do ta refuzonit pa hezituar përpjekjen e pronarit
- B) Bie dakort apriori me diagnozën e pronarit
- C) Pas vendosjes së diagnozës i ofroni klientit edhe informacion për sëmundjen
- D) Mundoheni ta bindni atë, që vendosja e diagnozës nuk është kompetencë e tij

Pyetja 30

Çfarë ndodh nëse një veteriner nuk paguhet mirë?

- A) Pronarët e kafshëve ndjehen më mirë
- B) Veterineri nuk do të ofrojë shërbimin më të mirë
- C) Ulet kosto e trajtimit mjekësor
- D) Kosto e ulët e bën më konkurent biznesin

Pyetja 31

Cili nga veprimet e përmendura mëposhtë, është i ndaluar sipas kodit të etikës profesionale?

- A) Alkooli, Droga
- B) Edukimi I vazhdueshëm professional
- C) Marëdhënie korrekte me koleget dhe klientët
- D) Raporte të mira institucionale

Pyetja 32

Cila konsiderohet si “distançë personale” gjatë një konsulte veterinare?

- A) Deri në 45 cm
- B) 45 – 120 cm
- C) 1.2 – 3.6 m
- D) Është shumë variabël

Pyetja 33

Komunikimi i mirë redukton?

- A) Eutanazitë
- B) Rrjedhjen e informacionit konfidencial
- C) Koston e shërbimeve
- D) Praktikën e keqe

Pyetja 34

Në rast gabimi mjekësor të konfirmuar:

- A) I duhet faturuar klientit tarifa e plotë
- B) I duhet faturuar gjysëm tarife
- C) Mundësisht të mos kenë detyrime financiare
- D) T'i lihet në dorë klientit

Pyetja 35

Në rastin kur një klient për një rast ndërron klinikë, a duhet që:

- A) Për të fituar klientin të fajësojmë apriori kolegun nga ai vjen
- B) Të mos bëjmë asnjë koment mbi kolegun pa patur informacion të detajuar
- C) Të mos e marrim rastin përsipër
- D) Të mbifaturojmë klientin

Pyetja 36

Cili organizim pune është më efikas në një klinikë veterinare?

- A) Sipas një protokolli me procedura standarde
- B) Sipas rasteve që paraqiten gjatë ditës
- C) Secili ta bëjë punën sipas mënyrës së tij
- D) E vendos drejtuesi

Pyetja 37

Për të shmangur ankesat e stafit të klinikës, rotacionet në klinikë duhet të shpallen:

- A) Në fillim të çdo muaji
- B) Në fillim të çdo tremujori
- C) Në fillim të çdo gjashtëmujori
- D) Në fillim të vitit

Pyetja 38

Çfarë nënkupton “struktura e raportimit” në një klinikë?

- A) Raportohen klientët që nuk paguajnë
- B) Raportohen shqëtësimet e stafit
- C) Raportohen të rejat më të fundit
- D) Raportohet mbi ecurinë e rasteve klinike

Pyetja 39

Çfarë nënkupton pyetja “kemi harruar ndonjë gjë?” në fund të konsultës?

- A) T’i themi me edukatë klientit që koha mbaroi
- B) Ndjehemi të pasigurtë për rezultatin e konsultës
- C) Të kontrollojmë nëse klienti është i kënaqur me rezultatin e konsultës
- D) Të mundohemi të lemë përshtypje pozitive tek klienti

Pyetja 40

Ekzaminimi fizik gjatë konsultës është më mirë të kryhet:

- A) Pa filluar marrja e anamnezës
- B) Pasi është marrë anamneza
- C) Atëherë kur e kërkon pronari i kafshës
- D) Midis marrjes dhe dhënies së informacionit

Pyetja 41

A preferohen nga klientët veterinerët me pirsing në fytyrë, burra me flokë të gjatë, femra me funde të shkurtra?

- A) Përgjithësisht po
- B) Përgjithësisht jo
- C) S’ka asnjë rëndësi
- D) Konsiderohet paragjykim

Pyetja 42

Modeli i vendimmarrjes “veprim i bazuar” mbi një procedurë veterinarë nënkupton:

- A) Vendimin e merr klienti

- B) Vendimi është produkt i dyanshëm
- C) Vendimin e merr veterineri
- D) Marrja e vendimit i lihet spontanitetit

Pyetja 43

Si duhet të bëhet komunikimi i rrezikut?

- A) Duke e mbivlerësuar atë për të qenë brenda
- B) Duke e zvogëluar atë për të mos trembur klientin
- C) Ta shprehim rrezikun në përqindje
- D) E komunikojmë në fund të procedurës

Pyetja 44

Çfarë nënkupton “parimi i përfitimit” në provat klinike për qëllime kërkimore?

- A) Kërkuesi të shmangë dëmet
- B) Kërkuesi të ofrojë gjithë informacionin
- C) Kërkuesi të përfshijë të drejtat e privatësisë
- D) Pjesëmarrësi të kuptojë që studimi ndihmon edhe të tjerët

Pyetja 45

Nëse ju jeni drejtuesi i një klinike dhe ju parqitet një klient me ankesa, çfarë duhet të evitoni?

- A) T’i kërkoni falje për dikë tjetër
- B) I kërkoni atij të tregojë historinë nga fillimi
- C) E falenderoni për problemin që sjell tek ju
- D) Mbani shënime dhe i kontrolloni ato me klientin

2. Mjekësi Ligjore & Nekropsi Veterinare

Pyetja 1

Në cilin moment të nekropsisë bëhet studimi i organeve të aparatit tretës?

- A) Gjatë ekzaminimit të jashtëm
- B) Sapo është bërë hapja e kadrës
- C) Në fund të nekropsisë
- D) Menjëherë pas ekzaminimit të kavitetit torakal

Pyetja 2

Në opsionet e listuara, cili konsiderohet abuzim me kafshët?

- A) Trajtimi i gabuar veterinar
- B) Lënia e kafshës pa trajtim veterinar
- C) Helmimi i brejtësve në një mjedis të caktuar
- D) Therja e kafshëve bujqësore në një thertore të palicensuar

Pyetja 3

Cili konsiderohet ndriçimi më i mirë gjatë kryerjes së një nekropsie?

- A) Me anë të llampave neon
- B) Me anë të llampave urtra violet
- C) Me anë të llampave infra të kuqe
- D) Natyral

Pyetja 4

Abuzimi me kafshët në fëmijëri konsiderohet si?

- A) Veprim naiv fëminor
- B) Kërkon të tërheqë vëmendjen
- C) Çrregullim i sjelljes
- D) Kuriozitet

Pyetja 5

Vdekja klinike ndodh atëhere kur?

- A) Ndalon puna e zemrës dhe frymëmarrjes
- B) Aktiviteti i trurit është zero, por zemra dhe frymëmarrja funksionojnë
- C) Ka kolaps vaskular
- D) Vërehet rigor mortis

Pyetja 6

Në cilin rast duhet të ngremë dyshimin për abuzim me kafshët ?

- A) Një anamnezë të pandryshuar sa herë që pyetet
- B) Anamnezë e paqëndrueshme sa herë që pyetet
- C) Anamneza dhe gjetjet ofrojnë aksident automobilistik
- D) Pronari nuk ofron fare anamnezë

Pyetja 7

Gjatë rigor mortis ndodh shkurtimi i:

- A) Enëve të gjakut
- B) Nervave
- C) Fijeve muskulare
- D) Epitelit të lëkurës

Pyetja 8

Cili nga dëmtimet ka më shumë gjasa të jetë abuzim fizik në një kafshë?

- A) Frakturë e shtyllës kurrizore
- B) Fraktura të shumëfishta në stadi të ndryshme shërimi
- C) Hemoragji nga hunda
- D) Kollë e fortë

Pyetja 9

Si duhet të kryhet ruajtja dhe transporti i mostrës për ekzaminim histopatologjik?

- A) Në kontakt me akull të thatë
- B) E vendosim në ngrirje, pastaj e transportojmë

- C) Në terren me glicerinë
- D) Në solucion 10% formaline

Pyetja 10

Në rastin e abuzimit me Sindromin Münchausen me prokurë, kafsha ndjehet mirë kur?

- A) Trajtohet me transfuzion gjaku
- B) Gjatë trajtimit pronari qëndron i pandarë nga kafsha
- C) Kafsha hospitalizohet dhe largohet nga pronari
- D) Kafshës i ndryshohet dieta

Pyetja 11

Të dhënat e mjekësisë ligjore referohen tek:

- A) Pronari i kafshës
- B) Shërbimi veterinar shtetëror
- C) Pronari i fermës ose stabilimentit
- D) Gjykata

Pyetja 12

Gjatë zbehjes së kadavrës ndodh:

- A) Tkurrja e muskujve të lëmuar të arterieve periferike
- B) Largimi i gjakut në pjesët e poshtëme të trupit
- C) Hemoragji para vdekjes
- D) Dekompozim i kadavrës

Pyetja 13

Cila nga sëmundjet e mëposhtme natyrale mund të ngatërrohet si abuzim fizik?

- A) Anemia
- B) Ruptura e stomakut
- C) Osteogjeneza imperfecta
- D) Dermatitet ulcerative

Pyetja 14

Ritmi i rënies së temperaturës në një kadavër normalisht ndodh me:

- A) 0.5 gradë celcius në orë
- B) 1.5 gradë celcius në orë
- C) 2 gradë celcius në orë
- D) E pamundur të përcaktohet

Pyetja 15

Gjatë një aksidenti automobilistik në qen, cila pjesë e trupit ka më shumë gjasa të dëmtohet?

- A) Gjysma e trupit kaudalisht brinjës së fundit
- B) Pjesa dorzale e trupit
- C) Koka dhe pjesa torakale
- D) Ekstremitetet

Pyetja 16

Cila është temperatura që fillon rigor mortis pas një vdekje në kushte normale?

- A) 3-4°C
- B) 8-12°C
- C) 22-24°C
- D) 32-36°C

Pyetja 17

Trombet e gjetura gjatë ekzaminimit nekroptik janë:

- A) Të lëmuar dhe të shndritshëm
- B) Me ngjyrë të kuqe të theksuar
- C) Të ngjitur me murin e enës gjakore
- D) Të pangjitur me murin e enës gjakore

Pyetja 18

Pas fillimit të dekompozimit të kadavrës, cili element ndihmon në përcaktimin e kohës së vdekjes?

- A) Mbetjet skeletore
- B) Insektet që invadojnë kadavrën
- C) Temperatura e mjedisit ku gjendet kadavra
- D) Indet e putrifikuara

Pyetja 19

Cila është gjetja më karakteristike gjatë nekropsisë për kafshët e shoqërimit në gjendje urie abuzive?

- A) Aromë e rëndë e aparatit tretës
- B) Torsione të zorrëve
- C) Mungesë arome e aparatit tretës
- D) Masa fekale me ngjyrë të zbehtë

Pyetja 20

Pse duhet t'i njohim mirë ndryshimet morfologjike post mortem dhe jo lezionet?

- A) Që të na ndihmojnë në vendosjen e diagnozës anatomopatologjike
- B) Për t'i njohur dhe eliminuar nga lista e vendosjes së diagnozës
- C) Na tregojnë për sëmundjet e zhvilluara gjatë jetës
- D) Janë ato që kanë shkaktuar vdekjen e kafshës

Pyetja 21

Cili opsion është karakteristike morfologjike për privim abuziv të ushqimit?

- A) Hipoplazi e gjendrave tiroide
- B) Hipertrofi e shpretkës
- C) Atrofi e mëlçisë
- D) Fibroza pulmonare

Pyetja 22

Melanozat janë?

- A) Tumore
- B) Infeksione parazitare
- C) Infeksione bakteriale
- D) Pigmentime normale të indeve

Pyetja 23

Grumbulluesit e kafshëve (pa zbatuar standardet ligjore) janë:

- A) Persona me empati të lartë ndaj kafshëve
- B) Pronarë kafshësh
- C) Kujdestarë normalë kafshësh
- D) Abuzues

Pyetja 24

Mukusi në pelvisin renal në derra dhe kuaj konsiderohet si:

- A) Sëmundje neoplastike të veshkave
- B) Ndryshim morfologjik pa rëndësi diagnostike
- C) Pielonefrit
- D) Pamjaftueshmëri kronike e veshkave

Pyetja 25

Dërmishjet (gërvishtjet) janë:

- A) Dëmtime të thella të nënlëkurës
- B) Dëmtim i enëve gjakore
- C) Plagë sipërfaqësore të lëkurës
- D) Dëmtime nga mjetet e mprehta

Pyetja 26

Ndër aromat që ndeshim në nekropsi në ripërtpës, aroma e hudhrës orienton për:

- A) Infeksion salmonelar
- B) Helmim nga arseniku
- C) Helmim nga urea
- D) Helmim nga fosfororganikët

Pyetja 27

Mbretjet janë:

- A) Dëmtime nga një mjet i topitur pa prishje të lëkurës
- B) Çarje të thella nga mjetet prerëse
- C) Dëmtim i organeve të brendshme nga mjete shpuese
- D) Gërvishje të lëkurës

Pyetja 28

Edema që vërehet në rastet e nefriteve, vjen si rezultat i:

- A) Stazave venoze
- B) Inflammacionit
- C) Hipoproteinemisë
- D) Formimit të trombeve

Pyetja 29

Në dëmtimet me mjete shpuese, kanali i plagës është zakonisht:

- A) Më i shkurtër se gjatësia e mjetit shpues
- B) Sa gjatësia e mjetit shpues
- C) Më i gjatë se gjatësia e mjetit shpues
- D) E vështirë të përcaktohet

Pyetja 30

Në cilat sëmundje gjejmë lëng seroz në abdomen?

- A) Edemë pulmonare
- B) Vese të zemrës
- C) Ulçera të stomakut
- D) Peritonit

Pyetja 31

Nëse një kafshë është djegur pasi është vlarë më parë, ka si karakteristike gjetjen e:

- A) Blozës në aparatit respirator
- B) Mungesën e blozës në aparatit respirator
- C) Hemoragjisë në aparatit respirator
- D) Likideve me shumicë në aparatit respirator

Pyetja 32

Cilat janë tipare të qëndrueshme patologjike të mbytjes?

- A) Hiperemi dhe konxhestion i aparati tretës me shtim likidesh
- B) Hiperplazi e dukshme e mëlçisë dhe çarje e kapsulës së saj
- C) Përdredhje të zorrëve dhe grumbullim likidesh transparente
- D) Konxhestioni i pulmoneve me shkumë rozë në bronke dhe trake

Pyetja 33

Në cilën sëmundje të shoqëruar me dëmtim masiv të eritrociteve gjejmë ikter?

- A) Hemoragji masive traumatike
- B) Mos funksionim i indit hemopoetik
- C) Anemi hemolitike infektive
- D) Insuficiencë kronike e veshkave në mace

Pyetja 34

Në cilin lloj abuzimi në mace ose fëmijë vërejmë në ekstremitete të ashtuquajturën “çorape” ose “dorezë”?

- A) Lënien në temperatura nën zero për një kohë të gjatë
- B) Zhytjen me forcë të gjymtyrëve në ujë të nxehtë
- C) Futjen e gjymtyrëve në acide të forta
- D) Vendosjen e përcjellësve elektrikë mbi gjymtyrë

Pyetja 35

Në cilën sëmundje gjatë nekropsisë vërejmë formim të shtuar fibrine?

- A) Leishmanioza e qenit
- B) Nefrit akut në qen
- C) Peritoniti infektiv i maces
- D) Panleukopenia e maces

Pyetja 36

Cili është një nga ekzaminimet më të rëndësishme në dëmtimet me armë zjarri?

- A) Histopatologjik
- B) Mikrobiologjik
- C) Me sy të lirë
- D) Radiografik

Pyetja 37

Në një fetus viçi të ngordhur gjatë lindjes, cila është gjetja më karakteristike që tregon jetësinë?

- A) Autoliza e avancuar e fetusit
- B) Mungesa e një koagule në kordonin umbelikal
- C) Ngjyrimi mekonial i karkasës
- D) Qumësht në stomak

Pyetja 38

Cili është shkaku i largët dhe më i mundshmi i vdekjes së një kali me kasheksi?

- A) Stomatiti ulçeroz nga ngrënja jo e rregullt e dhëmbëve
- B) Atrofi e muskulaturës dhe mëlçisë
- C) Katar kronik i stomakut dhe i zorrëve
- D) Atrofi seroze e dhjemit të epikardit

Pyetja 39

Asfiksia nga traumat gjatë transportit të kafshëve bujqësore i referohet:

- A) Pakësimin të oksigjenit në kabinën e transportit
- B) Goditjes nga të nxehtit
- C) Kufizimit të lëvizjeve të toraksit nga pesha e trupave të tjerë
- D) Gazeve helmuese të prodhuara nga automjeti

Pyetja 40

Një qen i lënë gabimisht me dritaret mbyllur në një makinë pëson goditje nga të nxehtit si rezultat i:

- A) Krijimit të gazrave toksike brënda makinës
- B) Rritjes së lagështirës si shkak i dihatjes
- C) Mos pranisë të të zotëve
- D) Hipotensionit arterial

Pyetja 41

Cili nga lezionet e mëposhtëm është tipik për goditjet nga rrufeja?

- A) Djegje në formë rrethi të lëkurës
- B) Ngurtësim i skajshëm i kadavrës
- C) Hemoragji nga hunda dhe goja
- D) Djegje në formën e degëve të pemës mbi lëkurë

Pyetja 42

Pse vrina dalëse është më e madhe se vrina hyrëse në një plagë penetruese nga armë zjarri?

- A) Sepse predha merr inde të buta me vete
- B) Për shkak të shtrëmbërimit të këndit të predhës kur ajo del
- C) Tendosjes së lëkurës në dalje të predhës
- D) Nxehtësisë së që fiton predha pas qitjes

Pyetja 43

Pse duhet treguar kujdes për të mos i dëmtuar predhat kur ato nxirren nga trupi i kafshës?

- A) Për të përcaktuar saktë kanalën e penetrimit
- B) Për të kuptuar më mirë krijimin e vrimës hyrëse
- C) Për të mos dëmtuar indet gjatë largimit të predhës
- D) Për të mundësuar zbulimin e autorit

Pyetja 44

Si e bëjmë diferencimin e rupturës gastrike ante-mortem nga ajo post-mortem?

- A) Duke analizuar përmbajtjen gastrike
- B) Nga prania ose jo e gazrave
- C) Prania ose jo e ndryshimeve inflamative në sipërfaqet peritoneale
- D) Dëmtimi ose jo i mureve abdominale

Pyetja 45

Pse është shumë i rëndësishëm përcaktimi i kohës kur ka ndodhur vdekja?

- A) Mundëson lidhjen e viktimës me abuzuesin
- B) Për të saktësuar fillimin e dekompozimit
- C) Për të studiuar më pas organet
- D) Është një e dhënë rutinë që e kërkon gjykata

3. Parazitologji

Pyetja 1

Të ushqyerit në një habitat të përbashkët është karakteristikë e marëdhënieve?

- A) Parazitare.
- B) Komensale.
- C) Mutualiste.
- D) Asnjë prej tyre.

Pyetja 2

Bujtësi tek i cili zhvillohen stadet larvore dhe aseksuale është i njohur si:

- A) Bujtës përfundimtar
- B) Bujtës i ndërmjetëm
- C) Rezervuar
- D) Vektor

Pyetja 3

Cila nga përgjigjet për karakteristikat e sëmundjeve parazitare është e gabuar?

- A) Karakteri kronik.
- B) Karakteri epidemiologjik.
- C) Karakteri sezonal.
- D) Patologji e species.

Pyetja 4

Me cilën nga teknikat e mëposhtme ngjason teknika Vajda?

- A) Teknika e ngjitësit celofan
- B) Teknika Knott e modifikuar.
- C) Teknika Baermann.
- D) Teknikan e hematokritit (Buffy coat).

Pyetja 5

Cila nga emërtesat e mëposhtme është e gabuar?

- A) *Setaria* spp..
- B) *Schistosoma bovis* Sonsino, 1876.
- C) *Parascaris equorum* (sin. *A. equorum*) (Goeze, 1782) Yorke & Maplestone, 1926.
- D) Gjinia *Acanthocephalus* Koelreuther, 1771.

Pyetja 6

Cili nga grupet e mëposhtme përdor pseudopodet për të lëvizur?

- A) Ciliatët
- B) Flagjelatët.
- C) Amebat.
- D) Asnjë prej tyre.

Pyetja 7

Cili stad i zhvillimit të *Entamoeba histolytica* është i lëvizshëm:

- A) Trofozoidi.
- B) Forma pre-cistike.
- C) Forma cistike.
- D) Asnjë prej tyre.

Pyetja 8

Leishmanioza viscerale e pamjekuar në qen është:

- A) 5-10% fatale.
- B) 25-45% fatale.
- C) 75-90% fatale.
- D) jo fatale.

Pyetja 9

Shkaktari i tripanosomozës së kuajve (durinës) është përfaqësues i grupit:

- A) Salivar.
- B) Sterkolar.
- C) Gjenital.
- D) Asnjë prej tyre.

Pyetja 10

Recidivat tek sporozoarët e gjakut i atribuohen?

- A) Hipnozoiteve.
- B) Bradizoiteve.
- C) Takizoiteve.
- D) Sporozoiteve.

Pyetja 11

Toksoplazmoza është sëmundje e:

- A) Primatëve.
- B) Qenve.
- C) Maceve.
- D) Ruminantëve.

Pyetja 12


Identifiko kujt paraziti i përket foto e mëposhtme e gjetur në feçet e ruminantëve me ekzaminimin McMaster (zmadhimi 1000 X)?



- A) Babesia bigemina.
- B) Sarcocystis spp..
- C) Cryptosporidium spp..
- D) Eimeria spp..

Pyetja 13

Identifiko kujt parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në feçe me ekzaminimin McMaster (zmadhimi 1000 X)?



- A) Giardia spp..
- B) Eimeria spp..
- C) Isospora spp..
- D) Sarcocystis spp..

Pyetja 14

Cili nga përfaqësuesit në vijim është jo flagjelat?

- A) Leishmania.
- B) Trikomonat.
- C) Histomonat.
- D) Amebat.

Pyetja 15

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ruminantë me ekzaminimin McMaster (zmadhimi 20 X)?



- A) Trichuris spp..
- B) Nematodirus spp.
- C) Strongyloides spp.
- D) Strongylus spp..

Pyetja 16

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ruminantë me ekzaminimin McMaster (zmadhimi 10 X)?



- A) Strongyloides spp..
- B) Nematodirus spp.
- C) Trichuris spp.
- D) Strongylus spp..

Pyetja 17

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ruminantë me ekzaminimin McMaster (zmadhimi 400 X)?



- A) Fasciola hepatica.
- B) Anoplocephala spp..
- C) Moniezia spp..
- D) Taenia spp..

Pyetja 18


Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ruminantë në ekzaminimin e feçeve?



- A) Dictyocaulus spp..
- B) Strongyloides spp..
- C) Nematodirus spp..
- D) Strongylus spp..

Pyetja 19


Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në ruminantë?



- A) Dictyocaulus spp..
- B) Strongylus spp..
- C) Capilaria spp..
- D) Fasciola hepatica.

Pyetja 20

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në ekuinë?



- A) Oxyuris equi.
- B) Parascaris equorum.
- C) Dictyocaulus arnfieldi.
- D) Strongylus equinus.

Pyetja 21

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në ekuinë (zmadhimi 400 X)?



- A) Monezia spp..
- B) Taenia spp..
- C) Anoplocephala spp..
- D) Strongylus vulgaris.

Pyetja 22

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në ekuinë?



- A) Oxyuris equi.
- B) Parascaris equorum.
- C) Strongilat gastrointestinal.
- D) Strongylus edentatus.

Pyetja 23

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në ekuinë (metoda e ngjitësit celofan)?



- A) Parascaris equorum.
- B) Pseudoparazit (Polen pische)
- C) Oksiuris equi.
- D) Strongilat gastrointestinal.

Pyetja 24

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në monogastrikë?



- A) Strongyloides ransoni.
- B) Ascaris suum.
- C) Trichuris suis.
- D) Strongylus spp..

Pyetja 25

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në monogastrikë?



- A) Strongyloides ransoni.
- B) Ascaris suum (lumbricoides).
- C) Metastrongylus apri.
- D) Trichuris suis.

Pyetja 26

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në derra?



- A) Strongyloides ransoni.
- B) Ascaris suum.
- C) Metastrongylus apri.
- D) Trichuris suis.

Pyetja 27

Identifiko cilit parazit i përket veza e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin koproskopik në derra?



- A) Ascaris suum.
- B) Metastrongylus apri.
- C) Strongyloides ransoni.
- D) Trichuris suis.

Pyetja 28

Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e gjakut në mishngrënës?



- A) *Strongyloides stercoralis*.
- B) *Toxocara canis*.
- C) *Aelurostrongylus abstrusus*.
- D) *Dirofilaria immitis*.

Pyetja 29


Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e rrjedhjeve të hundës ose feçe në mishngrënës?



- A) *Strongyloides stercoralis*.
- B) *Toxocara canis*..
- C) *Capilaria* spp..
- D) *Trichuris vulpis*.

Pyetja 30


Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e feçeve në mishngrënës?



- A) *Taenia* spp., ose *Echinococcus* spp..
- B) *Mesocestoides lineatum*.
- C) *Toxocara canis*.
- D) *Dipylidium caninum*.

Pyetja 31

Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e feçeve në mishngrënës?



- A) *Mesocestoides lineatum*.
- B) *Taenia* spp., ose *Echinococcus* spp..
- C) *Toxascaris leonina*.
- D) *Toxocara canis*.

Pyetja 32

Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e feçeve në mishngrënës?



- A) *Taenia* spp., ose *Echinococcus* spp..
- B) *Mesocestoides lineatum*.
- C) *Toxocara canis*.
- D) *Spirometra* spp..

Pyetja 33


Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e feçeve në mishngrënës?



- A) *Taenia* spp. ose *Echinococcus* spp..
- B) *Mesocestoides lineatum*.
- C) *Dipylidium caninum*.
- D) *Ancylostoma* ose *Uncinaria* spp.

Pyetja 34


Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e feçeve, sputumit dhe lëngut trakeal në mishngrënës?



- A) *Paragonimus* spp..
- B) *Ancylostoma* spp..
- C) *Toxocara cati*.
- D) *Toxascaris leonina*.

Pyetja 35


Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e feçeve në mishngrënës?



- A) *Mesocestoides lineatum*.
- B) *Taenia* spp., ose *Echinococcus* spp..
- C) *Toxascaris leonina*.
- D) *Toxocara canis*.

Pyetja 36

Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në zorrët e holla në monogastrikë?



- A) *Mesocestoides lineatum*.
- B) *Taenia* spp., ose *Echinococcus* spp..
- C) *Macracanthorhynchus hirudinaceus*.
- D) *Toxocara canis*.

Pyetja 37

Identifiko cilit parazit i përket pamja e mëposhtme e gjetur në ekzaminimin e lëkurës në mishngrënës?



- A) *Ixodes* spp.
- B) *Argas* spp..
- C) *Rhipicephalus sanguineus*.
- D) *Boophilus* spp..

Pyetja 38


Identifiko shkaktarin e zgjebes në foton e mëposhtme.



- A) Psoroptes spp.
- B) Chorioptes spp..
- C) Sarcoptes spp..
- D) Demodex spp..

Pyetja 39

Identifiko shkaktarin e zgjebes së syve dhe kokës.



- A) Sarcoptes spp..
- B) Notoedres spp..
- C) Psoroptes spp.
- D) Chorioptes spp..

Pyetja 40

Identifiko shkaktarin e zgjebes të pareteve të kanalit të veshit.



- A) Sarcoptes spp..
- B) Notoedres spp..
- C) Psoroptes spp.
- D) Otodectes spp..

Pyetja 41
 Identifiko shkaktarin e zgjebes së thellë të lëkurës?



- A) Sarcoptes spp..
- B) Notoedres spp..
- C) Psoroptes spp.
- D) Otodectes spp..

Pyetja 42
 Identifiko ektoparazitin e shpendëve në pamjen vijuese.



- A) Ornithonyssus spp..
- B) Notoedres spp..
- C) Psoroptes spp.
- D) Dermanyssus spp..

Pyetja 43

Identifiko parazitin e zgjebes në dhen:



- A) Sarcoptes spp..
- B) Notoedres spp..
- C) Psoroptes spp.
- D) Chorioptes spp..

Pyetja 44

Identifiko parazitin e shpendëve.



- A) Felicola spp..
- B) Haematopinus spp..
- C) Trichodectes spp..
- D) Menacanthus ose Menopon spp..

Pyetja 45

Identifiko parazitin në foto.



- A) Trichodectes spp..
- B) Haematopinus spp..
- C) Linognathus spp..
- D) Phthirus spp..

4. Radiologji – Ekografi

Pyetja 1

Cila është arsyeja që shkencëtarët i përkufizuan rrezatimet jonizues si rreze-X?

- E) Shkencëtarët përdorën rendin alfabetik për emërtimin e rrezatimeve të reja dhe ishte rradha e shkronjës X.
- F) Shkencëtarët i quajtën rreze-X sepse ishin të panjohura në kohën që u zbuluan.
- G) Shkencëtarët i quajtën rreze-X sepse qendroni të kryqëzuara si shkronja X.
- H) Shkencëtarët i quajtën rreze-X për nder të fizikantit që i zbuloj.

Pyetja 2

Cilën prej teknikave të mëposhtme përdorim për ekzaminimin e pacientëve nën ndikimin e rrezeve-X?

- E) CT-Computed Tomography (Skaner)
- F) MRI-Magnetic Resonance Imaging (Rezonanca Manjetike)
- G) Ekografia
- H) Endoskopia

Pyetja 3

Cili prej materialeve të mëposhtme bën të mundur përthithjen e rrezeve-X duke mos i tejkaluar ato në ambientet e jashtme?

- A) Zhiva
- B) Alumini
- C) Bakri
- D) Plumbi

Pyetja 4

Në rastet kur kemi ekzaminimin radiografik të pacientit me përdorim të gazeve natyrale si O₂ dhe CO₂, atëherë kemi të bëjmë me kontrastografi:

- A) Me kontrast vajor.
- B) Me kontrast të dyfishtë.

- C) Me kontrast negativ.
- D) Me kontrast pozitiv.

Pyetja 5

Çfarë do të kuptojmë me termin “gjatësi vale” në fushën e rontegenodiagnostikës?

- E) Distancën midis kulmit të një vale me kulmin e valës pasardhëse.
- F) Distancën midis kulmit të valës së parë dhe kulmit të valës së fundit.
- G) Përfaqëson sasinë e valëve për të prodhuar rreze-X.
- H) Gjatësinë e prodhimit të rrezeve-X.

Pyetja 6

Lëndët e kontrastit pozitiv përdoren gjatë ekzaminimit të pacientëve për cilën nga arsyet e mëposhtme?

- A) Për të rritur radio-opacitetin e strukturave dhe organeve të ndryshme.
- B) Për të rritur radio-transparencën e strukturave dhe organeve të ndryshme.
- C) Për të eliminuar artefaktet nga filmi radiografik.
- D) Për të qetësuar pacientin.

Pyetja 7

Cilat janë 5 etapat e procesimit manual të filmit radiografik?

- E) Zhvillimi, larja, fiksimi, shpëlarja dhe tharja.
- F) Zhvillimi, shpëlarja, fiksimi, larja dhe tharja.
- G) Fiksimi, larja, zhvillimi, shpëlarja dhe tharja.
- H) Fiksimi, shpëlarja, zhvillimi, larja dhe tharja.

Pyetja 8

Gratë shtatëzana:

- A. Lejohet të qendrojnë në ambjentet radiologjike
- B. Lejohet të qendrojnë në ambjentet radiologjike gjatë 3 mujorit të parë të shtatëzanisë.
- C. Lejohet të qendrojnë në ambjentet radiologjike gjatë 3 mujorit të fundit të shtatëzanisë.
- D. Nuk lejohet në mënyrë kategorike të qendrojnë në ambjentet radiologjike.

Pyetja 9

Nëse objekti i kontrollit të pacientit është stomaku dhe zorrët, përpara studimit duhet që këto organe të boshatisen nga përmbajtja ushqimore ose kafsha të lihet në diet urie për:

- E) 1-2 orë.
- F) 2-6 orë.
- G) 12-24 orë.
- H) Më shumë se 24 orë.

Pyetja 10

Çfarë përfaqëson tubi i rrezeve-X?

- A) Përfaqëson pjesën në të cilën kryhet kontrolli i 3 parametrave kryesor të cilët janë: kVp, mA dhe koha.
- B) Përfaqëson procesimin e filmit radiografik pas ekspozimit nga rrezet-X.
- C) Përfaqëson gjenezën (prodhimi) e rrezeve-X.

D) Përfaqëson furnizimin me energji elektrike të aparatit të rrezeve-X

Pyetja 11

Raporti i grilës ka të bëjë me:

E) Bashkëlidhjen midis peshës së shiritave prej plumbi të grilës dhe distancës midis tyre.

F) Numrin e grilave që vendosim gjatë një ekzaminimi radiologjik.

G) Tipet e grilave që vendosim gjatë ekzaminimit radiologjik.

H) Efikasitetin e përdorimit të grilave gjatë ekzaminimit radiologjik.

Pyetja 12

Ekranet përforcuese dhe filmi radiografik janë receptor imazherik, të cilat ndodhen në:

E) Panelin e kontrollit.

F) Tubin e rrezeve X.

G) Gjenerator.

H) Kasetë.

Pyetja 13

Rrezet-X të cilat përdoren për terapinë sipërfaqësore në dermatologji, quhen:

A) Rreze Grenz.

B) Rreze difraktive.

C) Rreze diagnostike.

D) Rreze sipërfaqësore.

Pyetja 14

Rrezet-X të cilat përdoren për terapinë e indeve të thella, quhen?

E) Rreze sipërfaqësore dhe diagnostike.

F) Rreze Grenz dhe supervoltazh.

G) Rreze supervoltazh dhe orthovoltazh.

H) Rreze diagnostike dhe difraktive.

Pyetja 15

Si do të paraqitet prania e gazrave në filmin radiografik?

E) Më radio-transparente të masës fekale në zorrë.

F) Më radio-opake të masës fekale në zorrë.

G) Izoekogene me masën fekale.

H) Hiperekoike-homogjene.

Pyetja 16

Në momentin e prodhimit të rrezeve-X, u theksua se:

A) Nga frenimi i menjëhershëm i elektroneve çlirohej 99% nxehtësi dhe vetëm 1% shkojnë për formimin e rrezeve-X.

B) Nga frenimi i menjëhershëm i elektroneve çlirohej vetëm 1% nxehtësi dhe 99% shkojnë për formimin e rrezeve-X.

C) Nga frenimi i menjëhershëm i elektroneve çlirohej 50% nxehtësi dhe 50% shkojnë për formimin e rrezeve-X.

D) Nga frenimi i menjëhershëm i elektroneve çlirohej vetëm 10% nxehtësi dhe 90% shkojnë për formimin e rrezeve-X.

Pyetja 17

Në rastet kur kemi të bëjmë me një anodë të dëmtuar, rrezet-X që do të prodhohen:

- A) Janë shumë herë më të mira për diagnostikimin e pacientit pasi pacienti nuk ekspozohet nga një sasi e lartë rreze-X.
- B) Do të shpërndahen në drejtime të ndryshme për shkak të pranisë së kraterëve.
- C) Do të ulin kohën e ekspozimit të pacientit.
- D) Do të shfaqin në filmin radiografik qartësi dhe konture cilësore të organeve.

Pyetja 18

Cilat prej karakteristikave të mëposhtme janë të pranishme në njësitë radiologjike të cilat përdoren për terapi?

- E) Anodë rrotullues, zonë fokale të vogël, këndi shenjë i vogël.
- F) Anodë stacionare, zonë fokale të madhe, këndi shenjë i madh.
- G) Anodë stacionare, zonë fokale të madhe, këndi shenjë i vogël.
- H) Anodë rrotulluese, zonë fokale të vogël, këndi shenjë i madh.

Pyetja 19

Rritja e voltazhit midis katodës dhe anodës së një tubi të rrezeve-X, rrit paksa numrin e rrezeve-X të prodhuara, por më e rëndësishme nga ana radiografike është që cilësia e rrezeve-X të prodhuara do të ndryshojë. Kjo ndodh për shkak se?

- A) Elektronet janë më pak të lidhura me filamentin.
- B) Anoda ndodhet në një temperaturë tjetër.
- C) Energjia kinetike goditëse e elektroneve është e lartë.
- D) Materiali shenjë zakonisht është i vendosur në një kënd të ndryshëm.

Pyetja 20

Në rastet klinike në të cilat dyshohet dhe konfirmohet nga klienti se pacienti ka konsumuar një trup të huaj para 4 ditësh dhe ka 2 ditë më konstipacione dhe nuk mund të defekoj. Cila është metoda diagnostike me efektive për vendosjen e një diagnoze definitive duke treguar pozicionimin e trupi të huaj brenda organizmit?

- A) Ultrasonografia.
- B) Fluoroscopia.
- C) Kontrastografia.
- D) Endoskopia.

Pyetja 21

Në cilin princip fizik bazohet prodhimi i ultratingullit gjatë ekzaminimit ekografik?

- A) Elektricitetin.
- B) Piezoelektricitetin.
- C) Radioaktivitetin.
- D) Fusha magnetike.

Pyetja 22

Cilat janë mënyrat e shfaqjes së imazhit gjatë ekzaminimit ekografik?

- A) A Mode, B Mode, C Mode.
- B) B Mode, D Mode, L Mode.
- C) B Mode, C Mode, M Mode.
- D) A Mode, B Mode, M Mode.

Pyetja 23

Artefakti “Hija posterior” ndodh kur ultratingujt kalojnë në këto formacione:

- A) Gurë, kocka dhe ajër.
- B) Likide dhe gjak.
- C) Hematoma dhe inde dhjamore.
- D) Absese, eksudate dhe transudate.

Pyetja 24

Teknika Doopler është e rëndësishme veçanërisht në ekzaminimin e aparatit:

- A) Respirator.
- B) Urinar.
- C) Kardiovaskular.
- D) Tretës.

Pyetja 25

Pse është e rëndësishme përgatitja e pacientit para ekzaminimit ultrasonografik?

- A) Për të shmangur traumatizimin.
- B) Për të qetësuar kafshën.
- C) Qimet, lëkura dhe papastërtitë ndikojnë në cilësinë e imazhit.
- D) Për të shmangur përdorimin e qetësuesve.

Pyetja 26

Termi Hipoekogen në ultrasonografi përdoret për të përshkruar formacione:

- A) Me përmbajtje likuide jo të pastër me natyrë korpuskulare.
- B) Me përmbajtje të kalcifikuara.
- C) Me përmbajtje gazore.
- D) Me përmbajtje ushqimore dhe fekale.

Pyetja 27

Termi Izoekogen në ekografi përdoret për të përshkruar formacione:

- A) Me ekogjenicitet të ndryshëm me organet fqinjë.
- B) Me ekogjenicitet më të lartë se organet fqinjë.
- C) Me ekogjenicitet të njëjtë me organet fqinjë.
- D) Me ekogjenicitet më të ulët se organet fqinjë.

Pyetja 28

Për ekzaminimin e zemrës, cila është sonda më e mirë për t’u përdorur:

- A) lineare.
- B) konvekse.
- C) mikrokonvekse.
- D) sektoriale.

Pyetja 29

Cili është pozicioni i duhur i sondës gjatë ekzaminimit të mëlçisë në kafshët e shoqërimet:

- A) Duke e vendosur në vijën mediane dhe zhvendosur majtas dhe djathtas.
- B) Duke e vendosur në vijën mediane dhe drejtuar kaudalisht.
- C) Duke vendosur sondën në procesin ksifoidal dhe lëvizur majtas-djathtas dhe lart-poshtë.
- D) Duke e vendosur poshtë brinjës së fundit në krahun e majtë.

Pyetja 30

Vlerësoni ekogjenicitetin e saktë të organeve parenkimatoze të mëposhtme:

- A) Korteksi renal < Heparit < Shpretka.
- B) Heparit < Shpretka < Korteksi renal.
- C) Shpretka < Heparit < Korteksi renal.
- D) Heparit < Korteksi renal < Shpretka.

Pyetja 31

Çfarë do të vëreni gjatë ekzaminimit ekografik të fshikëzës së tëmthit në rastet kur kemi pezmatim të saj, duke ditur pamjen normale të fshikëzës së tëmthit?

- A) Trashje të mureve të fshikëzës.
- B) Lëngu i tëmthit bëhet më ekogjenik.
- C) Dilatim të mureve të fshikëzës.
- D) Pamja e fshikëzës bëhet e njëjtë më të heparit.

Pyetja 32

Kur rekomandohet fillimi i ekzaminimit ultrasonografik të barrsmërisë në qen:

- A) Nga dita 22.
- B) Nga dita 28.
- C) Nga dita 34.
- D) Nga dita 38.

Pyetja 33

Gjatë ekzaminimit ekografik të traktit gastro-intestinal trupat e huaj duken si formacione:

- A) Anekoike.
- B) Homogjene.
- C) Hiperekoike.
- D) Hipoekoike.

Pyetja 34

Çfarë janë artefaktet gjatë ekzaminimit ultrasonografik?

- A) Imazhe që nuk i përgjigjen strukturës reale të organit.
- B) Imazhe dy dimensionale të organit.
- C) Imazhe tre dimensionale të organit.
- D) Imazhe patologjike të organit.

Pyetja 35

Pse gjatë ekzaminimit të kavitetit abdominal kemi vështirësi në indentifikim e gjetjeve ekografike dhe në vendosjen e nje diagnoze definitive?

- A) Na pengon gjatësia e madhe e aparatit tretës në kavitetin abdominal
- B) Nuk kemi pajisje të duhura për ekzaminimin e kavitetit abdominal.
- C) Ka një numër të madh të anzave të zorrëve.
- D) Ka prani të mëdha të masave ushqimore, fekaleve dhe gazeve.

Pyetja 36

Gjatë ekzaminimit ekografik të kavitetit abdominal mitra në gjëndjë normale (boshe) si dallohet?

- A) Dallohet me vështirësi.
- B) Dallohet me lehtësi.
- C) Nuk dallohet.
- D) Mbulohet nga duodeni dhe fillimi i jejunumit.

Pyetja 37

Cila është pamja normale e pjesës kortikale të veshkës gjatë ekzaminimit ekografik të kavitetit abdominal?

- A) Anekoik me granula të mëdha dhe ekogjenicitet të barabartë me shpretkën.
- B) Hiperekoike me granula të imta dhe ekogjenicitet të barabartë me shpretkën.
- C) Hipoekoike me granula të imta dhe ekogjenicitet më të madh së shpretkë.
- D) Izoekogen dhe me granula të mëdha.

Pyetja 38

Për ekzaminimin e kavitetit abdominal me rekumbencë dorzale, pacienti qethet dhe pastrohet nga:

- A) Proçesi ksifoidal deri te oss pubis duke ndjekur harqet ndërbrinjore.
- B) Oss ischi deri te harqet ndërbrinjore.
- C) Pjesën kaudale të rajonit umbilikal.
- D) Sternum, harqet ndërbrinjore dhe pjesa kraniale e rajonit umbilikal.

Pyetja 39

Cila është pamja normale e fshikëzës së tëmthit gjatë ekaminimit ultrasonografik të heparit?

- A) Ndodhet brenda parenkimës së heparit dhe e çrregullt me mure hiperekoike.
- B) Ndodhet brenda parenkimës së heparit, ovale dhe me mure të holla me përmbajtje anekoike.
- C) Ndodhet e zhvendosur nga parenkima e heparit dhe me përmbajtje hipoekoike.
- D) Ndodhet e zhvendosur nga parenkima e heparit me përmbajtje hiperekoike.

Pyetja 40

Artefakti i riverberacionit ndodh kur:

- A) Ultratingujt përplasen para-mbrapa ndërmjet dy sipërfaqeve reflektive.
- B) Ultratingujt përplasen majtas-djathtas ndërmjet dy sipërfaqeve reflektive.
- C) Ultratingujt përplasen para-majtas ndërmjet dy sipërfaqeve reflektive.
- D) Ultratingujt përplasen para-djathtas ndërmjet dy sipërfaqeve reflektive.

Pyetja 41

Cila është metoda diagnostike që përdorim në rastet klinike kur duam të bëjmë evidentimin e ndonjë mase tumorale në pjesën e zorrëve të trasha të traktit gastro-intestinal?

- A) Endoskopia.
- B) Gastroskopia.
- C) Kolonoskopia.
- D) Vaginoskopi.

Pyetja 42

Metoda diagnostike e cila përdor në të njëjtën kohë dy mënyra ekzaminimi të pacientit si ekografi dhe endoskopi, quhet:

- A) Endosonografi.
- B) Endoradiologji.
- C) Endoskopia pa gjak.
- D) Endoskopia me gjak.

Pyetja 43

Metoda diagnostike e cila përdor në të njëjtën kohë dy mënyra ekzaminimi të pacientit si radiologji dhe endoskopi, quhet:

- A) Endosonografi.
- B) Endoradiologji.
- C) Endoskopia pa gjak.
- D) Endoskopia me gjak.

Pyetja 44

Çfarë do të kuptojmë me termin Laparaskopi?

- A) Ekzaminimin në kohë reale me endoskop të kavitetit torakal.
- B) Ekzaminimin në kohë reale me endoskop të kavitetit abdominal.
- C) Ekzaminimin në kohë reale me endoskop të kavitetit pelvik.
- D) Ekzaminimin në kohë reale me endoskop të artikulacioneve.

Pyetja 45

Cilat prej metodave diagnostike të mëposhtme përdoren gjatë ekzaminimit endoskopik të aparatit respirator?

- A) Rinoskopia, Ezofagoskopia dhe Trakeoskopia.
- B) Oroskopia, Trakeoskopia dhe Bronkoskopia.
- C) Rinoskopia, Trakeoskopia dhe Bronkoskopia.
- D) Trakeoskopia, Artroskopia dhe Otoskopia

5. Farmakologjia Veterinare

Pyetja 1

Cili prej α_2 -agonistëve ka selektivitetin më të madh për α_2 -receptorët:

- A) Xylazinë
- B) Detomidinë
- C) Romifidinë

D) Medetomidinë

Pyetja 2

Cili është treguesi i parë i toksicitetit të anestetikut lokal?

- A) Hipertensioni
- B) Rigjidityti muskular
- C) Dridhja e muskujve të skeletit
- D) Takikardia

Pyetja 3

Cili prej substancave të mëposhtme është antagonist i receptorit NMDA?

- A) Izoflurani
- B) Guaifenesina
- C) Etomidate
- D) Ketamina

Pyetja 4

Cila nga substancat e mëposhtme pengon aktivitetin fiziologjik në gjëdrën mbiveshkore për disa orë pas hyrjes së tyre në organizëm?

- A) Diazepami
- B) Ksilazina
- C) Etomidati
- D) Acerpromazina

Pyetja 5

Cila prej substancave të mëposhtme përdoret për kryerjen e procedurave të shpejta në anestezinë e përgjithshme parenterale?

- A) Ketamina
- B) Diazepami
- C) Tiopentali
- D) Propofoli

Pyetja 6

Cila nga substancat e mëposhtme është shumë i tretshëm në lipide me një kohëzgjatje të shkurtër veprimi?

- A) Tiopentali
- B) Pentobarbitali
- C) Methoheksitali
- D) Fenobarbitali

Pyetja 7

Në cilën prej situatave të mëposhtme klinike nuk mund të përdoret manitol 5%?

- A) Oligourisë me shkakësi traumatike.
- B) Presionit intraokular të rritur.
- C) Edemë cerebrale me shkakësi traumatike.
- D) Edemë e gjeneralizuar me origjinë kardiake.

Pyetja 8

Cilën nga terapitë e mëposhtme do të korrigjonit?

- A) Tetraciklina - Psitakoza në zogj.

- B) Lincomycin - Dizenteria e derrave.
- C) Kloramfenikol - pneumoni mykoplazmale në derra.
- D) Metronidazol - Infeksion anaerob në mace.

Pyetja 9

Cili prej kombinimeve të mëposhtme të antibiotikëve nuk përdoret në mënyrë sistemike për shkak të nefrotoksicitetit?

- A) Kanamicina, Streptomicina, Bacitracina.
- B) Polimiksina B, Bacitracina, Tiamulina.
- C) Polimiksina B, Bacitracina, Neomicina.
- D) Gentamicina, Neomicina, Rifampina.

Pyetja 10

Cili nga antinematodalët e mëposhtëm përdoren në trajtimin e giardiazës në qen?

- A) Ivermektina.
- B) Fenbendazoli.
- C) Levamisoli.
- D) Piperazina.

Pyetja 11

Cila nga antinematodalët e mëposhtëm kur përdoret në mace rrisin çlirimin e neuropeptideve frenuese?

- A) Febantel.
- B) Emodepside.
- C) Selamectin.
- D) Pyrantel pamoate.

Pyetja 12

Cili nga preparatet ka efikasitet të qëndrueshëm kundër Taenia, Dipylidium, dhe Echinococcus në qen?

- A) Praziquanteli.
- B) Diklorofeni.
- C) Fenbendazoli.
- D) Pyranteli.

Pyetja 13

Me cilin prej efekteve të mëposhtme lidhet stimulimi i $\alpha 1$ -receptorëve?

- A) Dilatimin pupilar.
- B) Vasodilatacionin.
- C) Bronkodilatacionin.
- D) Hipertrofinë kardiake.

Pyetja 14

Cili prej medikamenteve të mëposhtme shkakton dilatim pupilar, pa shkaktuar cikloplegji?

- A) Soproterenoli.
- B) Pilocarpina.
- C) Fenilefrina.
- D) Tropicamidi

Pyetja 15

Cili prej preparateve të mëposhtme do të ndryshojë efektet e oksimorfinës në receptorin μ , ndërsa ende siguron analgjezi përmes stimulimit të receptorit κ .

- A) Naloksoni.
- B) Fentanili.
- C) Tramadoli.
- D) Nalbufina.

Pyetja 16

Cilat janë efektet anësore më të shpeshta të frenuesve të prostaglandinës?

- A) Agranulocitozat.
- B) Hepatitet.
- C) Ulcerat gastrike.
- D) Anemitë.

Pyetja 17

Kur do të aplikohet më shpesh digoxina në një qen me:

- A) Kardiomiopati hipertrofike.
- B) Sëmundjen e kribave të zemrës.
- C) Kardiomiopati të zgjeruar dhe fibrilacion atrial.
- D) Perikardit.

Pyetja 18

Cili nga opsionet për agonistët α_2 -adrenergjik është i gabuar?

- A) Aplikimi në muskuj i këtyre preparateve shkakton të vjella më shpesh se në aplikimet endovenoze.
- B) Ruminantët janë më të ndjeshëm ndaj sedativëve se jo ruminantët.
- C) Ato induktojnë antidiuresis.
- D) Përdorimi i Ketaminës mund të dobësojë sinergjikisht funksionin kardiopulmonar.

Pyetja 19

Cili prej medikamenteve trajton gjendjen e epilepsisë në qen:

- A) Ketamin.
- B) Acepromazin.
- C) Etomidat
- D) Diazepam.

Pyetja 20

Cili ekspektorant, kur absorbohet, prish lidhjet disulfide brenda mukusit trakeal?

- A) Jodur kaliumi.
- B) Terbutalina.
- C) Guaifenesina
- D) N-acetilcisteina.

Pyetja 21

Cili prej antikonvulsantëve ekskretohet i pandryshuar nga veshkat?

- A) Phenobarbitali.
- B) Gabapentina.
- C) Potasium bromide.
- D) Diazepami.

Pyetja 22

Një α 2-agonist i përdorur në venë shkakton të gjitha efektet farmakologjike të mëposhtme përveç:

- A) Bradikardisë.
- B) Shtimit të motorrikës gastrointestinale.
- C) Hipertensionit kalimtar.
- D) Diurezës.

Pyetja 23

Biodisponibiliteti i karprofenit mund të shtohet nga:

- A) Shtimi i pH të urinës
- B) Përdorimi i tabletave intestinale.
- C) Përdorimi i bikarbonatit të sodiumit P/O.
- D) Mbajtja e një pH të ulët në stomak.

Pyetja 24

Cili prej medikamenteve të mëposhtme antiinflamatore vepron nëpërmjet inhibimit enzimatik proteolitik për të rikthyer humbjen e mukopolisaharideve kartilagjene që ndodh në artrite?

- A) Glukosaminoglikan polisulfat.
- B) Dimetil sulfoksid.
- C) Karprofen.
- D) Fenilbutazon.

Pyetja 25

Një vazodilatator i aplikuar në venë do të ishte më i dobishëm në trajtimin e cilave nga gjendjeve të mëposhtme?

- A) Kardiomiopatisë së zgjeruar kronike.
- B) Endokarditit.
- C) Kolapsit kardiovaskular.
- D) Regurgitacioni mitral në edemën pulmonare akute.

Pyetja 26

Rezistenca bakteriale që krijohet për shkak të aktivizimit të medikamenteve enzimike është e rëndësishme për të gjithë antibiotikët e mëposhtëm përveç:

- A) Tetraciklinës.
- B) Ampicilinës.
- C) Gentamicinës.
- D) Cephalexinës.

Pyetja 27

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me receptorët e medikamenteve është i vërtetë?

- A) Receptorët e medikamenteve luajnë një rol të rëndësishëm në biodisponibilitetin e një medikamenti.
- B) Medikamenti nuk mund të veprojë nëse nuk lirohet së pari nga një receptor.
- C) Medikamenti mund të veprojë si një antagonist edhe nëse është i lidhur me një receptor droge.

D) Medikamenti nuk mund të veprojë nëse nuk lidhen së pari me një receptor.

Pyetja 28

Mekanismi me të cilin thithen shumica e medikamenteve pas një injeksioni intramuskular është:

- A) Difuzion i thjeshtë.
- B) Transport aktiv.
- C) Pinocitoza.
- D) Difuzioni i lehtësuar.

Pyetja 29

Organi kryesor për eliminimin e medikamentit është:

- A) Truri.
- B) Mëlçia.
- C) Veshka.
- D) Shpretka.

Pyetja 30

Cila nga alternativat e mëposhtme është e saktë në lidhje me një agonist të pjesshëm?

- A) Agonisti është një medikament, i cili prodhon përgjigjen e plotë të qelizës/indeve.
- B) Agonisti është një medikament që shkakton një përgjigje, por përgjigja maksimale është më pak se përgjigja maksimale ndaj një agonisti të plotë.
- C) Agonisti është një medikament që lidhet me receptorin, duke shtypur aktivitetin e brendshëm bazal të receptorit.
- D) Agonisti është medikamenti që ka prirje të madhe për receptorin, por nuk ka aktivitet të brendshëm.

Pyetja 31

Një qen që trajtohet me fenobarbital për kontrollin e epilepsisë mund të mos i përgjigjet terapisë antifungale me griseofulvin për shkak të fenobarbitalit sepse:

- A) Formon një kompleks të patretshëm me griseo-fulvinën.
- B) Bllokon marrjen e griseofulvinës nga qelizat pararendëse të keratinës.
- C) Rrit fluksin renal të gjakut, duke shpejtuar ekskretimin e griseofulvinës.
- D) Nxit enzimat mikrosomale hepatike, duke rritur metabolizmin e griseofulvinës.

Pyetja 32

Efikasiteti miotik i pilokarpinës mund të zvogëlohet në prani të:

- A) Fenitoinës.
- B) H1-antihistaminës.
- C) Glukokortikoidëve.
- D) Barnave anti-inflamatore jo-steroidale.

Pyetja 33

Ndërveprimi farmakodinamik që rezulton në antagonizëm të medikamentit mund të shkaktohet nga administrimi i njëkohshëm i penicilinës G dhe:

- A) Cefaleksinës.
- B) Gentamicinës.
- C) Doksiciklinës.
- D) Enrofloxacinës.

Pyetja 34

Medikamentet që pengojnë metabolizmin mikrosomal të mëlçisë (metabolizmi i tipit I) nuk përfshijnë:

- A) Fenilbutazon.
- B) Ketokonazol.
- C) Kloramfenikol.
- D) Enrofloxacin.

Pyetja 35

Cili nga kombinimet e mëposhtme është kombinim i pajtueshëm farmaceutik:

- A) Amfotericina B - Desoksikolati i natriumit.
- B) Tetraciklina - Riboflavina.
- C) Ketamine HCl – Tiopental natriumi.
- D) Penicilinë G - Sulfadimetoksinë.

Pyetja 36

Reagimet negative ndaj penicilinës tek kafshët manifestohen si shenja klinike që variojnë nga gërvishtjet e lëkurës, urtikaria, riniti, bronkokonstruksioni, diarreja deri tek shoku anafilaktik kërcënues për jetën. Cila lloj alergjie ndaj medikamenteve të ndërmjetësuar nga imuniteti jep reagimet negative të përshkruara më sipër?

- A) Lloji I.
- B) Lloji II.
- C) Lloji III.
- D) Lloji IV.

Pyetja 37

Cili nga opsionet e mëposhtëm të kombinimit të medikamenteve pengon enzimat mikrosomale hepatike dhe mund të zgjasë veprimin e medikamenteve të tjera?

- A) Cimetidine dhe Lindane.
- B) Kloramfenikol dhe Griseofluvin.
- C) Ketokonazol dhe Prednizolon.
- D) Fenilbutazoni dhe Fenobarbitali.

Pyetja 38

Cili nga medikamentet e mëposhtme mund të përdoret tek macet?

- A) Cisplatina.
- B) Benzokaina.
- C) Acetaminofeni.
- D) Meloksikami.

Pyetja 39

Të gjitha medikamentet e mëposhtme mund të përdoren në doza/intervale të ulëta te qentë, përveç:

- A) Kloramfenikolit.
- B) Lidokainës.
- C) Morfinës.
- D) Gentamicinës.

Pyetja 40

Cili nga grupet e mëposhtme të medikamenteve shkakton më shumë reaksione negative tek kafshët?

- A) Qetësuesit/analgjezikët.

- B) Medikamentet kardiovaskulare.
- C) Medikamentet antiparazitare.
- D) Medikamentet antimikrobike.

Pyetja 41

Për ekzaminimin e kornesë, retinës dhe nervit optik të një qeni, cili medikament është më i përshtatshmi për zgjerimin e pupilës?

- A) Atropina.
- B) Pilocarpina.
- C) Tropikamida.
- D) Acetilkolina

Pyetja 42

Një qen është paraqitur me shenja klasike të glaukomës duke përfshirë një presion shumë të lartë intraokular prej 65 mm Hg. Për të ulur presionin intraokular administrohet manitol në venë. Cili nga medikamentet e mëposhtme do të zvogëlonte sekretimin e lëngut ujqor dhe do të siguronte parametra normale të presionit.

- A) Atropina.
- B) Pilocarpina.
- C) Demekarium.
- D) Dorzolamida.

Pyetja 43

Cila nga këto medikamente do të ishte më efektive në lehtësimin e rrjedhjes së lëngut ujqor të syrit?

- A) Latanoprost.
- B) Flurbiprofen.
- C) Pilocarpinë.
- D) Demekarium.

Pyetja 44

Me shenja të keratokonjuktivitit dhe me rezultate të testit Schirmer (2 mm në secilin sy, ku 15-25 mm është normale), çfarë medikamenti do të zgjidhni për të larguar simptomat e keratokonjuktivitit?

- A) Pomadë ciklosporine.
- B) Pilocarpinë.
- C) Prednisolon acetat.
- D) Një zëvendësues i lotit.

Pyetja 45

Idoksuridine është medikament që përdoret për trajtimin e:

- A) Glaukomës.
- B) Infeksionit herpesvirus i konjuktivës.
- C) Një keratiti fungal.
- D) Një konjuktivi klamidial.

6. Iktiopatologjia

Pyetja 1

Cili nga peshqit e listuar përdoret në modelet kërkimore shkencore?

- A) Peshku Tilapia
- B) Peshku Piranja
- C) Peshku Zebër
- D) Peshku Kuq

Pyetja 2

Në opsionet e listuara, kush është degë prodhimit në akuakulturë?

- A) Hidrokultura
- B) Krustacokultura
- C) Larvikultura
- D) Ovikultura

Pyetja 3

Në cilën fazë të prodhimit në akuakulturë, përdorim karantinën për mos hyrjen e infeksioneve në fermë?

- A) Para fillimit të ciklit të prodhimit
- B) Gjatë ciklit të prodhimit
- C) Në fund të ciklit të prodhimit
- D) Nuk ka rëndësi koha se kur

Pyetja 4

Cili është funksioni i dekantorit në fermat e kultivimit të peshqve?

- A) Përgatitjen e ushqimeve të ndryshme për peshqit
- B) Inkubimin dhe çeljen e vezëve të peshkut
- C) Ruajtjen e ushqimeve, medikamenteve dhe dezinfektantëve
- D) Precipitimin e elementëve të padëshirueshëm të ujit

Pyetja 5

Cili është funksioni i lëkurës së peshqve?

- A) Reagon si linja e parë e mbrojtjes ndaj agjentëve invadues infektivë
- B) Reagon si linja e dytë e mbrojtjes ndaj agjentëve invadues infektivë
- C) Reagon si linja e tretë e mbrojtjes ndaj agjentëve invadues infektivë
- D) Reagon si linja e katërt e mbrojtjes ndaj agjentëve invadues infektivë

Pyetja 6

Cili është funksioni i aeratorit në njësitë e kultivimi të peshqve?

- A) Dhënia e ushqimit në mënyrë të automatizuar
- B) Numërimi automatik i peshqve në ferma
- C) Dezinfektimi i ujit para përdorimit
- D) Pasurimi i ujit me oksigjen

Pyetja 7

Cili është funksioni i veshkës së përparëme?

- A) ka funksion eskretues

- B) ka funksion tretës
- C) ka funksion hematopoetik
- D) ka funksion kontrollin e gazeve

Pyetja 8

Pigmentimi i sipërfaqes lëkurore të peshqve është nën kontrollin e:

- A) Fshikëzës notuese
- B) Sistemit neuro-endokrin
- C) Qarkullimit të gjakut
- D) Traktit tretës

Pyetja 9

Si duhet të kryhet transporti i mostrës peshk i ngordhur për analizim laboratorik?

- A) Në kontakt me akull të thatë
- B) Në qese të mbushur me ujë
- C) Në qese të mbushur me ajër
- D) Nuk ka rëndësi si kryhet

Pyetja 10

Në cilin drejtim e kryejmë kruajtjen e lëkurës për procedurën e biopsisë së saj?

- A) Kaudal-kranialisht
- B) Ventro-dorzalisht
- C) Latero-ventralisht
- D) Kranio-kaudalisht

Pyetja 11

Cili është funksion i lëkurës së peshqve?

- A) Redukton rezistencën duke siguruar fërkim të butë
- B) Rrit rezistencën duke siguruar fërkim të lartë
- C) Barrierë e përshkrushme për lëngjet dhe kripën
- D) Nuk reagon në mbrojtje ndaj agjentëve të ndryshëm

Pyetja 12

Dëmtimi i lamelave primare çon në shfaqjen e:

- A) Shenjave nervore
- B) Deformimit të skeletit
- C) Ulje e shkëmbimit të gazeve
- D) Errozion të pendëve

Pyetja 13

Kush është shkak për deformimin e skeletit të peshqve?

- A) Mungesa e acidit folik
- B) Mungesa e acidit askorbik
- C) Mungesa e acidit nikotinic

D) Mungesa e biotinës

Pyetja 14

Cilin nga anestetikët e listuar përdorim në Iktiopatologji?

- A) Zolazepamin
- B) Propofolin
- C) Ketaminën
- D) Trikainën

Pyetja 15

Testi i floreshencës në iktiopatologji aplikohet për:

- A) Identifikimin e hershëm të ulçerave
- B) Identifikimin gjenetik bakteriologjik
- C) Identifikimin gjenetik virologjik
- D) Identifikimin gjenetik mykotik

Pyetja 16

Në cilën fashë temperaturash inkubojmë kulturat bakteriale në iktiopatologji?

- A) 10 - 15°C
- B) 17 - 27°C
- C) 27 - 32°C
- D) 32 - 37°C

Pyetja 17

Qendrat melanomakrofage i konsiderojmë si:

- A) Indikatorë të riprodhimit
- B) Indikatorë të maturimit seksual
- C) Indikatorë të stresit kronik
- D) Indikatorë të tumoreve

Pyetja 18

Në cilën fashë temperature metabolizmi bazal i peshqve është më i lartë?

- A) 05 - 10°C
- B) 10 - 15°C
- C) 15 - 20°C
- D) 20 - 25°C

Pyetja 19

Cila nga mënyrat e vaksinimit të peshqve prodhon mbrojtjen imunitare më të mirë?

- A) Vaksinimi me banjëzim
- B) Vaksinimi intra-peritoneal
- C) Vaksinimi me ushqim
- D) Vaksinim konjuktival

Pyetja 20

Çfarë nënkupton termi “biosiguri” në iktiopatologji?

- A) Tërësinë e masave që garantojnë mosfutjen e infeksionit në fermë
- B) Tërësia e masave që garantojnë mosfutjen e njerëzve në fermë
- C) Tërësia e masave që garantojnë mosfutjen e kafshëve në fermë
- D) Tërësia e masave që garantojnë mosfutjen e shpendëve në fermë

Pyetja 21

Cilin nga elementet kimikë të listuar përdorim si dezinfektant në akuakulturë?

- A) Oksid nitrik
- B) Sulfur carbonil
- C) Acid sulfurik
- D) Formaldehida

Pyetja 22

Kundra kujt i përdorim probiotikët në iktiopatologji?

- A) Infeksioneve virale
- B) Infeksioneve parazitare
- C) Infeksioneve bakteriale
- D) Nuk përdoren në iktiopatologji

Pyetja 23

Cili nga elementët e poshtëshënuar i përket mbrojtjes specifike?

- A) Limfocitet
- B) Makrofaget
- C) Komplementi
- D) Lizocima

Pyetja 24

Çfarë nënkupton sistemi HACCP për fermat e akuakulturës?

- A) Analiza Rezikut dhe Kontrolli i Pikave Kufitare
- B) Analiza Rezikut dhe Praktikat e Mira të Punës
- C) Analiza Rezikut dhe Kontrolli i Praktikave të Punës
- D) Analiza Rezikut dhe Kontrolli i Pikave Kritike

Pyetja 25

Cili metal i rëndë prodhon keqformime mbas çeljes së vezëve?

- A) Cadmiumi
- B) Kromi
- C) Plumbi
- D) Seleni

Pyetja 26

Cili nga elementët e listuar shkakton patologjinë e Nefrolithiasis?

- A) Cd
- B) Cu
- C) Ca
- D) Fe

Pyetja 27

Cilin nga elementët e listuar përdorim për neutralizimin e viruseve?

- A) Trikainë
- B) Formalinë
- C) Metronidazol
- D) Eugeol

Pyetja 28

Si e klasifikojmë sëmundjen e Strawberry bazuar shkaktarit të saj?

- A) Idiopatike
- B) Virale
- C) Bakteiale
- D) Parazitare

Pyetja 29

Cila nga sëmundjet e mëposhtëme është e detyrueshme të raportohet në OIE?

- A) Sëmundja e Pikave të bardha
- B) Sëmundja e Saprolenjës
- C) Sëmundja Strawberry
- D) Nekroza Hemopoetike Infektive

Pyetja 30

Me çfarë shenjash paraqitet sëmundja e Gojës së Kuqe?

- A) Forunkula në sipërfaqjen lëkurore
- B) Hemorragji në kokë, pendë dhe vrimën anale
- C) Ulçera në sipërfaqjen lëkurore
- D) Shenja nervore dhe deformim të skeletit

Pyetja 31

Cili është organi që dëmtohet në sëmundjen e Sestnozës?

- A) Trakti tretës
- B) Fshikëza notuese
- C) Velëzat
- D) Veshkat

Pyetja 32

Cili është shkaku i shfaqjes së sëmundjes së Bulave të gazit?

- A) Mbingopje e ujit me gaze
- B) Pamjaftueshmëri gazesh në ujë

- C) Shkaktar bakterial
- D) Shkaktar viral

Pyetja 33

Çfarë shkakton te peshqit pamjaftushmëria e aminoacideve në racionet ushqimore?

- A) Verbime
- B) Vonesa në rritje
- C) Diare
- D) Shenja nervore

Pyetja 34

Çfarë shkakton te peshqit mungesa e Triptofanit në racionet ushqimore?

- A) Skoliozë të kolonës vertebrale
- B) Verbime
- C) Kostipacione
- D) Shenja nervore

Pyetja 35

Cilat janë shenjat që paraqesin peshqit nga Degjenerimi yndyror i mëlçisë?

- A) Shenja nervore dhe notim spiralor
- B) Veshka të rrumbullakosura
- C) Stomak dhe zorrë të tejmbushura me ushqim
- D) Anemi dhe zemër të rrumbullakosur ngjyrë bronxi

Pyetja 36

Cila është pasojë e sëmundjes së Gushës endemike?

- A) Defiçensa të acideve yndyrore në organizëm
- B) Sufiçensa të vitaminave në organizëm
- C) Defiçensa të mineraleve në organizëm
- D) Sufiçensa të mineraleve në organizëm

Pyetja 37

Cili është myku i listuar me poshtë që prodhon aflatoksinën?

- A) Saprolegnia eccentrica
- B) Aspergillus flavus
- C) Ichthyophonus hoferi
- D) Flavobacterium columnare

Pyetja 38

Cila është baza e të ushqyerit që nxit shfaqjen e sëmundjes Sekoke?

- A) Tuli i kristalinës së kribave të mëndafshit
- B) Tuli i kristalinës së kërmijve të tokës
- C) Tuli i kristalinës së kribave të tokës
- D) Tuli i molusqeve bivalvë

Pyetja 39

Myxobolus cerebralis në peshq ka tropizëm për:

- A) Velëzat
- B) Traktin tretës
- C) Sistemin nervor
- D) Kavitetin celomik

Pyetja 40

Biotoksina që shkakton Helmimin diarretik nga midhjet prodhohet nga:

- A) Bakter
- B) Virus
- C) Myqe
- D) Alga

Pyetja 41

Cila nga sëmundjet e mëposhme është zoonotike?

- A) Forunkuloza
- B) Vibriozat
- C) Goja e kuqe
- D) Streptokokozat

Pyetja 42

Cili është shkaktari i sëmundjes së Gojës së kuqe?

- A) *Vibrio parahaemolyticus*
- B) *Yersinia ruckeri*
- C) *Haemophilus influenzae*
- D) *Staphylococcus epidermidis*

Pyetja 43

Cili është shkaktari i sëmundjes së forunkulozës në peshq?

- A) *Vibrio anguillarum*
- B) *Yersinia ruckeri*
- C) *Streptococcus iniae*
- D) *Aeromonas salmonicida*

Pyetja 44

Paraziti *Diphyllbothrium latum* në peshq ka tropizëm për:

- A) Velëza
- B) Sistemin nervor
- C) Traktin tretës
- D) Sipërfaqjen lëkurore

Pyetja 45

Shkaktari i Nekrozës hemopoetike infektive i përket familjes:

- A) Rhabdoviridae
- B) Hepadnaviridae
- C) Spiraviridae
- D) Ascoviridae

Pyetja 46

Renibacterium salmoninarum ka tropizëm në peshq për:

- A) Veshkën e përparme
- B) Veshkën e pasme
- C) Fshikëzën notuese
- D) Mëlçinë

Pyetja 47

Sëmundja e Forunkulozës paraqitet me:

- A) Dëmtime të lëkurës
- B) Hemorragji në velëza
- C) Shenja nervore
- D) Deformim të skeletit

Pyetja 48

Cili nga speciet e gjinisë Anisakis, përbën rëndësi për shëndetin publik?

- A) A. pegreffii
- B) A. Schupakovi
- C) A. typical
- D) A. Simplex

Pyetja 49

Për trajtimin kundra Dactylogyrus përdorim:

- A) Deksametazon
- B) Solucion Jodi
- C) Oksitetraciklinë
- D) Metronidazol

Pyetja 50

Diphyllobothrium latum shkakton në organizmin e peshkut mungesë të:

- A) Vitaminës C
- B) Vitaminës B₁₂
- C) Vitaminës E
- D) Vitaminës K

Pyetja 51

Anisakis simplex në peshq ka tropizëm për:

- A) Velëzat

- B) Sistemin nervor
- C) Traktin tretës
- D) Sipërfaqjen lëkurore

Pyetja 52

Cili është shkaktari i Sëmundjes së pikave të bardha

- A) Ichthyophthirius multifiliis
- B) Aeromonas salmonicida
- C) Ergasilus sieboldi
- D) Flavobacterium columnare

Pyetja 53

Gyrodactylus sp. janë parazitë që vendosen në:

- A) Aparatin tretës
- B) Intesticium
- C) Lëkurë
- D) Fshikëza notuese

Pyetja 54

Dactylogyridët janë parazitë që vendosen në:

- A) Aparatin tretës
- B) Intesticium
- C) Lëkurë
- D) Velëza

Pyetja 55

Cili është faktori që ndikon në shfaqjen e Ichthyophthirius multifiliis?

- A) Mbingopja e ujit me gaze
- B) Temperatura e lartë e ujit
- C) Temperatura e ulët e ujit
- D) Ulja imunitare e peshqve

Pyetja 56

Sa është numri i gremçave në diskun fiksues të Gyrodactylus sp.?

- A) 8 gremça
- B) 14 gremça
- C) 16 gremça
- D) 18 gremça

Pyetja 57

Cili nga parazitët e listuar shkakton sëmundje zoonotike?

- A) Ergasilus sieboldi
- B) Diphyllbothrium latum
- C) Ichthyophthirius multifiliis

D) Myxobolus cerebralis

Pyetja 58

Sa është numri përgjithshëm i gremçave fiksues të Trichodina sp.?

- A) 6 deri në 12
- B) 14 deri në 22
- C) 24 deri në 27
- D) 28 deri në 32

Pyetja 59

Myxobolus cerebralis është përgjegjës për:

- A) Hemoragji petekiale në fshikëzën notuese
- B) Notim spiralor dhe deformim të kolonës vertebrale
- C) Hemoragji petekiale në pendën kaudale
- D) Plagë në velëza dhe vrimën anale

Pyetja 60

Shkaktari i Viremisë pranverore të krapit i përket familjes:

- A) Rhabdoviridae
- B) Ascoviridae
- C) Spiraviridae
- D) Coronaviridae

7. Sëmundjet e Kafshëve të Egra dhe Bletës

Pyetja 1

Cilat janë popullatat e gjitarëve të egër që rrezikojnë zhdukjen nga sëmundjet?

- A) Popullatat e mëdha të gjitarëve të egër
- B) Popullatat e introduktuara (popullatat e sjella nga një vend tjetër)
- C) Popullatat e prekura nga sëmundje parazitare
- D) Popullatat me numër të reduktuar.

Pyetja 2

Në menaxhimin e sëmundjeve të botës së egër, mund të paraqiten edhe situata, që quhen "Kriza menaxhimi". Në cilin rast paraqiten ato:

- A) Moskryerja e vaksinimit për gjitarët jo të egër.
- B) Vaksinimi i gjitarëve të egër natën
- C) Mospërfshirja e gjithë arealit (sipërfaqes) ku gjenden kafshët e egra
- D) Mungesa e mbështetjes me medikamente mjekuese

Pyetja 3

Në prefekturën X, gjatë vitit 2021 u realizua survejsimi për Ethet Hemorragjike në popullatën e lepujve të egër, duke programuar numrin e kampioneve, numrin e lepujve të egër që u kapën dhe kostot. Cili survejsim është aplikuar?

- A. Survejsimi pasiv
- B. Survejsimi aktiv

- C. Survejimi aktiv dhe pasiv
- D. Survejimi skanografik

Pyetja 4

Në prefekturën Y shpërtheu influencë aviare H5N8 në shpendët e egër. Shërbimi veterinar vendosi karantinën dhe mori kampione në disa shpendë të egër. Për çfarë survejimi bëhet fjalë?

- A. Survejim pasiv
- B. Survejim aktiv
- C. Survejim aktiv dhe pasiv
- D. Survejimi i objektivizuar

Pyetja 5

“Spill over” është:

- A) Përhapja e sëmundjeve brenda popullatës të një specie
- B) Përhapja e sëmundjes nga një specie në speciet e tjera të egra
- C) Përhapja e sëmundjes në një numër të vogël kafshësh të ega
- D) Përhapja e sëmundjes në një specie të caktuar kafshësh brenda një rezervuari kafshësh të egra

Pyetja 6

Survejimi i sëmundjeve tek kafshët është me kosto më të lartë në:

- A) Kafshët e domestikuara
- B) Kafshët e fermave
- C) Kafshët e egra
- D) Kafshët e zooparqeve

Pyetja 7

Deri tani, metoda më e mirë e kontrollit të sëmundjeve në popullatë mbetet?

- A) Mjekimi i popullatave të sëmura
- B) Vaksinimi i popullatave të infektura
- C) Depopullimi i rezervateve të kafshëve të prekura
- D) Mjekimi nëpërmjet ajrit

Pyetja 8

OIE (Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve) ka identifikuar disa probleme në planin ndërkombëtar mbi strategjinë e survejimit të sëmundjeve të kafshëve të egra. Identifiko njëjërën prej tyre.

- A) Mungesa e mjeteve laboratorike moderne
- B) Mungesa të skemave mjekuese
- C) Mungesa të strukturave qeveritare për survejimin e sëmundjeve të kafshëve të egra
- D) Mungesa e koordinimit të specialistve

Pyetja 9

Nëse në një zoopark, është identifikuar Tërbimi në karnivoret e egër, atëhere rekomandohet:

- A) Mjekimi i karnivorëve të mbetur
- B) Vaksinimi i karnivorëve në zoopark
- C) Eliminimi i të gjithë karnivorëve
- D) Mbyllja e përkohshme e zooparkut dhe vaksinimi i kafshëve të zooparkut

Pyetja 10

Amfibët kanë riprodhim:

- A) Të brendshëm
- B) Të jashtëm
- C) Të jashtëm dhe të brendshëm
- D) Varet nga specia

Pyetja 11

Amfibët preken nga shumë patogjenë. Cila është ajo lloj kërpudhe, që është identifikuar kohët e fundit, e cila po zhduk popullatat e amfibëve në gjithë botën?

- A) Saprolenja ferveks
- B) Chytridiomycetes
- C) Candidozat
- D) Aspergiloza

Pyetja 12

Gjarprinjtë shumohen nëpërmjet pjelljes së:

- A) Pjelljes së vezëve
- B) Pjelljes së vezëve dhe tek disa të tjerë edhe me anë të gjarpërinjve të vegjël
- C) Pjelljes së gjarpërinjve të vegjël
- D) Pjelljes vetëm të larvave të tyre

Pyetja 13

Gjarprinjtë mund të dëgjojnë tinguj me më pak se 600 Hz sepse:

- A) Kanë vesh të jashtëm
- B) Kanë membranë të daullës dhe vesh të mesëm
- C) Kanë yzengjia (gropa e brendshme e veshit) është në kontakt direkt me kockën katrore, duke transmetuar dridhjet
- D) Kanë sistem të panjohur dëgjimi

Pyetja 14

Zvarranikët e zooparqeve preken nga disa sëmundje. Cila është një prej vizozave mjaft mortale për zvarranikët?

- A) Herpesvirusët
- B) Adenovirusët
- C) Sëmundja e IBD ose Retrovirozat
- D) Iridoviruset

Pyetja 15

Enteriti viral i rosave (murtaja e rosave DVE) shkaktohet nga:

- A) Paramyxovirusët
- B) Herpesvirusët
- C) Myksovirusët
- D) Nuk i njihet shkaktari

Pyetja 16

“Qullosja e këmbëve” tek shpendët e egra në zooparqe, apo ata në robëri, është një sindromë që shkaktohet nga:

- A) Agjent viral

- B) Agjent parazitar
- C) Agjent viral, parazitar dhe mikrobik
- D) Agjent degjenerues

Pyetja 17

Cila nga përgjigjet e mëposhtme është e saktë për histoplazmozën:

- A) Sëmundje joinfektive
- B) Sëmundje virale zoonotike
- C) Sëmundje mikrobike joozonotike
- D) Sëmundje kërpudhore që prek shpendët e egër dhe njeriun

Pyetja 18

Antraksi përgjithësisht nuk i prek shpendët e egër. Cili është një prej shpendëve të zooparqeve që preket nga antraksi?

- A) Shqiponja
- B) Bufi
- C) Struci
- D) Pëllumbi

Pyetja 19

Cili nga shpendët e mëposhtëm shërben si rezervuar të Virusit të Nilit Perëndimor?

- A) Shqiponja
- B) Sorra
- C) Pulbardha
- D) Kanarina

Pyetja 20

Quket Gripi i shpendëve, ai që shkaktohet nga:

- A) H5N1
- B) H5N8
- C) H5N2
- D) Të gjithë nëntipet e mësipërm

Pyetja 21

Cila nga sëmundjet e mëposhtme shkakton Ethet e papagajve?

- A) Cirkovirozën
- B) Paramykovirozën
- C) Klamidiazën
- D) Salmonelozën

Pyetja 22

Gjatë vitit 2021, nga shpendët shtegëtar u përhap tek shpendët e oborreve influenza:

- A) H5N1
- B) H5N8
- C) H5N7
- D) H1N3

Pyetja 23

Pseudopesti në pëllumbat në zooparqe mund të parandalohet nëpërmjet:

- A) Vaksinit të pëllumbave
- B) Mjekimit paraprak të pëllumbave
- C) Izolimit të popullatës së pëllumbave për 3 javë deri në zhdukjen e infeksionit
- D) Veçimit të pëllumbave të sëmurë

Pyetja 24

Rodentët e egër (brejtësit) preken nga disa sëmundje, një pjesë e të cilave janë zoonotike. Cila prej sëmundjeve të mëposhtme është e transmetueshme edhe tek njerëzit:

- A) Faciloza
- B) Hantaviroza
- C) Nekrobaciloza
- D) Sëmundja e Tyzzer-it

Pyetja 25

Ivermectina është një preparat që përdoret tek rodentet për trajtimin e sëmundjeve të:

- A) Hantavirozës
- B) Xhiardiozës
- C) Tularemisë
- D) Salmonelozës

Pyetja 26

Cili virus mund të infektojë minjtë dhe hamsterat dhe është i transmetueshëm tek njeriu:

- A) Virusi i Sendait
- B) Virusi i Koriomeningiti Limfocitar (LCMV)
- C) Virusi i hepatitit të minjve
- D) Virusi cowpox

Pyetja 27

Staza gastrike në lepuj shkaktohet nga:

- A) Infeksione bakteriale dhe virale të sfinterit pylorik
- B) Nga shkaktarë të panjohur
- C) Nga faktorë gjenetik, që riaktivizohen kur lepujt kapen rob
- D) Trikobenzuaret (gurët) të shkaktuar nga qimet, gëzof, leshi ose pjesë pambuku

Pyetja 28

Cila nga sëmundjet shkakton në trupin e lepurit absese subkutan:

- A) Kolibaciloza
- B) Pastereloza
- C) Tularemia
- D) Salmoneloza

Pyetja 29

Cila është rruga e infektimit të njeriut me Tularemi, nga lepujt e egër?

- A) Nëpërmjet ujit
- B) Nëpërmjet ekskrecioneve të jargëve
- C) Nëpërmjet pickimit të kërpushave në bashkëjetesë me lepujt e sëmurë
- D) Nga paisjet në kontakt me lepujt e egër

Pyetja 30

Cilat nga sëmundjet e mëposhtme të popullatave të lepujve të egër është zoonotike?

- A) Sëmundja hemorragjike (sëmundja e calcivirusëve)
- B) Myksomatoza
- C) Fibroma Virale (fibroma Shope)
- D) Tularemia

Pyetja 31

Vaksinimi kundër tërbimit është efektiv kur:

- A) Realizohet në karnivorët e egër
- B) Realizohet në lakuriqët e natës
- C) Vaksinohen karnivorët dhe lakuriqët e natës
- D) Vaksinohen vetëm kafshët e sëmura

Pyetja 32

Përqendrimi më i lartë i virusit të tërbimit është në jargët:

- A) Dhelprave të kuqe
- B) Ujqërve
- C) Qelbësave (Vjedullave)
- D) Lakuriqëve të natës

Pyetja 33

Cila nga popullatat e mëposhtme i nënshtrohet vaksinimit kundër tërbimit, sipas skemave të OIE (Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve)?

- A) Lakuriqët e natës
- B) Karnivorët e egër
- C) Rodentët e egër
- D) Lagomorfëve

Pyetja 34

Cila është sëmundja virale që prek lakuriqët e natës:

- A) Tërbimi
- B) Sindromi i hundës së bardhë
- C) Histoplazmoza
- D) Dermatofitoza

Pyetja 35

Është transmetues i tërbimit:

- A) Lakuriqi i rendit Chiroptera
- B) Lakuriqi i rendit Mokola
- C) Lakuriqi i natës i grupit Chiroptera dhe Mokola
- D) Lakuriqi i natës Vampir dhe jo specie të tjera të lakuriqëve të natës

Pyetja 36

Kanidët e zooparqeve duhet domosdoshmërisht të vaksinohen për:

- A) Tërbimin
- B) Salomonelozën
- C) Inflencën A
- D) Koksidiozën

Pyetja 37

ASF (Murtaja Afrikane e derrave të egër) është një sëmundje që po redukton popullatat e derrave të egër në Evropë. Është ajo një sëmundje:

- A) Infektive zoonotike
- B) Infektive e panjohur
- C) Infektive jozoonotike
- D) Jo infektive, jo zoonotike

Pyetja 38

Është sëmundje zoonotike e primatëve:

- A) Hepatiti A
- B) Dermatiti
- C) Nefritis
- D) Toksoinfeksionet alimentare

Pyetja 39

Gjatë gjetisë të kafshëve të egra, duhet të:

- A) Mos hapet dhe pastrohet kaviteti abdominal i kafshës së gjuajtur
- B) Hiqen organet e brendshme me përjashtim të mëlçisë dhe veshkave
- C) Hiqen organet e brendshme të gjitha dhe të vendoset akull në kavitetin abdominal, nëse temperatura është mbi 18,3⁰C
- D) Hiqen organet me përjashtim të veshkave

Pyetja 40

Mushkonjat (kryesisht ato të familjes Corvidae), pasi pickojnë shpendët e egër, të cilët janë rezervuar të VWN (Virusi i Etheve të Nilit Perëndimor), mund ta transmetojnë atë tek njerëzit (gjahtarët janë më të ekspozuar). Cila është periudha e shpërthimit të sëmundjes tek njerëzit (gjahtarët)?

- A) Pas 10-14 ditësh
- B) Pas 5-6 ditësh
- C) Pas 7-8 ditësh
- D) Pas 3-4 ditësh

Pyetja 41

Në zonën A popullata e kafshëve të egra, rezultoi e infektuar nga një sëmundje infektive. Për të mbrojtur zonën B dhe zonën C, u aplikua metoda e krijimit të një zone buferike. Kjo zonë buferike u krijua midis:

- A) zonës A dhe C
- B) zonës B dhe C
- C) zonës A dhe B
- D) të tre zonave

Pyetja 42

Pesta Amerikane është sëmundje:

- A) Virale
- B) Bakteriale
- C) Parazitare
- D) Alimentare

Pyetja 43

Akarapitoza është sëmundje:

- A) Bakteriale
- B) Mykotike
- C) Parazitare
- D) Virale

Pyetja 44

Me cilën nga sëmundjet mund të ngatërrohet Nozematoza?

- A) Varroatoza
- B) Akarioza
- C) Pesta Amerikane
- D) Aspergilioza

Pyetja 45

Cila nga sëmundjet e mëposhtme shkaktohet nga virusët në bletë?

- A) Pesta Amerikane
- B) Diarreja pranverore
- C) Nozematoza
- D) Qeskat larvare të varura

Pyetja 46

Gjatë muajt Qershor është bërë spërkatja me pesticide në një zonë ku gjendet një park me bletë. Në cilin rast ka ndodhur helmimi i bletëve?

- A) Ishin vendosur 6 km larg vendit të spërkatjes.
- B) Ishin vendosur 8 km larg vendit të spërkatjes
- C) Ishin vendosur 4 km larg vendit të spërkatjes
- D) Ishin vendosur 9 km larg vendit të spërkatjes

Pyetja 47

Cila është sëmundjet virale tek Krimbat e Mëndafshit?

- A) Nozema
- B) Septisemia larvare
- C) Flasheria
- D) Diarreja

Pyetja 48

Shfaqja e fenomenit të rënjes së qimeve tek bleta lidhet me:

- A) Pestën Amerikane
- B) Pestën Evropiane
- C) Pestën Amerikane dhe Pestën Evropiane
- D) Virozat

Pyetja 49

Një bletar me përvojë, gjatë kontrollit të parë në pranverë, nëse nuk gjen Mbretëshën në koshere, dyshon për sëmundjen e:

- A) Varroatozës
- B) Akarapitozës
- C) Pestës Amerikane
- D) Nozematozës

Pyetja 50

Bletët flutojnë larg koshereve në një distancë deri në:

- A) 3 km
- B) 5 km
- C) 9 km
- D) 10 km

Pyetja 51

Pesta Amerikane dhe Pesta Evropiane janë sëmundje të:

- A) Bletëve të rritura
- B) Gjeneratës së bletëve
- C) Edhe të gjeneratës dhe bletëve të rritura
- D) Nuk ka lidhje me gjeneratën apo bletët e rritura

Pyetja 52

Pesta Amerikane prek larvat e:

- A) Vulosura
- B) Pavulosuara
- C) Vulosura dhe të pavulosura
- D) Sapoçelura

Pyetja 53

Ndryshimi i pozicionit të larvave në qelizë dhe përdredhja e tyre, tregon për prezencën e :

- A) Pestës Amerikane
- B) Paralizës virale të krahëve
- C) Akarapitozës
- D) Pestës Evropiane

Pyetja 54

U gjenden disa bletë të vdekura dhe disa me trompe të nxjerra përjashta dhe trup të pudrosur, përpara verandës. Bëhet fjalë për:

- A) Prezencën e Varroatozës
- B) Prezencën e Akariozës
- C) Helmimet nga Poleni
- D) Helmimet nga Klororganikët

Pyetja 55

Cila nga sëmundjet e mëposhtme është mykotike:

- A) Nozematoza.
- B) E keqa e zezë
- C) Askosferoza
- D) Akarioza

Pyetja 56

Në cilën fazë të zhvillimit të Krimbit të Mëndafshit ndodh thurja e mëndafshit:

- A) Faza e daljes së flutrës
- B) Faza e kristalidës
- C) Faza e parë larvare
- D) Faza e dytë larvare

Pyetja 57

Një bletar ka vëzhguar se në kosheret e bletëve, mbretëresha prodhon vezë por ato nuk çelin.

Në këtë rast bëhet fjalë për prezencë të:

- A) Sëmundjeve virale në koshere
- B) Sëmundjeve parazitare
- C) Helmimeve nga klor dhe fosfororganikët
- D) Sëmundjeve mykotike

Pyetja 58

Cikli biologjik i Nozematozës zgjat deri në:

- A) 6-7 ditë
- B) 10-14 ditë
- C) 15-20 ditë
- D) 21-26 ditë

Pyetja 59

Në kosheren e bletës është identifikuar që ka vetem bletë meshkuj. Përse bëhet fjalë?

- A) Mbretëresha është e sëmurë
- B) Nuk ka mbretëreshë ose ka vdekur
- C) Nuk bëhet fjalë për asnjë nga dy të parat
- D) Është futur mbretëreshë tjetër në koshere

Pyetja 60

Varroatoza është një prej sëmundjeve më shkatërruese në bletë. Cila është perioda më e përshtatshme për të kryer mjekimin e nevojshëm për të siguruar mbrotjen e kosheres?

- A) Në pranverën e hershme
- B) Para futjes në dimërim
- C) Në fillim të pranverës dhe para dimërimit
- D) Në vjeshtë

Pyetja 61

Pesta Europiane prek larvat e:

- A) Vulosura
- B) Pavulosuara
- C) Vulosura dhe të pavulosura
- D) Sapoçelurat

8. Etologjia dhe Mirëqenia e Kafshëve

Pyetja 1

Mirëqenia e kafshëve është koncept që është trajtuar për herë të parë në:

- A) Itali.
- B) Nigeri.
- C) Britani të Madhe.
- D) Amerikë.

Pyetja 2

Prof John Webster (Universiteti i Oxfordit) formulon për mirëqenien e kafshëve :

- A) 3 liri.
- B) 4 liri.
- C) 5 liri.
- D) 6 liri.

Pyetja 3

Mirëqënia e kafshëve është e trajtuar në ligjin:

- A) Mbi ushqimin.
- B) Mbi veterinarinë.
- C) Mbi identifikim regjistrimin.
- D) Mbi peshkimin.

Pyetja 4

Prof John Webster (Universiteti i Oxfordit) formulon për mirëqënien e kafshëve:

- A) 3 parime.
- B) 4 parime.
- C) 5 parime.
- D) 6 parime.

Pyetja 5

Mirëqënia e kafshëve ka të bëjë me:

- A) Statusin mental.
- B) Statusin fiziologjik dhe biologjik
- C) Statusin emotiv.
- D) Të treja së bashku.

Pyetja 6

Libri i Bardhë 2000 është përmbledhje e legjislacionit:

- A) Shqipëtar.
- B) Amerikan.
- C) Europian.
- D) Aziatik.

Pyetja 7

Periudha e bronzit (2600-1900 para krishtit) ishte teoria që “ku çdo njeri pas vdekjes, shpirti i kalonte tek kafshët”-është baza e grupimit religjioz:

- A) Jein.
- B) Hindu.
- C) Musliman.
- D) Hebraik.

Pyetja 8

Papirusi i Kahunit dhe elemntët e para mbi mirëqënien janë përgatitur para:

- A) 4000 vjetësh.
- B) 2000 vjetësh.
- C) 1900 vjetësh.
- D) 450 vjetësh.

Pyetja 9

Shërbimi veterinar dhe mirëqënia e kafshëve në nivel botëror ka kaluar në:

- A) 3 faza.
- B) 6 faza.
- C) 4 faza.
- D) 5 faza.

Pyetja 10

Shërbimi veterinar dhe së bashku me mirëqënien e kafshëve i Shqipërisë ka kaluar në:

- A) 3 faza.
- B) 6 faza.
- C) 4 faza.
- D) 5 faza.

Pyetja 11

Ligji ku flitet mbi mirëqënien e kafshëve miratohet nga:

- A) Parlamenti.
- B) Presidenti.
- C) Kryeministri.
- D) Ministri.

Pyetja 12

Një akt nënligjor mbi mirëqënien e kafshëve miratohet nga:

- A) Parlamenti.
- B) Presidenti.
- C) Kryeministri.
- D) Ministri.

Pyetja 13

Autoriteti veterinar mbi mirëqënien e kafshëve është i vendosur në:

- A) AKU.
- B) AKVMB.
- C) Në Ministrinë e Bujqësisë.
- D) Në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Pyetja 14

Manifesti i parë mbi kujdesin për kafshët është bërë nga:

- A) John Webster.
- B) Bilal Golemi.
- C) Richard Martin.
- D) Claude Borgelot.

Pyetja 15

Në 27 dhjetor 2007, nga 27 vende të BE, u firmos traktati mbi mirëqënien e kafshëve në:

- A) Romë.
- B) Lisbonë.
- C) Berlin.
- D) Gjenevë.

Pyetja 16

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar në RSH flet për Mirëqënien e kafshëve:

- A) Neni 19.

- B)Neni 65.
- C)Neni 84.
- D)Neni 87.

Pyetja 17

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar në RSH flet për përgjegjësitë e pronarëve të kafshëve për mirëqënien e tyre:

- A)Neni 19.
- B)Neni 65.
- C)Neni 84.
- D)Neni 66.

Pyetja 18

Regjistri i mjekimit të kafshëve duhet ligjërisht të ruhet për:

- A)1 vit.
- B)3 vjet.
- C)5 vjet.
- D)10 vjet.

Pyetja 19

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për kafshët e eksperimentit:

- A)65.
- B)66.
- C)67.
- D)68.

Pyetja 20

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për trajtimin në therje të kafshëve:

- A)65.
- B)66.
- C)67.
- D)68.

Pyetja 21

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për komisionin shtetëror të PMV-ve :

- A)65.
- B)66.
- C)70.
- D)88.

Pyetja 22

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për eutonazinë e kafshëve:

- A)65.
- B)66.
- C)67.
- D)70.

Pyetja 23

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për fazat e eutonazisë:

- A)65.

- B)66.
- C)70.
- D)71.

Pyetja 24

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për transportin e kafshëve:

- A)65.
- B)66.
- C)70.
- D)72.

Pyetja 25

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për sigurimin e kushteve të kafshëve:

- A)65.
- B)66.
- C)74.
- D)75

Pyetja 26

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për rregullat për mirëqënien e kafshëve të egra:

- A)65.
- B)66.
- C)75.
- D)80.

Pyetja 27

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar citon rregullat për “Veprime që bien ndesh me mirëqënien e kafshëve”:

- A)65.
- B)66.
- C)76.
- D)80.

Pyetja 28

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për ushtrimin e kontrolleve për mireqënien e kafshëve:

- A)65.
- B)66.
- C)77.
- D)80.

Pyetja 29

Vula e mjekut veterinar për mirëqënien e kafshëve miratohet nga:

- A)AKU-ja.
- B)AKVMB-ja.
- C)ISUV.
- D)Komisioni shtetëror i PMV-ve.

Pyetja 30

Rregullorja mbi transportin e kafshëve ka nr:

- A)365.
- B)345.
- C)354.
- D)380.

Pyetja 31

Guida ndërkombëtare e mirëqënies së kafsheve nga ana e OIE së është miratuar në vitin:

- A)1965.
- B)1966.
- C)2006.
- D)2020.

Pyetja 32

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për rregullat për mirëqënien e kafshëve të egra:

- A)65.
- B)66.
- C)75.
- D)80.

Pyetja 33

DG-SANCO, si strukturë që mbulon dhe fushën e mirëqënies së kafshëve është:

- A)Europiane.
- B)Shqipëtare.
- C)E OIE-së.
- D)Amerikane.

Pyetja 34

Në BE funksionet e shërbimit veterinar dhe të mirëqënies së kafshëve janë nën Komisionerin e:

- A)Bujqësisë.
- B)Mjekësisë.
- C)Arsimit.
- D)Financave.

Pyetja 35

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar në RSH përcakton detyrat e veterinerit zyrtar:

- E)Neni 109.
- F)Neni 115.
- G)Neni 120.
- H)Neni 132.

Pyetja 36

Cili është objekti i studimit të Etologjisë?

- A)Baza fiziologjike e sjelljes së kafshëve
- B)Baza gjenetike e sjelljes së kafshëve
- C)Gjithë tipet e sjelljes së kafshëve
- D)Proçeset fizio-psikologjike të kafshëve

Pyetja 37

Modeli i përcaktuar i veprimit (FAP) i nxitur nga ngacmuesit “çlirues” është një sekuençë sjellje e pandryshueshme, e cila nëse fillon duhet të:

- A) përfundojë patjetër
- B) ketë një fitues
- C) eliminojë kundërshtarin
- D) sigurojë lënien e pasardhësve

Pyetja 38

Model i sjelljes është një segment i organizuar sjelljeje, shpesh specifik për llojin e kafshës dhe që gjithmonë:

- A) është i njëjtë ndër gjithë individët e të njëjtit lloj
- B) modifikohet nga të mësuarit e kafshës
- C) ndryshon me avancimin e moshës së kafshës
- D) përmbush një funksion të caktuar jetësor

Pyetja 39

Sjellja eliminuese lidhet me eliminimin e:

- A) partnerit të padëshiruar riprodhues
- B) pasardhësit në kushtet e çrregullimeve fiziopsikologjike
- C) kundërshtarit gjatë konkurrencës për partnere riprodhuese
- D) feçeve dhe të urinës nga trupi i kafshës

Pyetja 40

Sjellja seksuale e kafshëve konsiston:

- A) në sjelljet e kafshëve para dhe pas çiftimit
- B) në sjelljet estrale prekopulative
- C) vetëm në sjelljet gjatë momentit të kopulimit
- D) vetëm në sjelljet që shoqërohen me çiftim fertil

Pyetja 41

Sjellja prindërore e kafshëve është sjellje:

- A) e nënës në përkujdesje të voglit para e pas pjelljes, e kontrolluar nga hormonet
- B) e të dy prindërve të disa llojeve kafshësh në përkujdesje të voglit para e pas pjelljes
- C) që përfshin babain e të gjithë llojeve të kafshëve në ndihmën ndaj të voglit
- D) vetëm e nënës në gjithë llojet e kafshëve, ndaj quhet sjellje mëmësore

Pyetja 42

Cila nga sjelljet ka tendencë t'i mbajë kafshët të distancuara nga njëra-tjera?

- A) Sjellja agresive
- B) Sjellja alelomimetike
- C) Sjellja eksploruese
- D) Sjellja ushqyese

Pyetja 43

Instikt konsiderohet si element i sjelljes së:

- A) lindur dhe të kontrolluar nga adenohipofiza
- B) lindur dhe të kontrolluar nga hipotalamusi
- C) mësuar dhe të kontrolluar nga talamusi
- D) mësuar dhe të kontrolluar nga neurohipofiza

Pyetja 44

Forma më e lartë e të mësuarit është:

- A) imprinting-u
- B) insight-i
- C) kushtëzimi operativ
- D) lidhja zinxhir e përgjigjeve

Pyetja 45

Kushtëzimi i neverisë së të shijuarit është një formë e të mësuarit gjatë së cilës kafsha mëson të evitojë një ushqim:

- A) me të njëjtën ngjyrë me një ushqim, që i ka shkaktuar një sëmundje të mëhershme gastrointestinale
- B) të papërshtatshëm për të, me të cilin vendoset për herë të parë në kontakt
- C) të përshtatshëm për të, pasi e bashkëlidh me një sëmundje të mëhershme gastrointestinale shkaktuar prej tij
- D) të përshtatshëm për të, pasi e bashkëlidh me një dëmtim të jashtëm fizik të përjetuar më herët gjatë konsumimit të tij

Pyetja 46

Kushtëzimi operativ konsiston në dukurinë kur kafsha mëson të kryejë një sjellje të caktuar:

- A) menjëherë pas një tingulli zileje a ndezje drite
- B) në përgjigje të një ngacmuesi të kushtëzuar
- C) në përgjigje të një ngacmuesi të pakushtëzuar
- D) pasi merr shpërblimin apo ndëshkimin pasues

Pyetja 47

Cila nga rastet është përdorim i mjeteve të punës prej kafshës?

- A) Një ari që fërkon kurrizin pas një peme
- B) Një mëllenjë që përplas kërmintë pas shkëmbinjve për t'iu thyer guackën
- C) Një shpend që mbledh me sqep shkopinj për të ndërtuar folenë
- D) Një zog që kap gurin dhe e lëshon mbi vezë

Pyetja 48

Cili nga opsionet e mëposhtme është sjellje instiktive?

- A) Një qen që shkundet pasi është lagur
- B) Një kalë që i ofron sjellje grooming një tjetër kali të të njëjtit grup shoqëror
- C) Një lepur që lëshon sinjale alarmi në mbrojtje të kolonisë prej grabitqarëve
- D) Një mace që reagon me frikë ndaj erës së një klinike veterinare

Pyetja 49

Kushtëzimi instrumental është një formë të mësuarit që arrihet përmes përforcimit me anë të:

- A) ngacmuesve dëgjimorë
- B) ngacmuesve vizivë
- C) trajnimit
- D) ushqimit

Pyetja 50

Një mënyrë e të mësuarit, që vlerësohet përmes përdorimit korrekt prej kafshës të një manovre shmangëse në zgjidhje të një detyre që i caktohet, quhet:

- A) ambjentim
- B) insight
- C) kushtëzim klasik
- D) kushtëzim operativ

Pyetja 51

Cila nga sjelljet vijuese përshkruan më mirë një sjellje sociale?

- A) një kafshë në ndjekje të presë
- B) një kafshë që mbron territorin e saj
- C) një majmun që i ofron përkujdesje një majmuni tjetër
- D) një qen që markon territorin me jashtëqitje

Pyetja 52

Cili nga termat përshkruan dukurinë e njohjes dhe ndjekjes prej të sapolindurit të objektit të parë që sheh në lëvizje?

- A) imprinting (ngulitje)
- B) kushtëzimi klasik
- C) të mësuarit konceptual
- D) të mësuarit latent

Pyetja 53

Sjellja e një qeni që jep përgjigjen e duhur me goditje putre për një veprim matematikor duke u shpërblyer prej trajnuesit me ushqim pas përgjigjeve të sakta, është një ilustrim i të mësuarit përmes:

- A) ambjentimit
- B) kushtëzimit instrumental
- C) kushtëzimit klasik
- D) lidhjes zinxhir të përgjigjeve

Pyetja 54

Periudha kritike gjatë së cilës vendoset imprintingu (ngulitja) zgjat:

- A) nga disa ditë në disa muaj në kafshët altrikale
- B) nga disa ditë në disa muaj në kafshët prekociale
- C) nga pak orë në pak ditë në kafshët altrikale
- D) nga pak muaj në pak vite në kafshët prekociale

Pyetja 55

Prania e kafshëve të sapolindura që mund të shkaktojë shfaqje të sjelljes prindërore tek femrat dhe meshkujt e rinj, është një dukuri e njohur si:

- A) imprinting (ngulitje)
- B) konkavim
- C) nakrolepsi
- D) nimfomani

Pyetja 56

Cili shkencëtar etolog njihet për formulimin e dukurisë së imprinting-ut?

- A) K. Lorenz
- B) N. Tinbergen
- C) K. von Frisch
- D) B. F. Skinner

Pyetja 57

Cili nga rastet vijuese konsiderohet si ritëm cirkadian?

- A) Ritmi i të ushqyerit
- B) Ritmi i gjumë-zgjimit
- C) Ritmi i disa parazitëve: psh dirofilaria
- D) Ritmet e riprodhimit

Pyetja 58

Termi Zeitgebers i referohet faktorëve kryesisht mjedisorë përcaktues të ritmeve:

- A) cirkadiane
- B) cirkatrigenciane
- C) infradiane
- D) ultradiane

Pyetja 59

Cila lloj kafshe shfaq këtë ritëm stinor të sjelljeve riprodhuese: anestrallë në vjeshtë e në dimër dhe fillojnë të shfaqin afshin në fillim të pranverës?

- A) Delet
- B) Derrat
- C) Gjedhët
- D) Kuajt

Pyetja 60

Një kafshë, që shfaq një përgjigje ciklike ndaj temperaturës së ulët ose burimeve të pakëta ushqimore duke ulur ritmin e metabolizmit, temperaturën trupore, ritmin e rrahjes së zemrës dhe frymëmarrjes, njihet si kafshë:

- A) diurne
- B) hibernante
- C) letargjike
- D) nokturne

Pyetja 61

Cili nga rastet e sjelljes ushqyese të kafshëve është pohim i saktë:

- A) Kuajt gjatë kullotjes e kafshojnë ushqimin me dhëmbët e sipërm dhe të poshtëm, e përtypin fuqishëm dhe nuk e ripërtypin
- B) Lepujt e butë e brejnë ushqimin me prerësit e mprehtë frontalë dhe e gëlltitin pa e përtypur
- C) Lopët gjatë kullotjes e këputin barin me dhëmbët e sipërm e të poshtëm prerës dhe e ripërtypin
- D) Qentë bëjnë bluarje të plotë dhe të gjatë të ushqimit të fortë përmes dhëmbëve lateralë

Pyetja 62

Allogrooming është aktivitet që konsiston në:

- A) krijimin e hapësirave personale mes kafshëve të një grupi shoqëror
- B) orientimin e aktiviteteve pastruese të një kafshe drejt vetes
- C) orientimin e altruizmit drejt anëtarëve të të njëjtit grup shoqëror
- D) transferimin e aktiviteteve pastruese të një kafshe nga vetja tek të tjerët

Pyetja 63

Sjellja agresive:

- A) ndikohet nga nivelet hormonale
- B) ndikohet nga ritmet cirkadiane
- C) është e pavarur nga faktorët gjenetikë
- D) është e pavarur nga niveli i neurotransmetuesve

Pyetja 64

Cili nga pohimet vijuese është i saktë nëse i referohemi sjelljes riprodhuese të gjedhëve?

- A) Dukuria e nimfomanisë vërehet tek të gjitha lopët në estrus
- B) Intensiteti i sjelljes seksuale të demave nuk ndikohet nga faktorët mjedisorë
- C) Lopët në afsh lejojnë tentativat e kërcimit të kafshëve të tjera
- D) Rendi hierarkik respektohet gjithnjë gjatë shfaqjes së sjelljeve riprodhuese

Pyetja 65

Dukuria e sjelljeve estrale të shpeshta dhe me intervale të çrregullta njihet si:

- A) katatoni
- B) katalepsi
- C) nakrolepsi
- D) nimfomani

Pyetja 66

Gjendja e palëvizshmërisë që vërehet në kafshën e hipnotizuar njihet si:

- A) katatoni
- B) koprofagi
- C) nakrolepsi
- D) nimfomani

Pyetja 67

Faktorët e domosdoshëm për të prodhuar një sjellje anormale janë:

- A) motivimi i lartë
- B) robëria ndaj burimit të ngacmimit
- C) pamundësia për t'u përshtatur
- D) të tre faktorët e sipërcituar njëkohësisht

Pyetja 68

Cili nga pohimet mbi tipet e sjelljes anormale të kafshëve është i saktë?

- A) Sjellja e zhvendosur është orientimi i një modeli sjelljeje të përshtatshëm ndaj një kafshe/objekti të gabuar dhe jo ngacmuesit origjinal
- B) Sjellja e zhvendosur është zëvendësimi i një modeli sjelljeje me një tjetër të papërshtatshëm për situatën
- C) Sjellja zhvendosëse është orientimi i një modeli sjelljeje të përshtatshëm ndaj një kafshe/objekti të gabuar
- D) Sjellja zhvendosëse është orientimi i një modeli të papërshtatshëm sjelljeje ndaj një kafshe/objekti të gabuar dhe jo ngacmuesit origjinal

Pyetja 69

Eksperimenti i famshëm në lidhje me hipnozën e kafshëve, i publikuar në Romë në 1646 prej priftit jezuit Athanasius Kircher, si kafshë eksperimentale kishte një:

- A) lepur
- B) mi
- C) pulë

D) qen

Pyetja 70

Sjelljet anormale të kafshëve:

- A) nuk hasen në sjelljet kopulative
- B) hasen gjatë të mësuarit konceptual
- C) përfshijnë kanibalizmin
- D) përfshijnë konkavimin

Pyetja 71

Cili nga shembujt është sjellje anormale e kafshëve?

- A) Një lepur që lëshon tinguj alarmi dhe lajmëron për praninë e grabitqarit që kërcënon grupin e tij
- B) Një qen shtëpiak që reagon me frikë ndaj klinikës veterinare që frekuenton
- C) Një qingj dyjavësh që heziton t'i afrohet nënës pasi ajo është qethur
- D) Një tigër që kryen lëvizje stereotipike përgjatë hekurave të kafazit të kopshtit zoologjik

Pyetja 72

Sjellja gjatë së cilës kafsha që e kryen humbet mirëqënie dhe kafsha që e pranon përfiton mirëqënie njihet si:

- A) sjellje altruiste
- B) sjellje grooming
- C) sjellje mëmësore
- D) sjellje territoriale

Pyetja 73

Termtat: gjumë i trupit, gjumë aktiv, gjumë paradoksal i referohen gjumit:

- A) DSWS
- B) LSWS
- C) REM
- D) SWS

Pyetja 74

Sjellja e orientimit të veprimeve pastruese të kafshës ndaj vetes njihet si:

- A) allogrooming
- B) autolezionizëm
- C) grooming personal
- D) koprofagi

Pyetja 75

Cili nga pohimet mbi hierarkinë e kafshëve është i saktë?

- A) Rendi hierarkik në derra nuk ndikohet nga niveli hormonal
- B) Rendi hierarkik në gjedhë është formë lineare
- C) Rendi i çukitjes është një tip hierarkie në zogjtë e pulës
- D) Rendi i thithjes së gjirit është një tip hierarkie në lepuj

Pyetja 76

Cila strukturë e shërbimit veterinar në Shqipëri ka të drejtën e vënies së gjobës mbi mirëqënien e kafshëve:

- A) Shërbimi veterinar privat.

- B) Shërbimi veterinar shtetëror.
- C) Laboratori i referencës.
- D) Shërbimi veterinar në AKU.

Pyetja 77

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për komisionin shtetëror të PMV-ve:

- A) 65.
- B) 66.
- C) 70.
- D) 88.

Pyetja 78

Cili nen i ligjit 10465 mbi shërbimin veterinar flet për eliminimin e kafshëve:

- A) 65.
- B) 66.
- C) 68.
- D) 69.

9. Legjislacioni Veterinar

Pyetja 1

Akti ligjor quhet:

- A) Një VKM.
- B) Një urdhër Ministri.
- C) Një ligj mbi një fushë të caktuar.
- D) Një udhëzim.

Pyetja 2

Akt nën ligjor quhet:

- A) Kushtetuta.
- B) Ligji mbi Ushqimin.
- C) VKM-ja mbi rregullat e liçensimit për tregëtimin e PMV-ve.
- D) Ligji mbi identifikim-regjistrimin e kafshëve.

Pyetja 3

Ligji nr. 10465 dt. 29/09/2011 është:

- A) Mbi ushqimin.
- B) Mbi veterinarinë.
- C) Mbi identifikim-regjistrimin.
- D) Mbi peshkimin.

Pyetja 4

Legjislacioni Veterinar zbatohet në fushën e:

- A) Sigurisë ushqimore.
- B) Veterinarisë.
- C) Peshkimit.

D) Zooteknisë.

Pyetja 5

Burimet për hartimin e Legjislacionit Veterinar shqipëtar janë:

- A) Të brendshme (nga përvoja e shërbimit veterinar).
- B) Të jashtme (direktivat dhe rregulloret perkatëse nga vende të BE dhe OIE).
- C) Të brendshme dhe të jashtme.
- D) Vetëm nga përkthimet e legjislacionit të BE-së.

Pyetja 6

Letra e Bardhë 2000, në fushën e sigurisë ushqimore është përmbledhje e legjislacionit:

- A) Shqipëtar.
- B) Amerikan.
- C) European.
- D) Anglez.

Pyetja 7

Cili është misioni i Urdhrit sipas ligjit 113/2015 për Urdhrit Profesional të mjekut veterinar?

- A) Ruajtja e standarteve të larta në formimin, sjelljen profesionale dhe ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve si dhe mbrojtjen e shëndetit publik.
- B) Hartimi i strategjisë për çrënjosjen e sëmundjeve infektive
- C) Hartimi i planit kombëtar të mbetjeve
- D) Hartimi planit kombëtar të kontrollit

Pyetja 8

Cila nga alternativat e mëposhtme sipas ligjit 113/2015 nuk është organ i urdhërit?

- A) Asambleja e Përgjithshme
- B) Këshilli Kombëtar
- C) Komisioni Disiplinor
- D) Komisioni i Zgjedhjeve të Përgjithshme

Pyetja 9

Në sa faza ka kaluar historiku i zhvillimit të shërbimit veterinar botëror:

- A) 3 faza.
- B) 6 faza.
- C) 4 faza.
- D) 5 faza.

Pyetja 10

Kur është dekretuar ligji i parë veterinar në Shqipëri:

- A) 1 mars 1927
- B) 23 mars 1928
- C) 1 mars 1929

D) 23 mars 1929

Pyetja 11

Një akt ligjor miratohet nga:

- A) Parlamenti.
- B) Presidenti.
- C) Kryeministri.
- D) Ministri.

Pyetja 12

Një akt nënligjor miratohet nga:

- A) Parlamenti.
- B) Presidenti.
- C) Kryeministri.
- D) Drejtor Drejtorie i një Ministrie.

Pyetja 13

Shërbimi veterinar në Shqipëri është:

- A) Shërbimi veterinar privat.
- B) Shërbimi veterinar shtetëror.
- C) Shërbimi veterinar shtetëror dhe privat.
- D) Shërbimi veterinar në stabilimentet e mbarështimit blegtoral.

Pyetja 14

Shërbimi veterinar shtetëror në Shqipëri nuk është i vendosur në:

- A) Ministrinë e bujqësisë dhe AKVMB.
- B) AKU.
- C) Bashki
- D) Prefekturë

Pyetja 15

Autoriteti veterinar është:

- A) AKU.
- B) AKVMB.
- C) MBZHR
- D) ISUV

Pyetja 16

Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar të Barnave është i vendosur në:

- A) AKU.
- B) ISUV
- C) Ministrinë e Bujqësisë.
- D) AKVMD.

Pyetja 17

Varësia teknike e PIK (Pika e Inspektimit Kufitar) është nga:

- A) Ministria e Bujqësisë.
- B) SPV (Struktura Përgjegjëse Veterinare).
- C) AKU-ja.
- D) Drejtoria Rajonale.

Pyetja 18

Operatori i biznesit importues njofton PIK (Pika e Inspektimit Kufitar) për ardhjen e ngarkesës, para:

- A) 24 orësh.
- B) 72 orësh.
- C) 48 orësh.
- D) 96 orësh.

Pyetja 19

Ligji mbi Shërbimin Veterinar ka për objekt:

- A) Zootekninë.
- B) Veterinarinë.
- C) Identifikim-regjistrimin.
- D) Peshkimin.

Pyetja 20

Fusha e zbatimit të Ligjit mbi Shërbimin Veterinar, përfshin:

- A) Mjekët veterinarë në sektorin shtetëror
- B) Mjekët veterinarë në sektorin privat
- C) Tërësia e trupës veterinare
- D) Tërësia e trupës veterinare, pronarët e kafshëve dhe operatorët e mbarështimit të tyre.

Pyetja 21

Për identifikim- regjistrimin e kafshëve dhe fermave, ligjërisht është përgjegjës:

- A) SPV në Ministri
- B) Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë
- C) ISUV
- D) Pronarët e tyre

Pyetja 22

Cilin veprim nuk duhet të kryejë veterineri zyrtar, kur konstaton një kafshë blegtorale të pa matrikulluar (e pa identifikuar):

- A) E fut në karantinë
- B) Ndalon hyrje-daljen (lëvizjen) e saj
- C) Ndërmerr sanksione ndaj pronarit të kafshës sipas ligjit
- D) E matrikullon atë

Pyetja 23

Brenda sa ditësh duhet njoftuar shërbimi veterinar (për regjistrim apo çregjistrim), nëse blihet një qen, apo ai humbet, ngordh, dhurohet apo shitet:

- A) 3 ditë
- B) 7 ditë
- C) 14 ditë
- D) 21 ditë

Pyetja 24

Brenda sa orësh duhet njoftuar OIE-ja në rast konfirmimi të një sëmundjeje infektive zoonotike:

- A) 12 orë
- B) 24 orë
- C) 36 orë
- D) 72 orë

Pyetja 25

Gjeni opsionin e gabuar për zonat dhe masat që vendos Shërbimi Veterinar rreth një vatre shpërthimi të një sëmundjeje infektive:

- A) Zona intensive (me rreze 1 km nga vatra)
- B) Zona e mbrojtur (me rreze 3 km nga vatra)
- C) Zona e mbikqyrur (me rreze 10 km nga vatra)
- D) Kontrolli dhe ndalimi i lëvizjes së kafshëve dhe produkteve nga zona e mbrojtur

Pyetja 26

Shërbimi veterinar mund të buxhetohet nga:

- A) Shteti, ministritë dhe drejtoritë.
- B) BE dhe shteti.
- C) Shteti dhe sektori privat.
- D) Shteti, BE dhe sektori privat.

Pyetja 27

Sa ditë përpara janë të detyruar të njoftojnë shërbimin veterinar subjektet organizatore të konkurseve, panairove apo shfaqjeve me kafshë:

- A) 3 ditë
- B) 7 ditë
- C) 10 ditë
- D) 15 ditë

Pyetja 28

Cila alternativë është e gabuar, lidhur me rastet e lëshimit të çertifikatës shëndetësore veterinare:

- A) Lëvizja e kafshëve jashtë zonës administrative
- B) Lëvizja e kafshëve jashtë kufijve shtetërorë

- C) Lëvizja e kafshëve për në thertore
- D) Lëvizja e kafshëve drejt tregut të zonës administrative

Pyetja 29

Sa ditë e ka vlefshmërinë çertifikata shëndetësore veterinare, nga momenti i lëshimit:

- A) 3 ditë
- B) 5 ditë
- C) 7 ditë
- D) 10 ditë

Pyetja 30

Nëse në kuadër të mbikqyrjes së zbatimit të Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve, shërbimi veterinar konstaton një sasi mishi nga kafshë të trajtuara me PMV para kohës së pezullimit, ai:

- A) Kryen trajtimin termik të mishit
- B) Lejon konsumin me kusht të tij
- C) Konservon mishin për një muaj
- D) Ndalon tregëtimin e mishit

Pyetja 31

Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve përgatitet nga:

- A) AKU-ja.
- B) Ministria Bujqësisë.
- C) ISUV.
- D) AKVMB-ja.

Pyetja 32

Autorizimi apo çertifikata për tregëtimin e PMV-ve jepet nga:

- A) AKU-ja.
- B) AKVMB-ja.
- C) ISUV.
- D) Komisioni shtetëror i PMV-ve.

Pyetja 33

Sa zgjat procedura e miratimit dhe lëshimit të çertifikatës së tregëtimin të PMV nga Komisioni Shtetëror përkatës, prej momentit të dorëzimit të kërkesës nga subjekti:

- A) 1 muaj
- B) 3 muaj
- C) 7 muaj
- D) 9 muaj

Pyetja 34

Çertifikata e tregëtimin të PMV e lëshuar nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve, është e vlefshme për:

- A) 1 vit
- B) 3 vjet
- C) 5 vjet
- D) Përgjithmonë

Pyetja 35

Nëse për një PMV të caktuar nuk jepet koha e pezullimit të saj, atëhere afati minimal që zbatohet për mishin e pulave dhe të gjitarëve është:

- A) 7 ditë
- B) 12 ditë
- C) 21 ditë
- D) 28 ditë

Pyetja 36

Farmacitë veterinare detyrohen ligjërisht ta ruajnë dokumentacionin e tyre:

- A) 1 vit
- B) 1,5 vjet
- C) 2 vjet
- D) 3 vjet

Pyetja 37

Gjeni opsionin e gabuar, lidhur me rastet kur Komisioni Shtetëror i PMV pezullon çertifikatën e tregtimit të PMV:

- A) Kur ka pretendime dhe denoncime nga tregëtuesit dhe rrjeti i farmacive
- B) Kur PMV-ja nuk zotëron efektet terapeutike të përshkruara në udhëzimin e përdorimit
- C) Kur PMV-ja tregtohet për një përdorim të ndaluar nga ligji
- D) Kur kërkohet nga vetë mbajtësi i çertifikatës

Pyetja 38

Vula e mjekut veterinar miratohet nga:

- A) AKU-ja.
- B) AKVMB-ja.
- C) ISUV.
- D) Komisioni shtetëror i PMV-ve.

Pyetja 39

Autorizimin për ushtrimin e aktivitetit të laboratorit veterinar rajonal e miraton:

- A) Ministri
- B) SPV-ja
- C) ISUV
- D) Komisioni shtetëror i PMV-ve

Pyetja 40

Vlerësimin e laboratorëve veterinarë rajonal të miratuar nga Ministri, e kryen:

- A) Drejtoria Rajonale e Veterinarisë
- B) ISUV
- C) AKVMB-ja
- D) Eksperti i Ministrit

Pyetja 41

Ligji Nr.9863, dt. 28.1.2008 ka për objekt:

- A) Zootekninë
- B) Veterinarinë
- C) Qumështin e produktet e tij
- D) Ushqimin

Pyetja 42

Gjeni opsionin e gabuar në lidhje me fushën e zbatimit të Ligjit mbi Ushqimin:

- A) Prodhimi primar i formave të ndryshme ushqimore
- B) Ushqimet e prodhuara apo përpunuara për qëllime përdorimi vetjak (jo për treg)
- C) Ushqimet e përpunuara në linja të mekanizuara teknologjike
- D) Ushqimet e shpërndara përmes rrjetit të kontrolluar të mjeteve të transportit

Pyetja 43

Analiza e riskut, në kuadër të sigurisë ushqimore kryhet nga:

- A) ISUV
- B) AKU
- C) AKVMB
- D) Ministria e Bujqësisë

Pyetja 44

Në kuadër të sigurisë ushqimore, risku menaxhohet nga:

- A) ISUV dhe Ministri
- B) AKU dhe Ministri
- C) AKVMB
- D) Ministria e Bujqësisë

Pyetja 45

Gjeni opsionin e gabuar lidhur me komponentët e analizës së riskut:

- A) Vlerësimi i riskut
- B) Dimensionimi i riskut
- C) Menaxhimi i riskut
- D) Komunikimi i riskut

Pyetja 46

Gjeni parimin e përgjithshëm ku bazohet analiza e riskut:

- A) Parimi parandalues
- B) Parimi i reciprocitetit

- C) Parimi i komunikimit
- D) Parimi i ndërvarësisë

Pyetja 47

Shpenzimet për marjen e mostrave në PIK dhe kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga:

- A) Importuesi
- B) Transportuesi
- C) Autoriteti Doganor
- D) Kryhen falas

Pyetja 48

Modelet e çertifikatave veterinarë ndërkombëtare në Shqipëri janë në gjuhë:

- A) Shqipe.
- B) Angleze.
- C) Shumë gjuhëshe.
- D) Shqip-Anglisht.

Pyetja 49

Cilët janë përgjegjës për garantimin e sigurimit të kërkesave të ligjit për ushqimin, në stabilimentet e bizneset ushqimore:

- A) Inspektorët veterinarë
- B) Inspektorët e AKU-së
- C) Veterinerët zyrtarë
- D) Operatorët ushqimorë

Pyetja 50

Kush e kryen vlerësimin e përmbushjes së kushteve tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare e veterinarë, për të filluar veprimtarinë prodhuese operatorët e biznesit ushqimor:

- A) Ministria e Bujqësisë
- B) AKVMB
- C) AKU
- D) ISUV

Pyetja 51

Cila kategori e mëposhtme është renditur gabimisht si “ushqime të reja”:

- A) Ushqimet dhe përbërësit ushqimorë që origjinojnë nga prodhime bio
- B) Ushqimet dhe përbërësit ushqimorë që përmbajnë OMGJ
- C) Ushqimet dhe përbërësit ushqimorë që nuk përmbajnë OMGJ, ose ato me strukturë molekulare parësore të re, apo të modifikuar qëllimisht
- D) Ushqimet dhe përbërësit ushqimorë të përbëra nga mikroorganizma, kërpudha e alga

Pyetja 52

Kostot e kryerjes së analizave laboratorike të mostrave të mara nga inspektorët për kontrollin zyrtar të ushqimit, mbulohet nga:

- A) ISUV
- B) AKU
- C) Ministria
- D) Kryhen falas

Pyetja 53

Drejtori i përgjithshëm i AKU-së emërohet nga:

- A) Ministria e Bujqësisë me propozim të ISUV
- B) Presidenca me propozim të Ministrisë
- C) Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë
- D) Parlamenti me propozim të Këshillit të Ministrave

Pyetja 54

Gjeni opsionin e renditur gabimisht si një kërkesë ligjore e prodhimit të qumështit për konsum dhe për produkte me bazë qumështi:

- A) Gjendja e mirë shëndetsore e kafshëve prodhuese të qumështit
- B) Gjendja optimale e fermës dhe lokaleve të mjeljes
- C) Kryerja sipas standardeve e procesit të mjeljes, grumbullimit e transportit të qumështit
- D) Gjendja numerike e kafshëve të fermës

Pyetja 55

Gjatë transportit të qumështit të pasterizuar në cisterna, ambalazhe të vogla dhe bidonë, temperatura e tij duhet të jetë:

- A) + 6 °C
- B) 0 °C
- C) + 2 °C
- D) + 5 °C

Pyetja 56

Institucionet kryesore e vendim-marrëse, që përbëjnë strukturën më të rëndësishme të BE-së janë 3. Gjeni institucionin i përfshirë gabim si i tillë:

- A) Parlamenti i Bashkimit Europian (PE)
- B) Këshilli i Ministrave i BE (KiM)
- C) Këshilli Administrativ i BE (KA)
- D) Komisioni Ekonomik i Bashkimit Europian (KE)

Pyetja 57

Cili nga institucionet e mëposhtme nuk përfshihet në strukturat e BE:

- A) Gjykata Europiane e Auditimit
- B) Gjykata Penale e Bashkimit Europian
- C) Banka Europiane e Investimeve
- D) Banka Europiane Qendrore

Pyetja 58

DG-SANCO, është strukturë:

- A) Italiane
- B) Franceze
- C) E OIE-së.
- D) Europiane

Pyetja 59

Në BE, funksionet e shërbimit veterinar janë nën juridiksionin e Komisionerit të:

- A) Bujqësisë
- B) Mjekësisë.
- C) Arsimit
- D) Financave

Pyetja 60

Cila prej strukturave të mëposhtme të BE-së ka fuqi e funksione ekzekutive?

- A) Parlamenti European
- B) Gjykata Europiane
- C) Këshilli i Ministrave
- D) Komisioni European

Pyetja 61

Cili nga opsionet e mëposhtme nuk përfshihet në objektivat e OIE?

- A) Transparenca e situatës epizotologjike të kafshëve në nivel global
- B) Informacion shkencor për përdorimin e metodave të kontrollit dhe çrrënjësjes së sëmundjeve
- C) Siguria e tregëtisë ndërkombëtare të kafshëve dhe produkteve shtazore
- D) Siguria e mbarështimit të kafshëve dhe mjekimi i tyre

Pyetja 62

Mbikqyrjen e medikamenteve mjekësore dhe veterinarë e kryen:

- A) EFSA.
- B) EMA.
- C) FVO.
- D) EAPHP.

Pyetja 63

Vlerësimin e përputhshmërinë e sektorëve të ushqimit, veterinarisë dhe bimëve me standardet e BE-së, e realizon:

- A) Zyra e Ushqimit dhe Veterinarisë (FVO)
- B) Agjencia Europiane e Mjekësisë (EMEA)
- C) Autoriteti apo Agjencia Europiane e Sigurisë Ushqimore (EFSA)
- D) Qendra Europiane e Kontrollit të Sëmundjeve (ECDC)

Pyetja 64

Qendra e Organizatës Botërore të Shëndetit ndodhet në:

- A) Zvicër.
- B) Amerikë.
- C) Itali.
- D) Gjermani.

Pyetja 65

FVO (Zyra e Ushqimit dhe Veterinarisë) është në përbërje të:

- A) Komisionit European
- B) Autoriteti European i Sigurisë Ushqimore (EFSA)
- C) Komisioni i Bashkimit European (KE)
- D) Drejtoria e Përgjithëshme e Shëndetit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve (DG-SANCO)

Pyetja 66

FVO (Zyra e Ushqimit dhe Veterinarisë) ndodhet në:

- A) Bruksel.
- B) Romë.
- C) Dublin.
- D) Riga.

Pyetja 67

FAO (Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit) ndodhet në:

- A) Bruksel
- B) Romë
- C) Dublin
- D) Riga

Pyetja 68

Cila nga organizatat e mëposhtme ndërkombëtare është renditur gabimisht ndër ato që lidhen me veterinarinë:

- A) Organizata Botërore e Shëndetësisë
- B) Organizata Botërore e Shëndetit të Kafshëve
- C) Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit
- D) Organizata Europiane e Përmirësimit Racor

Pyetja 69

OIE (Organizata Botërore e Shëndetit të Kafshëve) ndodhet në:

- A) Bruksel.
- B) Romë.
- C) Dublin.
- D) Paris.

Pyetja 70

Në cilën prej strukturave të mëposhtme ndodhet qendra kombëtare e referencës laboratorike veterinare:

- A) Laboratori i Tiranës
- B) ISHP
- C) UBT
- D) ISUV

Pyetja 71

Ndarja apo kategorizimi i një grupi të caktuar kafshësh, nëpërmjet zbatimit të praktikave të posaçme manaxheriale që lidhen me zbatimin rigoroz të masave të biosigurisë, quhet:

- A) Izolim
- B) Zonim
- C) Selektim shëndetësor
- D) Popullim i targetuar

Pyetja 72

Cila nga përcaktimet e mëposhtme nuk ka të bëjë me konceptin e karantinës:

- A) Karantina erradikuese
- B) Karantina stacionare
- C) Karantina e ndërmjetme
- D) Karantina permanente

Pyetja 73

Vendosja e karantinës veterinare urdhërohet nga:

- A) Shërbimi veterinar Rajonal
- B) SPV-ja
- C) ISUV
- D) Ministria e linjës.

Pyetja 74

Laboratori Shtetëror i Kontrollit të Medikamenteve Veterinare është pjesë e:

- A) AKU-së
- B) ISUV-it
- C) SPV-së
- D) Ministrisë së Bujqësisë

Pyetja 75

Minimumi i mirëqënies së kafshëve presupozon plotësimin e:

- A) 7 lirive.
- B) 8 lirive.
- C) 5 lirive.
- D) 3 lirive.

Pyetja 76

Procesi që përcakton një grupim kafshësh, me gjendje të njohur shëndetësore (normale apo e sëmurë), i vendosur apo i ndodhur në një territor gjeografik të përkufizuar me kufij të qartë natyralë ose artificialë, quhet:

- A) Izolim
- B) Zonim
- C) Popullim i targetuar
- D) Selektim shëndetësor

10. Sëmundjet e derrave

Pyetja 1

Cili nga agjentët e mëposhtëm është shkaktari i Epidermitit eksudativ në derra?

- A) Sui pox virus
- B) Sarcoptes scabiei
- C) Staphylococcus hyicus
- D) Hematopinus suis

Pyetja 2

Në një çerdhe me gica me moshë 10 ditëshe është diagnostikuar një sëmundje lëkure. Lëkura fillimisht mbulohet me kruste të holla nën të cilat gjenden vezikula shumë të vogla ose pustula. Lëkura komplet mbulohet me një eksudat ngjitës gri-në kafe. Më vonë kafshët e prekura bëhen apatike, ato ushqehen në mënyrë të çrregullt dhe për pasojë shfaqen shenja të dehidratimit dhe humbje të peshës. Sipërfaqja e lëkurës ashpërsohet në mënyrë progresive dhe në të formohen rrudha shumë të dukshme, të cilat në vijat e përthyerjes ja lenë vendin fisurave të thella. Cili është shkaku më i mundshëm i këtyre gjetjeve?

- A) Zgjebe me infeksion bakterial sekondar
- B) Lija e derrave me infeksion sekondar bakterial
- C) Fruthi i derrave
- D) Epidermiti eksudativ

Pyetja 3

Cili është medikamenti i zgjedhur për mjekimin e zgjebes dhe infestimit nga morrat në një tufë derrash?

- A) Ivermectin
- B) Squfur
- C) Lindani
- D) Carbaryl

Pyetja 4

Cila sëmundje e lëkurës shoqërohet me vdekshmëri të lartë?

- A) Infektimi nga Sarcoptes scabiei var. suis
- B) Pityriasis rosea
- C) Infeksioni nga Staphylococcus hyicus
- D) Dermatikoza

Pyetja 5

Cili është shkaktari i Pseudorabies në derra?

- A) Rabdovirus
- B) Herpesvirus
- C) Orthomyxovirus
- D) Pestivirus

Pyetja 6

Cila nga këto sëmundje që prekin derrat nuk ka karakter zoonotik?

- A) Pseudorabia
- B) Fruthi
- C) Infeksioni nga Streptococcus suis
- D) Salmoneloza

Pyetja 7

Në një tufë derrash majmërie u shfaq një sëmundje që karakterizohet nga ethe, karavatje, paraliza, çrregullime digjестive, paraliza dhe shenja respiratore.

Cili është shkaku i këtyre gjetjeve klinike?

- A) Pneumonia enzootike
- B) Gripi i derrave
- C) Listerioza
- D) Aujeszky

Pyetja 8

Cili është shkaktari i fruthit të derrave?

- A) Bakter
- B) Virus
- C) Parazit
- D) Alergji ushqimore

Pyetja 9

Cilat kategori të derrave preken më shumë nga fruthi?

- A) Gicat e porsalindur
- B) Gicat e shkëputur
- C) Derrat në rritje
- D) Derrat me moshë 3 muajsh deri në 3 vjet

Pyetja 10

Në një tufë derrash është shfaqur një formë klinike e fruthit që karakterizohet nga njolla të kuqe të lëkurës në formën e prerjeve të diamantit. Cilës formë të fruthit i përket këto shenja?

- A) Formës hiperakute
- B) Formës akute
- C) Formës sub-akute
- D) Formës kronike

Pyetja 11

Në një tufë derrash majmërie u shfaq klinikisht një sëmundje që manifestohet me ngritje të temperaturës deri në 41°C, depresion, anoreksi, rrjedhje nga hundët, sytë dhe nganjëherë fotofobi, ecje e pasigurt, lëvizje rrotulluese rreth vetes, dridhje muskulare, shtrëngim i maseterëve dhe në fund të sëmundjes pareza dhe paraliza të gjymtyrëve. Cila sëmundje i shkakton këto shenja?

- A) Aujeszky
- B) Murtaja klasike
- C) Listerioza
- D) Techen

Pyetja 12

Cili është virusi shkaktar i Murtajës klasike të derrave?

- A) Herpes virus
- B) Coronavirus
- C) Pestivirus
- D) Rabvovirus

Pyetja 13

Cili është virusi shkaktar i Murtajës Afrikane të derrave:

- A) Pestivirus
- B) Asfarvirus (Irridovirus)
- C) Coronavirus
- D) Herpesvirus

Pyetja 14

Gjatë kontrollit të disa derrave të therur në thertore, në zemër u gjetën leziona të një endokarditi proliferativ mbi valvulat e zemrës dhe gjithashtu artrite proliferative.

Cila sëmundje është përgjegjëse për këto leziona?

- A) Staphylococcus aureus
- B) Streptococcus suis
- C) Salmonella typhimurium
- D) Erysipelothrix rhusiopathiae

Pyetja 15

Në nekropsinë e një derri të ngordhur, ndër të tjera u vërejt gjendje septike dhe hemorragji në fshikëzën e urinës, të shoqëruara me çrregullime të koagulimit. Këto leziona shkaktohen nga:

- A) Actinobacillus pleuropneumoniae
- B) Pestivirus
- C) Brachyspira hyodysenteriae
- D) Salmonella cholerae suis

Pyetja 16

Vaksina për parambrojtjen e derrave nga Murtaja përdoret për:

- A) Murtajën Afrikane
- B) Murtajën klasike

C) Për Murtajën Afrikane dhe atë Klasike

D) Për asnjërën nga Murtajat

Pyetja 17

Në një kompleks derrash u shfaq një sëmundje që manifestohet me cianozë të lëkurës, ethe me temperaturë të lartë, hemorragji në cipat seroze dhe në organe të ndryshme si në shpretkë, nyje limfatike, palcë e kockave dhe veshka. Lezionet me të zakonshme ishin hemorragjitë e veshkave, splenomegalia dhe adeniti hemorragjik. Sëmundja shoqërohet me ngordhje të shumta. Cila sëmundje është përgjegjëse për këto leziona?

A) Murtaja klasike

B) Murtaja afrikane

C) Salmoneloza hiperakute

D) Fruthi hiperakut

Pyetja 18

Nekropsia e një derri 9 javësh zbuloi një eksudat fibrinopurulent në mëlçi dhe zemër. Shkaqet më të mundshme të kësaj gjetje janë:

A) Septisemia nga *Salmonella typhimurium* dhe infeksioni nga *Mycoplasma hyorhinis*

B) Infeksioni nga *Haemophilus parasuis* dhe *M. hyorhinis*

C) Infeksioni nga *Actinobacillus pleuropneumoniae* dhe *M. hyosynoviae*

D) Infeksioni nga *M. hyorhinis* dhe *M. hyosynoviae*

Pyetja 19

Riniti atrofik shkaktohet nga:

A) *Bordetella bronchiseptica*

B) *Pasteurella multocida*

C) Bashkëveprimi i *B. bronchiseptica* dhe *P. multocida*

D) Nga bashkëveprimi i *B. bronchiseptica* dhe *Streptococcus suis*

Pyetja 20

Cili është agjenti etiologjik në sëmundjen e Glasser?

A) *Streptococcus suis* tipi II

B) *Haemophilus parasuis*

C) *Actinobacillus pleuropneumoniae*

D) *Mycoplasma hyorhinis*

Pyetja 21

Mycoplasmoza shkaktohet nga:

A) Bakter

B) Virus

C) Parazit

D) Myk

Pyetja 22

Gripi i derrave shkaktohet nga virus i familjes:

A) *Orthomyxoviridae*

B) *Paramyxoviridae*

- C) Rheoviridae
- D) Herpesviridae

Pyetja 23

Në një fermë derrash, në fund të vjeshtës dhe fillimin e dimrit, u shfaq një sëmundje që manifestohej me shenja klinike, kryesisht të aparatit respirator si ethe, temperaturë rektale 41-42°C si dhe simptoma të përgjithëshme anoreksi dhe gjendje të rëndë depressive. Më pas u shfaqën shenja respiratore si: kollë, rrjedhje nga hundët dhe çrregullime të frymëmarrjes. Përgjegjëse për këto shenja është:

- A) Pneumonia enzootike
- B) Pleuropneumonia
- C) Sëmundja e Glasser
- D) Gripi

Pyetja 24

Në gicat me moshë 1-ditëshe diarreja që është jo hemoragjike dhe nuk prodhon leziona të dukshme në nekropsi shkaktohet nga:

- A) Koksidioza
- B) Infeksioni nga Escherichia coli
- C) Infeksioni nga Rotavirusi
- D) Mjedisi shumë i nxehtë i stallës

Pyetja 25

Diarea hemorragjike e gicave të prosalindur shkaktohet nga:

- A) Rotavirusi i derrave
- B) Brachyspira hyodysenteriae
- C) Bacillus perfringens tipi C
- D) Escherichia coli

Pyetja 26

Në një stallë derrash ndodhi një shpërthim akut i të vjellave dhe diarresë në gica me moshë 1 javëshe dhe u manifestua me një sëmundshmëri të lartë dhe një shkallë të lartë të vdekshmërisë. Cili është shkaku më i mundshëm i kësaj situate?

- A) Infeksioni nga Bacillus perfringens tipi C
- B) Infeksioni nga Rotavirusi
- C) Infeksioni nga Escherichia coli
- D) Infeksioni nga Gastro-enteriti i transmetueshëm

Pyetja 27

Tiflokoliti mukohemorragjik në derra shkaktohet nga:

- A) Salmonella typhimurium
- B) Bacillus perfringens tipi C
- C) Brachyspira hyodysenteriae
- D) Escherichia coli endotoksikogjen

Pyetja 28

Sëmundja e edemave shkaktohet nga:

- A) Salmonela typhimurium
- B) Escherichia coli
- C) Nga myqet
- D) Proteina e tepërt në ushqim

Pyetja 29

Tek gicat 5-ditësh antimikrobikët janë shumë efektivë në trajtimin e:

- A) Kolibacilozës e komplikuar nga infeksioni rotaviral
- B) Infeksionit me Arterivirus (sindromi riprodhues dhe respirator i derrit)
- C) Enteritit akut klostridial
- D) Gastroenteritit të transmetueshëm akut

Pyetja 30

Cili nga medikamentet e mëposhtëm është më i përshtatshëm për trajtimin e dizanterisë hemorragjike të derrave?

- A) Linkomicina dhe Tiamulina
- B) Penicilina
- C) Sulfatiazoli
- D) Tilmikozina

Pyetja 31

Në një tufë gicash në maternitet u shfaq një sëmundje me ngordhje të papritura të gicave 24-36 orë pas lindjes, me shenja diareje me ngjyrë gri të errët, e cila më vonë kthehej në diarre me ngjyrë të kuqe. Sëmundja karakterizohet nga ngordhshmëri e lartë. Cili është shkaktari për këtë sëmundje?

- A) Escherichia coli enterotoksikogjen
- B) Balantidium coli
- C) Bacillus perfringens tipi C
- D) Brachyspira hyodysenteriae

Pyetja 32

Nga sëmundja e edemave preken gicat në:

- A) laktacion me moshë 10 ditore
- B) laktacion me moshë 20 ditore
- C) laktacion me moshë 30 ditore
- D) shkëputje nga gjiri i dosave

Pyetja 33

Si mjekohet sëmundja e edemave tek derrat?

- A) vetëm me antibiotikë
- B) vetëm me dietë ushqimore
- C) vetëm me elektrolitë dhe vitamina

D) vetëm me antibiotikë dhe dietë ushqimore

Pyetja 34

Në cilën periudhë të barsmërisë vaksinohen dosat për parambrojtjen e gicave nga enterotoksiemia:

- A) Në momentin e lindjes
- B) Në momentin e ndërimit
- C) Në ditën pas lindjes
- D) 3 javë para lindjes

Pyetja 35

Në nekropsinë e një derri majmërie u konstatua përmbajtje të shtuar mukusi, trashje e mukozës dhe përmbajtje gjaku mbi mucus. Cila sëmundje e shkakton një lezion të tillë:

- A) Enterotoksemia
- B) Salmoneloza
- C) Dizanteria hemorragjike
- D) Koliobakterioza endotoksike

Pyetja 36

Shkaktari i sindromit PRRS në derra është:

- A) Salmonela typhimurium
- B) Parvovirusi i derrave
- C) Herpes virusi
- D) Arterovirusi

Pyetja 37

Në një kompleks derrrash me cikël të mbyllur lindje-majmëri, u shfaq një sëmundje që preku të gjitha kategoritë e derrave. Sëmundja u manifestua me fenomene riprodhimi tek dosat barsa, të tilla si: dështime, lindje gicash të ngordhur, ulje e indeksit të ndërzimeve. Në gicat e maternitetit pati dëmtime dhe zhvillim të vonuar. Në kategoritë e gicave në majmëri u manifestuan fenomene respiratore si: kollë e fortë dhe fenomene septisemike me cianozë të theksuar të veshëve, si të ngjyrosur me blu, aq sa sëmundja mori emrin dhe sëmundja e veshëve blu. Cila sëmundje është përgjegjëse për këto shfaqje klinike?

- A) Murtaja klasike
- B) Murtaja Afrikane
- C) Sindromi PRRS
- D) Salmoneloza hiperakute

Pyetja 38

Shkaktari i aktinomykozës në derra është:

- A) Mycoplasma hyosynoviae
- B) Aflatoksinat
- C) Zearalenoni
- D) Actinomyces suis

Pyetja 39

Një tufë derrash manifeston shenja të ndryshme klinike. Gicat neonatale në tufë manifestojnë dridhje intense kurse gicat e zvjerdhur rishtaz kanë diarre, dispne, ikter dhe leziona të lëkurës me kruste. Nekropsia e një kafshe çon në diagnozën e sëmundjes së porcine multisystemic wasting disease të shkaktuar nga një infeksion cirkovirus i tipit II. Cili është opsioni më i mirë i trajtimit për këtë tufë?

- A) Nuk kërkohet trajtim; tufa do të vetëpastrohet nga infeksionin me kalimin e kohës
- B) Shpopullim dhe ripopullim i tufës
- C) Antibiotiko-terapi nëpërmjet ushqimit
- D) Zbatojnë një politikë vaksinimi

Pyetja 40

Cili nga agjentët e mëposhtëm nuk shkakton zakonisht abort tek derrat?

- A) *Erysipelothrix rhusiopathiae*
- B) *Leptospira interrogans* serovar Pomona
- C) Herpes virus suis
- D) Parvovirus suis

Pyetja 41

Në dosa, vdekja e të gjithë embrioneve në ditën e 10 pas fekondimit rezulton në:

- A) Kthim i vonuar në estrus
- B) Pseudobarsmëri
- C) Kthim në estrus në një interval të rregullt
- D) Endometrit dhe anestrus

Pyetja 42

Cila sëmundje është më e zakonshme tek gicat e porsalindur?

- A) Hipoglicemia
- B) Mungesa e hekurit
- C) Meningjiti streptokoksik
- D) Tremori kongjenital

Pyetja 43

Cilat nga kategoritë e mëposhtëme të derrave preken nga gastroenteritis i transmetueshëm?

- A) Të gjitha kategoritë e derrave
- B) Gicat e porsalindur
- C) Gicat e shkëputur
- D) Riprodhuesit

Pyetja 44

Cilat prej kategorive të mëposhtëme të derrave preken zakonisht nga rotaviroza?

- A) Riprodhuesit
- B) Gicat në rritje
- C) Derrat e majmërisë
- D) Gicat në 2 javët e para të jetës dhe ato të porsa shkëputur nga dosa

Pyetja 45

Në një kompleks derrash me cikël të mbyllur u shfaqën manifestime klinike të sferës së riprodhimit, shoqëruar me gica të lindur të mumifikuar, gica të lindur jo vitalë, reduktim të numrit të gicave të lindur për dosë dhe rikthime në afshe normale të dosave të ndërzyera. Në asnjë rast nuk u vërejtën dështime të dosave. Cila sëmundje është përgjegjëse për këtë situatë?

- A) Murtaja klasike e derrave
- B) Aujeszky
- C) Parvoviroza
- D) Sindromi PRRS

Pyetja 46

Leptospiroza është një sëmundje bakteriale infektive dhe mund të prekë dhe të shkaktojë mjaft dëmtime në kafshë, përfshirë edhe derrat. Infeksioni mund të përhapet përmes vektorëve, si minjtë e infektuar, pellgjeve të ujrave të ndotura, urines së kontaminuar, etj.

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk përfshihet në klinikën e sëmundjes:

- A) Prania e etheve të forta, që mund të shkaktojnë meningjite me simptoma nervore.
- B) Shpesh lindin gica të mumifikuar, të vdekur, të vegjël dhe të fryrë nga lëngjet.
- C) Avancimi i sëmundjes (periudha të mëvonshme) mund të shoqërohet me aborte.
- D) Nuk shfaqen problem në pjellori dhe lindja e gicave është normale.

Pyetja 47

Infeksioni i dosave me parvovirusin e derrave pas ditës së 70^{te} të barrës çon në:

- A) Krijimin e mumjeve
- B) Ndërprerjen e barrsmërisë dhe krijimin e infertilitetit të përhershëm tek dosat
- C) Zhvillimin normal të barrës me përfundim lindjen e gicave normalë
- D) Lindjen e gicave të ngordhur në përfundim të periudhës së barrsmërisë

Pyetja 48

Nekropsia e disa gicave të ngordhur, të shkëputur nga gjiri, me moshën rreth 35-40 ditëshe tregoi leziona që përfaqësohen nga edema të nënlëkurës, edemë me natyrë sero-xhelatinoze të submukozës së stomakut, e lokalizuar kryesisht në pjesën e kardias, edema e kolonit spiral dhe edema e mezenteriumit. Nga cila sëmundje shkaktohen këto leziona?

- A) Salmoneloza kronike
- B) Enterotoksemia kronike
- C) Shtame endotoksikë të E. coli
- D) Coronavirusi

Pyetja 49

Nga nekropsia që ju bë disa gicave të pashkëputur nga gjiri i dosës, të ngordhur, rezultoi se tabllloja nekroskopike korrespondon me atë të një enteriti katarral dhe kjo tablllo dominohet nga një gjendje dehidratimi të gicave të ngordhur dhe me leziona që interesojnë zorrët e holla. Në to vihet re kongestion i enëve mezenteriale shoqëruar me një distension të përgjithshëm të traktit tretës, i cili gjendet i mbushur plot me një likuid të qelbur. Lezioni më karakteristik konsiston në një hollim të pareteve të zorrëve, i theksuar ky sidomos në pjesët jejunale dhe ileale të zorrëve të holla. Nga cila sëmundje shkaktohet ky kuadër patologjik?

- A) Gastroenteriti i transmetueshëm
- B) Rotaviroza
- C) Sëmundja e edemave
- D) Kolibakterioza neonatale

Pyetja 50

Sëmundja vezikulare e derrave shkaktohet nga:

- A) Poxvirus
- B) Reovirus
- C) Enterovirus
- D) Herpesvirus

Pyetja 51

Nga sëmundja vezikulare preken:

- A) Vetëm derrat
- B) Derrat dhe kafshët njëthundrake
- C) Derrat dhe gjedhët
- D) Derrat, dhentë dhe dhitë

Pyetja 52

Kripa e tepërt në dietat e derrave mund të rezultojë në:

- A) Meningjit i shkaktuar nga intoksikimi prej natriumit
- B) Encefalit i shkaktuar nga intoksikimi prej natriumit
- C) Gurë në veshka
- D) Diarre kronike

Pyetja 53

Sëmundja e Teschen (encefalomieliti infektiv) shkaktohet nga një:

- A) virus i familjes picornaviridae
- B) enterovirus
- C) reovirus
- D) herpes virus

Pyetja 54

Në një fermë derrash, në derrat e majmërisë u shfaq një sëmundje, e cila klinikisht karakterizohet nga paraliza të këmbëve të pasme të derrave, me qëndrim në pozicionin e sfinksit, me lëvizje rrotulluese rreth vetes dhe për t'u afruar tek ushqimi ata tërhiqen zvarrë. Cila sëmundje e shkakton këtë shfaqje klinike në derrat e majmërisë?

- A) Aujeszky
- B) Teschen
- C) Forma nervore e listeriozës
- D) Virusët hemaglutinues të encefalitit

Pyetja 55

Çala në derra shkaktohet nga:

- A) Virusi i aftës epizootike

- B) Virusi i sëmundjes vezikulare
- C) Virusi i lisë së derrave
- D) Fusobacterium necrophorum

Pyetja 56

Në derrat me moshë rreth 6-8 javë u shfaqën njolla në formë pikash, të lokalizuara kryesisht në parietet abdominale dhe faqet e brendëshme të kofshëve, të cilat brenda një kohe të shkurtër transformohen në papula të rumbullakta me diametër rreth 1 cm, të ngritura dhe të rrethuara nga një brez hiperemik, të cilat transformohen në pustula, me një ngjyrë të kuqe-të përhimtë, më vonë pustulat transformohen në kruste me ngjyrë gri në të zezë. Cila është sëmundja që shkakton këto leziona?

- A) Sëmundja vezikulare
- B) Pytiriasis rosea
- C) Lija e derrave
- D) Afta epizootike

Pyetja 57

Pytiriasis rosea shkaktohet nga:

- A) Viruse
- B) Bakterie
- C) Myqe
- D) Shkaqe të panjohura

Pyetja 58

Në disa derra u shfaq një sëmundje lëkure, e cila karakterizohet nga leziona specifike, të cilat përfaqësohen nga një e ngritur e vogël e lëkurës, që në harkun e disa ditëve gradualisht transformohet në zona me diametër 5-10 cm, të kufizuara rreth e rrotull nga një kordon me ngjyrë të kuqe, me gjerësi 1-2 cm, me tendencë të zgjerohen, duke krijuar zona më të gjëra, të cilat nuk janë më rrethore por paraqiten me forma të paregullta. Në brendësi të këtyre zonave lëkura paraqitet me ngjyrë gri dhe e deskuamuar. Cila është kjo sëmundje?

- A) Epidermiti eksudativ
- B) Sëmundje parazitare e lëkurës
- C) Sëmundje me bazë alergjike e lëkurës
- D) Pytiriasis rosea

Pyetja 59

Pytiriasis rosea mjekohet me:

- A) Antibiotikë
- B) Antimykotikë
- C) Antiparazitarë
- D) Kalon vetë pa u mjekuar

Pyetja 60

Anemia e gicave latantë shkaktohet nga:

- A) Sasia e pakët e kulloshtrës së dosës
- B) Sasia e pakët e qumështit të dosës
- C) Sasia e pamjaftueshme e hekurit në qumështin e dosës

D) Kequshqyerja e dosës gjatë periudhës së barrsmërisë

Pyetja 61

Nga autopsia që ju bë disa gicave të ngordhur të maternitetit u konstatua se në organe të ndryshme parenkimatoze si: mëlçi, zemër, veshka si dhe në muskujt e skeletit hasen ndryshime degjenerative dhe nekrotike, të cilat janë pasojë e hipoksisë së përgjithëshme të organizmit. Gjaku i këtyre gicave është me ngrë rozë të hapur dhe shumë i hollë. Në nënlëkurë dhe kavitetet e trupit hasen edema të mbushura me transudat. Këto leziona shkaktohen nga:

- A) Escherichia coli enterotoksikogjen
- B) Rotavirusi
- C) Bacillus perfringens
- D) Anemia e gicave nga mungesa e hekurit

Pyetja 62

Injekzioni i ferodekstranit, për parandalimin e anemisë së gicave latantë, bëhet në ditën e:

- A) 3^{të} të jetës së gicit
- B) 6^{të} të jetës së gicit
- C) 9^{të} të jetës së gicit
- D) 12^{të} të jetës së gicit

Pyetja 63

Gjatë kontrollit të mishit dhe organeve të derrave në thertore u vu re nekrozë fibroze e mëlçisë, në formën e disa pikave të bardha, me pamjen si të njollave të qumështit. Kjo patologji shkaktohet nga:

- A) Migrimi i larvave të Ascaris suum
- B) Metastrongylus apri
- C) Trichiuris suis
- D) Strongyloides ransomi

Pyetja 64

Cili nga këta parazitë shkakton në kolonin e derrave nodula me pasojë zhvillimin e një enteriti katarral kronik:

- A) Strongyloides ransomi
- B) Hyostrongylus rhubidus
- C) Trichiuris suis
- D) Metastrongylus apri

Pyetja 65

Gjatë kontrollit në thertore të disa derrave të therur u gjendën nodula me origjinë pasrazitare, me madhësi të konsiderueshme në cekum dhe kolon. Cili parazit është përgjegjës për këto leziona?

- A) Metastrongylus apri
- B) Oesophagostomum spp.
- C) Hyostrogylus rhubidus
- D) Strongyloides ransomi

Pyetja 66

Në disa derra u vërejtën shenja helmimi që manifestoheshin me methemoglobinemi karakterizuar nga ngjyrë e errët e gjakut, diarre, urinim me një ngjyrë të errët të urinës, ataksi, konvulsione dhe ngordhje. Ky helmim shkaktohet nga:

- A) kripërat e hekurit
- B) kripërat e bakrit
- C) nitritet
- D) substancat kumarinike që përdoren si rodenticide

Pyetja 67

Në disa derra u shfaqën shenja helmimi, që manifestoheshin me dridhje të kokës, moskoordinim të lëvizjeve, çrregullime lokomotorre (ataksi), pareza dhe në rastet më të rënda qorrime. Derrat e helmuar lëviznin me vështirësi dhe tentojnë të qëndrojnë për një kohë të gjatë në pozicionin e qenit në bisht. Helmimi është shkaktuar nga:

- A) Kripërat e bakrit
- B) Acidi arsenilik
- C) Helmimi nga sulfati i hekurit
- D) Helmim nga plumbi

Pyetja 68

Sindromi diarreik neonatal mjekohet me:

- A) Vetëm me antibiotikë
- B) Vetëm me elektrolitë
- C) Me antibiotikë dhe elektrolitë
- D) Vetëm me substanca adstrigjente

Pyetja 69

Sëmundja e edemave në gica mjekohet me:

- A) Vetëm me antibiotikë
- B) Vetëm me elektrolitë
- C) Me elektrolitë dhe antibiotikë
- D) Me dietë ushqimore dhe antibiotikë

Pyetja 70

Në disa gica femra të pa maturuara seksualisht u shfaqën shenja afshi si hiperestrogjenizëm, fryrje mamare dhe vulvare, vulvovaginit, estrus i zgjatur dhe pseudobarrsmëri. Cili ishte shkaku i këtyre shenjave?

- A) Helmimi nga aflatoksinat
- B) Helmimi nga mykotoksina Zearalenoni
- C) Helmimi me bimë që përmbajnë substanca estrogjenike
- D) Helmimi nga mykotoksina T₂

Pyetja 71

Në disa derra u vërejtën shenja helmimi që manifestonin uri intense, letargji, emetizëm, çrregullime nervore, leziona dermike dhe epiteliiale. Cili është shkaktari i këtyre simptomave?

- A) Helmimi nga mykotoksina Ochratoxin
- B) Helmimi nga aflatoxsin

- C) Helmimi nga mykotoksina T₂
- D) Helmimi nga mykotoksina Fumigaclavin

Pyetja 72

Gjatë kontrollit të organeve të një derri të therur sforcimisht u vunë re lezione të një pneumonie intersticiale, të karakterizuar nga mushkëri të rënda jo në kolaps me konsistencë gomoze, me zona multifokale të kuqërremta, tipike për këtë lezion dhe që korrespondojnë me shkallë të ndryshme të ashpërsisë midis lobulave pulmonare. Ky tip lezioni shkaktohet nga:

- A) Mykoplasma hyopneumoniae
- B) Virusi i gripit të derrave
- C) Virusi i sindromit PRRS
- D) Virusi i murtajës klasike

Pyetja 73

Në nekropsinë që ju bë një derri të ngordhur u konstatuan aderenca të shumta të pleurës dhe peritoneumit, të cilat janë tregues të inflamacionit të disa sipërfaqeve seroze (poliseroziti). Në këtë rast, rezistenca dhe ngjyra e bardhë e ngjitjeve tregojnë një kurs kronik (poliseroziti fibroz). Ky lezion zakonisht lidhet me infeksionin e shkaktuar nga:

- A) Actinobacillus pleuropneumoniae
- B) Haemophilus parasuis (Glaesserella parasuis)
- C) Bordetella bronchiseptica
- D) Orthomyxovirus

Pyetja 74

Nga nekropsia që ju bë një derri të ngordhur në mënyrë të papritur u vu re një sasi e madhe gjaku në stomak, sidomos në pjesën e kardias të stomakut, duke shkaktuar ngodhjen e menjëherëshme të kafshës nga hipovolemia. Ky lezion i stomakut shkaktohet nga:

- A) Hyostrongylus rhabdus
- B) Circovirus II
- C) Helmimi me kripëra të metaleve të rënda
- D) Ulçera gastroezofagale

Pyetja 75

Në nekropsinë e një derri u konstatua ekzistenca e një enteriti fibrino-nekrotik ose ulçerativ. Mëlçia paraqitet me vatra të vogla nekroze me 1-2 mm diametër, me një ngjyrë të bardhë. Ekzaminimi histologjik tregoi praninë e një koliti nekrotik me trombozë të submukozës, të lamina propria dhe mikrogranuloma hepatike. Cila sëmundje shkakton lezione të tilla?

- A) Enterotoksemia
- B) Gastroenteriti i transmetueshëm
- C) Salmoneloza digjестive
- D) Rotaviroza

11. Sëmundjet e Shpendëve

Pyetja 1

Vezët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në transmetimin e sëmundjes së:

- A) Rakitit
- B) Gutës
- C) Koksidiozës
- D) Salmonelozës

Pyetja 2

Salmonelozja është sëmundje që prek në shpendë:

- A) Aparatin tretës
- B) Aparatin respirator
- C) Veshkat
- D) Lëkurën

Pyetja 3

Gripi i shpendëve është një sëmundje virusale e cila ka përhapje:

- A) Ballkanike
- B) Europiane
- C) Pandemike
- D) Aziatike

Pyetja 4

Tuberkulozi në shpendë është një sëmundje bakteriale e karakterizuar nga formimi i tuberkulave në:

- A) Mushkëri
- B) Aparatin tretës
- C) Sistemin nervor
- D) Enët e gjakut

Pyetja 5

Rakiti në shpendë shkaktohet nga:

- A) Mungesa e vitaminës D3
- B) Mungesa e karbohidrateve
- C) Mungesa e proteinave
- D) Mungesa e vitaminës B6

Pyetja 6

Salmonelozja në shpendë konsiderohen si sëmundje:

- A) Më e shpeshtë në shpendë
- B) Të shfaqura rrallë në tufat e shpendëve
- C) Që prekin vetëm shpendët e egër
- D) Që prekin vetëm pëllumbat

Pyetja 7

Kolera e shpendëve është një sëmundje e shpendëve e cila shkaktohet nga:

- A) Escherichia coli
- B) Pasteurella multocida
- C) Mykotoksinat

D) Coronavirusët

Pyetja 8

Faktorët predispozues të shfaqjes së sindromit të të gutës janë:

- A) Ushqimet me vlera të larta proteinike që rrisin sasinë e acidit urik në organizëm
- B) Kontakti me shpendët e egër dhe migratorë
- C) Mbajtja e shpendeve në fermat miks së bashku me të imta e derra
- D) Ndricimi i shtuar artificial i mjediseve të kabanoneve

Pyetja 9

Cila është rruga kryesore e përhapjes së Mykotoksikozave:

- A) Nëpërmjet ushqimeve të kontaminuara
- B) Nëpërmjet rrugës vertikale nga tufat prinderore
- C) Nëpërmjet rrugëve inhalatore
- D) Nëpërmjet insektëve dhe hematofagëve

Pyetja 10

Sëmundja e Marekut në shpendë parandalohet nëpërmjet administrimit të:

- A) Antibiotikëve
- B) Antiparazitarëve
- C) Vaksinës
- D) Antimykotikëve

Pyetja 11

Mykotoksikonat në ushqimin e shpendëve prodhohen nga prania në të e:

- A) Bakterieve
- B) Parazitëve
- C) Myqeve
- D) Viruseve

Pyetja 12

Eritemat lëkurore në rajonin e gjoksit dhe kofsheve të shpendëve për prodhimtari mishi, janë karakteristikë klinike e:

- A) Koksidiozave në shpendë
- B) Erisipelozës në shpendë
- C) Kandidozës në shpendë
- D) Salomonelozës në shpendë

Pyetja 13

Ornitoza e shpendëve është një sëmundje bakteriale e cila prek rrugët:

- A) Respiratore
- B) Tretëse
- C) Nervore
- D) Renale

Pyetja 14

Parandalimi i lisë së shpendëve kryhet me anë të administrimit të:

- A) Antibiotikëve
- B) Vitaminave
- C) Antiparazitarëve

D) Vaksinit me gërvishje alare

Pyetja 15

Influenca aviare është sëmundje pandemike në shpendë e cila shkaktohet nga:

- A) Virus
- B) Bakter
- C) Parazit
- D) Myk

Pyetja 16

Leukoza e shpendëve është një sëmundje virusale e shpendit e cila shkakton:

- A) Dëmtime të lehta në shikim
- B) Tumore në shumë inde dhe organe
- C) Rënie të puplave
- D) Moskockëzim të sistemit kockor

Pyetja 17

Sëmundja e Marekut, është sëmundje virusale e cila shkakton:

- A) Formimin e ulcerave në lëkurë
- B) Formimin e krusteve në lëkurë
- C) Depozitim të acidit urik në arikulacione
- D) Demielinizim të nervave periferikë

Pyetja 18

Gripi i shpendëve është një sëmundje virusale pandemike e cila:

- A) Shkakton ngordhje të shpejta në shpendë
- B) Ka dekurs kronik në shpendë
- C) Ka ndjeshmëri dhe sëmundshmëri të ulët në shpendë
- D) Ka rezistencë dhe nuk ka klinikë në shpendë

Pyetja 19

Bronkiti infektiv në shpendë shkaktohet nga:

- A) Herpesvirusët
- B) Salmonellat
- C) Eimeriet
- D) Coronavirusët

Pyetja 20

Nga cila gjini bakteriale shkaktohet sëmundja e Tifos në shpendë:

- A) Salmonella
- B) Eimeria
- C) Mycoplasma
- D) Erisipela

Pyetja 21

Mykoplazkoza është një sëmundje bakteriale e shpendëve, klinika e së cilës karakterizohet nga shenja të:

- A) Aparatit respirator
- B) Aparatit tretës
- C) Mbulesës lëkurore

D) Sistemit nervor

Pyetja 22

Lija e shpendëve është një sëmundje virusale e shpendëve, e cila karakterizohet nga dy forma:

- A) Lëkurore dhe respiratore
- B) Lëkurore dhe difterike
- C) Respiratore dhe difterike
- D) Respiratore dhe nervore

Pyetja 23

Guta në shpendë është një sindrom, i cili shfaqet në dy forma:

- A) Lëkurore dhe nervore
- B) Nervore dhe viscerale
- C) Artikulare dhe viscerale
- D) Lëkurore dhe viscerale

Pyetja 24

Kampilobakterioza në shpendë është sëmundje e aparatit:

- A) Respirator
- B) Nervor
- C) Lëkuror
- D) Tretës

Pyetja 25

Klamidioza në shpendë quhet ndryshe edhe si:

- A) Ethja e papagallit
- B) Diareja e bardhë bacilare
- C) Kolera e shpendëve
- D) Tifo e shpendëve

Pyetja 26

Gripi i shpendëve, është një sëmundje virusale e cila:

- A) Prek të gjitha speciet e shpendëve
- B) Prek vetëm shpendët migratorë
- C) Prek vetëm shpendët shtëpiakë
- D) Prek vetëm pëllumbat

Pyetja 27

Guta artikulare në shpendë shfaqet klinikisht:

- A) Në artikulacionet e gjymtyrëve të poshtme
- B) Artikulacionet e gjymtyrëve të sipërme
- C) Sinuset dhe septumet nazale
- D) Në qeskat ajrore torakale

Pyetja 28

Guta artikulare në shpendë është një sindromë e shkaktuar nga:

- A) Prodhimi i mukusit në sinuse
- B) Depozitimi i urateve në artikulacione
- C) Tharja e lëngut sinovial të artikulacioneve

D) Formimi i abseseve në gjymtyrët e poshtëme

Pyetja 29

Kandidoza në shpendë është një sëmundje mykotike, kontrolli medikamentoz i së cilës bëhet me administrimin per os të:

- A) Nystatinës
- B) Tylosinës
- C) Streptomycinës
- D) Eritromicinës

Pyetja 30

Rakiti në shpendë karakterizohet nga një mungesë mineralizimi e kockave dhe klinikisht prek:

- A) Artikulacionet e sipërme
- B) Artikulacionet e poshtëme
- C) Sinuset nazale dhe frontale
- D) Septumin dhe turbinat nazale

Pyetja 31

Tuberkulozi në shpendë parandalohet nëpërmjet:

- A) Trajtimit me antibiotikë
- B) Vaksinimit të shpendëve
- C) Trajtimit me antiparazitare
- D) Eleminimit të shpendëve

Pyetja 32

Tuberkulozi është sëmundje e shpendëve e:

- A) Ditëve të para të jetës
- B) Moshave të avancuara
- C) Javëve të para të jetës
- D) Moshave të reja

Pyetja 33

Koriza infektive e shpendëve është një sëmundje me klinikë të shfaqur në:

- A) Rrugët e sipërme të frymëmarrjes
- B) Rrugët e poshtëme të frymëmarrjes
- C) Në artikulacionet e gjymtyrëve të poshtme
- D) Në lëkurën e e zonave të papupëluara (të zhveshura)

Pyetja 34

Parandalimi i shfaqjes së Mykotoksikozave në shpendë kryhet nëpërmjet magazinimit të kokrrave të drithrave të:

- A) Pabluara dhe të ruajtura në mjedise të thata
- B) Ruajtura në mjedise të lagështa
- C) Bluara
- D) Përziera me antibiotikë

Pyetja 35

Sëmundja e Pseudopestit në shpendë parandalohet nëpërmjet administrimit të:

- A) Antibiotikëve

- B) Vaksinë
- C) Antiparazitarëve
- D) Antimykotikëve

Pyetja 36

Parandalimi i sëmundjes së Marekut, në shpendë, bëhet nëpërmjet administrimit të:

- A) Antibiotikëve
- B) Antiparazitarëve
- C) Vaksinë
- D) Antiparazitarëve

Pyetja 37

Diarrjeja e bardhë bacilare në shpendë, është pjesë e klinikës së:

- A) Bronkitit infektiv
- B) Kolibacilozës
- C) Salmonelozës
- D) Gutës

Pyetja 38

Përvec aparatit respirator Mykoplazmozat në shpendë prekin edhe:

- A) Lëkurën
- B) Sinusët
- C) Zemrën
- D) Trurin

Pyetja 39

Omfalitet në zogjtë e moshave të reja janë klinikë e:

- A) Kolibacilozës në shpendë
- B) Koksidiozës në shpendë
- C) Kandidozës në shpendë
- D) Mykotoksikozës në shpendë

Pyetja 40

Kolibacilozat në shpendë janë sëmundje septicemike të cilat prekin:

- A) Vetëm aparatit tretës të shpendëve
- B) Inde dhe organe ekstraintinale të shpendëve
- C) Vetëm aparatit respirator të shpendëve
- D) Vetëm aparatit nervor të shpendëve

Pyetja 41

Laringotrakeiti ndryshe nga Bronkiti infektiv, në shpendë prek më shumë:

- A) Pulat për prodhim vezësh
- B) Gjelin e detit
- C) Papagajtë
- D) Rosat e patat

Pyetja 42

Mykoplazmozat në shpendë transmetohen me anë të:

- A) Rrugës oro-fekalorë

- B) Artropodëve
- C) Kanibalizmit
- D) Rrugëve inhalatore

Pyetja 43

Klamidioza është një sëmundje bakteriale e cila përhapet me anë të:

- A) Krusteve lëkurore
- B) Rrugëve inhalatore
- C) Rrugëve oro-fekalorë
- D) Rrugës vertikale

Pyetja 44

Sindromi i rënies së prodhimitarisë së vezëve është një sëmundje virusale e cila shkakton:

- A) Ndërprerjen e prodhimitarisë së vezëve
- B) Absese në aparatën riprodhues
- C) Pjellje të brendëshme
- D) Pjelljen e hershme të vezëve

Pyetja 45

Kandidoza është një sëmundje mykotike e cila në shpendë shkakton:

- A) Formimin e pseudomembranave në aparatën tretës
- B) Formimin e abseseve në aparatën respirator
- C) Trashje të qeskave ajrore torakale
- D) Lezione lëkurore në formën e krusteve

Pyetja 46

Histomonozë në shpendë, është një sëmundje:

- A) Virusale, që prek aparatën respirator
- B) Virusale, që prek shikimin
- C) Parazitare, që prek aparatën tretës
- D) Parazitare, që prek sistemin nervor

Pyetja 47

Zbutja e lëvozhgës së vezëve, vezët asimetrike si dhe përmbajtje e ujshme e albuminës vërehet gjatë sëmundjes së shpendëve me:

- A) Koksidiozë
- B) Tuberkuloz
- C) Bronkit infektiv
- D) Linë e shpendëve

Pyetja 48

Erisipelozë shfaqet në tufat e shpendëve të cilat mbahen:

- A) Së bashku me të imtat e derrat
- B) Në kafaze bashkë me pëllumbat
- C) Në mjedise me lageshtirë
- D) Në mjedise të ftohta dhe me korrente ajri

Pyetja 49

Sindromi i malabsorbimit është një patologji e shpendëve e cila shoqëron rritjen dhe ciklet e mbarështimit të:

- A) Pulave për prodhimtari vezësh
- B) Pulave për prodhimtari mishi
- C) Pëllumbave dhe fazanëve
- D) Rosave dhe patave

Pyetja 50

Klamidioza ose ethja e papagallit është një sëmundje e shpendëve të zbukurimit, e cila:

- A) Prek vetëm shpendët
- B) Prek shpendët dhe njeriun
- C) Prek vetëm papagallin
- D) Prek vetëm pëllumbat dhe papagallin

Pyetja 51

Salmoneloza në shpendë prekin:

- A) Traktin tretës dhe urinar
- B) Traktin tretës dhe riprodhues femëror
- C) Vetëm traktin tretës
- D) Vetëm traktin riprodhues femëror

Pyetja 52

Cila nga sëmundjet e mëposhtme të shpendëve shkakton leziona në aparatit riprodhues femëror:

- A) Koksidioza
- B) Rakiti
- C) Tuberkulozi
- D) Salmoneloza

Pyetja 53

Cila nga sëmundjet e mëposhtme të shpendëve, shkaktojnë ngordhje embrionale dhe ulje të përqindjes së çeljes së vezëve në inikubatorë:

- A) Koriza infektive
- B) Salmoneloza
- C) Erisipeloza
- D) Ornitoza

Pyetja 54

Përhapja e koksidiozave kryhet me anë të rrugës:

- A) Respiratore
- B) Lëkurore
- C) Oro-fekalore
- D) Vertikale (nëpërmjet vezëve)

Pyetja 55

Tuberkulozi në shpendë karakterizohet nga:

- A) Shtim i pakontrolluar në peshë
- B) Kasheksi progresive e shpendëve
- C) Zgjatje e kreshtës dhe lafshës
- D) Humbje e shikimit

Pyetja 56

Sëmundja e salmonelozës tek shpendët e moshës së re (1 ditëshe deri 3 javëshe):

- A) Ka ecure kronike
- B) Nuk i prek ato
- C) I prek klinikisht lehtë ato
- D) I preket klinikisht rëndë ato

Pyetja 57

Mareku është një sëmundje virusale, e cila shkakton në shpendë:

- A) Paraliza dhe tumore
- B) Ovarit dhe salpingit
- C) Celulit dhe osteomielit
- D) Kruste dhe eritema lëkurore

Pyetja 58

Mjekimi i Erisipelozës në shpendë kryhet me anë të:

- A) Penicilinës
- B) Nystatinës
- C) Amproliumit
- D) Nizoralit

Pyetja 59

Mjekimi i Koksidiozave në shpendë kryhet me anë të:

- A) Enrofloksacinës
- B) Amproliumit
- C) Nistatinës
- D) Penicilinës

Pyetja 60

Kolibacilozat në shpendë trajtohen me anë të administrimit të medikamentit të:

- A) Amproliumit
- B) Nistatinës
- C) Enrofloksacinës
- D) Dimetritazolit

Pyetja 61

Cila nga këto sëmundje të shpendëve është zoonozë dhe shkakton dizanteri tek njerëzit:

- A) Salmonelozë
- B) Mykoplazmoza
- C) Rakiti
- D) Guta

Pyetja 62

Koksidioza e shpendëve është sëmundje parazitare, e cila shkakton:

- A) Lezione në lëkurën e shpendëve
- B) Lezione në konjunktivat e shpendëve
- C) Inflamacion të mukozave intestinale
- D) Inflamacion të mukozave oro-nazale

Pyetja 63

Diagnoza diferenciale e sëmundjes së Erisipelozës në shpendë bëhet me:

- A) Rakitin e shpendëve
- B) Kolerën e shpendëve
- C) Salmonelozën e shpendëve
- D) Gutën e shpendëve

Pyetja 64

Bronkiti infektiv në shpendë shkakton prekjen e traktit:

- A) Respirator dhe tretës
- B) Respirator dhe nervor
- C) Respirator, riprodhues dhe renal
- D) Nervor, renal dhe atë tretës

Pyetja 65

Sindromi Hjarre's ose koligranulomatoza është një ndër shfaqjet klinike të shkaktuara nga infeksionet e shpendëve me:

- A) Salmonelozë
- B) Pasterelozë
- C) Kolibacilozë
- D) Mykotoksikozë

Pyetja 66

Salmonelozja dhe Tuberkulozi në shpendë kanë të përbashkët në klinikë prekjen e:

- A) Traktit tretës
- B) Sistemit nervor
- C) Sistemit respirator
- D) Mbulesës lëkurore

Pyetja 67

Mykoplazmoza është sëmundje bakteriale të shpendëve, e cila kontrollohet nëpërmjet terapisë medikamentoze me:

- A) Sulfonamide
- B) Tilmikozinë
- C) Penicillinë
- D) Amoksicilinë

Pyetja 68

Trashja uni ose bilaterale e nervit sciatic, në shpendë, është një lezion i vërejtur gjatë:

- A) Sëmundjes së Marekut
- B) Sëmundjes së Pseudopestit
- C) Kolerës në shpendë
- D) Leukozës në shpendë

Pyetja 69

Hemorragjitë në nivel të stomakut gjëndror në shpendë, janë një lezion patognomik i sëmundjes së:

- A) Kolibacilozës
- B) Koksidiozës
- C) Marekut
- D) Pseudopestit

Pyetja 70

Cili nga testet e mëposhtëme përdoret për diagnozën e salmonelozës së shpendëve në fushë:

- A) Elisa
- B) Seroaglutinimit të shpejtë
- C) Imunofluoreshencës
- D) PCR – Polimerase Chain Reaction

Pyetja 71

Mykopazmozat dhe Salmonelozat ngjajnë klinikisht për shkak se sëmundjet:

- A) Prekin sistemin tretës të shpendëve
- B) Transmetohen vertikalisht (Transovarian)
- C) Transmetohen në rrugë oro-fekalorë
- D) Shkaktojnë çrregullime nervore

Pyetja 72

Sëmundja e Pseudopestit dhe Marekut në shpendë janë të ngjashme për shkak se të dyja këto sëmundje në shpendë:

- A) Shfaqin klinikë në aparatit respirator
- B) Shkaktojnë çrregullime dhe fenomene nervore
- C) Shfaqin klinikë në aparatit tretës
- D) Shkaktojnë leziona dhe kruste në lëkurë

Pyetja 73

Koprofagia ose konsumimi i feçeve në shpendë, vihet re gjatë sindromit të:

- A) Malabsorbimit
- B) Kanibalizmit
- C) Hjarre's (Koligranulomatozës)
- D) Gutës viscerale

Pyetja 74

Vaksinimi i shpendëve kundër sëmundjes së Marekut, kryhet në shpendët e moshës:

- A) 1 ditësh
- B) 1 muajsh
- C) 3 ditësh
- D) 3 muajsh

Pyetja 75

Diagnoza diferenciale e sëmundjes virusale të Marekut bëhet me:

- A) Laringotrakeitin
- B) Gripin e shpendëve
- C) Bronkitin infektiv
- D) Leukozën

12. Toksikologji Klinike

Pyetja 1

Çfarë kuptojmë me dukurinë e “Mitridatizmit”?

- E) Është dukuria e helmimit të organizmit me substanca toksike
- F) Është dukuria e të mësuarit të organizmit me substanca toksike
- G) Është dukuria e imunizimit të organizmit me substanca toksike
- H) Është dukuria e vdekjes të organizmit me substanca toksike

Pyetja 2

Cili nga shkencëtarët ka thënë shprehjet: “Të gjitha substancat janë helme, nuk ka asnjë që nuk është helm. Doza e duhur e dallon helmin nga ilaçi.” dhe “Vetëm dozimi parandalon helmimin”?

- A) Orfila
- B) Ipokrati
- C) Paracelsusi
- D) Aristoteli

Pyetja 3

Të gjitha kafshët janë të ndjeshëm ndaj helmimit me Ethylene glycol, por nga përdorimi i gjerë në banesat tona, qentë dhe macet helmohen shpesh aksidentalisht. Cila nga substancat e mëposhtme është zakonisht origjina e helmimit me ethylen glicol në kafshët e shoqërimit?

- A) Antifriza
- B) Zbardhuesit shtëpiak
- C) Heqësit e manikyrit
- D) Bojrat e ujit

Pyetja 4

Konsumimi i frutave, farës, kërcellit ose gjetheve të avokados mund të shkaktojë toksicitet te kafshët. Në cilën nga speciet e mëposhtme, gëlltitja e sasive të mëdha të frutave të avokados ka më shumë gjasa të shkaktojë nekrozë të miokardit?

- A) Mace
- B) Papagall (Cockatiels)
- C) Qen
- D) Pula

Pyetja 5

Cilat nga kafshët e mëposhtme janë më të ndjeshme ndaj toksinave të tetanozit?

- A) Gjedhët
- B) Delet
- C) Dhitë
- D) Kuajt

Pyetja 6

Salivacioni, lotimi, urinimi dhe defekimi janë shenja klinike që lidhen me hiperstimulimin kolinergjik muskarinik dhe shkaktohen nga toksina të caktuara. Ndaj cilës prej klasave të mëposhtme të kimikateve, janë më të qëndrueshme gjatë ekspozimit shenjat klinike të përmendura më sipër?

- A) Karbamateve
- B) Metaldehidëve
- C) Hidrokarbureve të klorinuar
- D) Piretroidëve

Pyetja 7

DL₅₀ është doza e një ksenobiotiku e shprehur në mg/kg të peshës trupore, e cila nëse merret nga kafshët vetëm një herë brenda 24 orëve shkakton vdekjen e tyre në masën:

- A) 20%
- B) 50%
- C) 70%
- D) 100%

Pyetja 8

Cila nga degët e toksikologjisë merret kryesisht me përcaktimin e diagnozës klinike dhe terapinë e një helmimi, referuar dozës toksike, kinetikës dhe dinamikës së substancës helmuese?

- A) Toksikologjia mjedisore
- B) Toksikologjia klinike
- C) Toksikologjia alimentare
- D) Toksikologjia ligjore

Pyetja 9

Cila është koha që shpreh përgjigjen e saktë, në një helmim akut kur një kafshë është e ekspozuar për një here të vetme, ndaj një substance toksike?

- A) Katër orë
- B) Pesë ditë
- C) Një javë
- D) Një Muaj

Pyetja 10

Cila është koha që shpreh përgjigjen e saktë, në një helmim kronik kur një kafshë është e ekspozuar dhe ka marrë disa doza të përsëritura të një substance toksike?

- A) Dy orë
- B) Katër ditë
- C) Dy javë
- D) Një Vit

Pyetja 11

Substancat që përdoren për të luftuar (vlarë) parazitët e jashtëm si pleshta, riqna, mallofagë në qen dhe mace quhen:

- A) Insekticide
- B) Rodenticide
- C) Herbicide
- D) Repelentë

Pyetja 12

Cila është ajo pjesë apo degë e toksikologjisë, e cila studion ndryshimet që pëson në kohë përqendrimi i një substance toksike në organizëm gjatë procesit të thithjes, shpërndarjes, metabolizmit dhe eliminimit:

- A) Toksikokinetika
- B) Toksikodinamika
- C) Toksikologjia kimiko-analitike
- D) Toksikologjia e aplikuar në farmakologji

Pyetja 13

Cila është ajo pjesë apo degë e toksikologjisë e cila studion mekanizmin e veprimit dhe efektet që shkaktojnë substancat toksike në organizmin e gjallë?

- A) Toksikodinamika
- B) Toksikokinetika
- C) Toksikologjia teratogjenike
- D) Toksikologjia mutagenike dhe kancerogjenike

Pyetja 14

Blu metileni vepron si katalizator i reaksioneve oksidoreduktuese nëpërmjet të cilëve transferohen elektronet në methaemoglobinë (duke konvertuar Fe^{+++} në Fe^{++}). Ku përdoret blumetileni për mjekim?

- A) Në helmimet me Fosfororganike
- B) Në helmimet me Nitrate
- C) Në helmimet me Ure
- D) Në helmimet me metalet e rëndë

Pyetja 15

Insekticidet fosfororganike përbëjnë një nga shembujt më klasikë të veprimit të substancave helmuese në nivelin enzimatik, duke penguar aktivitetin e tyre sipas tipit konkurrues. Në cilën nga enzimat e më poshtme veprojnë fosfororganikët?

- A) mbi enzimën Ureazë
- B) mbi enzimën Rodanazë
- C) mbi enzimën Nitratoreduktazë
- D) mbi enzimën acetilkolinesterazë

Pyetja 16

Cila nga substancat e mëposhtme përdoret në helmimet me fosfororganikë dhe karbamatet si terapi simptomatike?

- A) Atropina
- B) Blu metileni
- C) Acidi salicilik
- D) Diazepami

Pyetja 17

Në cilat nga substancat e mëposhtme gjysmëjeta mjedisore lëviz nga 2 deri në 10 vjet:

- A) Fosfororganikët

- B) Karbamatet
- C) Klororganikët
- D) Piretroidet

Pyetja 18

Përbërjet fosfororganike tek kafshët ndikojnë kryesisht në sistemin nervor, të cilat zhvillojnë disa stadi të helmimit. Cila nga stadiet e mëposhtme është e gabuara?

- A) Akut, në tre ditët e para.
- B) I ndërlikimeve, nga dita e 4-të deri në 14-të.
- C) I mesëm, deri në 6 muaj.
- D) Afatëgjatë, që mund të zgjasë deri në tre vjet.

Pyetja 19

Në cilin grup të insekticideve bën pjesë Cypermethrina?

- A) Klororganikëve
- B) Fosfororganikëve
- C) Piretroidëve
- D) Karbamatëve

Pyetja 20

Cila nga kafshët e mëposhtme është më e ndjeshme ndaj piretroidëve?

- A) Qeni
- B) Macja
- C) Lopa
- D) Delja

Pyetja 21

Nga cili prej produkteve të mëposhtme helmohen më shpesh macet?

- A) Spot-on që përdoren në qen me përmbajtje piretroidesh
- B) Shampo antiparazitare me përmbajtje piretroidesh
- C) Sray antiparazitar me përmbajtje piretroidesh
- D) Pluhur antiparazitar me përmbajtje piretroidesh

Pyetja 22

Cili prej produkteve të mëposhtme është në grupin e rodenticidëve antikoagulant:

- A) Striknina
- B) Varfarina
- C) Antu
- D) Fosfuri i zinkut

Pyetja 23

Cili është mjekimi specifik në helmimin e një qeni me rodenticidë antikoagulantë:

- A) Përdorimi i vitaminës K₁, I/V ose P/O
- B) Përdorimi i glukonatit të kalciumit, I/V
- C) Përdorimi i hiposulfitit të natriumit, I/V
- D) Përdorimi i glukozës, I/V

Pyetja 24

Në një stallë vicash për majmëri në dt. 2 Shkurt 2021 u shtua për herë të parë në racionin ushqimor në orën 8.00 të mëngjesit, 500 gr Ure në briketa, si shtesë burimi proteinik. Pas 2-3 orësh filluan shqetësime në vica me shenja timpanie dhe pas 5 orësh u therën 2 sforcimisht 2 vica. Me cilin nga produktet e mëposhtme do të ishte mjekimi i duhur për rastin konkret?

- A) Ruminator
- B) Acid acetic (uthull)
- C) Blu metilen
- D) Karbonat kalciumi (sodë)

Pyetja 25

Cili është mekanizmi kryesor i veprimit të rodenticidëve antikoagulantë:

- A) Pengimi i enzimës tirozinazë
- B) Pengimi i faktorëve të koagulimit të gjakut
- C) Pengimi (bllokimi) i enzimës akonitazë
- D) Pengimi (bllokimi) i enzimës rodanazë

Pyetja 26

Me cilin nga helmimet e mëposhtme ngjyra e gjakut është e errët si çokollatë:

- A) cianure
- B) nitrate
- C) ure
- D) zhivë

Pyetja 27

Duke u mbështetur në mekanizmin e veprimit të metaleve të rëndë, cila është preferenca e tyre për t'u lidhur me:

- A) enzimën nitratorreduktazë
- B) enzimën ureazë
- C) enzimën në grupet "SH" të tyre
- D) enzimën rodanazë

Pyetja 28

Me cilin nga helmimet me metale të rëndë kemi karakteristikë klinike triadën, xhinxhivit, enterit dhe nefrit:

- A) Pb (plumb)
- B) As (arsenic)
- C) Cu (bakër)
- D) Hg (zhivë)

Pyetja 29

Me cilin nga helmimet me metale të rëndë kemi karakteristikë grumbullim të lartë të metalit në kocka:

- A) Pb (plumb)
- B) As (arsenic)
- C) Cu (bakër)
- D) Hg (zhivë)

Pyetja 30

Cila nga kafshët e mëposhtme është më e ndjeshme ndaj helmimeve nga bakri (Cu):

- A) Kali
- B) Dhija
- C) Delja
- D) Qeni

Pyetja 31

Cila nga shenjat klinike është më tipike për helmimet nga ureja:

- A) Timpania
- B) Diarreja
- C) Salivacioni
- D) Lotimi

Pyetja 32

Përse ngjyra e gjakut është e errët si çokollatë në helmimet me nitrate:

- A) Sepse ka sasi të lartë të hemoglobinës (Hb)
- B) Sepse ka sasi të lartë të methemoglobinës (metHb)
- C) Sepse ka sasi të lartë të oksigjenit (O₂)
- D) Sepse ka sasi të lartë të dyoksidit të karbonit (CO₂)

Pyetja 33

Helmimet me tuberet e patates mund të ndodhin më shpesh në derra, pastaj në dhen e gjedhë dhe më pak në kuaj e dhi. Cila është lëndë helmuese që shkakton intoksikimin në kafshë?

- A) Oksalatet
- B) Solanina
- C) Gosipoli
- D) Cianuret

Pyetja 34

Për mjekimin e helmimeve nga nitratat dhe nitritet në lopë përdoret Blumetileni në tretësirë ujore 0,5-1 % në doza 4-10 mg / kg peshë të gjallë. Mund të përdoret dhe në tretësirë 1 % në glukozë 25 % që quhet dhe tretësira kromosmon, në këtë rast përdoret në masën 0,5 - 1 ml / kg peshë. Cili është roli apo mekanizmi i blumetilenit në trajtimet e përmendura mësipër?

- A) Shton sasinë e hemoglobinës (Hb) në gjak
- B) Shton sasinë e oksigjenit në gjak
- C) Pakëson sasinë e methemoglobinës (metHb) në gjak
- D) Shndërron methemoglobinën (metHb) në hemoglobin (Hb)

Pyetja 35

Mishi i kafshëve të helmuara me nitrate konsumohet pasi të jetë bërë analiza për nivelin e ngarkesës toksike. Mishi i kafshëve të therura sforcimisht nga helmimi me nitrate/nitrite, nuk duhet të rrijë gjatë në frigorifer, sepse mund të:

- A) shtohet sasia e nitrateve
- B) krijohen nitrozamina
- C) shtohet sasia e nitriteve
- D) shtohet sasia e methemoglobinës

Pyetja 36

Cila nga kafshët e mëposhtme është më e ndjeshme nga helmimi me ure:

- A) Lopa
- B) Kali
- C) Qeni.
- D) Macja

Pyetja 37

Cila nga dozat e mëposhtme është doza letale e uresë e marrë nëpërmjet ushqimit në ripërtpës:

- A) 0,2 gr për kg peshë trupore.
- B) 12 gr për kg peshë trupore.
- C) 20 gr për peshë trupore.
- D) 1-1,5 gr për kg peshë trupore.

Pyetja 38

Ureja në vetvete nuk është helmuese, ajo bëhet e tillë mbasi zërthehet në organizmin e ripërtpësve nën efektin e fermentit ureazë, e cila është shumë aktive. Kështu një molekulë e saj është në gjendje të zërthejë deri 500 milionë molekula ure. Cili është gazi i dëmshëm që çlirohet në rumen nga zërthimi i uresë dhe që më pas thithet në gjak?

- A) Amoniaku
- B) Oksigjeni
- C) Dyoksidi i karbonit
- D) Azoti.

Pyetja 39

Cili nga gazet që çlirohet në rumen nga zërthimi i uresë dhe pas thithjes në gjak krijon shenjën klinike karakteristike (patognomike) të quajtur “Opistotonus”?

- A) Sulfuri i hidrogjenit (H₂S)
- B) Oksigjeni (O₂)
- C) Dyoksidi i karbonit (CO₂)
- D) Amoniaku (NH₃)

Pyetja 40

Cilat janë gazrat kryesore që formohen nga zërthimi i uresë nga ureaza në rumen dhe që klinikisht na japin timpaninë e rumenit?

- A) Amoniaku (NH₃) dhe dyoksidi i karbonit (CO₂)
- B) Oksigjeni (O₂) dhe dyoksidi i karbonit (CO₂)
- C) Oksidi i karbonit (CO) dhe Oksigjeni
- D) Oksidi i karbonit (CO) dhe dyoksidi i karbonit (CO₂)

Pyetja 41

Në mjekimin e kafshëve të helmuara me ure duhet të synojmë të bllokojmë aktivitetin e enzimës ureazë dhe të favorizojmë diurezën. Një nga mënyrat për të ulur aktivitetin e ureazës është të ulim pH ruminal. Cili nga acidet e mëposhtme mund të përdoret për uljen e pH ruminal në helmimet me ure?

- A) Acid acetic
- B) Acid klorhidrik

- C) Acid nitrik
- D) Acid fosforik

Pyetja 42

Ureja si shtesë proteinike në ushqimin e kafshëve, ka gjetur e po gjen një përdorim të gjerë edhe në vendin tonë. Si duhet ta përdorim urenë për të mënjanuar rreziqet e helmimit?

- A) Të fillojmë me dozë 50 g/kv p. gj. në racionin ushqimor të kafshëve
- B) Të fillojmë me doza të vogla, 15-20g/kv p. gj, për dy javë në racionin ushqimor
- C) Të përdorim dozë 60 g/kv p. gj. në racionin ushqimor të kafshëve
- D) Të përdorim 70 g/kv p. gj. në racionin ushqimor të kafshëve

Pyetja 43

Një mace me moshë 5 vjeç ka shenja klinike: anoreksi, sialorre, diarre, dridhje muskulare, depresion, ataksi, hipersalivacion, miozë, dispne, fashikulacione muskulare, reflekset kraniale dhe spinale ishin normale, përgjigjet muskulare të ulura. Analizat e gjakut janë në normë, analizat e urinës në normë. Cila është diagnoza?

- A) Helmim nga Piretroidët
- B) Helmim nga fosfoorganikët/Karbamatet
- C) Helmim nga klororganikët
- D) Helmim nga metaldehidet

Pyetja 44

Bërsitë e pambukut përdoren si shtesë ushqimore për kafshët. Cila është lënda helmuese që gjendet në bërsitë e pambukut dhe shkakton helmime gjatë përdorimit të tyre në racionet ushqimore të kafshëve?

- A) Nitrate
- B) Gosipoli
- C) Cianide
- D) Tanina

Pyetja 45

Në ekzaminimin klinik të një qeni 6 vjeç, mashkull kemi simptomat si më poshtë: ënjtje nënmandibulare, hematuri për 3 ditë, prani gjaku të freskët në nivel të prepuciumit, masë fluktuante prej 7,5 cm. Kemi prani gjaku në urinë, kurse analizat e gjakut janë normale. Pas 12 orësh qeni ka depresion, feçe blu në të gjelbër, temperature 37,4°C, frekuenca kardiake 152/min, frekuenca respiratore 40/min, mukoza të zbehta, epistaxis i lehtë, rrjedhje gjaku e lehtë nga xhinxhivat. Test i gjakut: Hct 22 %. Cila është diagnoza bazuar në klinikën e mësipërme?

- A) Helmim nga Piretroidët
- B) Koagulopati
- C) Helmim nga rodenticidët antikoagulant
- D) Helmim nga metaldehidet

Pyetja 46

Një qen racë e përzierë, mosha 5 vjeç, mashkull, jeton jashtë në hapësirë në klinikë vjen me këto simptoma: të vjella, depression, prej një dite pi më shumë ujë, ka kaluar një krizë konvulsive, ataksi, dehidratim, takipne e lehtë, takikardi (acidozë metabolike) dhe pas 12 orësh shfaqen shenja të një insuficënce renale akute (oliguri, anoreksi, vjellje) kurse analiza e gjakut rezulton me hiperazotemi, rritje e Hct, si dhe acidozë. Në analizat e urinës kemi prezencë kristalesh të oksalatit të kalciumit. Cila është diagnoza bazuar në klinikën e mësipërme?

- A) Faza e ketoacidozës në diabetin miellitus
- B) Pankreatit
- C) Helmim nga etilen glikoli
- D) Helmim nga melamina

Pyetja 47

Qen pastor 6 vjeç, femër, jeton në oborr dhe ushqehet me ushqimet komerciale. Ka këto shenja klinike: 3 ditë me konvulsione, salivacion, përthypje, dridhje dhe lëvizja e këmbëve si të ishte duke pedaluar, depresion, ataksi, përgjigje e dobët ndaj stimujve, temperatura 39.5 °C, frekuencë kardiake 120/min, frymëmarrje e vështirësuar, dhimbje abdominale, miokloni e muskujve fleksor të gjymtyrëve të pasme. Testi i dirofilariozës pozitiv. Ekzaminimi i gjakut na jep prezencë eritrocitësh me bërthamë dhe eritrocitësh me granula bazofile, nuk ka anemi. Cila është diagnoza bazuar në klinikën e mësipërme?

- A) Distemper
- B) Helmim ushqimor
- C) Helmim akut nga plumbi
- D) Infarkt cerebro-vaskular (dirofilaria)

Pyetja 48

Qen labrador retriever, 2 vjeç, femër me simptoma: Letargji prej disa orësh, qeni ka gëlltitur 4 cm të një kollareje antiparazitare, mukoza të thara, temperatura 38°C, midriazë me refleks pupilar të ngadaltë, frekuenca kardiake 57/min. Test i gjakut: hiperglicemi dhe testi i urinës: në normë. Cila është diagnoza bazuar në klinikën e mësipërme?

- A) Helmim me amitrazë
- B) Helmim me piretroidë
- C) Helmim ushqimor
- D) Helmim nga plumbi

Pyetja 49

Në një tufë delesh të ekspozuara në diell, u shfaqën në mënyrë të papritur: anoreksi, fotofobi, konjuktivite. Pas disa orësh në pjesët e pambuluara (me qime/lesh) e të papigmentuara (vulva, skrotumi, perineumi, gjijtë, turinjtë, veshët), u vërejt nxirje, edema dhe dhimbje në prekje që shkonin deri në formimin e vezikulave, pustulave e plagëve. Cila nga bimët e konsumuara ka sjellë efektin fotodinamik?

- A) Tërfilet e ndryshëm gjatë kullotjes
- B) Misri degë, i njomë i dhënë në grazhd
- C) Sillazhi i misrit, i dhënë në grazhd
- D) Ushqimi i koncentruar, i dhënë në grazhd

Pyetja 50

Në një tufë derrash që ushqehen në natyrë me jonxhë, tërfil, lupin dhe koncentratë nga ekspozimi i gjatë në diell shfaqen papritur anoreksi, fotofobi, konjuktivite. Pas disa orësh në pjesët e pambuluara (me qime/lesh) e të papigmentuara (vulva, skrotumi, perineumi, gjijtë, turinjte, veshët), u vërejt nxirje, edema dhe dhimbje në prekje që shkoi deri në formimin e vezikulave, pustulave e plagëve pas kruarjeve të forta. Cili është shkaku i gjendjes së mësipërme?

- A) Helmim nga bimët fotosensibilizuese
- B) Urtikariet alergjike
- C) Pruritozë parazitare
- D) Aujesky

Pyetja 51

Në raste kafshimesh nga merimanga e quajtur vejusha e zezë (*Latrodectus mactans*), çfarë sugjerohet të përdorim që të kemi efektin maksimal të mundshëm:

- A) Morfinë
- B) Antidod specifik
- C) Glukonat calciumi
- D) Antibiotikë

Pyetja 52

Mykotoksinat janë:

- A) myqe të gjinive të ndryshme
- B) metabolitë sekondarë të myqeve
- C) klasë kimike unike dhe e veçantë
- D) toksina të myqeve të ndryshme

Pyetja 53

Në cilën temperaturë shkatërrohen mykotoksinat?

- A) 100°C
- B) 110°C
- C) 120°C
- D) Janë termostabile

Pyetja 54

Ku gjendet përqëndrimi më i lartë i mykotoksinave në shpendë?

- A) Mëlçi
- B) Veshka
- C) Vezë
- D) Muskuj

Pyetja 55

Çfarë përbën problem për shëndetin e konsumatorëve përsa i përket mykotoksinave?

- A) Eleminimi i tyre nëpërmjet urinës
- B) Eleminimi i tyre nëpërmjet feceve
- C) Eleminimi i tyre nëpërmjet pështymës

D) Eleminimi i tyre nëpërmjet qumështit

Pyetja 56

Cili nga shkaktarët e mëposhtëm nuk kanë veti antigjenike:

- A) Salmonelat
- B) Mykotoksinat
- C) Pasterelat
- D) Mykobakteriet

Pyetja 57

Për cilën nga patologjitë e mëposhtme deri më sot nuk mund të prodhojmë vaksina:

- A) salmonelozën
- B) mykotoksikozën
- C) pasterelozën
- D) koksidiozën

Pyetja 58

Për cilën nga patologjitë e mëposhtme nuk ka protokoll mjekimi të mirfilltë:

- A) salmonelozën
- B) mykotoksikozën
- C) mykozën
- D) pasterelozën

Pyetja 59

Cila nga akronimet e mëposhtme përfaqëson sasinë maksimale të një substance kimike të lejuar për t'u konsumuar pa efekte dëmtoese në organizëm:

- A) NOEL
- B) ADI
- C) MRL
- D) PPM

Pyetja 60

Pas spërkatjes së ullinjve me Rogor, delet që kanë kullotur në ullishtë shfaqën shenja jargëzimi, dridhje muskulare, vështirësi në frymëmarrje, etj. Nga se është shkaktuar helmimi i tufës së deleve?

- A) piretroidët
- B) metalet e rëndë
- C) fosfororganikët
- D) rodenticidët

Pyetja 61

Një tufë delesh të qethura u banjëzua me Cypermethrine 10 % dhe pas 4 orësh shfaqën shenja helmimi. Nga se është shkaktuar helmimi i tufës së deleve?

- A) fosfororganikët
- B) piretroidët
- C) bimët fotosensibilizuese

D) karbamatet

Pyetja 62

Çokollata për konsum human nuk duhet t'i jepet qenve pasi ajo ka në përbërje:

- A) Teofilinë
- B) Teobrominë
- C) Kafeinë
- D) Karbohidrate

Pyetja 63

Cila nga akronimet e mëposhtme përfaqëson sasinë e një substance kimike të marrë çdo ditë gjatë gjithë jetës pa dhënë "asnjë efekt të vlerësueshëm":

- A) NOEL
- B) ADI
- C) MRL
- D) PPM

Pyetja 64

Cila nga substancat e mëposhtme janë hormone seksuale sintetike që stimulojnë shtesën e peshës (anabolizantë) dhe sipas ligjit të shërbimit veterinar nuk duhen përdorur për stimulimin e prodhimit në kafshë:

- A) Trenbolon
- B) Avilamycine
- C) Tylosine
- D) Prostoglandina

Pyetja 65

Në kontrollin e një materniteti në një kompleks derrash në muajin shkurt 2020, dalluam disa nga gicat femra 7 ditëshe më vulva të fryra dhe me shenja të estrusit. Dosat ushqehen me ushqime të koncentruara. Misri i racionit ushqimor vjen nga depot e kompleksit dhe është në përfundim. Çfarë duhet t'i rekomandoni fermerit:

- A) Ushqimi është i invaduar me kimikate
- B) Ushqimi ka mykotoksina të grupit Zearalenone
- C) Ushqimi ka substancë hormonale
- D) Ushqimi ka përzierje me antibiotikë

Pyetja 66

Në se nga analizat e ushqimit që kanë konsumuar lopët e qumështit në një kompleks kemi konstatuar Aflatoksina B1. Çfarë mund të konstatojmë gjatë kontrollit laboratorik të qumështit?

- A) Aflatoksinën B1
- B) Aflatoksinën M1
- C) Aflatoksinën B2
- D) Aflatoksinën M2

Pyetja 67

Cila është origjina e grupit të sëmundjeve që quhen mykotoksikoza?

- A) myqet
- B) mykotoksinat
- C) mykobakteriet

D) toksinat e algave

Pyetja 68

Aflatoksinat janë metabolitë sekondarë të myqeve:

- A) *Aspergillus flavus*
- B) *Aspergillus ochraceus*
- C) *Aspergillus clavatus*
- D) *Aspergillus versicolor*

Pyetja 69

Cili nga akronimet e mëposhtme përdorim për të shprehur dhe për të përcaktuar një pjesë për një milion pjesë:

- A) PPT
- B) PPB
- C) PPM
- D) Mcg

Pyetja 70

Në lumenj, liqene, pellgje, mostrat toksikologjike për analizat e ujit merren në shishe qelqi në disa vende dhe në thellësi të ndryshme deri 10-20 cm nga fundi i tyre. Sa duhet të jetë sasia e mostrës së marrë?

- A) 0.5-1 litra
- B) 2-3 litra
- C) 5-6 litra
- D) 8-9 litra

Pyetja 71

Në cilin nga helmimet e mëposhtme përdoret si antidot specifik Dimerkaproli(BAL)?

- A) Zhivë (Hg)
- B) Zink (Zn)
- C) Karbamate
- D) Rodenticidë

Pyetja 72

EDTA bisodike kalcike ($\text{EDTA-Na}_2\text{Ca}$) përdoret me rezultate të mira në disa helmime pasi ka aftësi të krijojë lidhje me shkaktarin e helmimit, pra shërben si lidhës duke e nxjerrë substancën helmuese nga organizmi i kafshës. Doza e përdorimit është 110 mg/kg në ditë, e ndarë në 3-4 herë në ditë, duke e holluar 1g/ml me dekstrozë 5% për 1-2 javë i/v ose p/o. Në cilin nga helmimet e mëposhtme përdoret EDTA- Na_2Ca ?

- A) Në helmimet me Arsenik (As)
- B) Në helmimet me Plumb (Pb)
- C) Në helmimet me kloororganikë
- D) Në helmimet me nitrate

Pyetja 73

Grupi i Oksimave ose Pralidoksimave (2PAM) përdoret si antidot specifik në helmimin me fosfororganikë. Cili është roli i këtij antidodi specifik?

- A) Bllokon kolinoreceptoret
- B) Riaktivizon acetilkolinesterazen (AChE)

- C) Shërben si katalizator për zërthimin e acetilkolinës
- D) Stimulon metabolizmin mikrozomal të helmit

Pyetja 74

Në një stallë me lopë qumështi kemi një helmim akut me shënja klinike si më poshtë: Jargëzim, tkurje muskulare, diarre, frymëmarrje të vështirësuar, timpani, opistotonus (kthimi i kokës prapa), pulsi i shpejtë, kolika. Një pjesë e shenjave klinike janë të njëjta për disa helmime. Cili është produkti që ka shkaktuar helmimin akut tek lopët ?

- A) Nitratet
- B) Fosfororganikët
- C) Ureja
- D) Zhiva (Hg)

Pyetja 75

Në një stallë më lopë qumështi kemi një helmim akut me shënja klinike si më poshtë : Jargëzim, tkurje muskulare, diarre, frymëmarrje të vështirësuar, timpani, miozë, pulsi i shpejtë, kolika. Një pjesë e shenjave klinike janë të njëjta për disa helmime. Cili është produkti që ka shkaktuar helmimin kronik tek lopët ?

- A) Nitratet
- B) Fosfororganikët
- C) Ureja
- D) Zhiva (Hg)

13. Sëmundjet infektive dhe epidemiologji veterinarë

Pyetja 1

Studimi i frekuencës, i shpërndarjes dhe i determinantëve të sëmundjes në një popullatë njihet si:

- A) Mjekësi parandaluese
- B) Epidemiologji
- C) Shëndet publik veterinar
- D) Shkenca e jetës

Pyetja 2

Komponenti kryesor i epidemiologjisë, që e dallon atë nga disiplinat e tjera, është fokusimi i saj tek:

- A) Shëndeti i tufës
- B) Shëndeti i kafshës
- C) Sëmundjet e kafshëve
- D) Popullatat

Pyetja 3

Cila nga alternativat e mëposhtme përshkruan më së miri konceptin “Një Shëndet”:

- A) Studimi i zoonozave
- B) Një qasje bashkëpunuese multidisiplinare për arritjen e shëndetit optimal për njerëzit, kafshët dhe mjedisin

- C) Përdorimi i kafshëve si modele për sëmundjet e njeriut
- D) Rritja e ndikimit të shkencës veterinare në hartimin e politikave kombëtare e ndërkombëtare

Pyetja 4

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk përfshihet në katër llojet kryesore të studimeve epidemiologjike:

- A) Studimi Kohort (Cohort)
- B) Studim rasti
- C) Studim ndër sektorial (longitudinal)
- D) Studimi Microarray

Pyetja 5

Cila prej situatave të mëposhtme përdoret për të përshkruar më së miri termin pandemi:

- A) Një sëmundje që prek një pjesë të madhe të popullatës në shumë vende
- B) Një sëmundje që është vazhdimisht e pranishme në një nivel të lartë, duke prekur të gjitha grupmoshat në mënyrë të barabartë
- C) Një rritje e papritur e numrit të rasteve të një sëmundjeje infektive në një popullatë
- D) Sëmundje që ndodh në mënyrë të parregullt dhe të rastësishme

Pyetja 6

Cili nga opsionet në vijim përshkruan më mirë përqindjen e individëve jo të sëmurë në fillim të periudhës së studimit të cilët sëmuren gjatë kësaj periudhe:

- A) Norma e incidencës
- B) Incidenca kumulative
- C) Prevalenca
- D) Norma e prekjës

Pyetja 7

Cila nga alternativat e mëposhtme është përkufizimi i saktë i “periudhës së inkubacionit” të një infeksioni:

- A) Periudha kohore midis infeksionit dhe eliminimit të agjentit
- B) Periudha kohore midis fazave analoge të një sëmundjeje infektive, gjatë një infeksioni zinxhir që përhapet dkt nga kafsha tek kafsha
- C) Periudha kohore e nevojshme për shumëzimin e patogjenit në mjedis
- D) Periudha kohore midis infeksionit dhe zhvillimit të shenjave klinike

Pyetja 8

Duke ditur se agjentët patogjenë kanë mekanizma mbijetese që konsiderohen si “strategji për ruajtjen e tyre”. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një strategji e tillë?

- A) Variacioni antigjenik
- B) Induksioni i imunosupresionit
- C) Parazitizmi intracelular
- D) Kufizimi për një specie të vetme bujtëse

Pyetja 9

Cili nga parametrat e mëposhtëm nuk është i nevojshëm për të llogaritur numrin bazë riprodhues, R_0 (transmetueshmërinë e një sëmundjeje infektive/infeksioni):

- A) d , kohëzgjatja e infektivitetit
- B) β , rreziku i transmetimit për kontakt
- C) S , përqindja e popullsisë që është e ndjeshme/receptive
- D) κ , numri i kontakteve për njësi kohore

Pyetja 10

Cili nga opsionet e mëposhtme për madhësinë e mostrës që kërkohet për vlerësimin e përhapjes së një sëmundjeje në një popullatë, është e vërtetë:

- A) Sa më e lartë saktësia e kërkuar, aq më e ulët është madhësia e kampionimit të kërkuar
- B) Madhësia e kërkuar e kampionimit do të jetë më e madhe nëse prevalenca e pritshme është 5% krahasuar me 20%
- C) Një kampionim i vetëm i rastësishëm kërkon një madhësi më të madhe të mostrës sesa një mostër e rastësishme e grupit
- D) Madhësia e kërkuar e kampionimit do të jetë më e ulët nëse prevalenca e pritshme është 65% krahasuar me 50%

Pyetja 11

Bazuar në të dhënat e tabelës, cila nga alternativat e mëposhtme është formula e saktë për llogaritjen e rrezikut relativ?

Tabela e kontigjencës 2×2 e ndërtuar për studimet vëzhguese.

Komponenti	Kafshë të sëmura	Kafshë të pasëmura	Totali
Faktor i hipotezuar i rrezikut i pranishëm	a	b	$a + b$
Faktori i hipotezuar i rrezikut mungon	c	d	$c + d$
Totali	$a + c$	$b + d$	$a + b + c + d = n$

- A) $[a/(a + b)] - [c/(c + d)]$
- B) $[a/(a + b)]/[c/(c + d)]$
- C) $[a/c]/[b/d]$
- D) $[(b/a)/(a + b)] + [(d/c)/(c + d)]$

Pyetja 12

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk do të ndikojë në prevalencën e antitropave të pranishme në popullatë:

- A) Shkalla e infeksionit
- B) Kohëzgjatja e shenjave klinike
- C) Koha nga fillimi i infeksionit
- D) Gjysmëjeta e antitropit

Pyetja 13

Cila nga alternativat e mëposhtme mund të shkaktojë një rezultat fallso-pozitiv në një test serologjik:

- A) Testet insensitive
- B) Testet në kohën e gabuar
- C) Infeksioni aktual
- D) Reaksionet e kryqëzuar

Pyetja 14

Përqindja e rezultateve të vërteta pozitive që zbulohen nga një test diagnostik, i referohet termit:

- A) Saktësi
- B) Sensitivitet
- C) Specifitet
- D) Vlera parashikuese

Pyetja 15

Cila prej alternativave të mëposhtme mund të interpretojë vlerën pozitive të parashikuar të një testi diagnostik:

- A) Prevalenca e pozitivëve të vërtetë midis kafshëve të rezultuara negativ ndaj testit
- B) Prevalenca e rasteve të vërteta pozitive në popullatën e përgjithshme
- C) Prevalenca e pozitivëve të vërtetë në kafshët e rezultuara pozitiv ndaj testit
- D) Incidenca e pozitivëve të vërtetë të cilët rezultojnë pozitiv ndaj testit

Pyetja 16

Cili nga opsionet e mëposhtme përkufizon më saktë rrugën e transmetimit të sëmundjes së Metritit kontagjioz të pelave?

- A) në rrugë aerogene.
- B) me vektorë.
- C) në rrugë digjестive.
- D) në rrugë kongjenitale.

Pyetja 17

Një protokoll testimi, në të cilin kafshët që rezultojnë pozitive për secilin nga dy testet diagnostike të kryera në të njëjtën kohë përshkruhet si testimi:

- A) paralel
- B) serial
- C) sekuencial
- D) diagnostik

Pyetja 18

Cila nga këto alternativa është përcaktimi më i mirë i termit “monitorim i sëmundjeve infektive”:

- A) Identifikimi i modeleve të infeksionit aktual dhe atij të kaluar, duke përdorur teste serologjike
- B) Investigimi i vazhdueshëm i një popullate të caktuar, për të zbuluar praninë e sëmundjes për qëllime kontrolli, që mund të përfshijë testimin e një pjese të popullsisë

- C) Ekzaminimi i rasteve klinike të prekur nga sëmundjet e specifikuara
- D) Mbledhja rutinë e informacionit mbi sëmundjet, produktivitetin dhe karakteristikat e tjera që mund të lidhen me to në një popullatë.

Pyetja 19

Cila nga këto përkufizime është më i mirë i "survejancës së synuar/target":

- A) Mbledhja e informacionit specifik për një sëmundje të përcaktuar, në mënyrë që niveli i saj në një popullatë target mund të matet dhe të monitorohet mungesa e saj
- B) Mbledhja e të dhënave në mënyrë që të sigurohet një vëzhgim i vazhdueshëm mbi sëmundjen
- C) Ekzaminimi i rasteve klinike të prekura nga sëmundjet specifike
- D) Marrjen e mostrave (duke përfshirë ekzaminimin post-mortem) të kafshëve klinikisht të shëndetshme në popullatë.

Pyetja 20

Cila nga alternativat e mëposhtme përshkruan më mirë një program, që ka për qëllim ndërhyrjen në shfaqjen e papritur të një sëmundjeje emergjente ndërkufitare, në një njësi epidemiologjike:

- A) Erradikimi
- B) Eliminimi
- C) Kontrolli
- D) Parandalimi

Pyetja 21

Cila nga alternativat e mëposhtme zakonisht përcakton kohëzgjatjen e karantinës:

- A) Periudha e inkubacionit të agjentit infektiv
- B) Periudha e inkubacionit të sëmundjes
- C) Koha e nevojshme për konfirmimin e diagnozës
- D) Koha e nevojshme që një kafshë infektive të bëhet joinfektive

Pyetja 22

Cila nga alternativat e mëposhtme përshkruan më së miri një strategji që përfshin therjen e të gjitha kafshëve të sëmura dhe në kontakt me to, eliminimin e kufomave të tyre dhe pastrimin e dezinfektimin e ambienteve:

- A) Kthimin e ngarkesës
- B) Mbulimin e plotë vaksinal
- C) Asgjësimin e të gjithë kafshëve të prekura dhe atyre në kontakt me to
- D) Therjen e kafshëve me shenja klinike

Pyetja 23

Sensitiviteti i një testi diagnostik përfaqëson ropabilitetin që një kafshë:

- A) e sëmurë të rezultojë pozitiv në testin përkatës;
- B) e cila nuk është e sëmurë të rezultojë negativ.
- C) e cila nuk është e sëmurë rezulton pozitiv;

D) e sëmurë rezulton negativ në testin e aplikuar;

Pyetja 24

Specificiteti i një testi diagnostik përfaqëson propabilitetin që një kafshë:

- A) e sëmurë të rezultojë pozitiv në testin përkatës;
- B) e cila nuk është e sëmurë të rezultojë negativ.
- C) e cila nuk është e sëmurë rezulton pozitiv;
- D) e sëmurë rezulton negativ në testin e aplikuar;

Pyetja 25

Cila alternativë është e saktë lidhur me zbatimin e mjekimit të sëmundjeve infektive në kafshë.

Mjekimi rekomandohet për:

- A) të gjitha sëmundjet infektive
- B) sëmundjet zoonotike
- C) ëmundjet ndërkufitare
- D) një pjesë të sëmundjeve infektive

Pyetja 26

Cili nga alternativat e mëposhtme në lidhje me virusin e murtajës afrikane të derrit është e saktë:

- A) Gjaku me EDTA është i papërshtatshëm për zbulimin direkt të virusit përmes PCR ose izolimit të virusit
- B) Organet/indet janë më pak të përshtatshme për testin e PCR dhe izolimin e virusit
- C) Mostrat e serumit nuk mund të përdoren për zbulimin e antitropave
- D) Virusi i murtajës afrikane të derrit edhe pse virus me mbështjellje, nuk inaktivizohet lehtësisht nëpërmjet autolizës, putrifikimit, proceseve të maturimit e ngrirjes.

Pyetja 27

Një sëmundje epizootike rishfaqet si pasojë e:

- A) Ndryshimeve sasiore të popullatës
- B) Ndryshimeve cilësore të popullatës
- C) Ndryshimeve sasiore të vektorëve
- D) Amplifikimit të infeksionit

Pyetja 28

Sëmundja e brucelozës përgjithësisht mbetet me karakter enzootik sepse:

- A) Burimet e infeksionit janë të pamjaftueshëm
- B) Periudha e inkubacionit është e gjatë
- C) Rrugët e transmetimit janë të kufizuara
- D) Agjenti shkaktar është i paqëndrueshëm në mjedis

Pyetja 29

Leptomeningjiti infektiv hematogjen (infektimi i cipave të buta të trurit) favorizohet nga:

- A) Infeksionet Bakteriale

- B) Infeksionet Virale
- C) Infeksionet Mykotike
- D) Mos marrja e sasisë dhe cilësisë së kulloshtres

Pyetja 30

Meningiti granulomatoz është tipar i infeksioneve me origjinë nga:

- A) Bakteriet
- B) Viruset
- C) Prionet
- D) Mykotoksinat

Pyetja 31

Shqipëria rrezikohet të preket nga sëmundja e:

- A) Encefalitit Venezuelian
- B) Encefalitit Japonez
- C) Nilit Perëndimor
- D) Encefaliti Lindor equin

Pyetja 32

Një nga tiparet unike të shkaktarit të Listeriozës (*Listeria monocitogenes*) është:

- A) Doza infektive shumë e ulët
- B) Kalojnë nga qeliza-qelizë pa kaluar në hapsirën ndërqelizore
- C) Nuk shumëzohen në brendësi të makrofagëve
- D) Nxit përgjigje immune për gjithë jetën

Pyetja 33

Sëmundja e Listeriozës nuk ka karakter:

- A) Sporadik
- B) Enzootik
- C) Panzootik
- D) Shpërthyes

Pyetja 34

Tërbimi, pas shfaqjes së shenjave klinike në njerëz, e ka shkallën e letalitetit:

- A) Pothuajse 100%
- B) 95%
- C) 100%
- D) 50%

Pyetja 35

Janë pjestarë të ciklit silvatic të tërbimit:

- A) Njeriu
- B) Kafshët ruminante
- C) Dhelpira e kuqe

D) Macet

Pyetja 36

Forma humane e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) quhet:

- A) Sindromi Gerstmann-Straussler (GSS)
- B) Sëmundja Creutzfeldt-Jacob (CJD)
- C) Varianti i ri Creutzfeldt-Jacob (vCJD)
- D) Skrapa

Pyetja 37

Periudha e inkubacionit të encefalopatisë spongiforme të gjedhit varion:

- A) 14 – 37 ditë
- B) 4 – 7 muaj
- C) 4 – 7 vite
- D) Mbi 2 vite

Pyetja 38

Në gjedhin e sëmure nga sëmundja e encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) nuk konsiderohet material me risk specifik (MRS):

- A) Indi muskular
- B) Truri
- C) Retina
- D) Ganglioni trigemin

Pyetja 39

Strategjia për kontrollin e sëmundjes së encefalopatisë spongiforme të gjedhit (BSE) është:

- A) Ndalimi i importimit të kafshëve dhe produkteve nga vende të pastra
- B) Ndalimi i përdorimit të miellit të mishit dhe kockave të ruminantëve
- C) Vaksinimi me vakcina të çertifikuara nga autoritetet kompetente
- D) Mjekimi i kafshëve me serume hiperimune

Pyetja 40

Ju po punoni si inspektor veterinar në një zyrë veterinare rajonale dhe merrni një raport nga veterinerët praktikë në lidhje me testimin e një tufe gjedhi për qumësht. Tufa kishte 682 krerë të kategorive të ndryshme moshore dhe 225 individë kishin reaguar pozitivisht në provën standarde simultane të tuberkulinizimit (IDCST). Rezultatet janë përmbledhur në tabelën vijuese. Në kontrollin pas therjes 7 lopë kishin leziona në gjendrën limfatike supramamare dhe 14 viça kishin leziona në gjëndrat limfatike mezenteriale. Nga tufa u therën edhe 60 krerë gjedhë të cilët reaguan negativ dhe, çuditërisht në 25 prej tyre u ekzaminuan me leziona bTB.

Lloji i kafshës	Total	Pozitiv	Negativ	Reagim me leziona
Lopë	230	154	76	83
Dema	3	1	2	0
Viça	200	69	131	46
Mëzetër nën 2 vjeç	88	19	69	5

Qe/2vjeçar	66	4	62	0
Mëshqerra nën 2 vjeç	70	2	68	0
Mëshqerra/2vjeçare	21	3	18	0
Lopë të ardhura në ekonomi nga viti i kaluar	4	3	1	3
Total	682	255	427	137

Gjeni sensitivitetin diagnostik i tuberkulinizimit.

- A) 95%
- B) 84.6%
- C) 75.3%
- D) 54.4%

Pyetja 41

Në kafshët e tuberkulinizuara në kuadër të survejancës së tuberkulinizimit të gjedhit, mund të shfaqen reaksione falso-negative. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ka ndikim në shfaqjen e reaksioneve falso-negative?

- A) Rastet e avancuara të tuberkulozit
- B) Lopët e pjella 6 javë më parë apo lopët e vjetra
- C) Kafshët me tuberkuloz lëkure ose të prekura nga paratuberkulozi
- D) Potenca e ulët e tuberkulinës apo dozat e pasakta

Pyetja 42

Strategjia e kontrollit të tuberkulozit të gjedhit bazohet në:

- A) Testin e tuberkulinizimit dhe survejancën në thertore
- B) Mjekimin e kafshëve me antituberkuloide
- C) Vaksinimin e gjedhit që në moshë të re
- D) Përdorimin e serumeve hiperimune

Pyetja 43

Rruga kryesore e transmetimit të sëmundjes së tuberkulozit të gjedhit është:

- A) Transkutane
- B) Aerogene
- C) Jatrogenike
- D) Me vektorë

Pyetja 44

Cila nga speciet ka më shumë risk të mbetet bartëse (portatore) e virusit të aftës epizootike:

- A) Gjedhi
- B) Derri
- C) Njëthundrakët
- D) Qentë e macet

Pyetja 45

Nëse jeni në pozicionin e kontrollit të vendit tonë ndaj aftës epizootike, cila do të ishte strategjia e zgjedhur:

- A) Testimi dhe therja e kafshëve të infektuara dhe atyre në kontakt
- B) Asgjësimi i kadavrave të kafshëve të prekura
- C) Vaksinimi me shtamet e përshtatshme
- D) Moslejimi i hyrjes së kafshëve/produkteve nga vende endemike, karantinimi në pikat e hyrjes

Pyetja 46

Sëmundja e gjuhës blu ka mortalitetin më të lartë në:

- A) Gjedhë
- B) Derra
- C) Dhen
- D) Dhi

Pyetja 47

Sëmundja e gjuhës blu në Shqipëri është përshkruar për të parën herë në vitin:

- A) 1940
- B) 1998
- C) 1975
- D) 2014

Pyetja 48

Dallimi kryesor midis sëmundjes së septicemisë hemorragjike të gjedhit dhe ethes së transportit qëndron në faktin se në septiceminë hemorragjike është e pranishme:

- A) Bronkopneumonia
- B) Pleuriti
- C) Gangrena pulmonare
- D) Septicemia

Pyetja 49

Ethja katarrale malinje është një sëmundje me përhapje:

- A) Epizootike
- B) Enzootike
- C) Sporadike
- D) Panzootike

Pyetja 50

Në një tufë dhensh shpërthen një sëmundje. Tufa ishte trajtuar një javë më parë kundër endoparazitëve me futjen e ilaçeve me pistoletë nga një person pa eksperiencë. Nga ekzaminimi i dhenve të sëmurë, vërehej dëmtimi i membranës mukoze të pjesës kaudale të grykës (faringut). Disa krerë, për shkak të verbimit endeshin pa kuptim. Të tjerët qëndronin shtrirë dhe e mbanin kokën në njërën anë (bashkë me veshin përkatës). Vërehej pareza e

muskujve facialë. Dy krerë kishin ngordhur ndërkohë që bëhej ekzaminimi i mëtejshëm. Cila sëmundje ka gjasa të jetë shkaktuar:

- A) Tërbimi
- B) Listerioza
- C) Leptospiroza
- D) Tetanozi

Pyetja 51

Në një tufë dhish evidentohet një kec rreth 3 muajsh me paralizë të gjymtyrëve të pasme, por nuk ka temperaturë apo çrregullime oreksi. Disa nga kafshët e rritura të tufës kanë artrite, veçanërisht në artikulacionin karpal, me çalime intermitente, ndërsa disa dhi vuajnë nga mastiti indurativ, kecat e tyre kanë shtesë peshe të ulët, madje vuajnë nga uria. Cila është sëmundja e mundëshme:

- A) Masti
- B) Maedi - Visna
- C) Pareza
- D) Arteriti encefaliti kaprin

Pyetja 52

Një mëshqerrë paraqet kruarje intensive me prirje të theksuar për vetëdëmtimin e rajonit të ijeve. Ekzaminimi për ektoparazitë rezultoi negativ. Prognoza e saj ishte e keqe dhe ngordhi brenda 2 ditësh. Dy mace kishin ngordhur gjithashtu, por fillimisht ishin neglizhuar. Në të njëjtën fermë mbarështoheshin edhe derra. Për cilën sëmundje dyshoni:

- A) Aujeszky
- B) Tërbimi
- C) Pseudotërbimi
- D) Prurit infektiv

Pyetja 53

Sa mund të zgjasë periudha e inkubacionit të sëmundjes së tërbimit në qen:

- A) 6 muaj
- B) 2 javë
- C) 10 Javë
- D) 6 Javë

Pyetja 54

Një grup rruërza-milorësh që kullosin në një zonë të infestuar me rriqna, shfaqin tremor muskular dhe një pozicion karakteristik pasojë e moskoordinimit të gjymtyrëve të pasme. Në shumicën e rasteve, ngordhjet rregjistrohen brënda 48 orëve. Sëmundja shkaktohet nga një flavivirus dhe përbën rrezik për njerëzit, duke u transmetur përmes rriqnave apo qumështit të papasterizuar të kafshëve të infektuara. Për cilën sëmundje infektive bëhet fjalë:

- A) Paraliza e rriqnave
- B) Sëmundja luping
- C) Shmalleberg

D) Piemia e rriqnave

Pyetja 55

Cili nga opsionet e mëposhtëme përkufizon më saktë rrugën kryesore të transmetimit të sëmundjes së brucelozës në dhi?

- A) kryesisht në rrugë aerogene.
- B) kryesisht me vektorë.
- C) kryesisht në rrugë digjестive.
- D) kryesisht në rrugë kongjenitale.

Pyetja 56

Gjedhët preken nga një sëmundje tipike për këtë specie e quajtur diarreja virale e gjedhit. Nëse lopët infektohen gjatë fazës së parë të basmërisë, sidomos nga dita e 40 deri 120, lindin viça me infeksion persistent (IP) ose imunotolerant. Viçat IP që mbijetojnë kanë raportin Antigjen (Ag) /Antitrupe (At):

- A) Ag+/At+
- B) Ag-/At+
- C) Ag+/At-
- D) Ag-/At-

Pyetja 57

Dhentë preken nga një sëmundje tipike për këtë specie e quajtur sëmundja e kufirit (border disease). Nëse dhentë infektohen gjatë fazës së parë të basmërisë, sidomos para fitimit të imunokompetencës fetale, lindin qingja me infeksion persistent (IP) ose imunotolerant. Qingjat IP që mbijetojnë kanë raportin Antigjen (Ag) /Antitrupe (At):

- A) Ag+/At+
- B) Ag-/At+
- C) Ag+/At-
- D) Ag-/At-

Pyetja 58

Cila sëmundje është çrrënjësore në nivel global :

- A) Afta epizootike
- B) Pleuropneumonia kontagioze e gjedhit
- C) Murtaja e gjedhit
- D) Septicemia hemorragjike

Pyetja 59

Një fermer bleu dhjetë lopë barse, të cilat u përziën me gjedhin e një tufë rezidente. Lopët e blera lindën dhe kishin viça në dukje normale. Megjithatë, disa javë me vonë ndodhën shumë aborte (shpërthyes) në lopët që ishin të fermës (dështuan më shumë se 30% e tyre). Rezultatet laboratorike provuan se shkak ishte bruceloza. Cila është masa profilaktike e neglizhuar:

- A) Vaksinimi i kafshëve të blera
- B) Vaksinimi i kafshëve rezidente
- C) Kontrolli i lëvizjes së kafshëve
- D) Dezinfektimi parandalues

Pyetja 60

Cila nga sëmundjet e gjedhit ka tipike këto tre shenja: dehidratim, rrjedhje nga vrimat natyrale e diarre, përfundim fatal:

- A) Murtaja e gjedhit
- B) Afta epizootike
- C) Pleuropneumonia kontagioze e gjedhit
- D) Ethja katarrale malinje

Pyetja 61

Me cilin infeksion është ngatërruar afta epizootike në njerëz:

- A) Infeksionin e shkaktuar nga virusi i stomatitit vesikular
- B) Infeksionin e shkaktuar nga enterovirusi 71
- C) Infeksionin e shkaktuar nga virusi i ekzantemës vesikulare
- D) Infeksionin e shkaktuar nga virusi i stomatitit vesikular të derrave

Pyetja 62

Cili është materiali patologjik i zgjedhur për diagnozën laboratorike direkte (izolim ose identifikim të virusit) të aftës epizootike:

- A) Gjaku
- B) Organet parenkimatoze
- C) Fluidi dhe epiteli vesikular
- D) Truri dhe zemra

Pyetja 63

Cili nga produktet ka më pak probabilitet për të transemtuar sëmundjen e aftës nga vendet ku sëmundja ka status enzootik në ato të pastra:

- A) Mishi i dekokëzuar (pa kocka)
- B) Mielli i kockave
- C) Të brendëshmet
- D) Lëkura, qimet dhe thundrat

Pyetja 64

Cili është shkaktari dhe toksina e sëmundjes së gojës së ujshme në qingja:

- A) Escherichia coli/endotoksina
- B) Escherichia coli/ekzotoksina
- C) Clostridium perfringens tipi A/toksina alfa
- D) Clostridium perfringens tipi D/toksina epsilon

Pyetja 65

Sëmundja e enterotoksiemisë kontrollohet me sukses përmes vaksinimit. Në cilën specie ato kanë efikasitet më të ulët:

- A) Në gjedhë
- B) Në dhen
- C) Në gjedhë e dhen
- D) Në dhi

Pyetja 66

Encefalomalacia vatrore simetrike e cila ka karakter sporadik dhe haset në qingat e shkëputur dhe dhentë e rritura 10-14 ditë pas transferimit të tyre në kullota të pasura apo pas përdorimit të tantihelmintikëve, shkaktohet nga:

- A) Toksina alfa e Clostridium perfringens tipi A
- B) Toksina epsilon e Clostridium perfringens tipi D
- C) Endotoksina e Escherichia coli
- D) Ekzotoksina e Escherichia coli

Pyetja 67

Gangrena e thatë terminale në gjedhë shkaktohet nga vaskuliti i enëve periferike të gjymtyrëve të pasme dhe bishtit, si pasojë e veprimit të Endotoksinave të:

- A) Salmonella dublin
- B) Escherichi coli, shtame septicemike
- C) Escherichi coli, shtame enteroadezive
- D) Pseudomonas aureginosae

Pyetja 68

Cila nga sëmundjet përbën shembullin më të spikatur për të kuptuar/shpjeguar formën iseberg të shfaqjes së sëmundjeve infektive:

- A) Leukoza enzootike e gjedhit
- B) Tuberkulozi i gjedhit
- C) Paratuberkulozi
- D) Diarreja virale e gjedhit

Pyetja 69

Cila është rruga kryesore e transmetimit të sëmundjes së paratuberkulozit:

- A) Kulloshtira
- B) Qumështi pluhur
- C) Iatrogenike
- D) Transplacentare

Pyetja 70

Izolimi i shkaktarit të paratuberkulozit kërkon 8-16 javë e madje deri një vit. Cilin nga testet do të rekomandoni si më racional:

- A) RLK (Reaksioni i lidhjes së komplementit)
- B) AGID (Agar xhel imunodifuzioni)

- C) ELISA.
- D) Testi i lëkurës duke përdorur alergjenin Joninë

Pyetja 71

Cila nga masat e mëposhtme nuk përdoret aktualisht për kontrollin e sëmundjes së paratuberkulozit në gjedhë e dhen:

- A) Moslejimi i hyrjes së kafshëve nga tufa të infektuara në tufat e pastra
- B) Testimi periodik dhe therja e kafshëve pozitive
- C) Ndarja e kafshëve të porsalindura nga nënat pozitive
- D) Vaksinimi me vaksina të gjalla

Pyetja 72

Sëmundja e mukozave në gjedhë është një formë me përfundim fatal e diarresë virale të gjedhit. Cili është shkaktari i saj:

- A) Shtamet jocitopatike të virusit të diarresë virale të gjedhit
- B) Shtamet citopatike të virusit të diarresë virale të gjedhit
- C) Shtamet e virusit të diarresë virale të gjedhit që kalojnë barrierën placentare
- D) Shtamet e gjenotipit 1 të virusit të diarresë virale të gjedhit

Pyetja 73

Identifikimi i kafshëve me infeksion persistent nga virusi i diarresë virale të gjedhit, është një nga elementët kryesorë për kontrollin e sëmundjes. Cili është grupi target i popullatës së gjedhit për testim:

- A) Gjedhi i rritur
- B) Lopët e qumështit
- C) Viçat në ditët e para të lindjes
- D) Viçat meshkujt mbi 12 muajsh

Pyetja 74

Për konfirmimin e diagnozës së plasjes nuk dërgohet në laborator:

- A) Gjak
- B) Shpretka
- C) Tampon
- D) Strisho mikroskopike

Pyetja 75

Strategjia e miratuar për kontrollin e plasjes në Shqipëri bazohet në dy masa kryesore. Cilat janë ato:

- A) Vaksinimi me vaksina me shtam shtern dhe mjekim me antibiotikë
- B) Vaksinimi me vaksina të certifikuara dhe asgjësimin e sigurtë të kadavrave të kafshëve të ngordhura.
- C) Vaksinimi me vaksina me shtam sporale dhe mjekim me antibiotikë
- D) Dezinfektim dhe therje e kafshëve të prekura dhe atyre në kontakt.

Pyetja 76

Groposja e kadvrave të kafshëve të ngordhura nga plasja, duhet bërë në gropa me thellësi:

- A) Rreth 1 metër
- B) Rreth 4 metër
- C) Rreth 3 metër
- D) Sipërfaqja e sipërme e kadvrave të jetë të paktën 1 metër nga sipërfaqja e tokës.

Pyetja 77

Sporet e plasjes në mjedis jetojnë për dekada. Vetëm pak dezinfektantë kimikë janë në gjendje të inaktivojnë sporet e plasjes. Cili është dezinfektanti i zgjedhur që përdoret për dezinfektimin e një kafshe që ngordh në stallë, sa është përqëndrimi i solucionit të punës dhe koha e kontaktit që garanton dekontaminimin e sigurtë:

- A) Fenol, 15%, 7 orë
- B) Formalinë, 2%, 10 orë
- C) Formalinë, 5 - 10%, 4 orë
- D) NaOH, 10%, një natë

Pyetja 78

Groposja e kadvrave të kafshëve të ngordhura nga plasja duhet të bëhet në vende të licensuara nga pushteti lokal. Sa është minimumi i largësisë (në metra) nga vendburimet e ujrave sipërfaqësore dhe puseve, që duhet të jenë varrezat:

- A) 15 m
- B) 25 m
- C) 150 m
- D) 500 m

Pyetja 79

Leukoza enzootike e gjedhit është:

- A) Zoonozë e rëndësishme
- B) Zoonozë e neglizhuar
- C) Sëmundje që nuk prek njeriun
- D) Zoonozë e dorës së dytë

Pyetja 80

Biosiguria në fermë është element me rëndësi për parandalimin e transmetimit të infeksionit midis fermave/tufave dhe brenda tufave. Nëse një fermë zbaton remontimin e brendshëm, nuk lejon blerjen e kafshëve nga burime të tjera, por lejon pjesëmarrjen e tyre në ekspozita, ajo klasifikohet si fermë e kategorisë së:

- A) parë
- B) dytë
- C) tretë
- D) katërt

Pyetja 81

Kontrolli i sëmundjes së brucelozës në gjedhin me drejtim për qumësht, në tufat komerciale në Shqipëri para së gjithash bazohet në:

- A) Vaksinimin me shtamin *Brucella abortus* RB51
- B) Survejancën aktive testim dhe therje të krerëve pozitivë
- C) Vaksinimin me shtamin *Brucella abortus* S19
- D) Mjekimin e kafshëve të sëmura dhe kastrimin e meshkujve

Pyetja 82

Kontrolli i sëmundjes së brucelozës në dhen e dhi në Shqipëri bazohet kryesisht në:

- A) Survejancën pasive,
- B) Survejancën aktive testim dhe therjen e krerëve pozitivë
- C) Vaksinimin me shtamin *Brucella abortus* S19 në rrugë intrakonjunktivale
- D) Vaksinimin me shtamin *B. melitensis* Rev 1 në rrugë intrakonjunktivale

Pyetja 83

Në një tufë dhensh shpërthen një sëmundje infektive me karakter enzootik, e cila manifestohet me dështime (deri 30%) në muajin e fundit të barsmërisë, placentit, trashje dhe edemë të indeve midis kotiledoneve, edemë të mëlçisë së fetusit dhe prani të vatrave nekrotike sa koka e gjilpërës. Shkaktari eliminohet në qumësht dhe është zoonozë e rrezikshme sidomos për gratë shtatzëna. Cila sëmundje ka më shumë gjasa të ketë prekur tufën, duke përjashtuar brucelozën dhe paratifon:

- A) Klamidioza
- B) Ethja e Maleve Shkëmbore
- C) Ethja Q
- D) Kamylobakterioza

Pyetja 84

Përlllogaritjet tregojnë se numri bazë riprodhues, R_0 , për një sëmundje është 5 (aftësia që ka një individ i infektuar për të infektuar individë të tjerë receptivë në një popullatë të paeksponuar më parë). Sa duhet të jetë shkalla e mbulimit vaksinal, nëse supozohet që vaksina ka efikasitet 100% (hipotetike) dhe popullata është homogjene:

- A) 50%
- B) 60%
- C) 70%
- D) 80%

Pyetja 85

Cila vaksinë duhet përdorur ndaj sëmundjes së Aujeszkit, që vaksinimi të jetë në përputhje me një skemë erradikimi të bazuar në testimin serologjike dhe therjen:

- A) e vrarë
- B) e gjallë
- C) marker
- D) polivalente

Pyetja 86

Ju kërkohet të kastroni një muez të ri. Si mund ta mbronni atë ndaj tetanozit, në qoftë se ai nuk është vaksinuar paraprakisht dhe operacioni duhet kryer menjëherë:

- A) Duke marrë masa biosigurie të përgjithshme
- B) Duke bërë vaksinimin e tij
- C) Duke injektuar serum antitetanik
- D) Duke përdorur antibiotikë dhe antiseptikë antitetanik

Pyetja 87

Përdorimi i vaksinave intranasale për sëmundjet respiratore ka avantazhe në kafshë, përveçse:

- A) Nuk shkakton dështime në kafshët barsa
- B) Nuk shmang krijimin e portatorëve
- C) Përdoren në rastet kur ka shpërthyer sëmundja
- D) Nuk interferon me imunitetin maternal

Pyetja 88

Vaksinimi përbën "mjete" biologjik më të fuqishme për kontrollin e sëmundjeve infektive, megjithatë ka raste kur ai mund të jetë i pasuksesëshëm. Cila prej alternativave nuk është e saktë:

- A) Mospërputhja e shtamit vaksinal me atë infektiv që qarkullon në popullatë
- B) Tretja me tretës të papërshtatshëm
- C) Përdorimi i vaksinave heterologe kur ka shpërthyer sëmundja
- D) Mos zbatimi i zinxhirit ftohës për ruajtjen e vaksinave

Pyetja 89

Dezinfektimi me komponentë kimikë përbën një nga masat e rëndësishme për kontrollin e sëmundjeve infektive, megjithatë ka raste kur ai mund të jetë i pasuksesëshëm. Cila prej alternativave nuk është e saktë:

- A) Mospërputhja e dezinfektantit me agjentin patogjen
- B) Përdorimi i përqëndrimeve të ulta të përbërjeve kimike
- C) Lënia në kontakt përtej minimumit të rekomanduar
- D) Prania e lëndës organike dhe përdorimi i ujit me përmbajtje të lartë kriprash (ujë i fortë)

Pyetja 90

Cila nga sëmundjet nuk shkakton dështime si pasojë e përhapjes sistemike (formës septicemike):

- A) Ethja Q
- B) Bruceloza
- C) Fruthi i derrave
- D) Ethja e luginës Rift

14. Sëmundjet e Njëthundrakëve

Pyetja 1

Gjatë perikarditit në kuaj në qeskën perikardiale grumbullohet?

- A) Transudat
- B) Limfë
- C) Eksudat
- D) Gjak

Pyetja 2

Gjatë perikarditit në kuaj klinikisht vlerësohet?

- A) Zemra
- B) Mushkëria
- C) Stomaku
- D) Edema e nënlëkurës

Pyetja 3

Në miokarditet kronike klinikisht vërehet?

- A) Puls i fortë
- B) Edem e shprehur dukshëm
- C) Zhurmë fërkimi
- D) Mukozë hiperemike

Pyetja 4

Ju paraqitet një kalë që godet barkun e tij me këmbë dhe realizon rrotullime të fuqishme në tokë. Këto shenja tregojnë që kali shfaq?

- A) Kolik
- B) Emfizemë
- C) Dermatit
- D) Laminit

Pyetja 5

Shfaqja e rrjedhjeve të vazhdueshme bilaterale purulente nga hundët është një tregues se kali është i sëmurë nga:

- A) Butri
- B) Sinuziti
- C) Emfizema alveolare kronike
- D) Pneumotoraksi

Pyetja 6

Cilët parazitë shkaktojnë zona të mëdha të irrituara rreth rajonit perianal?

- A) Strongilët
- B) Gastrofilët
- C) Oksiurët
- D) Habronemat

Pyetja 7

Kuajt, mushkat dhe gomerët janë kafshët më të ndjeshme ndaj sëmundjes së:

- A) Tetanozit
- B) Salmonelozës
- C) Edemës malinje
- D) Limfagjitit epizodik

Pyetja 8

Cili është emërtimi tjetër për Encefalomyelitin infektiv në kuajt?

- A) Borna
- B) Botulizëm
- C) Arteriti viral
- D) Dermatiti fotosensibilizues

Pyetja 9

Cila është sëmundja më e shpeshtë respiratore infektive që prek kuajt.

- A) Rinopneumonia
- B) Influenca
- C) Arteriti viral
- D) Anemia infektive e kuajve

Pyetja 10

Shenja klinike tek një kalë përfshijnë: Temperaturë të lartë, rrjedhje seroze bilaterale nga hundët, kollë në fillim e thatë dhe e ashpër dhe më vonë produktive, depresion, anoreksi, dobësi dhe mund të shfaqen infeksione dytësore të cilat mund të shkaktojnë pneumoni, pleuropneumoni dhe bronkit kronik të cilat mund të zhvillohen gjatë periudhës së përmirësimit nga 6-8 muaj. Cila sëmundje ka prekur kafshën?

- A) Influenca (Gripi i kuajve)
- B) Rinopneumonia
- C) Arteriti viral i kuajve
- D) Anemia infektive e kuajve

Pyetja 11

Si quhet forma e Rinopneumonisë tek kuajt që shfaq shenja klinike me rrjedhje bilaterale nazale, pireksi, qepalla të enjtura, kollë të thatë, anoreksi, kapsllëk ose diarre?

- A) Respiratore
- B) Abortive
- C) Septicemike
- D) Neurologjike

Pyetja 12

Në cilin muaj të shtatzanisë vaksinohen pelat kundër EHV1 dhe EHV4?

- A) 2, 4, 6

- B) 3, 5, 7
- C) 4, 6, 8
- D) 5, 7, 9

Pyetja 13

Kur tek një kalë vërehen rrjedhje nga hundët me ngjyrë me ngjyrë të kuqëremtë, do të thotë që është i sëmurë me:

- A) Rrinit
- B) Bronkit
- C) Sinuzit
- D) Pneumoni fibrinoze

Pyetja 14

Tek një kalë me emfizemë askultojmë?

- A) Frymëmarje bronkiale
- B) Frymëmarje amforike
- C) Frymëmarje vezikulare të dobësuar
- D) Frymëmarje vezikulare të forcuar

Pyetja 15

Kali i sëmurë me emfizemë ka kohë që vuan nga kjo sëmundje. Kur perkutojmë mbi toraks çfarë tingulli do dëgjojmë?

- A) Tingull të shurdhër
- B) Tingull timpanik
- C) Tingull të qypit të plasur
- D) Tingull metalik

Pyetja 16

Gjatë askultimit në toraksin e një kali që shfaq temperaturë të lartë dhe dhimbje të toraksit dëgjoen zhurma llokoçitëse. Do të mendoni për:

- A) Hidroperikard
- B) Hidrotoraks
- C) Pleurit eksudativë
- D) Pneumotoraks

Pyetja 17

Kali pasi konsumon një pjesë të ushqimit e gëlltit atë, por pak kohë më pas e nxjerr nga hundët. Ju mendoni që procesi ndodhet në:

- A) Faring
- B) Trake
- C) Ezofag
- D) Stomak

Pyetja 18

Një kalë pasi ka qëndruar në një mjedis të ftohtë pas një pune të lodhshme në mëngjes manifeston dhimbje barku, godet tokën, ulet dhe ngrihet herë pas here. Mendoni se ka:

- A) Dilatim akut të stomakut

- B) Obstipacion të zorrëve
- C) Enteralgi katarale
- D) Meteorizëm intestinal

Pyetja 19

Pas një pune të lodhshme kali i djersitur qëndron në një ambient të ftohtë dhe defekon masa fekale të brumta deri në të qullta. Mendoni se është sëmurë nga:

- A) Obstipacioni
- B) Enteralgia katarale
- C) Obturacioni
- D) Dilatimi akut i stomakut

Pyetja 20

Lidhjet e zorrëve janë patologji që rrezikojnë jetën e kalit dhe shoqërohen me mungesë defekimi. Mendoni se mund të mjekohen me:

- A) Purgativë
- B) Spazmolitik
- C) Anti-inflamator
- D) Ndërhyrje kirurgjikale

Pyetja 21

Cila kolikë shoqërohet me mungesë defekimi?

- A) Obstipacioni
- B) Enteralgia katarale
- C) Dilatimi akut i stomakut
- D) Meteorizmi intestinal

Pyetja 22

Një kalë pas një pushimi 3-4 ditor është ushqyer mirë me koncentrat dhe ka punuar në mënyrë të sforcuar. Në mëngjes ai qëndron si i ngrirë. Gjatë urinimit vërehet urinë me ngjyrë të kuqe. Çfarë mendoni se ka?

- A) Laminit
- B) Hemoglobinuri
- C) Mioglobinuri paralitike
- D) Tetanoz

Pyetja 23

Kali ka disa ditë që merr vazhdimisht pozicionin për urinim dhe urinon pika pika. Ju mendoni se kali ka:

- A) Parezë të fshikëzës urinare
- B) Mioglobinuri paralitike
- C) Cistit kataral
- D) Nefrit

Pyetja 24

Në një kalë shfaqet prej shumë kohësh (Forma kronike) dëmtim i shtresës së sipërme të lëkurës, tipi squamous-crustose, që shoqërohet me ngritjen e lehtë lokale të temperaturës së lëkurës, enjtje dhe kruarje. Ju mendoni se ndryshimet që kafsha shfaq në lëkurë janë si pasojë e:

- A) Ekzemës
- B) Dermatitit
- C) Urtikaries
- D) Papilomës

Pyetja 25

Gjatë shfaqjes së urtikarieve në kuaj vërehen çrregullime të përgjithshme (humbje apetiti, depresion dhe ethe), formim i shpejtë dhe i papritur i pllakave edematoze, përhapje në membranën mukoze të gojës, hundës, konjuktivave, rektum dhe vaginë. Cila alternativë mendoni se nuk është trajtimi i duhur për urtikarien?

- A) Eleminohet shkaku i sëmundjes
- B) Përdorim purgativ dhe e mbajmë kafshën në dietë urie
- C) Kortikosteroid dhe antihistaminik
- D) Kardionik dhe ekspektorant

Pyetja 26

Cili është shkaku më i shpeshtë i sinusitit maksillar në kuaj?

- A) Sëmundja bakteriale e traktit të poshtëm të frymëmarrjes që shtrihet deri në sinus
- B) Infeksioni dhe abscesi i rrënjës së dhëmballës që përhapet deri në sinus
- C) Trupat e huaj që vendosen në sinus
- D) Plagët shpuesë që shkojnë deri në sinusin maksillar

Pyetja 27

Një kalë 2-vjeçar shfaq pireksi, anoreksi dhe depresion. Ekzaminimi klinik tregon rrjedhje bilaterale të hundës dhe enjtje të gjendrave retrofaringeale. Cila nga alternativat e mëposhtme është diagnoza më e mundshme?

- A) Bllokimi ezofageal
- B) Gripi i kuajve
- C) Empiema e qeskave të ajrit
- D) Butri

Pyetja 28

Tek një kalë me sëmundje të zemrës klinikisht vërehen: zhurma llokoçitëse, zhurma fërkuese, temperaturë e lartë, leukocitozë neutrofile në analiza laboratorike. Këto simptoma tregojnë që kafsha është e sëmurë nga:

- A) Hidroperikardi
- B) Hidrotoraksi
- C) Perikarditi
- D) Pleuriti

Pyetja 29

Në miokarditet akute vërehet klinikisht?

- A) Bradikardi

- B) Aritmi e zemrës
- C) Zhurmë llokoçitëse
- D) Anoreksi

Pyetja 30

Gjatë askultimit të zemrës me endokardit valvular në valvulën bikuspidale dhe trikuspidale zhurma që dëgjohe është?

- A) Organike sistolike
- B) Organike diastolike
- C) Pleuroperikardiale
- D) Fiziologjike diastolike

Pyetja 31

Cili shkak nxit shfaqjen e emfizemës në kuaj?

- A) Uji i ndotur
- B) Kushtet klimaterike
- C) Pluhuri dhe sporet e myqeve në sanë
- D) Ushqimi i peletuar

Pyetja 32

Çrregullim i sjelljes, hipersensitiviteti ndaj stimujve, lëvizje e pavullnetshme e muskujve, probleme me shikimin, lëvizje të përhumbura, rrotullim rreth vetes, ushtrim presioni me kokë ndaj një objekti të palëvizshëm, paaftësi për gëlltitje, ataksi, parezë dhe konvulsione, janë të gjitha shenjat që një kalë mund të jetë i sëmurë me:

- A) Encefalomieli
- B) Traumë të kokës
- C) Aritmi të zemrës
- D) Helmim nga ushqimi

Pyetja 33

Shenjat klinike në rastet e pakomplikuara të influencës në kuaj shfaqen deri në:

- A) 3 ditë
- B) 6 ditë
- C) 10 ditë
- D) 14 ditë

Pyetja 34

Kuajt në rastet e moderuara të influencës do të konsiderohen të shëruar pas?

- A) 2-3 javësh
- B) 4 javësh
- C) 8 javësh
- D) 12 javësh

Pyetja 35

Kuajt në rastet e theksuara të shfaqjes së influencës do të konsiderohen të shëruar pas?

- A) 3 muajsh
- B) 6 muajsh
- C) 8 muajsh
- D) 10 muajsh

Pyetja 36

Cili shtam i virusit të Rinopneumonisë shkakton aborte, vdekje të mëzave dhe sëmundje neurologjike?

- A) EHV-1
- B) EHV-2
- C) EHV-3
- D) EHV-4

Pyetja 37

Kali me pneumoni fibrinoze u perkutua në fazën e dytë të procesit dhe u konstatua:

- A) Tingull timpanik
- B) Tingull metalik
- C) Tingull i shurdhër absolut
- D) Tingull atimpanik

Pyetja 38

Tek një kalë klinikisht vërehet frymëmarje e vështirësuar që diagnostikohet si edemë pulmonare. Gjatë perkutimit çfarë do të vlerësoni:

- A) Tingull timpanik
- B) Tingull metalik
- C) Tingull i shurdhër absolut
- D) Tingull atimpanik

Pyetja 39

Një kalë manifeston vështirësi në frymëmarje, flegrat e hundës të zgjeruara dhe një dispne e shprehur ekspirative. Mendoni se kali është i sëmurë me:

- A) Emfizemë alveolare kronike
- B) Edemë pulmonare
- C) Hemiplegi të laringut
- D) Pneumotoraks

Pyetja 40

Kali mbas ngrënies në sasi të madhe të ushqimit manifeston dhimbje barku dhe merr pozicionin si qëndrimi i qenit mbi bisht. Mendoni se ka:

- A) Gastrit
- B) Costipacion
- C) Dilatim akut të stomakut
- D) Obstipacion

Pyetja 41

Pronari i kalit në klinikën veterinare i tregon mjekut veteriner një të dhënë që kali ka 3 ditë që nuk defekon. Mendoni se mund të jetë i sëmurë me:

- A) Dilatim akut të stomakut
- B) Obstipacion të zorrëve
- C) Meteorizëm të zorrëve
- D) Enteralgi katarrale

Pyetja 42

Në kontrollin rektal tek një kalë me kolikë dhe që vuan nga mungesa e defekimit, në rektum vlerësohet një mukus i trashë më ngjyrë katrani. Mendoni se kali është sëmurë nga:

- A) Lidhje zorrësh
- B) Obturacioni
- C) Obstipacioni
- D) Ulçëra e stomakut

Pyetja 43

Kali ka kohë që urinon shpesh me urine me aromë të mollës së prishur. Ka oreks të mirë dhe pi mjaft ujë. Mendoni se kafsha është sëmurë nga:

- A) Hipertiroidizmi
- B) Nefriti kronik
- C) Diabeti mellitus
- D) Mioglobiuria paralitike

Pyetja 44

Pronari ankohet se kali i tij ka dhimbje në pjesën e belit, urinon me ngjyrë të kuqe, në faqe dhe kapakët e syrit vërehet enjtje. Gjatë vlerësimit të analizave të urinës vërehet hematuri e dobët, cilindra eritrocitarë, cilindra leukocitarë, cilindra epitelial, albuminuri 3%. Mendoni se kafsha është sëmurë me:

- A) Nefrit
- B) Nefroz
- C) Cistit kataral
- D) Mioglobiuria paralitike

Pyetja 45

Një kalë garash 3-vjeçar lodhet shpejt gjatë garës dhe gjatë vrapimit në inspirium dëgjohe një zhurmë e forte në laring. Cili nga testet e mëposhtëm diagnostikues ka më shumë gjasa të përcaktojë shkakun?

- A) Ekzaminimi citologjik i sekrecioneve transtrakeale
- B) Endoskopia e laringut
- C) Radiografia e qeskave të ajrit
- D) Radiografia e toraksit

Pyetja 46

Gjatë endokarditeve dhe insuficiencës së zemrës të anës së djathtë vërehet klinikisht:

- A) Edemë pulmonare
- B) Hiperemi e mukozës

- C) Kollë produktive
- D) Edemë e nënlëkurës

Pyetja 47

Gjatë insuficiencës së anës së majtë të zemrës, klinikisht vërehet:

- A) Edemë e nënlëkurës
- B) Edemë pulmonare
- C) Ashit
- D) Zhurmë sistolike e valvulës trikuspidale

Pyetja 48

Cili infeksion diagnostikohet me anë të testit të "Coggins"?

- A) Arteriti viral i kuajve
- B) Influenca e kuajve
- C) Anemia infektive e kuajve
- D) Rinopneumonia e kuajve

Pyetja 49

Cili është faktori i nevojshëm që sporet e bacilit të tetanozit të shkaktojnë probleme në kuaj?

- A) Plagët sipërfaqësore në lëkurë
- B) Plagët e thella të shkaktuara nga mjete të prehta
- C) Prania e ekzemave në lëkurë
- D) Prania e infeksioneve parazitare

Pyetja 50

Cili nga shtamet e virusit të Rhinopneumonisë mund të shkaktojë sëmundje neurologjike që përfshin inkoordinim dhe parezë të moderuar posteriore deri në parezë të rëndë të gjymyrëve të pasme, humbjen e refleksit të fshikzës së urinës dhe bishtit, si dhe humbje të ndjesisë në rajonin perianal?

- A) EHV-1
- B) EHV-2
- C) EHV-3
- D) EHV-4

Pyetja 51

Një sëmundje shumë ngjitëse akute e kuajve të rinj, karakterizohet nga formim absesi, sidomos në gjëndrat limfatike sub-maksillare (nën nofullës), dhe inflamacion të traktit të sipërm të frymëmarrjes me rrjedhje nga hundët. Cila është kjo sëmundje?

- A) Butri
- B) Influenca
- C) Rinopneumonia
- D) Arteriti viral

Pyetja 52

Në klinikën veterinare një pronar sjell një kalë me vështirësi në frymëmarrje dhe temperaturë që nuk ndryshon gjatë ditës më shumë se 1 gradë. Gjatë askultimit konstatohet:

- A) Frymëmarrje vezikulare e dobësuar
- B) Frymëmarrje vezikulare normale
- C) Frymëmarrje bronkiale
- D) Frymëmarrje amforike

Pyetja 53

Në klinikën veterinare pronari sjell një kalë me vështirësi në frymëmarrje dhe rrjedhje nga hundët, dyshohet për hiperemi dhe edemë pulmonare. Rrjedhjet janë:

- A) Seroze
- B) Purulente
- C) Shkumore me ngjyrë rozë
- D) Hemoragjike

Pyetja 54

Gjatë kontrollit klinik të një kali me hiperemi dhe edemë pulmonare në askultim konstatoni:

- A) Frymëmarrje alveolare të dobësuar
- B) Frymëmarrje amforike
- C) Frymëmarrje bronkiale
- D) Frymëmarrje vezikulare

Pyetja 55

Mjeku veterinar gjatë kontrollit klinik të një kali me perkutim vlerëson tingull timpanik dhe në askultim frymëmarrje vezikulare të dobësuar. Kali është prekur nga:

- A) Bronkopneumonia
- B) Pleuriti eksudativ
- C) Pneumotoraksi
- D) Emfizema alveolare kronike

Pyetja 56

Cilët nerva kranialë janë në kontakt me dhomën mediale të qeses së ajrit në kuaj?

- A) Nervat kranial V, VI, VII dhe VIII
- B) Nervat kranial IX, X, XI dhe XII
- C) Nervat kranial VIII, IX dhe X
- D) Nervat kranial VIII, IX, X dhe XI

Pyetja 57

Cila nga alternativat konsiderohet një trajtim i vlefshëm për tetanozin në kuaj në fazat e hershme të infeksionit?

- A) Qetësues dhe relaksues të muskujve
- B) Pastrimi i plagës, injeksione IV penicilinë dhe antitoksinë e tetanozit
- C) Fashimi i menjëhershëm i plagës
- D) Vaksinimi kundër tetanozit i ndjekur nga antitoksina e tetanozit

Pyetja 58

Çfarë lloj sëmundjeje tek kuajt shkakton *Corynebacterium pseudotuberculosis*?

- A) Limfadenitin granulomatoz
- B) Limfadenitin kazeoz
- C) Pielonefritin
- D) Limfangitin ulçeroz

Pyetja 59

Cila nga alternativat konsiderohet një pasojë e mundshme që vjen nga empiema e qeskës së ajrit në kuaj?

- A) Hemiplegia laringeale
- B) Kondroidët
- C) Absces të gjendrave retrofaringeale
- D) Epistaksi

Pyetja 60

Cili nga alternativat konsiderohet një faktor predispozues për shfaqjen e një lipome të pedunkuluar në kuaj?

- A) Anti-inflamatorët jo steroidial
- B) Kafshimi i grazhdit
- C) Parazitët cestodë
- D) Obeziteti

Pyetja 61

Cili nga shenjat e mëposhtme mund të sugjerojë që një kalë me dhembje barku mund të menaxhohet me trajtim medikamentoz?

- A) 1.5 litra refluks të lëngjeve nga stomaku
- B) Frekuencë e zemrës 64 rrahje në minutë
- C) Depresion/gjendje e plogët
- D) Lëngu peritoneal serohemoragjik

Pyetja 62

Cili bakter është përgjegjës për shkaktimin e Butrit në kuaj?

- A) *Streptococcus equi* subsp. *zooepidemicus*
- B) *Rhodococcus equi*
- C) *Staphylococcus aureus*
- D) *Streptococcus equi* subsp. *Equi*

Pyetja 63

Cili është mekanizmi farmakologjik i veprimit të omeprazolit gjatë ulçerës së stomakut?

- A) Frenuesi i pompës protonike
- B) Antagonist i receptorit të histaminës (H₂)
- C) Antiacid
- D) Analogë i Prostaglandinës E

Pyetja 64

Cili është mekanizmi farmakologjik i veprimit të ranitidinës gjatë ulçerës së stomakut?

- A) Frenuesi i pompës protonike
- B) Analogë i Prostaglandinës E
- C) Antiacid
- D) Antagonisti i receptorit të histaminës (H₂)

Pyetja 65

Cili virus i kuajve qëndron i fshehur në gjendje latente në makrofagë?

- A) Virusi i anemisë infektive të kuajve
- B) Virusi i arteritit të kuajve
- C) Virusi i encefalitit të kuajve
- D) Virusi i sëmundjes afrikane të kuajve

Pyetja 66

Cili virus shoqërohet më shpesh me aborte në shtatzëninë e vonë në pela?

- A) Virusi i Anemisë Infektive të Kuajve
- B) Virusi i Rinopneumonisë së Kuajve EHV-1
- C) Virusi i Arteritit të Kuajve
- D) Virusi i Gripit të Kuajve

Pyetja 67

Sa kohë pas vaksinimit të parë bëhet vaksinimi i tretë ndaj gripit të kuajve?

- A) 14 -16 ditë
- B) 21 - 92 ditë
- C) 150 - 215 ditë
- D) 365 - 550 ditë

Pyetja 68

Cilat gjetje kliniko-patologjike ndihmojnë në vendosjen e diagnozës përfundimtare të arteritit verminoz?

- A) Hiperglobulinemia, hipoalbuminemia dhe anemia
- B) Eozinofilia, hiperproteinemia dhe anemia
- C) Prania e vezëve strongile në feçe
- D) Nuk ka asnjë test laboratorik për diagnozën përfundimtare të arteritit verminoz

Pyetja 69

Cila alternativë është e saktë të kontrollit të feçeve për vezë parazitësh tek kuajt?

- A) Sasia e vezëve (vezë për gram feçe) lidhet me ashpërsinë e shenjave klinike.
- B) Parazitizmi mund të përjashtohet si shkak i diarresë kronike në kuaj kur ekzaminimi i feçeve për vezë parazitësh rezulton negativ.
- C) Ekzaminimi i feçeve për vezë parazitësh në disa kuaj në të njëjtin mjedis është i dobishëm për përcaktimin e efikasitetit të programit të kontrollit të parazitozave.
- D) Parazitizmi mund të përjashtohet si shkak i diarresë në kuaj, kur numri apo sasia e vezëve

në feçe është më pak se 200 vezë/gr/feçe.

Pyetja 70

Një kalë 500 kg ka patur diarre profuze të ujshme për 2 ditë dhe tani është 7% i dehidratuar. Cili është vëllimi i lëngjeve të nevojshëm, për të korigjuar këtë dehidratim?

- A) 10 litra
- B) 15 litra
- C) 35 litra
- D) 68 litra

Pyetja 71

Pasojat e zakonshme të bllokimit të ezofagut janë:

- A) Pneumonia aspirative
- B) Rupturë e ezofagut
- C) Megaezofag
- D) Kiste ezofagal

Pyetja 72

Ulçera e stomakut është një konstatim mjaft i zakonshëm në gastroskopinë e kuajve dhe mēzave. Shumica e kafshëve janë të prekur subklinikisht. Ulçerat e stomakut janë më të vendosura në:

- A) Harkun më të vogël të stomakut
- B) Pjesën skuamoze të margo plicatus
- C) Pjesën glandulare të stomakut
- D) Pjesën pilorike

Pyetja 73

Enteriti/duodeniti proksimal trajtohet me:

- A) Dekompresion të vazhdueshëm nazogastrik dhe lëngje intravenoze
- B) Dreinazh kirurgjikal i zorrëve të holla
- C) Doza të mëdha të fenilbutazonit
- D) RezekSION të pjesës së zorrës

Pyetja 74

Përdorimi i preparateve anti inflamatore josteroidale mund të çojë në ulçera të stomakut. Ky efekt anësor i padëshirueshëm mendoni se ka të bëjë me:

- A) Rritjen e prodhimit të prostaglandinës në mukozën e stomakut
- B) Frenimin e efekteve mbrojtëse të mukozës së prostaglandinës E₁ dhe prostaglandin E₂
- C) Uljen e sekretimit të acidit të stomakut
- D) Prishjen direkte të barrierës mukoze

Pyetja 75

Cila nga alternativat nuk është një terapi e pranueshme për largimin e një bllokimi me ushqim në ezofag?

- A) Administrimi i sedativëve për të zvogëluar spazmën e ezofagut
- B) Duke larguar bllokimin me presion me një tub nazogastrik
- C) Administrimi i qetësuesve dhe lavazhit me ujë të ngrohtë përmes tubit nazogastrik
- D) Lavazh duke përdorur një tub nazogastrik me anestezi të përgjithshme

Pyetja 76

Me çfarë diete duhet të ushqehet një kale menjëherë pas largimit të një bllokimi ezofagal ushqimor që shkakton dëmtim të moderuar të mukozës?

- A) Tërshërë
- B) Bar të cilësisë së mirë
- C) Jonxhë alfaalfa
- D) Ushqim në formë qulli

Pyetja 77

Mëzat me ulçer të mukozës skuamoze të stomakut manifestojnë:

- A) Depresion akut ose vdekje të papritur
- B) Distension abdominal dhe refluks nazogastrik
- C) Dhimbje barku me shtrirje në pozicion dorsal
- D) Diarre, rritje të dobët dhe mbulesë të ashpër të qimeve

Pyetja 78

Cila prej gjendjeve të mëposhtme nuk lidhet me shfaqjen e diarresë tek kuajt?

- A) Koliti
- B) Grumbullim i rërës
- C) Obstipacion
- D) Bllokim ezofagal

Pyetja 79

Cili është konstatimi klinik më i qëndrueshëm tek kuajt me duodenit-jejunit proksimal?

- A) Dhembje të forta të barkut
- B) Refluks i bollshëm nazogastrik
- C) Gjetje normale në ekzaminim rektal
- D) Temperaturë e lartë

Pyetja 80

Cila është terapia më e rëndësishme për kuajt me jejunit-duodenit proksimal?

- A) Analgjezikë për të kontrolluar dhimbjet
- B) Preparate për të stimuluar lëvizshmërinë e zorrëve
- C) Zbrazje të stomakut me sondë nazoezofagale
- D) Trajtim me Penicilinë G

Pyetja 81

Cilat janë konstatimet më të zakonshme klinike në kuajt që shfaqin peritonit të përhapur hiperakut që rezulton nga shpimi i zorrëve?

- A) Toksemi e thellë, dobësi, takikardi, pamjaftueshmëri e qarkullimit të gjakut dhe progresion i shpejtë drejt vdekjes
- B) Humbje peshe kronike, dhimbje barku intermitente, ethe e shkallës së ulët, anoreksi e pjesshme, një frekuencë pak e rritur e punës së zemrës
- C) Depresion, shqetësim, hipofagi dhe temperaturë, rrahjet e zemrës dhe frekuenca e frymëmarrjes normale.
- D) Ashit, edemë të gjymtyrëve, edemë ventral të barkut dhe humbje kronike në peshë

Pyetja 82

Kuinidina është një nga preparatet kardio vaskulare më të zakonshme që përdoren në kuaj për trajtimin e fibrilacionit atrial. Cili nga efektet e më poshtme nuk shkaktohet nga ky preparat?

- A) Zvogëlon përcjellshmërinë në zemër
- B) Zgjat fazën refraktare në zemër
- C) Zvogëlon nxitjen e nyjes sinusale
- D) Stimulon tonin vagal (vagusin)

Pyetja 83

Zhurma sistolike që dëgjohe dorzalisht dhe kaudalisht nga puncta optima e valvulës atrioventrikulare të majtë formohet nga:

- A) Pamjaftueshmëria e valvulës mitrale (bikuspidale)
- B) Pamjaftueshmëria e valvulës së aortës
- C) Regurgitacioni i valvulës pulmonare
- D) Pamjaftueshmëria e valvulës trikuspidale

Pyetja 84

Cila prej dëmtimeve të valvulave të zemrës në kuaj progreson më shpejt duke shkaktuar simptoma klinike që kanë lidhje me performancën fizike:

- A) Pamjaftueshmëria e valvulës trikuspidale
- B) Stenoza e valvulës pulmonare
- C) Pamjaftueshmëria e valvulës mitrale
- D) Pamjaftueshmëria e valvulës së aortës

Pyetja 85

Një muez 2 vjeçar që ka garuar sukseshëm në të kaluarën, shfaq papritur një rënie të performancës fizike. Menjëherë pas garës u krye askultimi i zemrës dhe konstatohet që ritmi nuk është i rregullt dhe tonet e zemrës janë me intensitet të ndryshueshëm. Megjithatë frekuenca e rritur e punës së zemrës u kthye në normë brenda 3 orëve pas garës, përsëri ritmi i punës së zemrës qëndroi i çrregullt.

Cila është shkaku i mundshëm i shfaqjes së kësaj gjendjeje klinike?

- A) Fibrilacioni atrial
- B) Blloku atriventrikular i shkallës së dytë
- C) Pamjaftueshmëria e valvulës trikuspidale
- D) Depolarizimi i parakohshëm ventrikular (ekstrasistolat)

Pyetja 86

Cila shenjë klinike nuk shoqëron pezmatimin akut të miokardit?

- A) Kolapsi
- B) Aritmia
- C) Disfagia
- D) Vdekja e papritur

Pyetja 87

Pezmatimi i valvulës mitrale ose endokarditi mural ventrikular nuk shoqërohet me:

- A) Trombe ose emboli dytësore në mëlçi, veshkë dhe tru
- B) Anoreksi dhe humbje në peshë
- C) Zhurma kardiake, ethe, anemi dhe leukocitozë
- D) Emboli pulmonare

Pyetja 88

Cila nga alternativat e mëposhtme është më karakterizuese për perikarditin në kuaj?

- A) Simptoma klinike të ndryshme në varësi të sasisë dhe shkallës së grumbullimit të eksudatit në perikard dhe etiologjisë së sëmundjes
- B) Pneumonia dhe pleuriti
- C) Temperatura, anoreksia dhe humbja e peshës
- D) Edema ventrale dhe dobësimi ose mungesa e toneve të zemrës

Pyetja 89

Cili nga efektet e veprimit të digoksinës nuk ndodh gjatë mjekimit të kuajve me pamjaftueshmëri të zemrës:

- A) Ulja e frekuencës së punës së zemrës
- B) Zvogëlimi i përcjellshmërisë së nyjes atrioventrikulare
- C) Fuqizimi i tkurrjes së ventrikujve
- D) Efekt ionotropik mbi qelizat e miokardit

Pyetja 90

Duke patur parasysh sensitivitetin mikrobik, cili është antibiotiku i duhur kundër *Streptococcus equi*?

- A) Gentamicina
- B) Penicilina
- C) Oksacilina
- D) Amikacina

Pyetja 91

Një mëz 2 vjeçar që ka garuar sukseshëm në të kaluarën, shfaq papritur një rënie të performancës fizike. Menjëherë pas garës u krye askultimi i zemrës dhe konstatohet që rritmi nuk është i rregullt dhe tonet e zemrës janë me intensitet të ndryshueshëm. Megjithëse frekuenca e rritur e punës së zemrës u kthye në normë brenda 3 orëve pas garës, përsëri rritmi i punës së zemrës qëndroi i çrregullt.

Cila është mënyra më e mirë e menaxhimit të këtij rasti?

- A) Mëzi nuk lejohet të marr pjesë në kompeticione (gara) sportive në të ardhmen

- B) Presim 24 orë, më pas realizojmë një elektrokardiogramë, nëse arritmia vazhdon fillojmë trajtimin me kuinidinë sulfat
- C) Mëzi mbahet në gjendje qetësie për 3 muaj, nëse nuk shfaqen ndryshime në zemër rrifillojmë seancat stërvitore
- D) Fillojmë mjekimin me digoksinë dhe furozemidë

15. Inspektimi i Produkteve me Origjinë Shtazore

Pyetja 1

Në rastin e identifikimit të BSE në thertore kë do të konsideronit materiale me rrezik specifik:

- A) Kokën, palcën shpinore dhe shpretkën,.
- B) Mëlcinë dhe parastomaqet
- C) Zorrët
- D) Lëngun sinovial

Pyetja 2

Në rastin e zbulimit të Dermatitit Pustular Kontagioz të shkaktuar nga Parapox virus i familjes Poxviridae, vlerësimi që duhet të japë veterineri është:

- A) Karkasa dhe organet jepen për konsum, ndërsa koka konfiskohet.
- B) Karkasa dhe organet konfiskohen
- C) Karkasa, organet dhe koka jepen për konsum
- D) Karkasa, organet dhe koka jepen për konsum me kusht

Pyetja 3

Për karkasat që rezultojnë me leukozë të gjeneralizuar cili opsion i vlerësimit të tyre është i vërtetë:

- A) Karkasa dhe organet konfiskohen .
- B) Organet konfiskohen, kurse karkasa konsumohet
- C) Karkasa konfiskohet kurse organet konsumohen
- D) Karkasa dhe organet konsumohen me kusht

Pyetja 4

Për cilën nga sëmundjet virale të derrave ju do të dyshonit kur konstatonit veshka të ngjashme si “veza e pulës së detit“ si dhe “butonet ulçerozë“ në bashkimin e ileumit me cekumin:

- A) Murtajën klasike të derrave
- B) Murtajën afrikane të derrave
- C) Sëmundjen Aujeszky
- D) Sëmundjen e Listeriozës

Pyetja 5

Në rast se karkasa që ju po inspektoni ka leziona patologjike si: çarje të venave sipërfaqësore të trupit, gjak me ngjyrë të errët që nuk koagulon në kavitetet e trupit, për cilën nga sëmundjet do të dyshonit:

- A) Salmonelozë
- B) Kolibakteriozë
- C) Anthrax
- D) Brucelozë

Pyetja 6

Tek karkasat që vërtetohet egzistenca e sëmundjes së Anthrax-it si kryhet vlerësimi veterinar:

- A) Karkasat konfiskohen
- B) Karkasat trajtohen me kusht zierje
- C) Karkasat trajtohen me kusht ngrirje
- D) Karkasat lejohen të shiten me çmim të ulët

Pyetja 7

Karkasat me leziona të tilla si: placentë me kotiledone edematoze, në ngjyrë të errët ose me zona nekrotike, granulare, mund të dyshohen se vijnë nga kafshë të sëmura me:

- A) Tuberkuloz
- B) Brucelozë
- C) Leukozë
- D) Ethja Q

Pyetja 8

Cilat nga masat e mëposhtëme konsiderohen të nevojshme se duhet të ndërmerren nga shërbimi veterinar, në rast të konfirmimit të sëmundjes së brucelozës në karkasat që gjenden në thertore:

- A) Heqja e kujdeshme e lëkurës dhe largimit të uterusit dhe gjirit nga thertorja
- B) Largimi i tavave të cilat janë përdorur gjatë aktit të therjes
- C) Ndërrimi i veterinerit i cili ndodhet në të njëjtin turn
- D) Shtimi i ventilimit në thertore

Pyetja 9

Si do ta bënit vlerësimin e karkasave të derrave në rast se do të konfirmonit diagnozën për formën akute të fruthit:

- A) Vlerësim të mishit me kusht zierje
- B) Konfiskim
- C) Konsum i lirë i mishit
- D) Konsum me çmim të ulët të mishit

Pyetja 10

Në një karkasë gjedhi me shfaqjen e lezioneve si: trashje të murit dhe formim të brazdave të ngjashme me ato të trurit tek zorrët e trasha, limfonodet mezenteriale dhe ileocekalë të edematizuara, ju do të konfirmonit diagnozën për:

- A) Tuberkuloz
- B) Paratuberkuloz
- C) Leukozë
- D) LSD

Pyetja 11

Në karkasat e derrave për cilën nga sëmundjet e mëposhtme ju do të jepnit konfirmimin tuaj nëse konstatoni: hiperemi, edemë me mukus, gjak dhe fibrinë të zorrës së trashë, enjtje të limfonodeve mezenteriale

- A) Disanteria hemoragjike e derrave
- B) Fruthi i derrave
- C) Murtaja klasike e derrave
- D) Murtaja afrikane e derrave

Pyetja 12

Paraqitja e një numri tuberkulash me ngjyrë gri që në prerje kanë qendër kazeoze apo të kalcifikuar dhe që rrethohen me ind fibroz të trashë, ju ndihmon që të konfirmoni cilën nga diagnozat:

- A) Tuberkuloz të një stadi akut
- B) Tuberkuloz miliar
- C) Tuberkuloz kronik
- D) Tuberkuloz të lokalizuar

Pyetja 13

Në cilët pjesë të karkasës së derrave do të merrnit mostrat për të kryer vlerësimin trikineloskopik

- A) Në këmbët e diafragmës dhe muskujt e gjuhës
- B) Në muskulaturën e gjymtyrëve të para
- C) Në muskulaturën e gjymtyrëve të pasme
- D) Në muskujt e stomakut

Pyetja 14

Kur dyshoni për cisticerkozë, në karkasat e derrave apo gjedhit në cilat inde, ju duhet të kryeni kontrollin veterinar:

- A) Në mm.masseter, zemër, gjuhë, diafragmë,
- B) Në muskulaturën e gjymtyrëve të para
- C) Në muskulaturën e gjymtyrëve të pasme
- D) Në muskulaturën e zorrëve

Pyetja 15

Lezionet e shkaktuara nga forma akute e fasciolozës në mëlcinë e gjedhit ju detyron të jepni cilin nga vlerësimet e mëposhtëme:

- A) Konfiskim tërësor i organit
- B) Konfiskim i pjesshëm i organit
- C) Konsum me kusht zierje i organit
- D) Shitje me çmim të ulët të mëlcisë

Pyetja 16

Kush nga indet e mëposhtëme paraqet interes të vecantë gjatë kontrollit veterinar të karkasave që dyshohen për ihter

- A) Kërçi i shpatullës
- B) Limfonodet mandibulare
- C) Limfonodet brakiale
- D) Muskulatura e gjymtyrëve

Pyetja 17

Në karkasat ihterike, ku shfaqja e ngjyrës së verdhë është intensive dhe nuk zhduket edhe pas 24 orëve, ato duhet të:

- A) Konfiskohen
- B) Vlerësohen me kusht zierje
- C) Jepen për konsum të lirë
- D) Jepen për konsum në një territor të kufizuar

Pyetja 18

A mendoni se dallimi midis mishit të maturuar dhe atij të pamaturuar bazohet në:

- A) Pamjen e muskulaturës dhe dhjamit
- B) Pamjen e syve
- C) Pamjen e zemrës
- D) Pamjen e zorrëve

Pyetja 19

Cila është pamja që marrin karkasat e një kafshe të therur me pireksi:

- A) Pamje iherike.
- B) Mëlçi, veshka dhe zemër me degjenerim yndyror
- C) Gjymtyrë të edematizuara
- D) Çarje të zorrëve

Pyetja 20

Në cilat forma të mastiteve karkasat e kafshëve femra konfiskohen?

- A) Mastite gangrenoze
- B) Mastitet Subklinike
- C) Mastitet klinike
- D) Mastite fibrinoze

Pyetja 21

Në cilat raste veterineri duhet të kërkojë egzaminimin bakterologjik të karkasave?

- A) Kur është kryer një therje emergjente
- B) Kur kafshët kanë vuajtur nga vertigo
- C) Kur kafshët janë goditur nga rufeja
- D) Kur kane shfaqur dëmtime të gjymtyrëve

Pyetja 22

Vlerësimi veteriner në karkasat e shpendëve që janë konfirmuar me sëmundjen Gumbaro është:

- A) Konfiskim
- B) Konsum i lirë
- C) Konsum me kusht ngrirje
- D) Konsum me kusht zierje

Pyetja 23

Karkasat e shpendëve që paraqesin lezionet në vijim: zmadhim i mëlçisë ose "sëmundja e mëlçisë së madhe" dhe tumore me ngjyrë gri si dhe tumore në shpretkë, bursën e Fabricit, mushkëri, zemër, proventrikulat dhe palcën e kockave, dyshohen për:

- A) Leukozë
- B) Tuberkuloz
- C) Sëmundjen e Marekut
- D) Salmonelozë

Pyetja 24

Karkasat e shpendëve me sëmundjet e Newcastle vlerësohen me:

- A) Konsum i lirë
- B) Konfiskim
- C) Konsum me kusht zierje
- D) Konsum me kusht ngrirje

Pyetja 25

Në karkasat e shpendëve të infektuara me *S. pullorum* dhe *S. gallinarum* vlerësimi veterinar do të jetë:

- A) Konfiskim
- B) Konfiskim vetëm i organeve të prekura dhe pjesa tjetër për konsum
- C) Konsum i karkasave dhe organeve
- D) Trajtim me kusht zierje i karkasave

Pyetja 26

Aspektet humanitare të transportit të kafshëve për në thertore janë të lidhura me:

- A) shkaqe të reputacionit të kompanive të transportit
- B) mënyrën e trajtimit të kafshëve gjatë transportit
- C) distancën që duhet të përshkruhet deri në destinacion
- D) llojin e transportit të kafshëve

Pyetja 27

Cilat përfshihen në kategorinë e kafshëve problematike gjatë transportit për në thertore?

- A) Kafshët adulte
- B) Kafshët barsa të rënda
- C) Kafshët me brirë të prera
- D) Kafshët me bisht të amputuar

Pyetja 28

Cila nga kategoritë e kafshëve mund të udhëtojë 24 orë pa ndërprerje nëse kushtet e transportit janë të mira:

- A) Gjedhi
- B) Delet
- C) Derrat
- D) Dhitë

Pyetja 29

Kur kafshët ngordhin gjatë transportit, cilat janë ndryshimet anatomo-patologjike që mund të konstatojnë:

- A) Gjakderdhje në kavitetet e trupit
- B) Hiperemi në zorrë
- C) Hiperemi akute pulmonare
- D) Infarkte në zemër

Pyetja 30

Tetania e transportit është një sëmundje që shfaqet tek:

- A) Gjedhi në moshë të re
- B) Gjedhi barsë
- C) Të gjitha kategoritë e gjedhit
- D) Gjedhi që vuan nga aparati tretës

Pyetja 31

Konsumimi i ujit nga kafshët deri pak orë para therjes është i nevojshëm sepse:

- A) I lehtëson punonjësit që ta kryejnë më mirë aktin e therjes
- B) Pakëson ngarkesën bakteriale në zorrët e kafshëve që theren

- C) Kryhet më mirë akti i çgjakësimit
- D) Kryhet më mirë akti i largimit të organeve

Pyetja 32

Për egzaminimin e kafshëve përpara therjes, cili është afati kohor i përcaktuar në rregullore:

- A) 10 orë para therjes
- B) 16 orë para therjes
- C) 24 orë para therjes
- D) 36 orë para therjes

Pyetja 33

A mendoni se gjatë egzaminimit klinik të kafshëve para therjes mund të quajmë anormalitet në sjellje nëse kafsha:

- A) Bën lëvizje të shpeshta rethore
- B) Pi ujë vazhdimisht
- C) Konsumom pak ushqim
- D) Tund bishtin

Pyetja 34

Veterineri kur nuk konstaton probleme në kafshën para therjes vendos që:

- A) Kafsha të shkojë për therje normale
- B) Kafsha të riezaminohet pas dy orëve të egzaminimit të parë
- C) Kafsha të theret në thertore sanitare edhe pse nuk paraqet shenja të dukshme të sëmundjes
- D) Kafsha duhet të ushqehet

Pyetja 35

Cili është veprimi që duhet të kryejë operatori i biznesit për të garantuar një therje të sigurtë?

- A) Fiksimi i kujdesshëm i kafshëve me qëllim trullrosjen ose therjen e tyre
- B) Fiksimi dhe renditja e kafshëve sipas madhësisë së tyre trupore
- C) Fiksimi dhe renditja e kafshëve sipas të njëjtës racë
- D) Fiksimi i kafshëve, mbështetur në kërkesat e pronarëve të kafshëve

Pyetja 36

Tek speciet dhen, dhi dhe derra tulloja me rrymë elektrike në kokë dhe në trup kërkohet të kryhet përmes respektimit të parametrave të mëposhtëm:

- A) 1 A për dele dhe dhi dhe 1.30A për derra
- B) 1.30 A për dele dhe dhi dhe 1A për derra
- C) 1.30 A për dele, dhi dhe derra
- D) 1 A për dele dhe dhi dhe 1 A për derra

Pyetja 37

Pajisjet dhe objektet për fiksimin e kafshëve në momentin e therjes modelohen për të:

- A) Parandaluar dëmtimet në kafshë
- B) Minimizuar lëvizjen e kasapëve
- C) Lehtësuar lëvizjen e mjeteve që transportojnë kafshët
- D) Për të lehtësuar punën e menaxherëve të thertores

Pyetja 38

Kafshët të cilat nuk do të theren brenda 12 orëve pas mbërritjes së tyre në thertore duhet:

- A) Të lihen pa ushqyer deri sa të kryhet akti i therjes
- B) Të ushqehen në sasi dhe në intervale të përshtatshme
- C) T'ju jepet vetëm ujë
- D) T'ju kryhen vetëm shërbimet e pastrimit

Pyetja 39

Cili nga parametrat e mëposhtëm ka vlerë në suksesin e trullësjes me gaz karbonik?

- A) Koha e ekspozimit të gazit
- B) Mënyra e qëndrimit të kafshëve në dhomën e gazit
- C) Mënyra e trajtimit të kafshëve brenda në dhomën e gazit
- D) Shpejtësia e futjes së kafshëve në dhomën e gazit

Pyetja 40

Çfarë të dhënash duhet të mbajë ne veçanti operatori i biznesit ushqimor që prodhon produkte primare me origjinë shtazore?

- A) Vendin se ku janë mbarështuar kafshët;
- B) Produktet mjekësore veterinarë (PMV) ose trajtime të tjera që i kryhen kafshës, datat e kryerjes dhe periudhat e ndërprerjes së tyre;
- C) Sasinë e ushqimit që kanë përdorur kafshët;
- D) Llojet e ushqimeve të ndryshme që kanë përdorur kafshët.

Pyetja 41

Operatori i biznesit ushqimor që zbaton Praktikat e Mira të Higjenës (PMH) për shmangien e rreziqeve që mund të lindin gjatë prodhimit primar ndërmer masa si:

- A) Përgatitja, depozitimi, përdorimi dhe gjurmueshmeria e ushqimit për kafshë
- B) Sigurimi i rrugëve dytësore për lëvizjen e mjeteve me kafshë
- C) Sigurimi i çatave të stallave me tjegulla
- D) Sigurimi i dyerve të stallave me mbyllje automatike

Pyetja 42

Mishi i gjedhit i ruajtur në ngrirje në temperaturën -18°C mund të qëndrojë në këto kushte deri në:

- A) 8 javë
- B) 8 muaj
- C) 15 muaj
- D) 2 vjet

Pyetja 43

Diegia nga ngrirja në karkasa ndodh për arsye të:

- A) oshilacioneve që pëson temperatura brenda në tynelet e ngrirjes
- B) ventilimit të pamjaftueshëm në tunel
- C) lagështisë së tepërt në tunel
- D) karkasave që nuk janë të ambalazuara

Pyetja 44

Ngrirja si metodologji e shëndetsimit të mishit me probleme higjienike këshillohet të përdoret në rastin e sëmundjeve me shkaktarë:

- A) Bakteriale
- B) Parazitarë
- C) Viralë
- D) Protozoarë

Pyetja 45

Arsyeja e përdorimit të nitritit të Na, në mishin e përpunuar, lidhet me:

- A) Pengimin e zhvillimit të mikroorganizmave të dëmshme
- B) Ritjen e peshës së produktit
- C) Përmirësimin e konsistencës së produktit
- D) Homogjenizimin e përbërësve në produkt

Pyetja 46

Arsyeja e identifikimit të sallameve me ngarkesë mikrobike përtej standardit është e lidhur me:

- A) Trajtimin e kafshëve me antibiotikë
- B) Mungesën e kushteve higjienike në stabilimentin e sallameve
- C) Përdorimin e nitritit të Na
- D) Përdorimin e miellit të sojës

Pyetja 47

Çfarë temperature duhet të jetë uji i ngrohtë që përdoret në thertore?

- A) 75⁰C
- B) 82⁰C
- C) 90⁰C
- D) 100⁰C

Pyetja 48

Në impiantin për therjen e derrave, cilin nga faktorët e mëposhtëm duhet të marrim në konsideratë për garantimin e produktit?

- A) Racën e derrave,
- B) Korrozionin e paisjeve
- C) Eksperiencën e kasapëve
- D) Menaxhimin e therjeve

Pyetja 49

Cila është temperatura që rekomandohet për mbajtjen e organeve në regjim ftohje?

- A) 0⁰C
- B) 3⁰C
- C) 7⁰C
- D) 10⁰C

Pyetja 50

Dizinfektantët që përdorim në thertore janë më efektiv kur:

- A) Zgjedhim përqëndrimin korrekt të tyre
- B) I përdorim në fillim të procesit të punës

- C) I përdorim me dritare të mbyllura
- D) I përdorim në mbyllje të procesit të punës

Pyetja 51

Gjatë kryerjes së aktit të therjes së kafshëve në thertore duhet të kujdesemi për:

- A) Respektimin e mirëqënies së kafshëve
- B) Kostot ekonomike
- C) Shpejtësinë e lëvizjes së kasapëve në thertore
- D) Mënyrën se si i varim karkasat

Pyetja 52

Cili është objektivi më i rëndësishëm i humbjes së ndjeshmërisë tek kafsha gjatë trullësjes:

- A) Arritja e bllokimit të aktivitetit respirator
- B) Arritja e bllokimit të shikimit
- C) Mosfunksionimi i gjymtyrëve
- D) Ndërprerja e dëgjimit

Pyetja 53

Trullësja me voltazh të lartë rezulton problematike sespe ajo shoqërohet me:

- A) hemorragji petekiale dhe fraktura
- B) lëvizje të gjymtyrëve
- C) lëvizje të kokës
- D) dridhje muskulare

Pyetja 54

Në inspektimin para therjes shkak i konfiskimit të gjedhit adult është:

- A) Aspergiloza
- B) Mastiti
- C) Fotosensibilizimi
- D) Ngordhja para kryerjes së egzaminimit

Pyetja 55

Në inspektimin pas therjes, shkak i konfiskimit të karkasave të derrave është:

- A) Fruthi me formë kronike
- B) Peritoniti
- C) Artriti
- D) Pneumonia

Pyetja 56

Në rast të zbulimit të karkasave të gjedhit me leptospirozë, diagnoza diferenciale bëhet për sëmundjen:

- A) Babeziozë
- B) Helmim me plumb
- C) Aspergilozë
- D) Tuberkuloz

Pyetja 57

Gjatë kryerjes së procesit të mjeljes mekanike, cilën nga rregullat e mëposhtme do ta konsideroni korrekte:

- A) Të përdoren detergjentë pa praninë e ujit

- B) Të bëhet dizinfektimi me lëndë kimike (acide, halogjene) si dhe shplarja e impiantit me ujë të rrjedhshëm.
- C) Të përdoret ujë i ngrohtë për larje
- D) Të përdoret ujë i ftohtë për larje

Pyetja 58

Në rastin e vjetërimit të qumështit të freskët, cilin nga opsionet e mëposhtme do ta konsideroni të pavërtetë:

- A) Qumështi ka parametra normal
- B) Qumështi ndryshon pH në drejtim të vlerave më bazike
- C) Qumështi pëson ndryshime në ngjyrë
- D) Qumështi bëhet më transparent

Pyetja 59

Cili nga regjimet e shëndetsimit të qumështit të infektuar me *Brucella spp* do të garantonte një produkt të sigurtë?

- A) Pasterizimi
- B) Sterilizimi
- C) Qumështi i pa përpunuar termikisht
- D) Qumështi i termizuar

Pyetja 60

Qumështi me mbetje të antibiotikëve, gjatë konsumimit shoqërohet me problematikën e mëposhtme:

- A) Antibiotikorezistencën,
- B) Largimin e CO₂ nga qumështi
- C) Shtimin e qelizave somatike në qumësht
- D) Zvogëlimin e peshës specifike të qumështit

Pyetja 61

Qëllimi i trajtimit të qumështit me nxehtësi lidhet me ndikimin që ka temperatura e lartë

- A) Për homogjenizimin e mirë të qumështit
- B) Mbingarkesën mikrobike të pranishme në qumështin e freskët
- C) Ndryshimin e pH të qumështit
- D) Përmirësimin e viskozitetit të qumështit

Pyetja 62

Përdorimi i metodës Delvotest për të testuar qumështin e tankeve ka si synim zbulimin e:

- A) aciditetit në qumësht
- B) antibiotikëve
- C) ngarkesës mikrobike totale në qumësht
- D) qelizave somatike në qumësht

Pyetja 63

Nëse në stallë ka lopë me mastit ato duhen mjelë:

- A) Në fillim të aktit të mjeljes
- B) Në fund të aktit të mjeljes
- C) Në mes të aktit të mjeljes
- D) Sipas dëshirës së mjeljes

Pyetja 64

Cili është emërtimi i saktë që përdorim për qelizat e bardha dhe ato epiteliale të gjendura në qumësht:

- A) Euzinofilë
- B) Neutrofile
- C) Monocite
- D) Qeliza somatike

Pyetja 65

Cili është opsioni i saktë për *Campylobacter jejuni*?

- A) *Campylobacter* është zbuluar më shpesh në shpërthimet me origjinë ushqimore nga konsumi i qumështit
- B) *Campylobacter* është zbuluar më shpesh nga konsumi i mishit të shpendëve
- C) *Campylobacter* është i kudo gjendur në ushqimet me origjinë shtazore
- D) *Campylobacter* tek konsumatorët bëhet shkak për shqetsime të sistemit nervor qëndror

Pyetja 66

Cilin nga faktorët e mëposhtëm do të konsideronit si pjesë të teknologjive penguese në përgatitjen e sallameve:

- A) Acidetin e përmbajtjes së brumit
- B) Mbajtjen e sallameve në temperaturën e mjedisit
- C) Përdorimin e miellit të sojës
- D) Përdorimin e lëndëve pikante

Pyetja 67

Difekti i hidhërimit të brumit të sallameve të forta e detyron inspektorin të marrë një nga vendimet e mëposhtme:

- A) Të konfiskojë sallamin
- B) Të konfiskojë pjesërisht sallamin
- C) Të lejojë konsumin e sallamit
- D) Të lejojë të shitet me çmim të ulët

Pyetja 68

Cili nga opsionet e mëposhtme është i vërtetë për mishin që konservohet në temperatura të ftohta?

- A) Mundësohet parandalimi i shumëfishimit të mikroorganizmave të dëmshme përmes krijimit të shtresës tharëse në sipërfaqe të mishit
- B) Mundësohet parandalimi i shumëfishimit të mikroorganizmave të dëmshme përmes zvogëlimit të mundësisë së shfrytëzimit të ujit të lirë në ushqim.
- C) Mundësohet parandalimi i shumëfishimit të mikroorganizmave të dëmshme përmes uljes së pH.
- D) Mundësohet parandalimi i shumëfishimit të mikroorganizmave të dëmshme përmes rritjes së pH.

Pyetja 69

Me cilin nga faktorët e mëposhtëm lidhet prania e formave vegjetative të mikrobeve në konservat e mishit?

- A) ruajtjen e konservave të mishit pas përpunimit në temperaturën e mjedisit
- B) përdorimin e mishit i cili para përpunimit ka pasur ngarkesë mikrobike

- C) përdorimin e trajtimit termik të pamjaftueshëm
- D) qëndrimin e konservave për një kohë tepër të gjatë në magazinat e ruajtjes

Pyetja 70

Cili është vendimi që do të merrni nëse përmbajtja e konservës që po inspektoni ka erë të keqe seksuale?

- A) Konfiskim
- B) Konsum me çmim më të lirë
- C) Konsum i lirë
- D) Riambalazhim në një kuti tjetër konserve

Pyetja 71

Cilën nga karakteristikat organoleptike do ta konsideroni si shumë të rëndësishme në vlerësimin e freskisë së peshkut sardele?

- A) Erën karakteristike që ka peshku në nivelin e branshive
- B) Largimin me lehtësi të luspave të peshkut
- C) Pozicionin e gojës së hapur
- D) Konsistencën e barkut

Pyetja 72

Tek peshku, pamja e syrit të veshur me mukus intensiv dhe të futur në orbitë tregon që ai është:

- A) I freskët
- B) Bajat
- C) Për t'u konfiskuar
- D) Për t'u shitur me çmim të ulët

Pyetja 73

Cila nga teknologjitë e përmendura më poshtë është e vlefshme për ruajtjen gjatë të peshkut?

- A) Konservimi në ngrirje
- B) Konservimi në temperaturën e mjedisit
- C) Konservimi në ftohje
- D) Konservimi me acid laktik

Pyetja 74

Shfaqja e kolerës tek konsumatorët e shkaktuar nga *Vibrio cholera*, mund të ndodhë kur ata konsumojnë:

- A) Peshk të papërpunuar
- B) Qumësht të pa pasterizuar
- C) Vezë pa përpunim termik
- D) Sallam të fermentuar

Pyetja 75

Vezët me erë kashte, mund të shfaqen nga:

- A) Aktiviteti ezimativ i mikrobeve të pranishme në përmbajtjen e tyre
- B) Qëndrimi i vezëve gjatë në kushte frigoriferike
- C) Qëndrimi i vezëve në frigorifer së bashku me fruta
- D) Qëndrimi i vezëve në bikerina plastike

Pyetja 76

Vezët tek të cilat zbulohen trupa të huaj në përmbajtje, vlerësohen

- A) Për konsum të lirë
- B) Konfiskohen
- C) Përdoren në industrinë ushqimore
- D) Përdoren në mensat

Pyetja 77

Cila nga teknologjitë e përpunimit të vezëve konsiderohet e përshtatshme për shkatërrimin e salmonelave në përmbajtjen e tyre?

- A) Pasterizimi i vezëve
- B) Larja në lëvozhgën e vezëve me ujë të ngrohtë
- C) Mbajtja e vezëve në regjim ftohje
- D) Lyerja e lëvozhgës së vezëve me vaj

Pyetja 78

Cili nga shkaktarët bakteriale të mëposhtëm trasmetohet përmes vezëve?

- A) Bac. anthrax
- B) Brucella spp
- C) Salmonella spp
- D) Vibrio parahaemolyticu

Pyetja 79

Procedura e marrjes rastësore e mostrave të vezëve mbështetet në:

- A) Analizën e riskut
- B) Madhësinë e ndërmarrjes
- C) Eksperiencën e ndërmarrjes prodhuese
- D) Faktin që ndërmarrja është eksportuese e vezëve

Pyetja 80

Vezët industriale duhet të tregtohen në kontenierë paketimi me informacionin:

- A) Të përshtatshme për konsum njerëzor me shkronja të paktën 8 mm lartësi
- B) Të përshtatshme për konsum njerëzor me shkronja të paktën 10 mm lartësi
- C) Të përshtatshme për konsum njerëzor me shkronja të paktën 12 mm lartësi
- D) Të përshtatshme për konsum njerëzor me shkronja të paktën 14 mm lartësi

Pyetja 81

Vezët duhet të klasifikohen, shënohen dhe paketohen të paktën brenda:

- A) 3 ditëve nga çelja e tyre
- B) 5 ditëve nga çelja e tyre
- C) 7 ditëve nga çelja e tyre
- D) 10 ditëve nga çelja e tyre

Pyetja 82

Për vezët e klasës A ekstra sa kërkohet të jetë lartësia e dhomës së ajrit:

- A) deri 1 mm
- B) deri 2 mm
- C) deri 4 mm
- D) deri 5 mm

Pyetja 83

Vezët me lëvozhgë kafe në krahasim me ato me lëvozhgë të bardhë shquhen për :

- A) Lëvozhgë më të fortë
- B) Cilësi më të mirë
- C) Vlerë ushqyese më të lartë
- D) Peshë më të madhe

Pyetja 84

Specifikimet e klasave të vezëve janë të vleshme për:

- A) Efekte estetike
- B) Të eliminuar vezët e pavlefshme dhe difektoze
- C) Më shumë të ardhura për tregtarët e vezëve
- D) Punë më komode të inspektorëve të ushqimit

Pyetja 85

Cili nga shënimet është i detyrueshëm të vendoset në ambalazhet e vezëve:

- A) Vezë në ngjyrë kafe
- B) Të kryhet ruajtja në temperaturën deri 10⁰C
- C) Vezë me dy të verdha
- D) Vezë ngjyrë të bardhë

Pyetja 86

Shpërthimet e salmonelozës në njerëz mund të vihen më mirë nën kontroll nëse:

- A) Shmangim konsumin e mishit të shpendëve
- B) Konsumojmë vezë të cilat janë përpunuar mirë termikisht
- C) Edukojmë më mirë konsumatorët
- D) Shmangim konsumin e mishit të peshkut

Pyetja 87

Cilat janë shërbimet që i duhen kryer kafshës në vendin e therjes kur ajo është therur jashtë thertores?

- A) T'i largohet lëkura dhe më tej ajo të transportohet drejt thertores në mënyrë higjienike
- B) T'i hiqen mëlcia dhe mushkритë jashtë thertores në praninë e veterinerit
- C) T'i hiqen të gjitha organet e brendshme jashtë thertores në praninë e veterinerit
- D) Të kryhet çgjakësimi si dhe të hiqen stomaget dhe zorrët jashtë thertores në praninë e veterinerit

Pyetja 88

A është detyrim i veterinerit zyrtar, të kontrollojë nëse procedurat e brendshme të operatorit të biznesit ushqimor garantojnë, që mishi është i çliruar nga:

- A) faciet dhe ligamentet
- B) koagulat e gjakut
- C) përmbajtje fekale apo ndotje të tjera
- D) përmbajtja e indit dhjamor

Pyetja 89

Tek karkasat e gjedhit nëse zbulojmë lezionet e tuberkulozit, ato duhet t'i konfiskojmë në rastet kur:

- A) Lezionet janë të lokalizuara
- B) Kemi dyshuar për tuberkuloz në kontrollin para therjes
- C) Karkasa demonstron se rezervat e indit dhjamor janë të pakta
- D) Lezionet janë të përhapura në kavitetin torakal dhe abdominal

Pyetja 90

Fermentimi dhe maturimi natyral prej jo më pak se nëntë muaj për mishin pa kocka, që përfundon me karakteristikat (a_w jo më shumë se 0.93 dhe pH jo më shumë se 6.0), kryhet në rastet e prekjes nga sëmundja:

- A) Afta Epizotike
- B) Newcastle
- C) Influenza Aviare
- D) Murtaja e Dhenve dhe Dhive

Pyetja 91

Kontrollet zyrtare në fermat e prodhimit të qumështit kryhen për të verifikuar nëse:

- A) respektohen kërkesat shëndetësore për prodhimin e qumështit si lëndë e parë
- B) respektohet vendosja e kafshëve në stallë sipas prodhimit mesatar të tyre
- C) kafshët ushqehen me racione ushqimore të kombinuara
- D) kafshët prodhuese dalin në padoqe për çdo ditë

Pyetja 92

Cili është detyrimi i Autoriteti Kompetent për të kryer kontrole zyrtare:

- A) Të paktën dy herë në vit në çdo fermë të prodhimit të qumështit për të kontrolluar se mjelja grumbullimi dhe transporti i qumështit në pikën e grumbullimit përmbush kërkesat legjislative
- B) Të paktën një herë në vit në çdo fermë të prodhimit të qumështit për të kontrolluar se mjelja grumbullimi dhe transporti i qumështit në pikën e grumbullimit përmbush kërkesat legjislative
- C) Të paktën tre herë në vit në çdo fermë të prodhimit të qumështit për të kontrolluar se mjelja grumbullimi dhe transporti i qumështit në pikën e grumbullimit përmbush kërkesat legjislative
- D) Se mjelja, grumbullimi dhe transporti i qumështit në pikën e grumbullimit përmbush kërkesat legjislative mbështetur në situatën e paraqitur një vit më parë, në çdo fermë të prodhimit të qumështit

Pyetja 93

Cilin nga treguesit duhet të testojmë për analizimin dhe testimin e qumështit të papërpunuar?

- A) Përcaktimin e antibiotikëve dhe sulfonamidëve
- B) Përcaktimin e lëndës së thatë
- C) Përcaktimin e Yndyrës
- D) Përcaktimin e proteinave

Pyetja 94

Cilat nga të dhënat e mëposhtme ka detyrim t'i mbajë me kujdes operatori i biznesit ushqimor që mbarështon kafshë prodhuese të qumështit:

- A) Produktet mjekësore veterinarë ose trajtime të tjera që i kryhen kafshës, datat e kryerjes dhe periudhat e ndërprerjes së tyre
- B) Prodhimin ditor të qumështit
- C) Konsumin ditor të ushqimit
- D) Shpeshtinë e lëvizjes së kafshëve nga stalla në padoqe

Pyetja 95

Praktikat e Mira të Higjenës sigurojnë veprime për kontrollin e rreziqeve si:

- A) Përdorimin e duhur dhe të përshtatshëm të produkteve mjekësore veterinerë dhe aditivëve të ushqimeve për kafshë dhe gjurmimin e tyre
- B) Transportin komod të ushqimit për kafshë
- C) Asgjesimin e duhur të insekteve në stallë
- D) Masat për të mos lejuar hyrjen e punonjësve të paautorizuar në stallë

Pyetja 96

Ushqimet e gatshme për konsum janë të kontaminuara me *Staphylococcus aureus* nga:

- A) Përbërës me qumësht të kontaminuar
- B) Përbërës me vezë të kontaminuara
- C) Nga ajri i kontaminuar i mjedisit të punës
- D) Nga punëtorë që kanë manipuluar ushqimet

Pyetja 97

Ushqimet e konservuara në mënyrë jo korrekte janë shkak i shpërthimit të:

- A) Brucelozës
- B) Botulizmit
- C) Tuberkulozit
- D) Tularemisë

Pyetja 98

Konsumi i produkteve krudo të peshkut mund të bëhet shkak për rritjen e rasteve të shpërthimit të:

- A) Infeksioneve të *Diphyllobotrium latum* dhe *Anisakis marina*
- B) Tularemisë
- C) Trikinosis
- D) Helmimit me trematol

Pyetja 99

Në ndërmarrjen e përpunimit të ushqimeve me origjinë shtazore, HACCP zbatohet sipas:

- A) 3 parimeve
- B) 5 parimeve
- C) 7 parimeve
- D) 9 parimeve

Pyetja 100

Nga cilat mjedise duhet të vijnë molusqet e gjalla bivalvoret:

- A) Nga një zonë prodhimi e klasës A
- B) Nga një zonë prodhimi e klasës B
- C) Nga një zonë prodhimi e klasës C
- D) Nga një territor i paklasifikuar

Pyetja 101

Nëse ka përfunduar zhveshja e lëkurës së karkasës së diagnostikuar me plasje dhe pranë saj ka karkasa të tjera, cilin vendim duhet të marrim:

- A) Karkasa e diagnostikuar me plasje konfiskohet
- B) Karkasat në të dy krahët e karkasës me plasje konfiskohen gjithashtu sikurse karkasa me plasje
- C) Të gjitha karkasat që janë në këtë moment në sallën e therjes konfiskohen
- D) Konfiskohet karkasa me plasje, ndërsa karkasat e tjera trajtohen me kusht zierje

Pyetja 102

Cistet e *Trichinella* spp , në cilat nga indet e poshtëshënuara duhet t'i kërkojmë:

- A) Laring
- B) Muskujt e gjymtyrëve të pasme
- C) Mushkri
- D) Zorrë

Pyetja 103

Si bëhet vlerësimi i karkasave kashektike në rast të pranisë së cisteve hydatidë, në muskuj?

- A) Karkasa lejohet për konsum
- B) Karkasa lejohet për konsum pas trajtimit me nxehtësi
- C) Karkasa lejohet për konsum pas trajtimit me ngrirje
- D) Karkasa konfiskohet

Pyetja 104

Vlerësimi me konfiskim i karkasave të cilat nuk arrijnë të çgjakësohen mirë në therjet emergjente, kryhet për shkak të :

- A) Mundësisë së situatës febrile
- B) Përdorimit të trullësjes me mjete mekanike
- C) Zhveshjes me shpejtësi të karkasës
- D) Përdorimit të trullësjes me elektroshok

Pyetja 105

Cili nga vendimet e mëposhtme është korrekt, për karkasat e kafshëve që ju kryhet akti formal i therjes menjëherë pas ngordhjes:

- A) Karkasa konfiskohet
- B) Karkasa shitet si mish me cilësi të ulët, me kusht që të jetë e lirë nga aroma dhe shija jonormale
- C) Karkasa jepet për konsum me kusht zierje
- D) Karkasa tregtohet në një territor të limituar.

Pyetja 106

Karkasat e kafshëve që kanë vuajtur nga iheri dhe demostrojnë ngjyrë të verdhë të theksuar edhe pas qëndrimit 24 orë, kanë destinacionin:

- A) Lejohen të përdoren për konsum pas testeve laboratorike
- B) Konfiskohen
- C) Lejohen për konsum me çmim të ulët
- D) Përdoren për ushqim për kafshët

Pyetja 107

Për ruajtjen e ushqimeve me origjinë shtazore cila nga opsionet e temperaturave të mëposhtme konsiderohet si zona më e rrezikshme:

- A) -15°C deri 15°C
- B) -15°C deri 60°C
- C) 4°C deri 15°C
- D) 4°C deri 60°C

Pyetja 108

Për cilën arsye bëhet kontrolli i temperaturës gjatë manipulimit dhe ruajtjes së produkteve të mishit?

- A) Për të ruajtur ngjyrën normale të tyre
- B) Për të përmirësuar konsistencën e tyre
- C) Për të minimizuar prishjen e produkteve
- D) Për të përmirësuar aromën e tyre

Pyetja 109

Për analizat mikrobiologjike të mishit të grirë, mishit të përpunuar, mishit të ndarë mekanikisht apo mishit të pulës së freskët, Operatorët e Biznesit Ushqimor duhet të marrin:

- A) 2 mostra
- B) 3 mostra
- C) 5 mostra
- D) 7 mostra

Pyetja 110

Menaxherët e riskut për të interpretuar rezultatet e vlerësimit të riskut duhet:

- A) Të kenë informim pjesor rreth pikave të forta dhe të dobëta të vlerësimit të riskut, përfshirë edhe limitimet
- B) Të jenë të familjarizuar me protokollin e vlerësimit të riskut
- C) Të kenë informim të pjesshëm për natyrën, burimet dhe variabilitetin në karakterizimin e riskut
- D) Të vlerësojnë pjesërisht kuptimin dhe limitimet e vlerësimit relativ dhe absolut të riskut

Pyetja 111

Për menaxhimin e riskut mikrobiologjik tek ushqimet, cili nga opsionet është i saktë:

- A) Shkatërroni patogjenët /parazitët përmes ngrirjes së ushqimeve
- B) Shkatërroni patogjenët /parazitët përmes vendosjes së ushqimeve në temperaturën e mjedisit
- C) Shkatërroni patogjenët /parazitët përmes vendosjes së ushqimit në ambalazhe
- D) Shkatërroni patogjenët /parazitët përmes hedhjes në ushqim të acidit acetik

Pyetja 112

A është e vërtetë që rruga e saktë e vlerësimit të riskut varet nga:

- A) Lloji i riskut dhe konteksti ku ndodh
- B) Eksperienca e vlerësuesve të riskut
- C) Koha e shfaqjes së riskut
- D) Pasoja e riskut

Pyetja 113

A është e vërtetë që risku mikrobiologjik në ushqime karakterizohet nga:

- A) Hyrja e shkaktarit mikrobiologjik në disa hallka të zinxhirit ushqimor
- B) Shpërndarja homogjene e shkaktarit mikrobiologjik në ushqim
- C) Njëtrajtshmëria e konsumatorëve (sipas moshës) që bëhen viktime të konsumit të ushqimit të përlyer
- D) Njëtrajtshmëria e shenjave që shfaqin konsumatorët pas konsumit të ushqimit të përlyer

Pyetja 114

A mendoni që komunikimi i riskut ndihmon në:

- A) Inkurajimin e besimit të publikut për sigurinë ushqimore

- B) Punën e prodhuesve të ushqimeve për rritjen e fitimeve
- C) Përmirësimin e shijes së produkteve ushqimore
- D) Përmirësimin e kushteve të tregimit të produkteve ushqimore

Pyetja 115

Në cilën nga rastet e mëposhtme është i nevojshëm egzaminimi bakterologjik i karkasave:

- A) Është kryer një therje normale;
- B) Janë therur kafshë pa kryer aktin e trullësjes
- C) Është kryer eviscerimi i karkasave mbasi ka kaluar një orë nga akti i çgjakësimit
- D) Janë kryer në sallën e therjes njëkohësisht therje të specieve të ndryshme

Pyetja 116

Nga cilët faktorë varet gjendja bakteriale e mishit?

- A) Kontaminimi i karkasës, gjatë aktit të therjes
- B) Vendosja e karkasës në dhomat e magazinimit në ftohje
- C) Transporti i karkasave në kushte frigoriferike
- D) Vendosja e mishit në banakët frigoriferikë të dyqanit

Pyetja 117

Në cilin prej pozicioneve anatomike, kryhet marrja e mostrave për testim bakterologjik të karkasave të gjedhit:

- A) Qafë,
- B) Gjymtyrën e parë
- C) Kokë
- D) Kurriz

Pyetja 118

Cila nga shenjat e mëposhtme tregon se në karkasë ka gjeneralizim të sëmundjes:

- A) Prezencë e abseseve në pozicione të ndryshme anatomike të karkasës
- B) Prezencë e inflamimit në limfonodet e kokës
- C) Prezencë e lezioneve në zemër
- D) Prezencë e inflamimit të limfonodeve të gjymtyrës së parë

Pyetja 119

Cila nga shenjat e mëposhtme është bindëse për të vendosur që lezionet në karkasë i përkasin një stadi akut të sëmundjes?

- A) Prani aderencash në organe
- B) Hemoragji petekiale në organe të ndryshme
- C) Prani të abseseve në zorrë
- D) Prani të indit fibroz në zorrë

Pyetja 120

Karkasa e një kafshe, e cila në kontrollin para therjes, është diagnostikuar me LSD (Lympho skin disease) dhe ka demonstruar ethe, duhet të:

- A) Konfiskohet
- B) Trajtohet me kusht zierje
- C) Shitet me çmim të ulët
- D) Trajtohet në regjim ngrirje

16. Riprodhimi i kafshëve

Pyetja 1

Cili nga hormonet e mëposhtëm prodhohet nga Hipotalamusi?

- A) Hormoni Luteinizuës
- B) Hormoni PGF 2- α
- C) Hormoni Oksitocinë
- D) Hormoni Tiroksinë

Pyetja 2

Cili nga hormonet e mëposhtëm prodhohet nga Adenohipofiza?

- A) 17 β - Estradioli
- B) Prolaktina
- C) Testosteroni
- D) Relaksina

Pyetja 3

Cili nga hormone e mëposhtëm prodhohet nga endometra (mitra) e lopës ciklike?

- A) Hormoni folikulostimulues
- B) Hormoni PGF 2- α
- C) Hormoni Melatoninë
- D) Hormoni Somatotrop

Pyetja 4

Cili nga hormonet e mëposhtëm nxit maturimin dhe çarjen e folikulës së grafit?

- A) Hormoni Luteinizus
- B) 17 α - Estdioli
- C) Progesteroni
- D) Insulina

Pyetja 5

Cilin nga hormonet prodhohet nga trupi i verdhë?

- A) Prolaktina
- B) 17 α - Estdioli
- C) Progesteroni
- D) PGF 2- α

Pyetja 6

Cili nga hormonet e mëposhtëm prodhohet nga Folikula e Grafit?

- A) Progesteroni
- B) Prostaglandina F2- α
- C) Estradioli
- D) Hormoni Folikulo-Stimuluës

Pyetja 7

Sa zgjat mesatarisht afshi në lopë?

- A) 6 orë
- B) 18 orë
- C) 30 orë
- D) 36 orë

Pyetja 8

Kur ndodh ovulimi në lopë?

- A) Rreth 6 orë pas fillimit të afshit
- B) Rreth 12 orë pas fillimit të afshit
- C) Rreth 12 orë pas mbarimit të afshit
- D) Rreth 24 orë pas fillimit të afshit

Pyetja 9

Me cilin nga hormonet e mëposhtme bëhet sinkronizimi i afshit në lopë me prani të trupit të verdhë në vezore?

- A) Duke përdorur Progesteron
- B) Duke përdorur Oksitocinë
- C) Duke përdorur Serumin e Palave Barrëse (SPB)
- D) Duke përdorur Prostaglandinë F2- α

Pyetja 10

Cili nga kombinimet e mëposhtme përdoret për nxitjen e aktivitetit ovarik në lopë?

- A) Gn-RH + Progesteron
- B) Prostaglandinë F2- α + Progesteron
- C) Prolaktinë + Progesteron
- D) Oksitocinë + Progesteron

Pyetja 11

Cili nga kombinimet e mëposhtme përdoret për sinkronizimin e afshit dhe ovulimit në lopë?

- A) Gn-RH + Progesteron + Prostaglandinë F2- α + Prolaktinë
- B) Gn-RH + Progesteron + Prostaglandinë F2- α + Estradiol
- C) Gn-RH + Progesteron + Prostaglandinë F2- α + Gn-RH
- D) Gn-RH + Progesteron + Prostaglandinë F2- α + Melatoninë

Pyetja 12

Cili nga hormonet e mëposhtme përdoret për superovulimin në lopë?

- A) Hormoni luteinizues (HL)
- B) Prostaglandina F2- α (PGF 2- α)
- C) Progesteroni (P4)
- D) Serumi i Pelave Barrëse (SPB)

Pyetja 13

Cili nga hormonet e mëposhtme përdoret krahas inseminimit artificial në lopë?

- A) Prostaglandinë F2- α
- B) Hormonin Gn-RH
- C) 17 β Estradiolin
- D) Relaksinë

Pyetja 14

Në cilën pjesë të traktit gjeneral hidhet materiali biologjik gjatë inseminimit artificial në lopë?

- A) Në fundin e vaginës
- B) Në qafën e mitrës
- C) Në trupin e mitrës
- D) Në bririn e mitrës

Pyetja 15

Sa duhet të jetë temperatura e shkrirjes së materialit gjenetik pas nxjerrjes nga kontejneri (IA lopë)?

- A) 15⁰ C
- B) 25⁰ C
- C) 27⁰ C
- D) 37⁰ C

Pyetja 16

Sa duhet të jetë koha e shkrirjes së materialit gjenetik pas nxjerrjes nga kontejneri (IA lopë)?

- A) 10 - 40 sekonda
- B) 40 - 60 sekonda
- C) 60 - 120 sekonda
- D) 120 – 180 sekonda

Pyetja 17

Pas sa minutash rritet shkalla e fertilitetit kur materiali gjenetik depozitohet në traktin gjenital të lopës pas montimit të mikrosheringës?

- A) 10 - 20 minuta
- B) 20 - 40 minuta
- C) 40 - 60 minuta
- D) 60 – 120 minuta

Pyetja 18

Si trajtohen lopët me ciste folikulare?

- A) Duke injektuar Estrogjenë
- B) Duke injektuar PGF 2 - α
- C) Duke injektuar Gn-RH
- D) Duke injektuar Serum të Pelave Barëse (SPB)

Pyetja 19

Si trajtohen lopët me trup të verdhë persistent?

- A) Duke injektuar PGF 2 - α
- B) Duke injektuar Gn-RH
- C) Duke injektuar Estrogjenë
- D) Duke injektuar Progesteron

Pyetja 20

Si veprohet me një viç femër që lind nga një pjellje binjakë me viç mashkull në lopë?

- A) Mbahet për remont
- B) Trajtohet me hormone
- C) Trajtohet me rrugë kirurgjikale
- D) Skartohet për mish

Pyetja 21

Cila është domethënia klinike e kthimeve 25-35 ditë pas inseminimit në lopë?

- A) Mos-fekondim
- B) Ngordhje embrionale
- C) Afsh mbi barrën

D) Ngodhje fetale

Pyetja 22

Aderencat Burso-Ovarike (ABO), janë për shkak të:

- A) trajtimit hormonal
- B) shtypjes me dorë të trupit të verdhë
- C) ushqimeve të njëanshme
- D) prodhimit të së lartë të qumështit

Pyetja 23

Cila është karakteristika klinike e ngordhjeve embrionale të “rreme”?

- A) Kthime në cikle të rregullta
- B) Shkurtimi i ciklit estral
- C) Zgjatje e ciklit estral
- D) Rrjedhje vaginale të pista

Pyetja 24

Kur bëhet inseminimi artificial në lopë?

- A) Në fillim të afshit
- B) Në mes të afshit
- C) Në fund të afshit
- D) Pas përfundimit të afshit

Pyetja 25

Sa zgjat cikli estral në pela (mesatarisht)?

- A) 17 ditë
- B) 21 ditë
- C) 24 ditë
- D) 27 ditë

Pyetja 26

Sa zgjat afshi në pela (mesatarisht)?

- A) 1 ditë
- B) 2 ditë
- C) 5 ditë
- D) 10 ditë

Pyetja 27

Ovulimi në pela ndodh (mesatarisht):

- A) 12 - 24 orë para përfundimit të afshit
- B) 24 - 48 orë para përfundimit të afshit
- C) 12 - 24 orë pas përfundimit të afshit
- D) 24 - 48 orë pas përfundimit të afshit

Pyetja 28

Depozitimi i materialit gjenetik gjatë inseminimit artificial në pela bëhet në:

- A) vaginë
- B) fillim të qafës së mitrës
- C) fund të qafës së mitrës
- D) mitër

Pyetja 29

Sa duhet të jetë diametri i folikulës së Grafit në momentin e inseminimit artificial në pela (matje ekografike)?

- A) Rreth 5 mm
- B) Rreth 15 mm
- C) Rreth 25 mm
- D) Rreth 40 mm

Pyetja 30

Cili hormon përdoret krahas inseminimit artificial në pela për të sinkronizuar ovulimin?

- A) Gonadotropina Korionike Humane (GCH/HCG)
- B) Progesteron (P4)
- C) Prostaglandinë (PGF2- α)
- D) Estrogjenë (E2)

Pyetja 31

Serumi i Pelave Barrëse prodhohet nga:

- A) Trupi i verdhë primarë
- B) Trupat e verdhë sekondarë
- C) Kupat e endometrës
- D) Fetusi

Pyetja 32

Kur është koha e marrjes së SPB gjatë barrsmërisë në pela?

- A) 1 - 40 ditë të barrës
- B) 50 - 150 ditë të barrës
- C) 150 - 250 ditë të barrës
- D) 250 - 330 ditë të barrës

Pyetja 33

Sa zgjat cikli estral në dele (mesatarisht)?

- A) 14 ditë
- B) 17 ditë
- C) 21 ditë
- D) 24ditë

Pyetja 34

Sa zgjat afshi në dele (mesatarisht)?

- A) 6 - 12 orë
- B) 12 - 24 orë
- C) 24 - 40 orë
- D) 40 - 60 orë

Pyetja 35

Cili metodë ka efikasitet më të lartë në riprodhimin e programuar në dele?

- A) Trajtimi horemonal
- B) Trajtimi ushqimor
- C) Faktori “dash”
- D) Fotoperioda

Pyetja 36

Cili kombinim hormonal aplikohet për sinkronizimin e afshit brënda dhe jashtë sezonit të ndërzimit në dele?

- A) Serumi i Pelave Barëse (SPB) + Prostaglandinë F2- α
- B) Estrogjenë (E2) + Progesteronë
- C) Progesteronë (P4) + Foligonë (eCG)
- D) Prostaglandinë F2- α + Oksitocinë

Pyetja 37

Sa është koha e qëndrimit të tamponit në vaginën e deleve gjatë sinkronizimit të afshit në sezonin e riprodhimit?

- A) 7 ditë
- B) 10 ditë
- C) 14 ditë
- D) 17 ditë

Pyetja 38

Kur injektohet Foligoni (eCG ose SPB) gjatë sinkronizimit të afshit në dele?

- A) 12 orë para heqjes së tamponit vaginal
- B) Në momentin e heqjes së tamponit vaginal
- C) 12 orë pas heqjes së tamponit vaginal
- D) 24 orë pas heqjes së tamponit vaginal

Pyetja 39

Sa kohë pas trajtimit hormonal (afshi i sinkronizuar) duhet të bëhet ndërzimi natyral tek delet?

- A) 12 orë pas heqjes së tamponit vaginal
- B) 24 orë pas heqjes së tamponit vaginal
- C) 36 orë pas heqjes së tamponit vaginal
- D) 48 orë pas heqjes së tamponit vaginal

Pyetja 40

Ku depozitohet sperma gjatë inseminimit artificial në dele (metoda me vaginoskop)?

- A) Në vaginë
- B) Në hyrje të cerviksit
- C) Në trupin e mitrës
- D) Në mitër

Pyetja 41

Ku depozitohet sperma gjatë inseminimit artificial në dhi (metoda me vaginoskop)?

- A) Në vaginë
- B) Në hyrje të cerviksit
- C) Në trupin e mitrës
- D) Në mitër

Pyetja 42

Sa zgjat cikli estral në dhi (mesatarisht)?

- A) 14 ditë
- B) 17 ditë

- C) 21 ditë
- D) 24 ditë

Pyetja 43

Sa zgjat afshi në dhi (mesatarisht)?

- A) 6 - 12 orë
- B) 12 - 24 orë
- C) 24 - 36 orë
- D) 36 - 48 orë

Pyetja 44

Kush ka efikasitet më të lartë në riprodhimin e programuar në dhi?

- A) Të ushqyerit + faktori “Cjap”
- B) Të ushqyerit + fotoperioda
- C) Të ushqyerit + trajtimi hormonal
- D) Të ushqyerit + pa trajtime të veçanta

Pyetja 45

Cili kombinim hormonal aplikohet për sinkronizimin e afshit brenda sezonit të ndërzimit në dhi (trajtimi afat-shkurtër)?

- A) Progesteron (P4) + Foligon (eCG, SPB) + Prostaglandinë F2- α
- B) Progesteron (P4) + Estrogjenë (E2) + Oksitocinë
- C) Progesteron (P4) + Prostaglandinë F2- α + Prolaktinë
- D) Progesteron (P4) + Prostaglandinë F2- α + Melatoninë

Pyetja 46

Kur injektohet SPB ose eCG tek dhitë me afsh të sinkronizuar jashtë sezonit të ndërzimit?

- A) 12 orë para heqjes së tamponit vaginal
- B) 24 orë para heqjes së tamponit vaginal
- C) 36 orë para heqjes së tamponit vaginal
- D) 48 orë para heqjes së tamponit vaginal

Pyetja 47

Sa kohë pas trajtimit hormonal (afshi i sinkronizuar) duhet të bëhet ndërzimi natyral tek dhitë?

- A) 12 orë pas heqjes së tamponit vaginal
- B) 24 orë pas heqjes së tamponit vaginal
- C) 36 orë pas heqjes së tamponit vaginal
- D) 48 orë pas heqjes së tamponit vaginal

Pyetja 48

Sa zgjat cikli estral në dosa (mesatarisht)?

- A) 14 ditë
- B) 17 ditë
- C) 21 ditë
- D) 24 ditë

Pyetja 49

Sa zgjat afshi në dosa (mesatarisht)?

- A) 10 - 12 orë

- B) 12 - 24 orë
- C) 24 - 36 orë
- D) 36 - 48 orë

Pyetja 50

Kurba më e lartë e fertilitetit është kur dosat i inseminojmë:

- A) 1 - 12 orë pas fillimit të afshit
- B) 12 - 24 orë pas fillimit të afshit
- C) 24 - 36 orë pasfillimit të afshit
- D) 36 - 48 orë pas fillimit të afshit

Pyetja 51

Cili nga shenjat klinike tregon se dosa është në momentin më të mirë për t'u inseminuar?

- A) Ulja e oreksit
- B) Lëvizjet e shpeshta
- C) Refleksi i palëvizshmerisë
- D) Kërcimi mbi dosat e tjera

Pyetja 52

Sa zgjat cikli estral në bushtra (mesatarisht)?

- A) 2 muaj
- B) 3 muaj
- C) 4 muaj
- D) 6 muaj

Pyetja 53

Sa zgjat afshi në bushtra (mesatarisht)?

- A) 3 ditë
- B) 6 ditë
- C) 9 ditë
- D) 12 ditë

Pyetja 54

Në cilën fazë të ciklit estral është bushtra me rrjedhje sero-hemoragjike?

- A) Anestrus
- B) Proestrus
- C) Diestrus/metaestrus
- D) Estrus

Pyetja 55

Cilat qeliza dominojnë në një strishe vaginale gjatë afshit në bushtra?

- A) Qeliza intermediale
- B) Qelizat superficiale anukleare
- C) Qeliza parabazale
- D) Qeliza gjaku (eritrocite)

Pyetja 56

Cilat qeliza dominojnë në një strishe vaginale gjatë anestrusit në bushtra?

- A) Qelizat intermediale
- B) Qelizat superficiale

- C) Qelizat e kuqe të gjakut (eritrocite)
- D) Qelizat e bardha të gjakut (leukocite)

Pyetja 57

Cilat qeliza janë karakteristike në një strishe vaginale gjatë metastrus në bushtra të ndërzyera/iseminuara?

- A) Qelizat parabazale
- B) Qelizat superficiale
- C) Qelizat e kuqe të gjakut (eritrocite)
- D) Material biologjik (spermatozoidë)

Pyetja 58

Cilat janë qelizat karakteristike në një strishe vaginale gjatë proestrusit në bushtra?

- A) Qelizat intermediale
- B) Qelizat parabazale
- C) Eritrocitet
- D) Leukocitet

Pyetja 59

Cila skemë përdoret për nxitjen dhe sinkronizimin e afshit në bushtra jashtë sezonit të ndërzimit?

- A) Gonadotropina Serumit të Pelave Barrse + Gonadotropina Korionike Humane
- B) Progesteron + Gonadotropina Korionike Humane
- C) Progesteron + Gonadotropina Serumit të Pelave Barrse
- D) Gonadotropina Korionike Humane + Estrogjenë

Pyetja 60

Kur është momenti më i mirë për inseminimin artificial me spermë të ngrirë të bushtrës në afsh?

- A) 1 – 2 ditë pas fillimit të afshit
- B) 2 – 4 ditë pas fillimit të afshit
- C) 5 – 7 ditë pas fillimit të afshit
- D) 8 – 10 ditë pas fillimit të afshit

Pyetja 61

Sa zgjat cikli estral në mace (mesatarisht)?

- A) 7 ditë
- B) 10 ditë
- C) 14 ditë
- D) 21 ditë

Pyetja 62

Sa zgjat afshi në mace (mesatarisht)?

- A) 2 ditë
- B) 4 ditë
- C) 6 ditë
- D) 8 ditë

Pyetja 63

Cila është shenja kryesore gjatë kontrollit rektal për barsmërinë në lopë 75 ditë pas inseminimit?

- A) Asimetria e brirëve të mitrës
- B) Prova negative e tërheqjes
- C) Prania e placentomave
- D) Vibrimi i arteries uterine-media (AUM)

Pyetja 64

Kontrolli rektal tek lopët fillon nga:

- A) Vezoret
- B) Oviduktet
- C) Brirët e mitrës
- D) Cerviksi

Pyetja 65

Kontrolli rektal tek pelat fillon nga:

- A) Vezoret
- B) Oviduktet
- C) Brirët e mitrës
- D) Cerviksi

Pyetja 66

Barsmëria në kafshët bujqësore fillon në:

- A) Vaginë
- B) Ovidukte
- C) Brirët e mitrës
- D) Vezore

Pyetja 67

Sa ditë pas fekondimit mund t'i mbledhim zigotat e lira në mitrën e lopës?

- A) 2-4 ditë pas fekondimit
- B) 4-6 ditë pas fekondimit
- C) 6-8 ditë pas fekondimit
- D) 8-10 ditë pas fekondimit

Pyetja 68

Kur ndodh formimi i cipave fetale gjatë barsmërisë tek lopët?

- A) 1 - 15 ditë pas fekondimit
- B) 15 - 35 ditë pas fekondimit
- C) 35 - 45 ditë pas fekondimit
- D) 45 - 60 ditë pas fekondimit

Pyetja 69

Cili është veprimi praktik i gabuar tek një lopë me diagnozën "afsh mbi barrën"?

- A) Trajtimi hormonal
- B) Inseminimi artificial
- C) Trajtimi ushqimore
- D) Ndërzimi natyral

Pyetja 70

Tek cila kafshë është karakteristike Pseudobarsmëria?

- A) Lopa
- B) Dosa
- C) Bushtra
- D) Pela

Pyetja 71

Në cilën shenjë klinike bazohemi për vendosjen e diagnozës “Pseudobarrsmëri” në bushtra?

- A) Mungesa e oreksit
- B) Madhësia e barkut
- C) Zmadhimi i gjirit
- D) Ndryshimi i sjelljes

Pyetja 72

Si do ta trajtoni një bushtër me Pseudobarsmëri?

- A) Duke e trajtuar me Androgjene
- B) Duke e trajtuar me Estrogjene
- C) Duke e trajtuar me Progesteron
- D) Duke e trajtuar me SPB (Serumin e Pelave Barrëse)

Pyetja 73

Cili është shkaku i mumifikimit fetal?

- A) Hormonal
- B) Mikrobik
- C) Gjenetik
- D) Ushqimor

Pyetja 74

Si veprohet në rastet kur kemi një diagnozë “mumifikim fetal” në lopë?

- A) Shtojmë racionin ushqimor
- B) Nxitim procesin e pjelljes
- C) Presim datën e pjelljes
- D) E trajtojmë me antibiotikë

Pyetja 75

Cili nga hormonet e mëposhtëm nxit pjelljen tek një lopë me diagnozën “mumifikim fetal”?

- A) Progesteron (P4)
- B) Gn-RH
- C) SPB
- D) PGF 2- α

Pyetja 76

Si veprohet tek kafshët shumë-fetale (dosa, bushtra dhe mace), kur diagnostikohen me fetues të mumifikuar gjatë barrës (diagnozë ekografike)?

- A) Shtojmë racionin ushqimor
- B) Nxitim procesin e pjelljes
- C) Presim datën e pjelljes
- D) Paksojmë racionin ushqimor

Pyetja 77

Përdredhja e mitrës gjatë barsmërisë është me ferkuencë më të lartë në:

- A) pela
- B) lopë
- C) dele
- D) dhi

Pyetja 78

Si veprohet në raste e përdredhjes së mitrës para afatit të pjelljes me viç të gjallë (mosha e barrës 260 ditë tek lopa)?

- A) Aplikohet shpërdredhja e mitrës dhe vazhdimi i barrsmërisë
- B) Aplikohet shpërdredhja e mitrës dhe nxitja e pjelljes
- C) Aplikohet shpërdredhja e mitrës dhe anestezia e përgjithëshme
- D) Aplikohet shpërdredhja e mitrës dhe ndërprerja e ushqimit

Pyetja 79

Cila është shenja klinike kryesore në përdredhjen e mitrës gjatë barsmërisë në lopë?

- A) Shtimi i lëvizjeve
- B) Shtimi i ritmit të frymëmarrjes
- C) Shformimi i buzëve të vulvës
- D) Shtimi i rrahjeve të zemrës

Pyetja 80

Cili nga veprimet nuk aplikohet gjatë përdredhjes së mitrës me viç të gjallë (mosha e barrës >275 ditë tek lopa)?

- A) Prova e rrotullimit
- B) Laparatomia
- C) Prerja e Çezarit
- D) Trajtimi hormonal para shpërdredhjes

Pyetja 81

Si veprohet në rastet e përsëritura të prolapsit të vaginës para pjelljes?

- A) Qepja e vulvës
- B) Shtimi i ushqimit
- C) Shtimi i lëvizjeve
- D) Trajtimi me hormone

Pyetja 82

Faza e tretë e pjelljes mungon tek:

- A) pela
- B) lopa
- C) dosa
- D) delja

Pyetja 83

Anestezia epidurale në gjedhë kryhet në mes të vertebrës:

- A) 1 dhe 2 Lumbale
- B) 2 dhe 3 Lumbale
- C) 1 dhe 2 Koksigale
- D) 2 dhe 3 Koksigale

Pyetja 84

Anestezia epidurale në kuaj kryhet në mes të vertebrës:

- A) 1 dhe 2 Lumbale
- B) 1 dhe 2 Koksigale
- C) 2 dhe 3 Koksigale
- D) 2 dhe 3 Lumbale

Pyetja 85

Anestezia epidurale në dhën dhe dhi kryhet në mes të vertebrës:

- A) 1 dhe 2 Lumbale
- B) 2 dhe 3 Lumbale
- C) 2 dhe 3 Koksigale
- D) 1 dhe 2 Sakrale

Pyetja 86

Anestezia epidurale tek derri kryhet në mes të vertebrës:

- A) të fundit Lumbale dhe të parë Sakrale
- B) 1 dhe 2 Lumbale
- C) 2 dhe 3 Koksigale
- D) 1 dhe 2 Sakrale

Pyetja 87

Anestezia epidurale tek qeni kryhet në mes të vertebrës:

- A) 1 dhe 2 Lumbale
- B) së fundit Lumbale dhe të parës Sakrale
- C) 2 dhe 3 Koksigale
- D) 1 dhe 2 Sakrale

Pyetja 88

Procesi i pjelljes në kafshë nxitet nga:

- A) Mitra e mëmës
- B) Mëlçia e fetusit
- C) Hipotalamusi i mëmës
- D) Hipotalamusi i fetusit

Pyetja 89

Kur duhet të bëhet dhënja e kulloshtres tek të porsalindurit?

- A) 1 - 2 orë pas lindjes
- B) 2 - 3 orë pas lindjes
- C) 3 - 4 orë pas lindjes
- D) 4 - 5 orë pas lindjes

Pyetja 90

Tek një lopë gjatë pjelljes me diagnozën “ngushtësia e pelvisit” me viç të gjallë aplikohet:

- A) trajtimi hormonal
- B) tërheqja e fetusit me forcë
- C) prerja e Çezarit (operacioni)
- D) Fetotomia

Pyetja 91

Tek një lopë gjatë pjelljës me diagnozën “placentoma gjigande” me viç të gjallë ose të ngordhur aplikohet:

- A) fetotomia
- B) prerja e Çezarit
- C) tërheqja e fetusit me forcë
- D) trajtimi hormonal

Pyetja 92

Tek një lopë gjatë pjelljës me diagnozën “ngushtësia e vulvës” me viç të gjallë aplikohet:

- A) prerja e Çezarit (operacioni)
- B) tërheqja e fetusit me forcë
- C) vulvotomia
- D) Fetotomia

Pyetja 93

Tek një lopë gjatë pjelljës me diagnozën “stenoza cervikale shkalla 4” me viç të gjallë ose të ngordhur aplikohet:

- A) prerja e Çezarit
- B) tërheqja e fetusit me forcë
- C) Fetotomia
- D) trajtimi hormonal

Pyetja 94

Mpleksja e kordonit umbelikal haset më shpesh tek:

- A) qengjat
- B) gicat
- C) kecat
- D) kotelet

Pyetja 95

Tek një lopë gjatë pjelljës me diagnozën “fetus absolutisht i madh” me viç të gjallë aplikohet:

- A) trajtimi hormonal
- B) tërheqja e fetusit me forcë
- C) Fetotomia
- D) prerja e Çezarit

Pyetja 96

Kur vendoset diagnoza mbetje e shtratit në lopë?

- A) 1- 4 orë pas daljes së fetusit
- B) 4 - 8 orë pas daljes së fetusit
- C) 8 – 12 orë pas daljes së fetusit
- D) 12 - 24 orë pas daljes së fetusit

Pyetja 97

Kur vendoset diagnoza mbetje e shtratit në pela?

- A) 1 - 2 orë pas daljes së fetusit
- B) 2 - 4 orë pas daljes së fetusit
- C) 4 - 6 orë pas daljes së fetusit
- D) 6 - 8 orë pas daljes së fetusit

Pyetja 98

Kur vendoset diagnoza mbetje e shtratis në dele-dhi?

- A) 1 - 2 orë pas daljes së fetusit
- B) 2 - 6 orë pas daljes së fetusit
- C) 6 - 12 orë pas daljes së fetusit
- D) 12 - 24 orë pas daljes së fetusit

Pyetja 99

Cila skemë e trajtimit përdoret në pela me mbetje shtrati?

- A) Injektimi i sol. fiziologjik + Oksitocinë 50 UI
- B) Injektimi i glukonatit të kalciumit + Progesteron
- C) Injektimi i glukozës (40 %) + PGF 2-alfa
- D) Injektimi i glukozës (40 %) + Progesteron

Pyetja 100

Prerja e Çezarit bëhet në anën e djathtë të barkut gjatë pjelljes kur:

- A) fetusit është absolutisht i madh
- B) kemi përdredhje të mitrës
- C) kemi stenoze të cerviksit
- D) emi fetus monstruoze

Pyetja 101

Cili nga preparatet antimikrobikë është më efektiv në trajtimin e metritit akut me rrugë intrauterinë?

- A) Penicilina
- B) Oxitetraciklina
- C) Aminoglikozidet
- D) Nitrofurazoni

Pyetja 102

Cili nga preparatet antimikrobikë duhet të përzgjidhet gjatë metritit akut me rrugë paranterale?

- A) Penicilina
- B) Oxitetraciklina
- C) Aminoglikozidet
- D) Nitrofurazoni

Pyetja 103

Cili nga preparatet antimikrobikë duhet të përzgjidhet për trajtimin e metritit kronik me rrugë paranterale?

- A) Oxitetraciklina
- B) Penicilina
- C) Nitrofurazoni
- D) Aminoglikozide

Pyetja 104

Cili nga hormonet ka efikasitet më të lartë në trajtimin e piometrës në kafshë?

- A) Oksitocina
- B) Estrogjenët

- C) PGF 2-alfa
- D) Progesteroni

Pyetja 105

Cila është terapia antimikrobike pas largimit të qelbit gjatë piometrës në lopë?

- A) Aminoglikozide
- B) Oxitetraciklina
- C) Nitrofurazoni
- D) Penicilina

Pyetja 106

Cili nga hormonet ka efikasitet më të lartë në parandalimin e mbetjes së shtratit në kafshë?

- A) PGF 2 -alfa
- B) Oksitocinë
- C) Progesteron
- D) Estrogjenë

Pyetja 107

Sa kohë i duhet një lope për të zhvilluar involucionin e plotë të mitrës (racat e qumështit)?

- A) 25 - 30 ditë pas pjelljes
- B) 30 - 40 ditë pas pjelljes
- C) 40 - 50 ditë pas pjelljes
- D) 55 - 60 ditë pas pjelljes

Pyetja 108

Sa kohë i duhet një lope për të zhvilluar involucionin e plotë të mitrës (racat e mishit)?

- A) 25 - 30 ditë pas pjelljes
- B) 30 - 40 ditë pas pjelljes
- C) 40 - 50 ditë pas pjelljes
- D) 55 - 60 ditë pas pjelljes

Pyetja 109

Sa ditë pas pjelljes shfaqet afshi i parë në pela?

- A) rreth 5 ditë pas pjelljes
- B) rreth 9 ditë pas pjelljes
- C) rreth 15 ditë pas pjelljes
- D) rreth 21 ditë pas pjelljes

Pyetja 110

Ovulimi i parë në lopë zakonisht ndodh:

- A) 20 -30 ditë pas pjelljes
- B) 30 - 40 ditë pas pjelljes
- C) 40 - 50 ditë pas pjelljes
- D) 50 - 60 ditë pas pjelljes

Pyetja 111

Në cilën fazën të ciklit estral bëhet transferimi i embrioneve tek lopët?

- A) Proestrusit
- B) Estrusit
- C) Diestrusit

D) Metaestrus

Pyetja 112

Në cilën ditë të ciklit estral bëhet transferimi i embrioneve tek lopët (dita 1 konsiderohet dita e afshit)?

- A) Ndërmjet ditëve 1 dhe 2 të ciklit
- B) Ndërmjet ditëve 2 dhe 4 të ciklit
- C) Ndërmjet ditëve 4 dhe 6 të ciklit
- D) Ndërmjet ditëve 6 dhe 8 të ciklit

Pyetja 113

Çfarë nënkuptoni me termin Servis-Periodë?

- A) Periudhën nga pjellja deri në afshin e parë
- B) Periudhën nga pjellja deri në inseminimin e parë
- C) Periudhën nga pjellja deri në inseminimin fekunduës
- D) Periudhën nga inseminimi fekondues deri në pjellje

Pyetja 114

Sa duhet të jetë Servis-Perioda (SP) në një femër që nuk vuan nga shterpësia (mesatarisht në ditë)?

- A) 85 ditë
- B) 95 ditë
- C) 105 ditë
- D) 115 ditë

Pyetja 115

Sa duhet të jetë indeksi i inseminimit (II) në një femër që nuk vuan nga shterpësia (mesatarisht në doza spermë)?

- A) 1.5 – 1.7 doza spermë
- B) 1.8 – 2.0 doza spermë
- C) 2.1 – 2.3 doza spermë
- D) 2.3 – 2.5 doza spermë

Pyetja 116

Si bëhet trajtimi i mastiteve klinike në kafshë?

- A) Trajtim lokal
- B) Trajtim të përgjithshëm
- C) Trajtim i kombinuar
- D) Trajtim simptomatik

Pyetja 117

Si është gjendja e përgjithëshme e kafshëve me mastit subklinikë (lopë)?

- A) Normale
- B) E përkeqësuar
- C) E rëndë
- D) Shumë e rëndë (kolaps)

Pyetja 118

Kur mjekohen lopët me mastiti subklinik gjatë laktacionit të fundit?

- A) 24 orë para tharjes

- B) 12 orë para tharjes
- C) Mjeljen e fundit
- D) 12 orë pas mjeljes së fundit

Pyetja 119

Cili nga hormonet stimulon çlirimin e përmbajtjes së gjirit me mastit para trajtimit intramamarë?

- A) Estrogjenë
- B) Oksitocinë
- C) Progesterone
- D) Prostaglandinë

Pyetja 120

Cila është karakteristika klinike e cisteve luteinike (trupit të verdhë persistent) në lopë?

- A) Zgjatja e afshit
- B) Cikle estrale të shpeshta
- C) Ndërprerja e ciklit estral
- D) Shkurtimi i afshit

17. Kirurgji veterinare

Pyetja 1

Kur operacioni synon vetëm eliminimin e shenjave kryesore që rrezikojnë jetën e kafshës por jo shkaktarëve, atëhere operacioni quhet:

- A) Radikal
- B) Paliativ
- C) Plastik
- D) Septik

Pyetja 2

Përgjithësisht ndërhyrjet kirurgjikale me gjak realizohen duke kaluar në tre etapa të njëpasnjëshme. Cila prej tyre nuk është pjesë e këtyre etapave:

- A) Kontrolli radiologjik
- B) Afrimi operator
- C) Kryerja e ndërhyrjes kirurgjikale
- D) Mbyllja e plagës operatore

Pyetja 3

Cila nga patologjitë e mëposhtme nuk është infeksion kirurgjikal lokal?

- A) Forunculi
- B) Abscesi
- C) Septicemia
- D) Flegmona

Pyetja 4

Për të përshpejtuar procesin e pjekjes dhe çarjes së një abscesi aplikohet pomada me:

- A) Antibiotik
- B) Icthiol
- C) Prednison

D) Antimycotik

Pyetja 5

Me cilën nga patologjitë e mëposhtme nuk kryhet diagnoza diferenciale për absces?

- A) Hematoma
- B) Hernie
- C) Ulçer korneale
- D) Tumore

Pyetja 6

Cila prej substancave të mëposhtme konsiderohet si Antiseptike (Anti-kundër, sepsis-qelbëzim)?

- A) Prednisolon
- B) Amoxacyclinë
- C) Lidocainë
- D) Atropinë

Pyetja 7

Diagnostikimi i fistulës realizohet nëpërmjet njërës prej teknikave të mëposhtme:

- A) Kyretimi
- B) Drenazhimi
- C) Kontrastografi
- D) Kauterizimi

Pyetja 8

Cila nga situatat e mëposhtme nuk konsiderohet infeksion kirurgjikal i përgjithshëm:

- A) Bakteriemi
- B) Septicemi
- C) Antisepsi
- D) Pyemi

Pyetja 9

Mungesa e mikrobeve patogjene në indet e gjalla quhet:

- A) Asepsi
- B) Sterilizim
- C) Antiseptik
- D) Sepsis

Pyetja 10

Cila prej substancave të mëposhtme nuk përdoret për përpunimin dhe përgatitjen e fushës operatore?

- A) Alkooli
- B) Azot i lëngshëm
- C) Betadina
- D) Tinktura e Jodit

Pyetja 11

Prania e mikrobeve patogjene ose të toksinave të tyre në indet e gjalla quhet:

- A) Asepsi
- B) Dezifektim

- C) Sepsis
- D) Sterilizim

Pyetja 12

Cila nga patologjitë e mëposhtme konsiderohet dëmtim i hapur i indeve?

- A) Hernie
- B) Kontuzion
- C) Luksacion
- D) Plagë

Pyetja 13

Cila nga trajtimet e mëposhtme konsiderohet si ndërhyrje kirurgjikale pa gjak?

- A) Enterotomi
- B) Imobilizim i jashtëm i frakturës
- C) Rumenocentezis
- D) Torakotomi interkostale

Pyetja 14

Shërimi i plagëve kirurgjikale të freskëta dhe sterile konsiderohet si shërim:

- A) Me ind granulimi
- B) Me shtrirje primare
- C) Me shtrirje sekondare
- D) Shërim cikatrizues

Pyetja 15

Procesi i shkatërrimit të mikroorganizmave në paisje dhe instrumenta quhet:

- A) Sterilizim
- B) Antisepsi
- C) Kauterizim
- D) Sepsis

Pyetja 16

Koha e largimit të drenazhit në një plagë të infektuar është:

- A) 1-2 ditë
- B) 4-5 ditë
- C) Një javë
- D) Mbi 10 ditë

Pyetja 17

Cili nga penjtë për qepje është i tretshëm?

- A) Nailon
- B) Silk
- C) Catgut chromik
- D) Tefkon

Pyetja 18

Në rastet e mungesës së komplikimeve gjatë shërimit të plagëve operatore, pas sa ditësh nga operacioni duhen larguar penjtë e qepjes?

- A) 2-3 ditë
- B) 4-5 ditë

- C) 7-10 ditë
- D) 15- 17 ditë

Pyetja 19

Cila nga elementët e mëposhtëm nuk është pjesë e një hernie?

- A) Unaza ose porta herniale
- B) Qeska herniale
- C) Përmbajtja e hernies
- D) Membrana pyogene

Pyetja 20

Në rastin e hernies umbilikale, nuk është pjesë e përmbajtjes herniale:

- A) Dhjami
- B) Veshka
- C) Zorrët
- D) Omenta

Pyetja 21

Cilat nga patologjitë kirurgjikale të mëposhtme nuk bën pjesë në dëmtimet e mbyllura të indeve?

- A) Kontuzioni
- B) Flegmona intersticiale
- C) Plagë prerëse
- D) Luksacioni

Pyetja 22

Inflamacioni i njëkohshëm i disa artikulacioneve njihet me emrin:

- A) Bursit
- B) Poliartirit
- C) Pseudoarthros
- D) Tendosinovit

Pyetja 23

Cila nga patologjitë e mëposhtme të kockave nuk është me karakter inflamativ?

- A) Periostit
- B) Osteomielit
- C) Osteit
- D) Osteomalaci

Pyetja 24

Përdorimi i teknikës me të ftohtë, për të shkatërruar indet e nekrotizuara quhet:

- A) Kirurgji kozmetike
- B) Kriokirurgji
- C) Kirurgji ortopedike
- D) Kirurgji profilaktike

Pyetja 25

Cila nga procedurat e mëposhtme nuk konsiderohet endoskopi?

- A) Laringoscopi
- B) Bronkoscopi

- C) Intubim endotrakeal
- D) Artrosopi

Pyetja 26

Inflamacioni i kanalit dhe palcës së kockave të gjata njihet si:

- A) Periostit
- B) Osteit
- C) Osteomielit
- D) Rakitizëm

Pyetja 27

Cila nga gjakderdhjet e mëposhtme nuk konsiderohet hemorragji e brendshme?

- A) Hemothorax
- B) Hemoperitoneum
- C) Hemarthrosis
- D) Hematuri

Pyetja 28

Cila nga procedurat e mëposhtme nuk konsiderohet punkcion?

- A) Rumenocentesis
- B) Gastroectomy
- C) Cistocentesis
- D) Thoracocentesis

Pyetja 29

Grumbullimi i ajrit në brendësi të kavitetit torakal njihet si:

- A) Hemothorax
- B) Pyothorax
- C) Pneumothorax
- D) Hydrothorax

Pyetja 30

Në cilin rast të ndërhyrjes kirurgjikale rekomandohet hapja e kavitetit abdominal në linea alba (Laparotomi postumbilikale) në kafshët e shoqërimet?

- A) Gastrotomi
- B) Hernie diafragmatike
- C) Splenectomi
- D) Ovariohisterectomi

Pyetja 31

Në cilin rast të ndërhyrjes kirurgjikale për fiksimin e abomazit gjatë zhvendosjes së tij, rekomandohet që hapja e kavitetit abdominal në ripërtypësa të kryhet me teknikën:

- A) Laparotomi në linea alba
- B) Laparotomi paralumbalis destra
- C) Laparotomi paracostalis
- D) Laparotomi paralumbalis sinistra

Pyetja 32

Për cilën nga patologjitë e mëposhtme në ripërtypësa, nuk kërkohet hapja e kavitetit abdominal (Laparotomi abdominale)?

- A) Perikardit traumatik
- B) Zhvendosje e abomazit
- C) Rumenotomi
- D) Invaginacion i zorrës

Pyetja 33

Trajtimi kirurgjikal i timpanisë së rumenit në gjedhë realizohet nëpërmjet kryerjes së:

- A) Rumenotomisë
- B) Fistulës ruminale
- C) Rumenocentesis
- D) Intubim endotrakeal

Pyetja 34

Për cilën prej shkaqeve të mëposhtme ndodh deformimi i kockave të gjata pas lindjes?

- A) Dëmtimi i kërcit të rritjes
- B) Fraktura
- C) Mungesa e kalciumit
- D) Osteomieliti

Pyetja 35

Procedura e bashkimit të kockave të thyera njihet si:

- A) Fluidoterapi
- B) Kateterizim
- C) Kriokirurgji
- D) Osteosintezë

Pyetja 36

Cilët nga indet e mëposhtme kanë aftësi rigjeneruese minimale pas dëmtimit dhe trajtimit kirurgjikal të tyre?

- A) Kockat
- B) Indi tendinoz
- C) Indi nervor
- D) Zorrët

Pyetja 37

Hapja e kavitetit abdominal nga procesi ksifoid deri në cikatricen umbilikale konsiderohet:

- A) Laparotomi dorsale
- B) Laparotomi parakostale
- C) Laparotomi paramediane
- D) Laparotomi preumbilikale

Pyetja 38

Si konsiderohet aftësia shëruese e kockave të thyera?

- A) E shkëlqyer
- B) E mirë
- C) E dobët
- D) Shumë e dobët

Pyetja 39

Cila nga teknikat e mëposhtme nuk është e përshtatshme për ndalimin e hemorragjisë?

- A) Lidhja (Legatura) e enës gjakore
- B) Elektrokoagulimi
- C) Kyretimi
- D) Shtypja (tamponimi)

Pyetja 40

Ndërlikimi që nuk vërehet gjatë procesit të shërimit të një kocke të thyer pas imobilizimit është:

- A) Ngjitje në pozicion jo normal
- B) Ngjitje e vonuar
- C) Mosngjitje e frakturës (Pseudoarthrosis)
- D) Luksacion i kockave

Pyetja 41

Cila nga metodat e ndalimit të hemorragjisë aplikohet në rastin e përdorimit të tamponave të njomura me adrenalinë në fushën operatore?

- A) Metoda fizike
- B) Metoda kimike
- C) Metoda biologjike
- D) Metoda mekanike

Pyetja 42

Cila nga teknikat e mëposhtme nuk është pjesë e metodës mekanike të ndalimit të hemorragjisë?

- A) Tamponimi i fushës operatore
- B) Pincimi i enës së gjakut
- C) Lidhja (Legatura) e enës së gjakut
- D) Përdorimi i elektrokauterit

Pyetja 43

Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk është e vërtetë për penjtë që përdoren për qepjen e indeve?

- A) Të jenë plotësisht të sterilizueshëm
- B) Të rezistojnë ndaj forcës tërheqëse të indeve
- C) Të luftojnë infeksionin e plagës
- D) Të jenë të pranueshëm nga indet ku përdoren

Pyetja 44

Cila nga komplikacionet e mëposhtme nuk vërehet në reaksionet transfuzionale që ndodhin gjatë kryerjes së transfuzionit të gjakut në kafshë?

- A) Anafilaksi
- B) Hemolizë
- C) Hipokalcemi
- D) Septicemi

Pyetja 45

Moszbritja e testikujve në rajonin skrotal, pas lindjes njihet si:

- A) Anomali congenitale
- B) Criptorchisem
- C) Hernie inguinale
- D) Hernie scrotale

Pyetja 46

Në rastin e hernies inguinale dhe scrotale, struktura që duhet qepur dhe mbyllur hermetikisht është:

- A) Cipa e dyfishtë që mbështjell testikulin
- B) Kordoni spermatik
- C) Unaza e brendshme inguinale
- D) Unaza e jashtme inguinale

Pyetja 47

Prejta e cilës shtresë mbështjellëse të testikujve e diferencon kastrimin e hapur nga kastrimi i mbyllur?

- A) Tunika vaginale viscerale
- B) Tunika vaginale e dyfishtë
- C) Tunika spermatike
- D) Tunika parietale testikulare

Pyetja 48

Cili prej ligamenteve të traktit riprodhues femëror duhet shkëputur për të ndihmuar nxjerrjen e vezores gjatë ovariohisteroektomisë?

- A) Ligamenti suspensor
- B) Ligamenti proper
- C) Ligamenti uteroovarik
- D) Ligamenti i gjërë

Pyetja 49

Pseudoartroza është një difekt i ngjitjes së kockave të thyera që nuk ndodh për shkakun e mëposhtëm:

- A) Distanca e madhe e segmenteve të frakturës
- B) Lëvizshmëria e vazhdueshme e segmenteve të frakturës
- C) Si pasojë e dëmtimit të muskujve
- D) Vendosja e indeve të buta midis segmenteve të frakturës

Pyetja 50

Në diegjet e Shkallës III, pasoja më e lehtë që nuk rrezikon jetën e pacientit është:

- A) Hemorragjia
- B) Intoksikacioni
- C) Infeksioni kirurgjikal
- D) Shocku dolorik

Pyetja 51

Cila nga teknikat e mëposhtme kirurgjikale nuk përdoret për të siguruar imobilizim (palëvizshmëri) të segmenteve kockore të thyera?

- A) Përdorimi i shufrave endomedullare prej çeliku inoksidabël
- B) Përdorimi i fiksatorëve të jashtëm
- C) Përdorimi i pllakave me vida fiksuese prej çeliku inoksidabël
- D) Përdorimi i elektrokauterit për riakutizimin e procesit

Pyetja 52

Paraqitet rasti i një qeni të racës Labrador Retriever me një situatë klinike të tillë: enjtje akute dhe rrjedhje në artikulationin e djathtë të karpit. Radiografitë tregojnë ndryshime degjenerative minimale të karpit të djathtë dhe enjtje të indeve të buta rreth artikulationit radiokarpal. Nga vlerësimi i lëngut sinovial të artikulationit të djathtë karpal janë marrë rezultatet e mëposhtme: numuri i plotë i qelizave 150,000 qeliza/ μ , 90% neutrofile të segmentuara, 10% monocite, koagula mucine. Cili është shkaktari më i mundshëm i këtyre rezultateve?

- A) Artrit traumatik
- B) Artrit degjenerativ
- C) Artrit septic
- D) Artrit reumatizmal

Pyetja 53

Fiksimi i kafshëve nëpërmjet përdorimit të substancave miorelaksante nënkupton:

- A) Fiksim fizik të kafshëve
- B) Fiksim elektrik të kafshëve
- C) Fiksim kimik të kafshëve
- D) Fiksim me mjete rrethanore

Pyetja 54

Mbidozimi aksidental nga substancat analgjezike mund të korrigohet nëpërmjet injektimit të:

- A) Antisedan
- B) Detomidinë
- C) Doxapram
- D) Naloxon

Pyetja 55

Polamivet është specialitet neuroleptanalgjezik i përbërë nga kombinimi:

- A) Atropinë dhe Fentanil
- B) Droperidol dhe Fentanil
- C) Hioscinë dhe Methadone
- D) Detomidinë dhe Pethidine

Pyetja 56

Me cilën nga substancat e mëposhtme Diazepam (Valium) është fizikisht i pajtueshëm dhe mund të përzihet në të njëjtin injektor?

- A) Atropinë
- B) Fenotiazinik
- C) Barbiturik
- D) Ketaminë

Pyetja 57

Solucioni 2.5% i Novokainës përmban:

- A) 0.25 mg/ml Novokainë
- B) 2.5 mg/ml Novokainë
- C) 25 mg/ml Novokainë
- D) 250 mg/ml Novokainë

Pyetja 58

Mbështetur në forcën analgjezike, cila nga substancat e mëposhtme është analgjezik i fuqishëm?

- A) Fentanil
- B) Meperidinë
- C) Morfinë
- D) Xilazinë

Pyetja 59

Në cilën situatë kirurgjikale është e papërshtatshme anestezia e përgjithshme me Ketaminë?

- A) Cistotomi
- B) Kastrim
- C) Laparotomi
- D) Torakotomi

Pyetja 60

Mbidozimi i Ksilazinës mund të korigjohet nëpërmjet injektimit të:

- A) Antisedan
- B) Detomidinë
- C) Epinefrinë
- D) Naloxon

Pyetja 61

Cila prej teknikave të mëposhtme anestetikë, nuk është pjesë e anesteziës spinale?

- A) Anestezia epidurale
- B) Anestezia subdurale
- C) Anestezia disociative
- D) Anestezia subarachnoidale

Pyetja 62

Cila nga teknikat e mëposhtme nuk përdoret për anestezinë e murit anësor të barkut në rastin e rumenotomisë në ripërtpësë?

- A) Anestezia paravertebrale
- B) Anestezia infiltrative në vijën e prerjes
- C) Anestezia paralumbale
- D) Anestezia epidurale

Pyetja 63

Cila nga teknikat e Anestezia paravertebrale të murit anësor të kavitetit abdominal në gjedhë nuk përdoret për të bllokuar nervat spinale që dalin nga proceset transversale të vertebrave lumbale:

- A) Bllokimi në L1
- B) Bllokimi në L2
- C) Bllokimi në L3
- D) Bllokimi në L4

Pyetja 64

Për zgjatjen e efektit të veprimit të substancave anestetike lokale duhet që në tretësirën e tyre të shtohet një prej substancave të mëposhtme:

- A) Atropinë
- B) Adrenalinë

- C) Analginë
- D) Amoxacyclinë

Pyetja 65

Cili prej anestetikëve inhalatorë të mëposhtëm është në gjendje të gaztë?

- A) Halotani
- B) Metoxyfluorani
- C) Oksid Azoti (N₂O)
- D) Enfluorani

Pyetja 66

Cila është teknika që përdoret për futjen e gazeve në mushkëri gjatë anestezisë inhalatore?

- A) Trakeostomi
- B) Sondim gastrik
- C) Torakocentesis
- D) Intubim endotrakeal

Pyetja 67

Cila nga substancat e mëposhtme përdoret për eutanazi?

- A) Succinilcolina
- B) Sulfati i magnezit
- C) Eutanal
- D) Atropinë

Pyetja 68

Cili nga operacionet e mëposhtme për hapjen e një organi dhe largimin e një trupi të huaj në brendësi të tij nuk është korrekt si emërtesë?

- A) Cistotomi
- B) Enterotomi
- C) Gastroectomi
- D) Rumenotomi

Pyetja 69

Cili është emërtimi i saktë i ndërhyrjes për largimin kirurgjikal të shpretkës?

- A) Splenotomi
- B) Splenectomy
- C) Splenopexy
- D) Splenoscopi

Pyetja 70

Inflamacioni i trupit të vertebrës dhe i artikulacioneve intervertebrale njihet me emrin:

- A) Luksacion intervertebral
- B) Frakturë e procesit transversal
- C) Spondiloartrit
- D) Hernie diskale

Pyetja 71

Cili është termi i saktë kirurgjikal i qepjes së stomakut në murin anësor të kavitetit abdominal në rastet e përdredhjes së stomakut?

- A) Gastrotomy
- B) Gastropexy
- C) Gastroskopi
- D) Gastroectomi

Pyetja 72

Cili është termi i saktë kirurgjikal për rastin e hapjes së përhershme të trakesë në pjesën ventrale të qafës:

- A) Trakeotomy
- B) Trakeopexy
- C) Trakeoskopi
- D) Trakeostomi

Pyetja 73

Grumbullimi i gjakut poshtë lëkurës së llapës së veshit njihet me termin:

- A) Otit kronik
- B) Otohematomë
- C) Hemangiomë
- D) Hemartrosis

Pyetja 74

Teknika e bashkimit të segmenteve të zorrëve pas largimit të një pjese të nekrotizuar, njihet si:

- A) Enterotomi
- B) Invaginacion i zorrës
- C) Anastomozë e zorrëve
- D) Enteropexy

Pyetja 75

Shtresa e ezofagut që reziston më shumë qepjes gjatë ezofagotomisë është:

- A) Adventicia
- B) Mukoza
- C) Submukoza
- D) Shtresa muskulare e lëmuar

Pyetja 76

Cila prej nyjeve limfatike të shtrira kaudalisht deri te gjëndra e pestë mamare duhet të largohet gjatë mastektomisë unilaterale të gjirit?

- A) Pudentale
- B) Perineale sipërfaqore
- C) Inguinale
- D) Pudento-epigastike

Pyetja 77

Bllokimi i gjëndrës së pështymës (mukocele salivare) kërkon largimin e:

- A) Gjëndrës parotis
- B) Gjëndrës submaxillare
- C) Gjëndrës sublinguale
- D) Gjëndrës zigomatike

Pyetja 78

Cila prej bllokimit të gjëndrave të pështymës njihet me emrin ranula salivare?

- A) Mandibulare
- B) Parotide
- C) Sublinguale
- D) Zigomatike

Pyetja 79

Gjatë zhvendosjes së abomazit, pas ripozicionimit duhet të kryhet procedura kirurgjikale e mëposhtme:

- A) Abomazotomi
- B) Abomazopexy
- C) Abomazocentesis
- D) Abomazoscopi

Pyetja 80

Cili është emërtimi i saktë i hapjes së fshikës urinare gjatë nxjerrjes së gurëve urinarë?

- A) Cistoscopi
- B) Cistocentesis
- C) Cistotomi
- D) Cistopexy

Pyetja 81

Paretet korneale të thundrës në lopë rriten afërsisht:

- A) 2-4 mm në muaj
- B) 6-8 mm në muaj
- C) 10-12 mm në muaj
- D) 14-16 mm në muaj

Pyetja 82

Prerjet e thundrave në lopë duhet të realizohen periodikisht:

- A) Çdo 3 muaj
- B) Çdo 6 muaj
- C) Çdo 9 muaj
- D) Çdo 12 muaj

Pyetja 83

Kryerja e trakeostomisë së përkohshme në kuaj realizohet në rastin e:

- A) Edemës pulmonare
- B) Tumoreve të laringut
- C) Bllokimit të rrugëve të sipërme të frymëmarjes
- D) Torakotomisë interkostale

Pyetja 84

Për cilën arsye duhet të evitohet sa më shumë që të jetë e mundur hapja e ezofagut në brendësi të rajonit torakal në rastet e bllokimit nga trupa të huaj (ezofagotomi intratorakale)?

- A) Ngushton aortën
- B) Traumatizon trakenë
- C) Shkakton hernie diafragmatike
- D) Rrezikon infeksion intratorakal

Pyetja 85

Forma më e rëndë e dëmtimit të kafazit të kraharorit gjatë depërtimit të ajrit në brendësi të tij, e cila pasohet me vdekjen e shpejtë të pacientit është:

- A) Pneumotoraksi i hapur
- B) Pneumotoraksi i mbyllur
- C) Pneumotoraksi valvular
- D) Pleuriti akut

Pyetja 86

Cila nga patologjitë e mëposhtme të shpretkës nuk është arsye për largimin operator të saj (Splenectomi)?

- A) Përdredhja e shpretkës
- B) Reaksione autoimune
- C) Tumor i shpretkës
- D) Sëmundje parazitare

Pyetja 87

Cila nga patologjitë e mëposhtme të stomakut në kafshët monogastrike nuk trajtohet në rrugë kirurgjikale?

- A) Inflamacioni i stomakut
- B) Përdredhja dhe dilatimi i stomakut
- C) Ulçera gastrike
- D) Trupat e huaj në stomak

Pyetja 88

Cila nga teknikat e mëposhtme kirurgjikale duhet të aplikohet në rastin e largimit të trupit të huaj në zorrë?

- A) RezekSION intestinal
- B) Enterotomi
- C) Enteropexy
- D) Anastomozë e zorrëve

Pyetja 89

Largimi vetëm i vezoreve për sterilizimin në mace njihet si:

- A) Sectio Cesare
- B) Ovarioectomi
- C) Ovariohisterectomi
- D) Trajtim Hormonal

Pyetja 90

Në cilën nga patologjitë e mëposhtme të organeve të riprodhimit në kafshët e shoqërimit nuk realizohet largimi operativ i vezores së bashku me mitrën (Ovariohisterectomi):

- A) Piometër
- B) Tumor i vezoreve
- C) Prolaps i mitrës
- D) Tumor vaginal

Pyetja 91

Cila nga teknikat kirurgjikale aplikohet për largimin e gurëve urinare në fshikën e urinës:

- A) Kateterizim
- B) Cistotomi
- C) Cistocentesis
- D) Uretrostomi perineale

Pyetja 92

Kur nuk respektohen rigorozisht rregullat e asepsisë gjatë rumenotomisë, komplikacioni më i shpeshtë postoperator është:

- A) Hernia inguinale
- B) Përdredhja e mitrës
- C) Fistula ruminale
- D) Zhvendosja e abomazit

Pyetja 93

Cili është faktori më i rëndësishëm predispozues për zhvendosjen e abomazit në gjedhë?

- A) Boshatisja e kavitetit abdominal pas lindjes
- B) Invaginacioni i zorrëve
- C) Timpania e rumenit
- D) Tejmbushja e rumenit

Pyetja 94

Dëmtimi më i rëndë që vërehet në rastin e luksacionit koksofemoral është:

- A) Thyerja e kokës së femorit
- B) Dëmtimi i muskujve obturatore
- C) Këputja e Ligamentit rotond
- D) Nekroza aseptike e kokës së femorit

Pyetja 95

Komplikacioni më i rëndë postoperator që bashkëshoqëron korrigjimin kirurgjikal të hernies diafragmatike është:

- A) Insuficencë hepatike
- B) Edemë pulmonare
- C) Fibrilacion arterial
- D) Hemoragji nga plaga diafragmatike

Pyetja 96

Zmadhimi i kolonit në mace (megakolon) më shpesh shoqërohet me:

- A) Prania e një mase jashtë lumenit siç është adenokarcinoma
- B) Prania e një mase brenda lumenit siç është trupi i huaj
- C) Displazi e pelvisit
- D) Traumë lumbosakrale

Pyetja 97

Bllokimi i pjesës cervikale të ezofagut nga trupa të huaj mund të korrigjohet nëpërmjet afrimit operator në:

- A) Pjesën dorsale të ezofagut
- B) Pjesën laterale të ezofagut
- C) Në brazdën jugulare
- D) Në pjesën ventrale të rajonit cervical, duke sposuar trakenë

Pyetja 98

Çifti i arterieve dhe venave që duhet të lokalizohen, të izoloohen, të lidhen dhe të priten gjatë largimit të gjëndrës së pestë mamare në mace është:

- A) Pudentoepigastrike
- B) Kaudale e thellë epigastrike
- C) Inguinale
- D) Pudente e jashtme

Pyetja 99

Shenja klinike më e zakonshme që lidhet me stenozën pilorike është:

- A) Ptializëm
- B) Anoreksi
- C) Vjellja
- D) Dhimbje abdominale

Pyetja 100

Cila nga patologjitë e mëposhtme nuk prek thundrat:

- A) Tylom (Limax)
- B) Bursit precarpal
- C) Ulcera soleare
- D) Dermatitis Digitalis (DD/Mortellaro/ Sëmundja e luleshtrydhes)

Pyetja 101

Dëmtimi më i shpeshtë dhe më i rëndë i thundrave në njëthundrakë njihet si:

- A) Tendinit i fleksorit sipërfaqësor
- B) Laminit
- C) Luksacion i falangës I
- D) Bursit i ekstensorit të përbashkët të gishtërinjve

Pyetja 102

Cila nga procedurat e mëposhtme rekomandohet për trajtimin e tendinitit kronik në kuaj:

- A) Fluidoterapi
- B) Përdorim i pomadave antiinflamatore
- C) Riakutizim i procesit
- D) Qepje e tendinit

Pyetja 103

Qëllimi kryesor i largimit kirurgjikal të mitrës të mbushur me eksudat qelbëzor (Piometër) është:

- A) Për të ndryshuar sjelljen e kafshës
- B) Për diagnostikim
- C) Për të rikthyer sistemin riprodhues të kafshës në gjendje normale
- D) Për qëllime mjekuese, pavarësisht humbjes së aftësive riprodhuese të kafshës

Pyetja 104

Cili nga faktorët predispozues të mëposhtëm nuk përbën shkak për këputjen e ligamentit kryqor kranial në qen:

- A) Qen obez
- B) Qen i racave të mëdha
- C) Qen me moshë 8 muajsh

D) Qen impulsiv që kërcen dhe vrapon gjithmonë

Pyetja 105

Në qentë me nekrozë aseptike të kokës së femurit, anamneza përfshin të gjitha alternativat e mëposhtme me përjashtim të:

- A) Qen lodër ose racë e vogël
- B) Qen me moshë 3-4 vjeç
- C) Shpërthim gradual me shtim të çalimit
- D) Unilateral ose bilateral

Pyetja 106

Të gjitha trajtimet e mëposhtme për luksacionin koksofemoral janë të sukseshme me përjashtim:

- A) Fashimi Ehmer
- B) Fiksimi transartikular me kapse
- C) Kapsulorafi
- D) Qepje e ligamentit rotond

Pyetja 107

Cila prej alternativave të mëposhtme nuk përbën indikacion për korrigjimin emergjent të një hernie diafragmatike (herniorafi)?

- A) Grumbullimi i gjakut dhe ajrit në toraks
- B) Insuficencë e rëndë respiratore nga organe të pranishme në hapsirën torakale
- C) Bllokim i stomakut në brendësi të toraksit, duke rritur akumulimin e gazit
- D) Cianozë persistente pavarësisht oksigjenoterapisë dhe fluidoterapisë

Pyetja 108

Cili është shkaku më i mundshëm i regurgitacionit në një mace 1-2 muaj pas ovariohisterektomisë:

- A) Zmadhim i ezofagut si rrjedhojë e efekteve të substancave preanestetike
- B) Ngushtim i ezofagut si rrjedhojë e refluksit ezofagal
- C) Çrregullimi i inervimit vagal
- D) Hipersensitiviteti ndaj ushqimit të dhënë në shtëpi në ndryshim nga ushqimi i dhënë në klinikë.

Pyetja 109

Një nga komplikacionet më të rëndësishme që lidhet me vendosjen e trakeotubit gjatë trakeostomisë së përkohshme është:

- A) Emfizemë subkutane
- B) Pneumomediastinum
- C) Bllokim i tubit me mukus
- D) Paralizë e laringut si rrjedhojë e gacimit të nervit laryngeal

Pyetja 110

Ngushtimi i trakesë pas kryerjes së trakeotomisë në kuaj është më shumë pasojë e:

- A) Përdorimit të penjëve të paabsorbueshëm
- B) Tensionit në vijën e qepjes
- C) Pranisë së mikroorganizmave në lumenin e trakesë
- D) Vendosjes së nyjeve shumë larg njëra tjetrës

Pyetja 111

Procedura kirurgjikale që zgjidhet për korrigjimin e konstipacionit kronik bashkëshoqëruar me megakolon është:

- A) Kolonektomi e pjesshme
- B) Largimi i një rripi gjatësor të kolonit për të zvogluar diametrin e lumenit
- C) Kolonopeksi
- D) Kolonektomi e plotë

Pyetja 112

Cili prej nervave mund të dëmtohet më shpesh gjatë ndërhyrjes kirurgjikale për korrigjimin e frakturës proksimale të femurit ose frakturës pelvike?

- A) Nervi obturator
- B) Nervi perineal
- C) Nervi ishiatik
- D) Nervi pudent

Pyetja 113

Komplikacioni më i zakonshëm dhe më serioz pas uretostomisë perineale është :

- A) Urinim i pavullnetshëm
- B) Ngushtimi uretral
- C) Formimi i gurëve urinarë
- D) Inflamacion i fshikës së urinës

Pyetja 114

Korrigjimi i prolapsit të mitrës nëpërmjet laparotomisë, kur duhet të ruhen aftësitë riprodhuese të kafshës realizohet nëpërmjet teknikës kirurgjikale të mëposhtme:

- A) Kryerja e një histerektomie unilaterale për të paksuar volumin uterin në këtë mënyrë prolapsi ka më pak mundësi që të rihvillohet
- B) Kryerja e një ovariohisteroektomie unilaterale
- C) Qepja e trupit të mitrës ose të çdo briri të mitrës në murin lateral të trupit
- D) Lidhja dhe prerja e brirëve të mitrës

Pyetja 115

Procedura kirurgjikale e zgjedhur për trajtimin e një tumori mamar të pranishëm në një gjëndër gjiri është:

- A) Rezekcioni vetëm i masës tumorale
- B) Mastektomia rajonale
- C) Ovariohisteroektomi
- D) Mastektomia laterale e një rrjeshti me largimin edhe të nyjeve limfatike rajonale

Pyetja 116

Inflamacioni i kornesë njihet si:

- A) Scleritis
- B) Cheratitis
- C) Cheratoconjunctivitis
- D) Uveitis

Pyetja 117

Në cilat patologji të syrit është i kundërlinduar përdorimi lokal i kortikosteroideve:

- A) Uveitis

- B) Episcleritis
- C) Glaukomë
- D) Ulçer korneale

Pyetja 118

Cila prej teknikave të mëposhtme diagnostike në Oftalmologji përdoret për të matur presionin (tensionin) e syrit në rastin e Glaukomës:

- A) Testi Schirmer
- B) Testi i Fluoresceinës
- C) Tonometria
- D) Testi i Fenolit të kuq

Pyetja 119

Verbimi në fazën e fundit të glaukomës është rezultat i dëmtimit të:

- A) Kornesë
- B) Retinës
- C) Lentës kristaline
- D) Nervit optik

Pyetja 120

Katarakti (Cataract) është sëmundje e syrit që prek:

- A) Sklerën
- B) Kornenë
- C) Lentën kristaline
- D) Konjuktivën

18. Sëmundjet e Kafshëve Ripëtypëse

Pyetja 1.

Në klinikë paraqitet një viç femër, me moshë 12 muaj. Viçi po bën 3 ditë që ka ulje oreksi dhe zgjedh vetëm ushqimet e imta dhe të gjelbra. Në pjesën e gushës evidentohet një zonë e ënjtuar simetrike e cila gjatë kontrollit me palpim ndihet e fortë, e nxehtë dhe e dhimbshme. Kafsha paraqet vështirësi në frymëmarrje, zhurma të ngjashme me gërhitjen në të dy fazat e frymëmarrjes dhe ka zërin e ngjirur. Temperaturën e trupit e ka 40.3 °C (me luhatje ditore nga 39.8 deri në 40.6 °C).

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Faringit akut
- B) Absces i faringut
- C) Laringit akut
- D) Parotit akut

Pyetja 2.

Një dem me moshë 2-vjeçare, paraqet vështirësi për të kullotur në 4 ditët e fundit, e shkaktuar nga paaftësia për të mbyllur plotësisht gojën e tij. Demi duket indiferent dhe në gjendje të deboluar. Demi manifeston pak ataksi kur ecën në stallë. Temperatura rektale është 40.5 °C. Gjatë kontrollit klinik ai ka reagim normal ndaj ngacmimit në të dy sytë, por reflekset pupillare ndaj dritës mungojnë. Te ai vërehet strabismus por jo nistagmus. Në syrin e djathtë duket fenomeni i ekzoftalisë. Demi paraqet gjithashtu paralizë bilaterale të muskujve mastikatorë të

pasuar me ashpërsimin e mukozës së faqeve. Gjuha ka një pozicion pasiv dhe e dalë jashtë, por që mund të tërhiqet në kavitetin e gojës pas ngacmimit. Demi përjeton vështirësi në gëlltitje, por është në gjendje të konsumojë koncentrat kur ena për ushqim ngrihet në lartësinë e shpatullave. Nuk ka pjerrësi të dukshme në mbajtjen e kokës. Auskultimi i gjoksit nuk arrin të zbulojë ndonjë zhurmë jonormale të mushkërive, por në auskultimin e zemrës dallohet bradycardi e theksuar (42 rrahje në minutë). Peristaltika e rumenit paraqitet me kontraktime normale.

Në gjykimin tuaj demi mundet të vuajë nga:

- A) Abscese në tru (hipofizarë)
- B) Listerioza
- C) Sëmundja “Lopa e çmendur” (BSE)
- D) Botulizmi

Pyetja 3.

Një lopë e racës Laramane e zeze, me moshë 12 vjet paraqitet në klinikë me gjendje të deboluar dhe temperaturë 40.8 °C. Lopa ka lindur para 8 muajve dhe nuk është ndërzyer. Prodhimi ditor i qumështit është 6 litra. Lopa qëndron shumë kohë si e menduar, ka të zmadhuara venat jugulare dhe shfaq dridhje të muskujve prapa shpatullës. Shpesh në mëngjes i vërehen zona të ënjtura në gushë, gjoks, në bark dhe në gjymtyrë, por që i zhduken gjatë ditës. Lopa ecën me ngadalë dhe lodhet shpejt. Ajo shfaq frymëmarrje të vështirësuar, ulje të oreksit të shoqëruar dhe me rrallim të procesit të ripërtpjes. Nuk ka vështirësi për të lëvizur në terena të tatëpjeta.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Perikarditi traumatik akut
- B) Perikarditi traumatik kronik
- C) Endokarditi verukoz
- D) Miokarditi kronik

Pyetja 4.

Një viç me moshë rreth 2 muajsh ka pësuar gjendje kolapsi. Temperatura e rektumit është subnormale, 38.1 °C. Sytë janë dukshëm të zhytur në orbita dhe pasi bëhet prova e dehidratimit, lëkurës i duhet më shumë se 5 sekonda për të shkuar në pozicion normal (ekuivalente me një shkallë dehidratimi 7 – 10 %). Mukozat e kontrollueshme (konjuktivat dhe ajo e gojës) janë hiperemike. Ritmi i punës së zemrës është 120 rrahje në minutë. Denduria e frymemarrjes është 28 akte frymëmarrëse në minutë dhe në auskultim dëgjohet një rënkim i lehtë gjatë ekspirimit. Abdomeni paraqitet i fryrë dhe gjatë palpimit të tij viçi reagon me rënkim të dhimbshëm.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Enteriti clostridial
- B) Ulçera perforative e abomazit
- C) Trikobezoarët
- D) Invaginacioni i zorrëve

Pyetja 5.

Një qengj mashkull me moshë 8 mujsh, paraqitet me histori një mujore të ecjes së vështirësuar (si i ngrirë) dhe me ënjtje unilaterale skrotale. Në zonën e ënjtur të skrotumit ka rënie e mungesë qimesh (alopeci). Nuk vërehen shenja të tjera klinike gjatë ekzaminimit klinik.

Në gjykimin tuaj shkaku i lezionit në skrotum lidhet me:

- A) Epididimitis i njëanshëm
- B) Herie scrotale
- C) Pickim nga gjarpëri

D) Hematoma nga trauma

Pyetja 6.

Në verën e vonë një fermer ankohet se disa dele kanë humbur peshë të konsiderueshme si pasojë e mos kullotjes, disa ditë pas matrikullimit. Ato janë parë shpesh duke goditur kokën e tyre me gjymtyrët e prapme, madje kanë shkaktuar dhe dëmtime traumatike në kokë dhe në veshë. Delet e prekura duken në gjendje stresi, vrapojnë në mënyrë të rufeshme për 10 – 15 m dhe pastaj ndalojnë për të filluar sërish të vrapojnë.

Në gjykimin tuaj dukuria në dele mundet të shkaktohet nga:

- A) Cenuroza
- B) Miaza (Larvat e *Hydrotea irritans*)
- C) Deficiencat e vitaminës B₁
- D) Dermatiti fotosensitizues

Pyetja 7.

Një viç mashkull me moshë 4-ditësh nuk ka qenë në gjendje të mbajë peshën e tij në këmbën pasme të djathtë që nga lindja, e cila ishte e vështirë dhe me shumë tërheqje. Temperatura në rektum është 38.5 ° C. Te viçi vërehet trashje e mureve të kërthizës. Gjatë kontrollit klinik konstatohet se ekziston humbje e tonusit të muskujve dhe janë ulur ndjeshëm reflektet në gjymtyrën e pasme të djathtë, ndërsa gjymtyra e pasme e majtë paraqitet normale. Reflekse normale janë të pranishme edhe në gjymtyrët e para.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Trauma e palcës së kurrizit
- B) Artriti septik i atrikulacionit tarsal
- C) Paraliza e nervit radial
- D) Luksacioni i artikulacionit koksofemoral

Pyetja 8.

Një qengj me moshë 4 muaj, është gjetur në gjendje të deboluar, shumë i lodhur, në qëndrim të shtrirë dhe i ndarë nga nëna e tij. Temperatura rektale është 41.1 °C. Denduria e frymëmarrjes është 24 akte frymëmarrëse për minutë dhe ritmi i punës së zemrës është 120 të rrahura për minutë. Nuk ka rrjedhje nga sytë apo hunda. Mukozat e kontrollueshme duken të kongjestiuara. Auskultimi i kraharorit evidenton zhurma fishkëllyese në zonat antero-ventrale. Qengji defekon me feçe normale në formë dhe konsistencë. Klinikisht nuk vërehen anormalitete të tjera.

Në gjykimin tuaj, qengji mundet të vuajë nga:

- A) Sëmundje respiratore akute (*Mannheimia haemolytica*)
- B) Gjendje septicemike
- C) Infeksione klostridiale në fazat e para (Sëmundja e veshkës së zbutur)
- D) Peritonit i gjithësuar

Pyetja 9.

Në mes të pranverës një klient ankohet për humbje në peshë dhe diarre që ka prekur të paktën 30 nga 120 qengjat me moshë 3 – 6 javë. Asnjë nga delet nuk është prekur. Qengjat janë rritur brenda për javët e para të jetës dhe 2 javë më parë kanë filluar të mbahen plotësisht në kullota natyrale. Delet janë ushqyer përveç kullotës dhe me silazh plus 1 kg ushqim të koncentruar me përmbajtje 18 % proteina (për një dele çdo ditë). Qengjat më të vegjël janë të prekur më rëndë dhe duken në gjendje trupore më të keqe. Ndotje me feçe vërehen në bishtin dhe zonën perineale të qengjave. Qengjat manifestojnë tenezma të shpeshta dhe defekojnë sasi të vogla fekalesh të lëngshme që përmbajnë shumë mukus dhe spërka gjaku të fresket.

Në gjykimin tuaj, qengjat mundet të vuajnë nga:

- A) Salmonelozë
- B) Kokcidiozë
- C) Infestimi nga *Strongyloides papillosus*
- D) Kriptosporidiozë

Pyetja 10.

Një viç mashkull me moshë 4-ditore nga një tufë viçash, paraqitet me gjendje shumë të deboluar dhe nuk ka qenë i aftë të pijë qumësht për 36 orë e fundit. Viçi u shfaq normal për 2 ditë e para kur dhe u vërejt të pinte normalisht kulloshtren, madje brenda 2 orëve të para paslindjes. Temperatura rektale është 38.2 °C. Viçi është shumë i dobët, por megjithatë është në gjendje të qëndrojë në këmbë kur ndihmohet. Viçi është i dehidratuar me sy të futur thellë në orbita. Pala e lëkurës gjatë provës së dehidratimit kthehet në pozicionin normal për më shumë se 5 sekonda. Mukozat e kontrollueshme duken të kongjestionuara. Denduria e frymëmarrjes është e rritur, deri në 40 akte frymëmarrëse në minutë. Abdomeni është dukshëm i fryrë dhe gjatë balotimit dëgjohet prania e zhurmave të përplasjes së lëngjeve. Nuk ka dëshmi të diarresë dhe nuk ka prani feçesh në termometër. Nyjet limfatike nuk janë të zmadhuara, por ka trashje të mureve të kërthizës.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Onfaloflebiti dhe peritoniti shoqërues
- B) Atresia coli
- C) Gjendje septicemike
- D) Ruptura e fshikzës së urinës (uoperitoneum)

Pyetja 11.

Tre nga 120 viçat e mbajtur për majmëri kanë ngordhur papritmas gjatë javës së fundit. Viçat janë mbajtur në stallë për 6 javë dhe janë ushqyer me racion me përmbajtje të lartë koncentratesh plus ad libitum patate dhe kashtë elbi. Ekzaminimi i njollave të gjakut nga kafshët e ngordhura ka rezultuar negativ për antraksin.

Në gjykimin tuaj, viçat kanë ngordhur nga:

- A) Këmbëzeza
- B) Asfiksia
- C) Pasterelozë apo gjendje të tjera septicemike
- D) Acidoza klinike (toksike)

Pyetja 12.

Një lopë e racës Holstein, e cila ka pjell 10 ditë më parë, nuk ka oreks dhe dha vetëm 4 litra qumësht në mjeljen e saj të fundit. Lopa është shumë e deboluar dhe e dehidratuar. Ajo ka sy të futur thellë në orbita dhe gjatë provës së dehidratimit lëkura kërkon më shumë se 5 sekonda për t'u kthyer në pozicionin normal (dehidratim > 7 %). Pavarësisht oreksit të ulët të raportuar, gjatë 2 ditëve të kaluara, abdomeni duket i zmadhuar. Temperatura në rektum është 38.4 °C. Ritmi i punë së zemrës është 104 rrahje në minutë dhe denduria e frymëmarrjes është 28 akte në minutë. Perkutimi dhe auskultimi i njëkohshëm zbulojnë tinguj të lartë në trajtën e fishkëllimës në një sipërfaqe me diametër 45 cm në fossa sublumbale të djathtë, por mëlçia nuk është e zhvendosur nga muri i djathtë i barkut. Ekzaminimi rektal nuk arrin të zbulojë ndonjë anomali në pozicionin e organeve. Në rektum ka vetëm feçe të pakta me konsistencë të butë. Nuk ka melena.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Acidoza klinike (toksike)
- B) Alkalozë metabolike
- C) Zhvendosja e abomazit në të djathtë

D) Zhvendosja e abomazit në të majtë

Pyetja 13.

Një fermer është ankuar se afërsisht 5 % e tufës së deleve kanë lindur qengja shumë të vegjël (me peshë 2.5 - 3.0 kg). Qengjat janë të shëndetshëm dhe aktivë por peshojnë 2 - 4 kg më pak se norma. Nga ekzaminimi i 3 deleve që kanë lindur qengja të tillë rezultoi se ato ishin të dobëta me kondicion të vlerësuar 1.0 – 1.5 (shkalla 1 – 5), ndërkohë që shumica e deleve të tufës janë në gjendje ideale trupore (me kondicion të vlerësuar rreth 3.0).

Në gjykimin tuaj, cili mundet të jetë shkaku i lindjes së qengjave me peshë të vogël:

- A) Paratuberkulozi
- B) Gastroenteriti parazitarr (PGE)
- C) Adenomatoma pulmonare e deleve (SPA)
- D) Gjendja e urisë së zgjatur

Pyetja 14.

Një dele, 6 ditë mbas pjelljes shfaq gjendje të plogësht dhe me veshët e varura poshtë. Delja ka mungesë oreksi dhe prodhimtari të pakët të qumështit. Kjo e dyta evidentohet me faktin se teksa qengjat mundohen të pijnë nga gjiri, ajo largohet. Gjatë kontrollit klinik konstatohet se delja e ka temperaturën rektale 41.5 °C. Mukozat e kontrollueshme shfaqen të kongjestuara. Denduria e frymëmarrjes është e rritur në 65 akte frymëmarrëse për minutë (thuajse sa dyfishi i normës), ndërsa ritmi i punë së zemrës është 84 rrahje për minutë. Në askultim të zemrës nuk dëgjohen zhurma murmëritëse. Gjatë askultimit të toraksit dëgjohen zhurma të larta “fishkëllyese” në rajonet anteroventrale të mushkërisë. Lëvizjet peristaltike të rumenit janë të pakësuara në numër dhe në forcë. Në bishtin e deles dallohen shenja të rrjedhjeve me ngjyrë të kuqe në kafe. Gjiri dhe sekrecioni i qumështit shfaqen normal.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Pastereloza
- B) Pneumoni qelbëzore
- C) Metriti septik
- D) Endokarditi

Pyetja 15.

Një fermer ka afro 200 viça që i mban për majmëri në një stallë. Dy nga viçat kanë humbur gjatësi të ndryshme të pjesës distale të bishtit dhe në bazën e bishtit janë zhvillur abscese septike duke i shkaktuar deformime. Fermeri nuk u shqetësua shumë për këtë problem, derisa njëra prej kafshëve filloi të çalonte, pati ënjtje të artikulacioneve dhe rënie në peshë. Kafsha e sëmurë u zhvendos nga stalla në një boks të veçantë. Fermeri ia atribuoi këtë problem laminitit të shkaktuar nga racioni me përmbajtje të lartë në koncentre dhe dyshemesë së ashpër e të pashtruar dhe nuk e ndoqi problemin më tej, deri kur ky viç u gjet i ngordhur. Nga ndryshimet pas ngordhjes, fermerit i tërhoqi vëmendjen zemra e zmadhuar dhe e mbushur shumë me gjak të koagulluar. Viçi tjetër paraqitet i shëndetshëm, është i gjallë, vigjilent dhe në gjendje të mirë trupore, pavarësisht se trangu i bishtit është me abscese septike dhe me sinuse të shumta me sekrecione. Temperatura në rektum është normale, 38.6 °C.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të ketë ngordhur nga:

- A) Gjendje septicemike
- B) Endokarditi bakterial
- C) Këmbëzeza
- D) Acidoza klinike (laktike) e rumenit

Pyetja 16.

Në fillim të vjeshtës një klient ankohet për rritje të dobët në tufën e madhe me qengja të rritur në shtëpi për mish të shkëputur 6 javë më parë. Një numër i madh i qengjave kanë diarre me ndotje të mëdha me fekale në pjesët e bishtit dhe të perineumit. Kjo fermë ka vetëm dele. Qengjat janë dehelmintizuar në verë me preparatin benzimidazol, 2 herë me interval 4 javë. Preparati benzimidazol është përdorur në këtë fermë për 3 vitet e fundit.

Në gjykimin tuaj, qengjat mundet të vuajnë nga:

- A) Ushqimi i pakët (i deleve dhe më pas i qengjave)
- B) Gastroenteriti parazitar (PGE)
- C) Defiçienca e selenit
- D) Defiçienca e kobaltit

Pyetja 17.

Një mëshqerrë me moshë 15-muajshe, paraqet anoreksi dhe gjendje të deboluar. Temperatura e rektumit është 41.5 °C. Kafsha paraqitet me fotofobi të theksuar, me blefarospazëm dhe opacitet të kornesë. Ajo ka sekrecione të pakta mukopurulentë nga sytë dhe hunda. Pasqyra e hundës është dukshëm hiperemike dhe me rënie të epitelit sipërfaqësor nga ku fillon të rrjedhi lehtësisht gjak edhe nga ngacmime të lehta. Kafsha ka salivacion të shtuar. Limfadenopatia e gjithësuar e nyjeve limfatike periferike është shumë e dukshme. Mëshqerra është shumë e ndjeshme (hiperestezike) nga stimulimet prekëse, veçanërisht në zonat rreth kokës. Nuk ka leziona të dukshme në lëkurë.

Në gjykimin tuaj, mëshqera mundet të vuajë nga:

- A) Sëmundja e mukozave (mucozal disease)
- B) Ethe katarale malinje
- C) Meningoencefaliti tromboembolik
- D) Gjuha blu

Pyetja 18.

Një viç me moshë 6-mujore paraqitet me këthim dhe pak rrotullim të kokës drejt anës së djathtë. Viçi paraqet nistagmus spontan horizontal me lëvizje të shpejta, të drejtuar në anën e majtë. Nuk ka lëvizje rrotulluese të bulbeve të syve. Në syrin e anës së djathtë ka rënie të kapakut të sipërm (ptozis) dhe strabizëm ventral (rënie e bulbit të syrit), njëkohësisht vërehet dhe rënie e veshit të djathtë. Viçi është i gjallë, vigjilent, nuk ka temperaturë dhe ka oreks të mirë. Nuk vërehen shenja të tjera klinike.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Leziona të nervit vestibular
- B) Trauma me dëmtim të nervave të fytyrës
- C) Listerioza
- D) Abscese të trurit

Pyetja 19.

Një viç mashkull me peshë 90 kg, është paraqitur në klinikë me timpani (kronike) me kohëzgjatje prej gati 3 javësh. Megjithëse timpania është lehtësuar dy herë në ditë për 4 ditët e fundit me ndihmën e sondës ezofagale, gjendja e kafshës raportohet se po vazhdon të keqësohet. Dieta e përditshme e viçit përbëhet nga bar i thatë ad libitum dhe 1 kg ushqim i koncentruar me bazë elbi. Viçi duket vigjilent dhe i përgjegjshëm. Vihet re zmadhim i gropës së urisë në anën e majtë. Feçet e viçit janë të forta dhe veçanërisht me përmbajtje fibrash të patretura si dhe me grimca drithrash. Kontraksionet peristaltike të rumenit janë të ngadalta dhe të dobëta (nuk dëgjohen të plota). Palpimi i barkut zbulon se zmadhimi është shkaktuar nga gazet, sidomos në sektorin dorsal në anën e majtë. Nën shtresën e gazeve, përmbajtja ruminale ndihet e fortë në palpim. Sonda ezofagale e çliron plotësisht zmadhimin e abdomenit nga timpania.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Zhvendosja e abomazit
- B) Retikuloperitoniti akut
- C) Dëmtime fizike të kardies (nga polipet, inflamacioni, etj.)
- D) Indigestioni vagal

Pyetja 20.

Një lopë që ka pjellë një javë më parë, paraqitet me histori letargjie, oreks të dobët dhe rendiment të qumështit prej 5 litra në ditë. Lopa kaloi një gjendje hipokalcemie menjëherë paspjelljes kur ajo ishte gjetur e shtrirë në shpinë dhe jashtëzakonisht e fryrë (me timpani). Lopa ju përgjigj mirë mjekimit me kalcium borogluconat intravenoz. Lopa tani mban qëndrim të kërrusur, me qafë të zgjatur përpara dhe me kokën e ulur poshtë. Temperatura rektale është e rritur, 39.6 °C. Mukozat në konjunktiva dhe ato të gojës janë të kongestionuara. Nga flegrat e hundës ka rrjedhje sekrecionesh (bilaterale) mukoide. Ritmi i punës së zemrës është 80 rrahje në minutë. Denduria e frymëmarrjes është rritur deri në 44 akte frymëmarrëse në minutë dhe me frymëmarrje të dukshme të tipit abdominal. Auskultimi i toraksit zbulon zhurma kërcitëse të përhapura në gjysmën e poshtme në anën e djathtë. Ushtrimi i presionit në rajonin midis shpatullave (pickimi në xhidavi) provokon një reagim me dhimbje. Kontraktimet peristaltike të rumenit janë të reduktuara në forcë dhe në numër.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Endokardit
- B) Pleurit exudativ
- C) Pneumonia aspirative
- D) Phlebitis me bakteremi (pas injektimit intravenoz me aq të kontaminuar)

Pyetja 21.

Një lopë qumështi me moshë 3-vjeçare paraqet histori 2 mujore të humbjes së peshës dhe të diarresë, pavarësisht trajtimit me anthilmintikë nga fermeri. Lopa është blerë 3 muaj më parë e sapolindur dhe aktualisht jep vetëm 11 litra qumësht në ditë. Temperatura e rektumit është normale, por në rajonin submandibular ka filluar të evidentohet një zonë e ënjtur, e ftohtë dhe e padhimbshme. Në kontrollin klinik nuk u gjet asnjë simptomë e konsiderueshme, përveç diarresë së ujshme (por pa prani gjaku), me përmbajtje mukusi dhe gjendjes së dobët trupore (kondicioni i vlerësuar 1.5; shkalla 1 – 5).

Në gjykimin tuaj lopa mundet të vuajë nga:

- A) Paratuberkulozi
- B) Fasciolaza kronike
- C) Infeksionet virale (BVD/MD)
- D) Salmonelozë kronike

Pyetja 22.

Një lopë me moshë 6-vjeçare paraqet një histori prej 3 javësh me oreks të dobët, humbje peshe dhe rendiment të ulët në prodhimin e qumështit. Trajtimi intramuskular me oxytetraciklinë për 4 ditë rresht nga fermeri, nuk ka çuar në asnjë përmirësim. Në kontrollin klinik temperatura rektale është paksa e rritur, 39.7 °C. Lopa është në gjendje të deboluar dhe ecën ngadalë. Te ajo vërehet zmadhimi i venave Jugulare dhe ka formim të edemave në pjesën ventrale të kavitetit torakal dhe në rajonin submandibular. Mukozat e konjunktivave dhe të gojës duken hiperemike. Pulsu është 80 pulsacione në minutë, por tonet e zemrës dëgjohej të mbytur në të dy anët e gjoksit. Denduria e frymëmarrjes është e rritur deri në 40 akte frymëmarrëse në minutë dhe pjesërisht e tipit abdominal.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Miokarditi (Kardiomiopatia dilatative)
- B) Endokarditi
- C) Perikarditi traumatik
- D) Absceset e mëlcisë

Pyetja 23.

Gjatë një vizite rutinë fermeri kërkon ndihmë nga veterineri për një lopë të pjelljes së parë e cila pasi ka lindur nuk po shihet të vijë në afsh për një periudhë prej më shumë se 60 ditësh. Gjatë kontrollit klinik vërehet që ajo ka një legen të pazakontë e të deformuar. Fermeri raporton se lopa nuk ishte në gjendje të ngrihej për disa ditë pasi ajo rrëshqiti kur hyri në mjedisin e stallës 2 ditë paspjelljes.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Luksacion koksofemoral bilateral
- B) Fraktura e kockave të legenit
- C) Fraktura e kokës së femurit
- D) Abscese ne rajonin e vitheve

Pyetja 24.

Një lopë për prodhim qumështi, me moshë 5-vjeçare paraqet një histori prej 6 javësh me rritje dhe zmadhim të abdomenit dhe keqësim të kondicionit të saj (dobësim) trupor. Oreksi i lopës është i zvogëluar dhe ajo defekon rrallë e me sasi të pakta feçesh. Në brendësi të rektumit ka gjithashtu sasi të pakët fekalesh në formë topash me konsistencë të fortë dhe të veshur me mukus. Lopa qëndron me kurriz të harkuar nga sipër dhe paraqitet e shqetësuar. Abdomeni është dukshëm i zmadhuar dhe në formë “molle” (i zmadhuar 4 nga 10). Temperatura e rektumit është normale. Pulsu është 38 pulsacione në minutë. Forca dhe ritmi i kontraktimeve ruminale është i rritur përafërsisht tre deri në katër cikle në minutë. Kalimi i sondës ezofagale lejon kalimin e vetëm një sasi të vogël gazesh.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Indigestioni vagal
- B) Timpania kronike (p.sh, nga limfosarkoma e timusit ose abscese)
- C) Shtatzani me binjakë
- D) Hidrops i abdomenit

Pyetja 25.

Është paraqitur një lopë me moshë 6-vjeçe, 5 ditë pas një “pjelljeje të vështirë” (paraqitje e pasme e viçit me fleksion bilateral të gjymtyrëve) të korrigjuar nga vetë fermeri. Temperatura rektale e lopës është, 38.4 °C. Lopa qëndron me kurrizin pak të harkuar nga lart, lëviz ngadalë dhe ka reagim me dhimbje në provën e pickimit në xhidavi. Mukozat e kontrollueshme janë të kongjestionuara dhe lopa është në gjendje të dehidratuar (rreth 5 – 7 %). Ritmi i punë së zemrës është 96 rrahje në minutë. Abdomeni shfaqet i zmadhuar në kundërshtim me oreksin e paksuar dukshëm gjatë 3 ditëve të fundit. Gjiri duket i mbledhur dhe përmban pak qumësht. Në auskultim nuk dëgjohen kontraktime peristaltike të rumenit për mbi 3 minuta. Në rektum nuk ka feçe, por vetëm përmbajtje mukoide me konsistencë të trashë të cilat kufizojnë ekzaminimin e hollësishëm të abdomenit.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Torsioni i zorrëve
- B) Zhvendosja e abomazit me volvulus
- C) Peritoniti i gjithësuar septik (nga raptura e mitrës)
- D) Retikulit traumatik

Pyetja 26.

Një grup viçash të rracave për prodhim mishi, paraqesin nje histori 4 javore të kruarjeve (pruritus) dhe kanë humbje masive të qimeve (alopeci) sidomos në zonat mbi shpatull, në qafë dhe në veshë. Viçat janë vërejtur shpesh duke u fërkuar tek muret dhe përgjatë gardheve.

Në gjykimin tuaj, viçat mundet të vuajnë nga:

- A) Infestime nga morrat
- B) Zgjeba sarkoptes
- C) Zgjeba chorioptike
- D) Zgjeba psoroptes

Pyetja 27.

Një lopë me moshë 6-vjeçare e cila ka pjellë 36 orë më parë, qëndron shtrirë në pozicion sternal. Ajo duket në gjendje të rëndë debolese, është e dehidratuar, por nuk ka temperaturë (temperatura e brendshme është 38.2 °C. Mukozat e konjuktivave dhe të gojës duken hiperemike, me nuanca cianotike dhe ka shtim të punës së zemrës deri 96 në minutë. Denduria e frymëmarrjes është e rritur deri në 34 akte frymëmarrëse për minutë. Gjendra e gjirit është e butë, por nga njëri çerek nxirret një sekrecion me ngjyrë të zbehtë, me pamjen si serum.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Mastiti koliform
- B) Hipokalcemia e paspjelljes
- C) Metriti akut septik
- D) Endotoksemia

Pyetja 28.

Në fund të verës, një fermer ankohet se një lopë e cila pjell në vjeshtë dhe kullot në kullota të varfra kodrinore, po 'bëhet si e drunjtë'. Lopa qëndron e izoluar nga grupi dhe është në gjendje të deboluar. Lopa ka pamje të trishtuar, duket si në agoni dhe nuk ka dëshirë të ecë. Temperatura në rektum është 40.0 °C. Mukozat e kontrollueshme janë të kongjestionuara. Kontraksionet e rumenit janë të reduktuara në numër dhe në forcë. Denduria e frymëmarrjes është e rritur, deri në 40 akte frymëmarrëse në minutë. Nyjet limfatike sipërfaqësore janë të zmadhuara dukshëm. Lopa do dhe më shumë se 4 javë që të pjellë, por gjiri i saj është i ënjtur veçanërisht çereku i përparmë i djathtë. Thitha e këtij çereku është shumë e ënjtur (me edemë) e skuqur dhe me miza të grumbulluara në të.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Ketoza e formës dobësuese
- B) Endokarditi bakterial
- C) Babezioza
- D) Mastiti i verës

Pyetja 29.

Një lopë me moshë 6-vjeçare paraqitet me çalim të dukshëm (në nivelin 6 nga 10) që ka prekur gjymtyrën e pasme të majtë. Fillimi i çalimit ishte i fshehtë, por ashpërsia është rritur gjatë 3-muajve të fundit dhe lopa harxhon shumë më tepër kohë, në gjendje qëndrimi shtrirë. Lopa është e gjallë, vigjilente dhe ka oreks të mirë. Tonusi i anal dhe i fshikzës së urinës janë normal. Bishti është pak i deformuar dhe i tërhequr drejt anës së prekur (shkaktuar nga atrofia e muskujve). Palpimi i gjymtyrës së majtë nuk zbulon ndonjë anomali në pjesën distale që përfshin artikulationet, ligamentet, bursat dhe muskujt. Mbi rajonin e majtë të vitheve evidentohet një zonë e madhe e ënjtur. Lëvizja anësore e gjymtyrës së pasme prodhon një zhurmë të lehtë kërcitëse (crepituse) që ndihet në rajonin e majtë të vitheve. Ekzaminimi rektal nuk zbulon anomali të legenit.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Fraktura e femurit (që përfshin trokanterin e madh)
- B) Fraktura e legenit (që përfshin acetabulumin)
- C) Luksacion koksofemoral i majtë
- D) Absces i thellë (pas injeksioneve në muskujt glutealë)

Pyetja 30.

Një lopë qumështi me moshë 7-vjeçe paraqitet me një histori 4 javore të salivacionit të vazhdueshëm. Lopa herë pas here manifeston regurgitacion të 20 – 30 ml të pështymës të përzierë me lëng ruminal nga vrimat e hundës dhe nga goja e pasuar menjëherë nga një kollë e lagësht. Rreth hundës dhe në pjesët e poshtme të fytyrës, lëngu nga refluksi është i dukshëm. Lopa paraqitet me zmadhim të lehtë të abdomenit, pavarësisht se ka ulje të oreksit dhe humbje të gjendjes së kondicionit trupor (kondicioni i vlerësuar 1.5; shkalla 1 – 5). Lopa mund të gëlltisë sasi të vogla të ushqimit të përtypur, por bolusi ushqimor është më pak i dukshëm se normalisht, sepse ezofagu shfaqet i zgjeruar. Lopa nuk është vërejtur duke u ripërtypur. Ajo mban qëndim me kurriz të harkuar nga sipër dhe ka pamje që shpreh shqetësim. Temperatura në rektum është normale. Treguesi i pulsit është 52 pulsacione në minutë. Venat jugulare janë dukshëm të zgjeruara. Nyjet limfatike submandibulare dhe retropharyngeale janë dy deri tre herë më të mëdha se normalisht. Kontraksionet peristaltike të rumenit janë të rritura në numër (afro tre deri në katër cikle në minutë), por me forcë të ulur. Feçet janë të buta dhe përmbajnë një përqindje të lartë të fibrave të gjata, të patretura. Nga sonda ezofagale del vetëm një sasi të vogël gazi nga rumeni.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Dilatimi i ezofagut (megaesophagus)
- B) Abscese retikulare
- C) Limfosarkoma e timusit
- D) Paraliza e faringut

Pyetja 31.

Një lopë me moshë 5-vjeçe, e cila ka pjellë 1 muaj më parë dhe jepte 42 litra qumësht në ditë, paraqet ulje të theksuar të oreksit dhe rënie në mënyrë të qëndrueshme të rendiment gjatë 2 ditëve të fundit, deri në 22 litra qumësht në ditë. Lopa është vënë re se ka lëpirë objekte të tilla si muret dhe ijet e saj për periudha të gjata kohore. Temperatura në rektum është normale. Lopa ka një pamje të pikëlluar dhe me gropat e urisë (fossae paralumbale) të thelluara në përputhje me oreksin e zvogëluar. Lopa ka gjendje konstipacioni, ndërsa lopët e tjera në grup (me prodhim të lartë) defekojnë me feçe të buta.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Zhvendosja e abomazit në anën e majtë
- B) Gjendja ketonike e formës nervore (Acetonemia nervore)
- C) Retikuliti traumatik
- D) Osteomalacia

Pyetja 32.

Një lopë me moshë 6-vjeçe, paraqitet me histori 2 javore të uljes së oreksit dhe humbjes së dukshme të peshës së trupit. Lopa ka pjellë 2 muaj më parë. Temperatura në rektumit është në kufirin e sipërm të normës, 39.4 °C. Mukozat e konjuktivave dhe të gojës janë pak të zbehta. Ritmi i punës së zemrës është 70 rrahje në minutë. Denduria e frymëmarrjes është 24 akte frymëmarrëse në minutë dhe në auskultim të toraksit nuk dëgjohen zhurma jonormale në frymëmarrje. Tkurrjet peristaltike të rumenit janë të rralla dhe të dobëta në forcë (hipotoni). Lopa defekon rrallë, por feçet janë normale. Lopa bën përpyetje të shpeshta për të urinuar, por

zakonisht urinon vetëm sasi të vogla urine të turbullt, e cila përmban dhe sasi të vogla qelbi. Lopa kundërshton kontrollin rektal, i cili kur realizohet zbulon trashjen e murit të fshikzës dhe të ureterëve.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Cistiti kataral
- B) Pielonefriti
- C) Tumori i fshikzës së urinës
- D) Endometriti kronik

Pyetja 33.

Një grup prej 40 viçash të mbajtur në regjim stallor, me moshë 4 – 6 muajsh paraqiten me leziona të shumta të lëkurës me diametër 2 - 6 cm, të shpërndarë në të gjithë trupin, por veçanërisht në kokë dhe në qafë. Lezionet janë sipërfaqësore, të thata, me ngjyrë të bardhë, alopecike, me përmbajtje luspash dhe që nuk kruhen (jopruritike). Lëkura e prekur nuk është e trashur.

Në gjykimin tuaj, viçat mundet të vuajnë nga:

- A) Infestimi nga morrat (pedikuloza)
- B) Zgjeba korioptike
- C) Zgjeba sarkoptike
- D) Trikofitoza

Pyetja 34.

Kur zgjedhi delet në muajin tetor për të mbajtur për sezonin e ri të mbarështimit, një klient që ka dele gjen 10 krerë nga 700 dele të reja, me kondicion trupor të dobët. Në përballje me një dele të moshës 4 vjeçe të kësaj tufe konstatohet dobësimi trupor tipik i ankesës së klientit. Delja ka mbulesën e trupit jo uniforme, me lesh të rrallë dhe në pjesën e pasme të ndotur nga feçet. Temperatura rektale është normale. Sytë i duken të futur në orbita dhe kjo mendohet të jetë e shkaktuar nga mungesa e dhjavit intraorbital. Mukozat e kontrollueshme duken të zbehta.

Në gjykimin tuaj, problemi te delet e këtij klienti lidhet me:

- A) Fascioliazën subakute
- B) Paratuberkulozin
- C) Pneumoninë supurative kronike
- D) Dhëmbë molarë të dobët (mangët)

Pyetja 35.

Në fund të verës kërkohet konsultë për 6 dele nga 95 krerë të një tufe, të cilat janë me temperaturë të rritur deri 42.0 °C. Delet paraqiten të deboluara, qëndrojnë si të ngrira dhe padëshirë për të lëvizur. Ato kanë marrë pozicion qëndrimi me kurriz të përkulur nga sipër dhe mbajnë qafën e zgjatur përpara me kokën e ulur poshtë. Disa dele duken me edema në fytyrë dhe në veshë. Shumica e tyre janë me dispne. Në buzë dhe në pasqyrën e hundës dallohen plagë si gërryerje të mukozës dhe lëkurës. Delet kanë salivacion të shtuar dhe rrjedhje seroze deri në mukopurulentë nga hundët. Në lëkurën e fytyrës, të gojës dhe të zonës së kurorës së thundrave dallohet hiperemi e theksuar. Gjuha dallohet që është e enjtur.

Në gjykimin tuaj, delet mundet të vuajnë nga:

- A) Afta epizootike
- B) Ektima kontagioze
- C) Gjuha blu
- D) Dermatiti fotosensitizues

Pyetja 36.

Një dash me moshë 18 muaj, i rritur në shtëpi paraqitet me një ënjtje të madhe dhe të fortë nënlekurore, poshtë këndit të mandibulës së djathtë e cila është parë nga fermeri 2 javët e fundit. Ënjtja nuk është zvogëluar në masë pavarësisht trajtimeve 4 ditore me prokain penicilin. Kontrollat klinike nuk kanë zbuluar lëzime të tilla në lëkurë në deshet e tjerë të grupit.

Në gjykimin tuaj, dashi mundet të vuajë nga:

- A) Aktinobaciloza
- B) Abscesi i thellë
- C) Flebiti perivaskular
- D) Limfadeniti kazeoz (CLA)

Pyetja 37.

Një mbarështues delesh ankohet se gjatë vitit të kaluar njëri nga deshet pas sforcimeve gjatë ndërzimit mezi mbushej me frymë dhe tani kjo gjendje me hyperpnoe i ndodh edhe në qetësi. Fermeri gjithashtu raporton për ulje të kondicionit trupor të dashit gjatë muajve të fundit. Ekzaminimet klinike tregojnë intolerancë ndaj ushtrimeve fizike të shprehur me rritjen e dendurisë dhe thellësisë së frymëmarrjes, me përpjekje për frymëmarrje të tipit abdominal, me zgjatje të qafës përpara, me uljen e kokës poshtë, si dhe me frymëmarrje me gojë të hapur. Nga hunda vërehen rrjedhje të pakta muko-purulentë. Dashi ka temperaturë normale. Gjatë askultimit (edhe pse zhurmat e frymëmarrjes janë të rritura në volum), nuk dëgjohen zhurma kërcitëse apo fishkëllyese. Herë pas here dashi manifeston kollë të thatë, pa atake dhe jo të dhimbshme. Nuk konstatohen shenja të tjera klinike jonormale.

Në gjykimin tuaj, dashi mundet të vuajë nga:

- A) Infeksion nga virusi Maedi-visna (MVV)
- B) Abscesi laringeal ose faringeal
- C) Adenomatoma pulmonare e deleve (SPA)
- D) Pneumonia supurative kronike

Pyetja 38.

Një qengj mashkull i kastruar me moshë 8 ditësh, paraqet i dobët dhe me shqetësime shëndetësore. Qengji duket se është shumë i lodhur dhe me mungesë oreksi në 2 ditët e fundit. Qengji është në gjendje më të dobët dhe më i vogël se binjaku i tij. Temperatura rektale është dukshëm nën-normë, 38.2 °C. Ritmi i punës së zemrës arrin 90 rrahje për minutë. Mukozat e kontrollueshme janë të kongestionura. Denduria e frymëmarrjes është e rritur në 40 akte frymëmarrëse për minutë. Kërthiza dhe zona rreth saj qëndron e lagur. Palpimi abdominal tregon për mbushje me gaze të abomazit dhe të zorrëve të holla. Delja nënë nuk tregon shenja të mastitit për të justifikuar gjendjen e keqe të qengjit.

Në gjykimin tuaj, gjendja e dobët e qengjit lidhet me:

- A) Nekrobacilozën e mëlçisë
- B) Trikobezoarët
- C) Peritonitin pas infeksionit umbelikal
- D) Urachusin e infektuar

Pyetja 39.

Një dele më fytyrë të bardhë, e cila kullot në një lëndinë paraqitet me kokë dhe veshë të ënjtur dhe shumë edematoze. Shenjat klinike tregojnë lotim të shtuar dhe pjesë të lëkurës jo të pigmentuar edematoze dhe shumë të ndryshme. Në vende të ndryshme nga lëkura edematoze ka rrjedhje lëngjesh të ngajshme me serum. Temperatura rektale është normale.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Gjuha blu

- B) Sëmundja koka e madhe (infeksioni nga Clostridium chauveoi)
- C) Fotosensitizimi
- D) Pickimi nga gjarpëri, grerëzat, etj.

Pyetja 40.

Një viç me moshë 5 muajsh, i vendosur në regjim stallor 2 javë më parë ka filluar të manifestojë disa probleme shëndetësore. Viçi paraqet vështirësi në frymëmarrje (dispne) dhe qëndron me qafë të zgjatur përpara, me kokën e ulur poshtë dhe me gjuhë të zgjatur jashtë gojës. Temperatura në rektum është 41.1 °C. Nga hunda dhe nga sytë nuk ka sekrecione të dukshme. Mukozat e kontrollueshme janë të kongestionuara. Denduria e frymëmarrjes është e rritur në 56 akte frymëmarrëse në minutë. Në auskultimin e mushkërisë dëgjohen zhurma të reduktuara “kërcitëse” në pjesët oroventrale dhe akoma më pak në rajonet caudodorsale. Nga pjesa tjetër e ekzaminimit klinik nuk fitohet ndonjë e dhënë me interes. Pas trajtimit 3-ditor me antibiotikë, gjendja e viçit përkeqësohet më tej. Ai tani duket shumë i stresuar me flegrat e hundës të zgjeruara dhe me frymëmarrje të theksuar të tipit abdominal. Herë pas here dëgjohet dhe një rënkim i zgjatur në frymënxjerrje.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Bronkiti parazitar (Dictiokaulus viviparus)
- B) Pastereloza
- C) Infeksioni hiperakut BRSV (pasuar me infektion dytësor bakterial)
- D) Laringiti nekrotik

Pyetja 41.

Një dash me moshë 4 vjeçar paraqitet me histori të kolapsit kur stresohet si p.sh, kur i drejtohet qeni që ruan delet. Dashi merr pozicion qëndrimi shtrirë mbi sternum, me qafën e zgjatur dhe kokën e shtrirë përtokë për rreth 10 minuta. Në këtë gjendje dashi nuk mund të ngrihet në këmbë edhe nëse nxitet, por do të ngrihet më vonë pa u ndihmuar dhe do të duket normal. Anomalitë në qëndrim përfshijnë ataksinë e gjymtyrëve të pasme të cilat e ruajnë forcën muskulare, por nuk janë në harmoni me gjymtyrët e para, pasi mbahen në pozicion me hapje më të gjerë anash. Anomalitë në ecje janë më të shprehura kur kafsha detyrohet të eci në dishezë apo të kthehet në kënde të drejta. Në raste të tilla kafsha zakonisht lëviz duke u hedhur me dy të gjymtyrët e pasme. Në gjykimin tuaj, dashi mundet të vuajë nga:

- A) Deficienca e zinkut
- B) Keqformime të vertebrave cervikale
- C) Atrofi e trurit të vogël
- D) Sëmundja e muskulit të bardhë

Pyetja 42.

Një lopë me moshë 3-vjeçare paraqitet me histori 2 mujore të humbjes së peshës dhe prani të diarresë, pavarësisht trajtimit me antihelmintikë nga fermeri. Lopa ka pjellë 3 muaj më parë dhe viçi nuk ka patur rritje të mirë. Temperatura në rektum është normale. Asnjë shenjë klinike e rëndësishme nuk konstatohet, përveç diarresë profuse pa njolla gjaku dhe pa prani të mukusit. Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Paratuberkulozi
- B) Fasciolaza kronike
- C) Infeksione virale kronike (BVD/MD)
- D) Salmoneloza kronike

Pyetja 43.

Gjatë natës, një dem me moshë 9-muajsh (360 kg), paraqet një ënjtje shumë të madhe në pjesën ventrale të abdomenit, e cila shtrihet nga procesi ksifoidal e deri te skrotumi. Në palpim (duke ushtruar presion me gishta) ndihet prania e grumbullimit të lëngjeve. Demi shfaqet i shqetësuar dhe shpesh adopton një qëndrim me bazë të gjerë duke i vendosur gjymtyrët e pasme më të spostuara anash se normalisht. Ai ka temperaturën e rektumit në normë, 38.5 °C, oreksin normal dhe rrjedhje normale të urinës. Në qimet prepuciale ka shumë grimca rëre. Ekzaminimi rektal nuk zbulon anomali. Në zonën e mesit të ënjtjes lëkura duket si e thatë dhe ka filluar të plasaritet.

Në gjykimin tuaj, demi mundet të vuajë nga:

- A) Hernie abdominale
- B) Ruptura e penisit e pasuar me hematomë
- C) Balanopustiti infektiv
- D) Celuliti (nga plagët e krijuara nga injeksionet në murin ventral të abdomenit)

Pyetja 44.

Pas një nate vjeshte me stuhi, një fermer kërkon ndihmë urgjente për një nga lopët e tij me moshë 10-vjeçe që ka pjellë 36 orë më parë. Lopa qëndron shtrirë në pozicion lateral. Lopa mbarështohet në kullotë me një grup lopësh të tjera që pjellin kryesisht në verë, të cilat nuk marrin asnjë ushqim plotësues përveç kashtës. Lopa u gjet nga fermieri e shtrirë në pozicion në brinjë (lateral) dhe shumë e egërsuar. Në momantin kur mbërrini ju lopa duket e qetë, por gjatë ekzaminimit klinik rifillojnë reagimet agresive.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Tetania hipomagnezëmike
- B) Hipokalcemia akute
- C) Helmimi nga plumbi
- D) Listerioza

Pyetja 45.

Në fundin e stinës së verës një dash paraqitet me probleme të rënda respiratore, me kokën e ulur poshtë dhe qafën e zgjatur përpara. Denduria e frymëmarrjes të dashi është e rritur mbi 90 akte frymëmarrëse për minutë dhe e shoqëruar me zhurma të dallueshme inspirative (zhurma që dëgjohen deri 9 metër larg). Flegelat e hundës janë të zgjeruara dhe goja e hapur me gjuhën të dalë gjysëm jashtë. Nga goja duken rrjedhje të shtuara pështyme (hipersalivacion) të cilat e mbajnë të lagur zonën rreth gojës dhe nofullës së poshtme. Temperatura rektale është 40.2 °C. Mukozat e kontrollueshme duken cianotike. Dëgjimi mbi laring evidenton zhurma “kërcitëse” që transferohen mbi të gjithë fushën e mushkërisë. Ritmi i punës së zemrës është i rritur në 120 rrahje për minutë.

Në gjykimin tuaj, dashi mundet të vuajë nga:

- A) Kondriti laringeal
- B) Trupa të huaj në laring
- C) Zmadhimi i nyjeve limfatike rajonale
- D) Absces faringeal

Pyetja 46.

Në mesin e stinës së vjeshtës shqetësimet e një fermieri janë për disa probleme të grupit prej 64 viçash të moshës 9 - 12 muajsh. Fermieri mbarështon viça për majmëri dhe këtë grup e ka blerë në tregjet e ndryshme gjatë 3 javëve të fundit. Kollitja e shpeshtë është dëgjuar në grupin e kafshëve gjatë javës së kaluar. Fermieri ka zgjedhur dy kafshë me oreks të dobët dhe me rrjedhje purulente nga sytë dhe hundët për ekzaminim më të hollësishtë veterinar. Ekzaminimi klinik zbulon gjendjen me temperaturë (përkatësisht 40.8 dhe 41.1 °C). Denduria e frymëmarrjes

është rritur dhe auskultimi i toraksit evidenton praninë e tingujve kërcitës (ronke të thata) të cilët duket se transferoheshin nga rrugët e sipërme të frymëmarrjes. Inspektimi vizual i pjesës tjetër të grupit të kafshëve zbulon një numër të konsiderueshëm viçash me rrjedhje mukopurulente nga sytë dhe hundët, si dhe frymëmarrje të vështirësuar (takipnoe). Zgjidhen dhe ekzaminohen edhe gjashtë kafshë të tjera dhe të gjitha kanë temperaturën rektale > 40.5 °C.

Në gjykimin tuaj, viçat mundet të vuajnë nga:

- A) Rhinotrakeiti infektiv i gjedht (IBR)
- B) Pastereloza
- C) Gjuha blu
- D) Infeksioni BRSV

Pyetja 47.

Një dem shumë i vlefshëm me moshë 5 vjeç, nuk ka mundur fizikisht të ndërzejë gjashtë lopë të paraqitura për gjatë 4 javëve të fundit. Ai ka ereksion, realizon kërcimin, por nuk mundet të realizojë penetrimin. Demi kishte ndërzyer më parë lopët në mënyrë të suksesshme për tre sezona të mbarështimit, madje ka qenë rezultativ edhe deri 10 muaj para ekzaminimit. Aktualisht gjatë kontrollit klinik, demi duket i shëndetshëm dhe vigjilent. Ai paraqitet me trup në gjendje të shkëlqyer dhe me oreks normal. Temperatura në rektum është, 38.5 °C. Demi defekon sasi normale të feçeve, por urinën e derdh pothuajse vazhdimisht nga prepuciumi. Nuk ka shenja të kolikave, të tenesmave ose të lëvizjes lartë e poshtë të bishtit. Tonusi anal dhe i bishtit, si dhe ndjeshmeria e lëkurës në zonën perineale janë normale. Nuk ka anomali të organeve gjinitale të jashtme. Ekzaminimi nëpërmjet rektumit zbulon fshikëzën e urinës dukshëm të zmadhuar që shtrihet kranialisht për më shumë se 40 cm nga hyrja pelvike. Ekzaminimi me ultratinguj tregon fshikëzën e zmadhuar dhe që përmban sasi të rritur precipitatesh. Nuk konstatohet pulsimit në uretrën pelvike. Ekzaminimi i menjëhershëm mikroskopik i tre ejakulateve nuk zbulon lëvizshmëri të spermatozoidëve. Strishot e përgatitura nga sperma nuk tregojnë asnjë spermatozoid të gjallë, por 51 % janë me koka të shkëputura, 8 % me pjesë të përkulura të mesit dhe 11 % janë me bishta të përkulur.

Në gjykimin tuaj, demi mundet të vuajë nga:

- A) Balanopustit
- B) Urolithiazis
- C) Pielonefrit
- D) Dëmtime të nervit pelvik

Pyetja 48.

Një qengj femër në kondicion të mirë trupor (vlerësuar me 3.5; shkalla 1 - 5) paraqitet me fillim të papritur duke e tërhequr zvarrë një rënë nga gjymtyrët e pasme. Gjatë pyetjeve fermeri shprehet se te qengji është bërë një injeksion intramuskular në këmbën e pasme 2 ditë para se ai të behëj i çalë. Qengji është i gjallë, vigjilent dhe ka oreks të mirë. Në gjymtyrën e prekur tregon mungesë të ndjeshmërisë dhe në ecje e tërheq thundrën mbi sipërfaqen dorsale. Në qëndrim qengji e mbështet gjymtyrë në tokë me sipërfaqen dorsale të artikulationit metatarsofalangeal. Kocka metatarsale duket sikur është shumë e zgjatur. Asnjë anomalitet tjetër nuk u zbulua në kontrollin e plotë klinik. Në veçanti asnjë lezion i gjymtyrës apo artikulationeve nuk është gjetur si përgjegjës i qëndrimit jonormal të kësaj gjymtyre.

Në gjykimin tuaj, qengji mundet të vuajë nga:

- A) Luksacion i artikulationit metatarsofalangeal
- B) Artit septik i artikulationit metatarsofalangeal
- C) Neuropatia peroneale (pasoje e injektimeve perineurale me substanca irrituese)
- D) Lezione në palcën e kurrizit (sektori T₂ – L₃)

Pyetja 49.

Një mëshqerrë e moshës 2-vjeçare, paraqitet me zona të ënjtura (edema) të dukshme mirë në rajonin submandibular, në pjesës ventrale të gjoksit dhe të gjymtyrëve të përparme, gjatë 3 javëve të fundit. Temperatura në rektum është normale. Mëshqerra ka denduri të rritur të frymëmarrjes (54 akte frymëmarrëse në minutë) me kollitje të shpeshtë, por pa sekrecione. Auskultimi i toraksit zbulon dëgjueshmëri të zvogëluar të zhurmave normale të mushkërisë dhe rezonancët të zvogëluar të tingujve në perkutimin e të tretës ventrale, nga të dy anët e gjoksit. Tonet e zembrës mund të dëgjohen vetëm nga ana e majtë e gjoksit. Ritmi i punës së zembrës është 90 rrahje në minutë. Pulsu është i rregullt. Venat jugulare janë të zgjeruara dukshëm. Nuk ka çalim dhe nuk ka zmadhim të palpueshëm të nyjeve limfatike sipërfaqësore. Kontrolli hematologjik afion vlera normale për numrin e përgjithshëm të eritrociteve (7.6×10^6 /ml nga norma $5 - 9 \times 10^6$ /ml) dhe të hemoglobinës (11.2 g/dl nga norma 8 – 14 g/dl). Numri i qelizave të bardha ishte 5.1×10^3 /ml nga norma $4 - 10 \times 10^3$ /ml) dhe përbëhej nga 58 % neutrofile dhe 36 % limfocite. Evidentohet hipoalbuminemi dhe hipoglobulinemi e moderuar (përkatesisht 2.4 g/dl dhe 2.93 g/dl). Përqendrimi i AST është pak i rritur (147 UI/L nga norma 53 - 105 UI/L).

Në gjykimin tuaj, mëshqerra mundet të vuajë nga:

- A) Pneumoni ose pleuropneumoni qelbëzore kronike
- B) Limfosarkoma e timusit
- C) Kardiomiopatia dilatative
- D) Hipoproteinemia (Sëmundje kronike të mëlçisë)

Pyetja 50.

Disa qengja kanë shfaqur vështirësi për t'u ngritur në këmbë dhe më pas kur çohen bëjnë ecje të sforcuar. Qengjat janë me moshë 4 muajsh dhe kanë shfaqur simptoma "përtese" që kur ishin 6 javësh. Të gjithë qengjat kanë të prekur një ose të dy artikulacionet e gjunjëve, të cilët paraqiten të ënjtur dhe kanë grumbulluar lëngje. Kapsula e artikulacionit është e trashur deri në 1 cm dhe kjo krijon pengesë fizike në lëvizjen normale të gjurit. 4 nga 6 qengjat e prekur kanë edhe enjtje bilaterale në artikulacionet karpale të shoqëruara dhe me zmadhim të nyjeve limfatike prescapulare.

Në gjykimin tuaj, qengjat mundet të vuajnë nga:

- A) Rakiti
- B) Osteomalacia
- C) Endokarditi bakterial
- D) Poliartriti infektiv (*Erysipelothrix rhusiopathiae*)

Pyetja 51.

Në stinën e dimrit një femer ankohet për mëshqerën e tij me moshë 9-muajshe dhe me peshë 220 kg, sepse ka 3 ditë me mungesë oreksi dhe vazhdon të jetë me timpani të moderuar. Mëshqerra paraqitet në qëndrim me këmbë të hapura dhe ecën pa dëshirë. Ecjen e realizon me gjymtyrët e shtrira apo si "të ngrira" dhe bishtin e mban larg pjesës së pasme me një rigjiditet të konsiderueshëm. Mëshqerra paraqitet me pamje të shqetësuar me veshët e ngritur lart dhe me flegrat e hundës të zmadhuara. Qepalla e tretë është më e dukshme se normalisht. Nga goja ka sekretim të vazhdueshëm të pështymës dhe nuk është e mundur t'i hapet goja për ta kontrolluar. Temperatura në rektum është normale. Ritmi i punës së zembrës është 94 në minutë dhe denduria e frymëmarrjes 24 akte frymëmarrëse në minutë. Asnjë kontraksion i rumenit nuk dëgjohet për mbi 3 minuta auskultim.

Në gjykimin tuaj, mëshqerra mundet të vuajë nga:

- A) Trauma në kolonën vertebrale ($C_2 - C_6$)

- B) Meningoencefaliti bakterial
- C) Helmimi nga plumbi
- D) Tetanozi

Pyetja 52.

Një viç me moshë 4 muajsh, që ushqehet me qumësht nga gjiri i lopës, po manifeston çalim të theksuar (në shkallën 9 nga 10) me kohëzgjatje prej 3 javësh. Te viçi vërehet dhe ënjtje e indeve të buta mbi rajonin distal metatarsal të artikulacionit metatarso-falangeal (të pengojës) në gymtyrën e pasme të majtë. Viçi është rritur mirë dhe është në gjendje kondicioni të mirë (kondicioni i vlerësuar 3.5; shkalla 1 – 5). Temperatura në rektum është 39.2 °C. Zona e ënjtur është e nxehtë dhe e dhimbshme dhe shtrihet përafërsisht 3 cm përtej zonës proksimale të artikulacionit të pengojës. Nuk ka tregues të grumbullimit të eksudatit në artikulacion. Limfonodula popliteale nuk mund të palpohet. Nuk ka nyje të tjera limfatike të ënjtura. Nuk evidentohet asnjë anomali tjetër e rëndësishme klinike.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Fraktura e kockës së tretë metatarsale
- B) Infeksioni septik i artikulacionit metatarso-falangeal
- C) Bursiti septik e artikulacionit metatarso-falangeal
- D) Tendovaginit septik

Pyetja 53.

Një viç me moshë 3-javësh u gjet një mëngjes nga fermeri me çalim nga gjymtyra e përparme e djathtë, me fillim të papritur dhe me ënjtje të artikulacionit të bërrylit. Fermeri dyshoi për një dëmtim nga vrapimi i tij me grupin e lopëve, por megjithatë nuk vendosi t'i injektojë oxytetracyclinë me veprim të gjatë në dozë 20 mg/kg, sipas rekomandimit nga ju dha në telefon. Gjendja e viçit u përkeqësua dhe tani (3 javë më vonë) ju prezantoheni me viçin. Viçi është i gjallë dhe vigjilent, por vazhdon të jetë i çalë (shkalla 9 nga 10) nga gjymtyra e përparme e djathtë. Ai tani është i çalë edhe nga gjymtyra e pasme e majtë. Temperatura në rektum është 39.7 °C. Mukozat e kontrollueshme shfaqen me pamje normale. Artikulacioni i djathtë i bërrylit është i nxehtë, i ënjtur dhe i dhimbshëm edhe në palpimin e lehtë. Nyja limfatike preskapulare e djathtë është e zmadhuar dukshëm. Në kontrollin e artikulacionit metatarso-falangeal të majtë, artikulacioni është i nxehtë, i ënjtur dhe i dhimbshëm. E zmadhuar paraqitet dhe nyja limfatike popliteale e anës së majtë.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Difekt i lindur
- B) Hipovitaminoza A
- C) Acidoza metabolike
- D) Poliartriti septik

Pyetja 54.

Një qengj me moshë 8 javësh paraqitet me kondicion trupor të dobët pas një periudhe me diarre dhe humbjes së shpejtë të peshës trupore. Në grupin ku bën pjesë qengji ka pasur dhe një numër të madh qengjash të tjerë që kishin diarre 3 javë më parë. Ata u diagnostikuan me kokcidiozë dhe u trajtuan me diklazuril. Mementalisht qengji është në gjendje të deboluar, i dehidratuar dhe shpesh qëndron në pozicion urinimi. Temperaturën rektale e ka normale. Binjaku i tij është i shëndetshëm dhe po rritet mirë.

Në gjykimin tuaj, qengji mundet të vuajë nga:

- A) Listerioza
- B) Enteriti bakterial
- C) Kequshqyerja

D) Nefroza

Pyetja 55.

Një mëshqerrë me moshë 18-muajshe paraqet papritur nofullën e varur, gjuhën e zgjatur dhe të dalë jashtë gojës, si dhe salivacion të shtuar. Mëshqerra has vështirësi të konsiderueshme për të përtypur dhe gëlltitur ushqimin. Mëshqerra është mbajtur në regjim stallor dhe kjo gjendje nuk është vërejtur një ditë më parë.

Në gjykimin tuaj, mëshqera mundet të vuajë nga:

- A) Fraktura e mandibulës
- B) Gjuha e drunjtë (infeksion nga *Actinobacillus lignieresii*)
- C) Nofulla me gungë (infeksion nga *Actinomyces bovis*)
- D) Listerioza

Pyetja 56.

2 javë pas një lindjeje të vështirë (dy viça të paraqitur në të njëjtën kohë) të korrigjuar nga vetë fermeri, një lopë me moshë 6 vjeçe, paraqitet me shqetësime serioze të shëndetit. Lopa ishte normale ditët e para por më pas ajo pati ulje të theksuar të oreksit dhe tani të dy viçat po ushqehen artificialisht për shkak të rendimentit të ulët të qumështit. Lopa ka marrë dy trajtime 5 ditore me antibiotikë (amoxicillin + acid klavulanik dhe më pas oksitetraciklinë), por përmirësimi ka qenë i pakët. Temperatura në rektum tani është 38.4 °C. Lopa qëndron me kurriz të harkuar nga sipër dhe ka një shprehje të dhimbshme të fytyrës. Mukozat e dukshme paraqiten të zbehta dhe lopa është e dehidratuar (niveli 5 – 7 %). Ritmi i punës së zemrës është 96 rrahje në minutë. Abdomeni paraqitet i zmadhuar, në kundërshtim me oreksin e zvogëluar. Tkurrjet peristaltike të rumenit dëgjohen të dobëta dhe të rralla (me vetëm një cikël në 2 minuta). Në kontrollin rektal konstatohen sasi të pakta feçesh, me konsistencë të fortë (si të thara). Mitra gjendet e pozicionuar përtej hyrjes së legenit.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Peritoniti septik i gjithësuar (nga ruptura e mitrës)
- B) Retikuloperitoniti traumatik
- C) Endometriti septik
- D) Torsioni i zorrëve

Pyetja 57.

Një dem me moshë 20 muaj paraqet një timpani të rëndë e cila filloi papritur. Demi i përket një grupi prej 120 bagëtish në majmëri që ushqehen me racione ushqimore për prodhimtari të lartë që përfshin dhe gluten misri dhe patate ad libitum. Demi qëndron me qafën e shtrirë përpara dhe me kokën të ulur poshtë. Demi ka salivacion të shtuar dhe herë pas here kollitet duke nxjerrë rreth 200 ml pështymë.

Në gjykimin tuaj, demi mundet të vuajë nga:

- A) Tërbimi
- B) Ngushtimi i ezofagut (neoformacione)
- C) Obstruksioni i ezofagut
- D) Acidoza klinike laktike

Pyetja 58.

Një dem me moshë 1-vjeçare, paraqitet me një lezion të vetëm të ngritur mbi lëkurë, me formë të rumbullakët dhe me përmasa të mëdha (me diametër 50 cm) në zonën e qafës, i cili është i pranishëm për më shumë se 6 muaj. Lezioni është me ngjyrë gri, i fortë në konsistencë, i përbërë nga epiteli i keratinizuar dhe me çarje të thella. Në sipërfaqe të lezionit ka filluar dhe një infeksion bakterial dytësor që prodhon aromë të keqe (shumë të rëndë). Demi nuk ka

temperaturë, është vigjilent, me oreks normal dhe në gjendje të mirë trupore. Leziona të tilla të ngjashme të lëkurës në gjoks ka dhe në dy nga 30 viçat e të njëjtit grup, por ato janë me diametër më të vogël (4 - 6 cm).

Në gjykimin tuaj, viçat mundet të vuajnë nga:

- A) Papillomatoza (Fibropapilloma)
- B) Limfosarkoma e lëkurës
- C) Tuberkulozi i lëkurës
- D) Dermatofiloza e formës së rëndë

Pyetja 59.

Një viç me moshë 10-ditësh dhe me peshë 45 kg paraqitet në gjendje të kolapsuar dhe me diarre të ujshme, me kohëzgjatje prej 3 ditësh. Viçi është indiferent dhe shumë i dobët pavarësisht trajtimit me një solucion rehidruës që i është dhënë nga goja dy herë në ditë nga fermeri. Sytë nuk janë shumë të futur në orbita dhe kohëzgjatja e rikthimit të lëkurës në pozicionin fillestar gjatë provës së dehidratimit është pothuaj normale. Nuk ka ndryshime të ngjyrës në mukoza dhe nuk i ka të injektuara enët episklerale. Temperatura në rektum është, 38.0 °C. Ritmi i punës së zemrës është 82 rrahje në minutë dhe denduria e frymëmarrjes është 30 akte frymëmarrëse në minutë. Kërthiza nuk duket të jetë e fryrë, si dhe nuk zbulohen shenja diareje dhe ënjtje të artikulacioneve të gjymtyrëve.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Acidoza metabolike
- B) Infeksione nga Rota dhe Koronavirusët
- C) Kolibakterioza septicemike
- D) Meningiti qelbëzor

Pyetja 60.

Një fermer që mbarështon lopë për prodhim qumështi ankohet se një pjesë e madhe e lopëve të tij kanë leziona të mëdha të lëkurës me luspa, në sejcilën anë të bazës së bishtit (fossae perianale). Lezionet janë bërë shumë më të përhapura gjatë muajit të fundit dhjetor. Lezionet nuk provokojnë kruarje (janë jopruritike) dhe nuk kanë eritremë të lokalizuar.

Në gjykimin tuaj, lopët mundet të vuajnë nga:

- A) Zgjeba sarkoptike
- B) Infestime me morra
- C) Zgjeba korioptike
- D) Trikofitoza

Pyetja 61.

Në fund të stinës së vjeshtës, një fermer raporton ngordhjen e papritur të një lope me moshë 6-vjeçe, e cila kishte pjellë 6 javë më parë. Sipas fermerit, lopa ishte munduar shumë përpara ngordhjes dhe këtë e tregonin gjurmët e tokës së gërvishtur. Lopa ushqehet në kullotë duke e plotësuar me 2 kg ushqim të koncentruar në ditë por pa suplementë mineralo/vitaminikë.

Në gjykimin tuaj, cila nga sëmundjet e mëposhtme mundet të ketë shkaktuar ngordhjen:

- A) Tetania hipomagnezëmike
- B) Goditje nga rufeja
- C) Plasja
- D) Deficienca vitaminike

Pyetja 62.

Një dele që ka lindjen e pestë dhe pritet për lindje binjake, është gjetur e veçuar nga tufa dhe në pamundësi për t'u ngritur në këmbë. Tufa e deleve mbahet në kullotë, por ushqehet edhe me 300

g miell misri me kalli. Delet janë grumbulluar tre ditë më parë pasi u vaksinuan kundër sëmundjeve klostridiale. Pas vaksinimit delet janë lëvizur në një kullotë tjetër. Delja paciente do dhe 3 javë për të pjellë. Ajo paraqitet në gjendje të rëndë debolese dhe me humbje të mëdha të tonusit muskular. Në kontrollin klinik konstatohet se temperatura rektale ishte 38.2 °C. Rektumi ishte i lëshuar dhe kishte feçe si topa të fortë. Ritmi i punës së zemrës ishte 80 rrahje për minutë. Denduria e frymëmarrjes 40 akte frymëmarrëse në minutë. Frymëmarrja realizohej e vështirësuar dhe kishte të pranishme rrjedhje nazale me ngjyrë të gjelbër. Rumeni ishte në gjendje staze (atoni) dhe me timpani të lehtë. Gjiri ishte pak i zhvilluar. Nuk kishte mastit dhe rrjedhje nga vulva. Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuante nga:

- A) Listerioza
- B) Toksemia e barrës në dele
- C) Acidoza nga mbingrënia e ushqimeve të koncentruara
- D) Hipokalcemia akute

Pyetja 63.

Në fillim të pranverës dy qengja të racës Suffolk, me moshë 1-muajsh, paraqiten me tetraparezë që ka zgjatur për 10 ditë. Temperatura rektale e çdo qengji është normale. Nuk konstatohen ënjtje të artikulacioneve dhe as të nyjeve limfatike. Qengjat duken se po fillojnë të tregojnë shenja të dhimbjeve cervikale në lëvizjet e kokës dhe qafës lart e poshtë apo majtas e djathtas, por manipulimi i lehtë tolerohet. Harqet reflektore janë normale në të katër gjymtyrët.

Në gjykimin tuaj, qengjat mundet të vuajnë nga:

- A) Trauma cervikale
- B) Empiema vertebrale C₁ - C₆
- C) Distrofia muskulare (sëmundja e muskulit të bardhë)
- D) Avit aminoza B₁

Pyetja 64.

Kur po mblidhte delet me qengja për t'i shkëputur nga të ushqyerit me qumësht një fermer u ankua për rritjen e dobët të tyre (pesha aktuale 18 – 22 kg). Njëkohësisht ai raporton se delet ishin me gëzof jo uniforme, me lesh të rrallë dhe dukeshin më bark të fryrë dhe me ndotje fekale të perineumit dhe bishtit.

Në gjykimin tuaj, defekti më i mundshëm në këtë fermë lidhet me:

- A) Mungesa e ushqimeve të mjaftueshme
- B) Masat e dobëta antiparazitare
- C) Deficienca nga mikroelementët (kobalti)
- D) Deficiencat vitaminike

Pyetja 65.

Një mëshqerrë e cila ka pjellë 2 muaj më parë, paraqet çalim të theksuar (shkalla 9 nga 10) të gjymtyrës së djathtë të pasme, me atrofi të muskujve (në anën e gjymtyrës së prekur) dhe me humbje të gjendjes së përgjithshme të trupit (kondicionit). Thundra e gishtit lateral duket e ënjtur pak rreth bulbit (zona e pulvineve) të thundrës. Mëshqerra mban këmbën të abduktuar duke e kaluar peshën e trupit mbi gishtit medial të thundrës. Pamja e thundrës tregon dukshëm për rritje të konsiderueshme të bririt dhe për deformim të konformacionit. Në kontrollin vizual, thundra paraqitet e mavijosur në të gjithë sipërfaqen e tabanit (solare).

Në gjykimin tuaj, mëshqera mundet të vuajë nga:

- A) Dermatit interdital
- B) Artriti podalik septik
- C) Abscese në linea alba
- D) Ulçera të tabanit

Pyetja 66.

Një lopë qumështi me moshë 5-vjeçe, e cila ka pjelle para 4 javësh, paraqet histori 6 javore të rritjes dhe zmadhimit të barkut (që nga periudha e tharjes). Lopa është e gjallë dhe vigjilente, ka oreks të mirë dhe realizon prodhimin e pritsëm të qumështit. Abdomeni është shumë i zgjeruar ventralisht në të dy anët. Temperatura në rektum është normale. Forca dhe numri i kontraktimeve të rumenit janë gjithashtu normale.

Në gjykimin tuaj, shkak i zmadhimit të barkut te lopa mundet të jetë:

- A) Indigestioni vagal
- B) Dietë me ushqime me shumë fibra
- C) Konsumi i pakët i proteinave në periudhën e tharjes
- D) Shtatzani me binjakë

Pyetja 67.

Një lopë e pjelljes së parë, me moshë 2.5-vjeçe paraqitet me anoreksi, rënie të theksuar të rendimentit të qumështit dhe salivacion të shtuar. Lopët e tjera në grup janë të prekura, por në formë më të lehtë dhe fermeri dyshon për veprimin kaustik të kashtës së trajtuar me amoniak, të shtuar në racionin ushqimor të përzier, që ka filluar të përdoret për herë të parë, 3 ditë më parë. Temperatura në rektum e lopës është 40.5 °C. Në kontrollin klinik evidentohet prania e disa flluckave dhe ulçerave në xhinxhiva, në mukozën e faqeve dhe në qiellzën e butë. Mukoza veçanërisht e gojës është dukshëm hiperemike dhe me rënie të epitelit mbulues mbi një zonë relativisht të madhe. Ka rritje të salivacionit me derdhje të pështymës jashtë gojës në formë shkumbore. Nuk ka prani të sekrecioneve te sytë ose në hundë.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Afta epizootike
- B) Sëmundja e mukozave (MD)
- C) Ethe katarale malinje
- D) Gjuha blu

Pyetja 68.

Një lopë me moshë 10-vjeçe, paraqitet me një lezion okular që përfshin syrin e djathtë. Fermeri ka vërejtur rrjedhje të pakta okulare purulente të njëanshme dhe skuqje të palpebres së poshtme gjatë muajit të kaluar. Skaji i poshtëm i palpebrës së syrit të djathtë është hiperemik dhe me pamje kokrrizore. Zhvendosja e pjesshme e qepallës së poshtme zbulon nodula të shumta të parregullta, me madhësi 3 - 5 mm dhe me ngjyrë të kuqërremta. Nuk ka asnjë përfshirje të palpebrës së tretë (membrana nictitans). Njaja limfatike submandibulare e djathtë nuk është e zmadhuar.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Leukoza enzootike e gjedhit
- B) Trauma me infeksione dytësore
- C) Keratokonjuktiviti infektiv i gjedhit
- D) Karcinoma skuamoze okulare

Pyetja 69.

Një lopë me moshë 5-vjeçe paraqet lezione të lëkurës të kufizuara në zona të pa pigmentuara. Lëkura e prekur është e thatë dhe e ngritur në periferi dhe kështu dallon nga lëkura normale e shëndetshme e pigmentuar. Lëkura e thithave të gjirit duket e thatë dhe vende vende si letër e grisur. Fermeri gjithashtu raporton se kjo lopë shpesh ka një hundë të “kuqe” gjatë stinë së verës.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Dermatofiloza
- B) Dematiti fotosensitizues
- C) Dermatiti alergjik i kontaktit
- D) Dermatiti irritant i kontaktit

Pyetja 70.

Në gjysmë të kohës së lindjes së deleve, një klient ankohet për morbiditet dhe mortalitet të lartë te qengjat e moshës 24 - 36 orësh. Qengjat manifestojnë salivacion të shtuar dhe për pasojë kanë nofullën e poshtme të lagur. Ata kanë reflekse të dobëta të pirjes dhe mbajtje të mekoniumit. Të gjithë qengjat vuajnë nga zmadhimi progresiv i barkut me lëngje dhe gaze. Temperatura e tyre është nën normë, madje dhe gojën e kanë të ftohtë. Ata duken të dehidratuar, me qarkullim të dobët të gjakut periferik, me ekstremitete të ftohta dhe me puls të shpeshtë dhe të dobët gjatë fazave të agonisë.

Në gjykimin tuaj, problemi sëmundësor te këta qengja lidhet me:

- A) Enteriti nga E. coli enteropatogen
- B) Enteriti nga E. coli enterotoksigen
- C) Septicemia me endotoksemi (sëmundja e gojës së lagur)
- D) Gjendja e urisë (kujdesi i keq nga nëna)

Pyetja 71.

Një qengj paraqitet me gjendje të rënduar dhe me qëndrim të shtrirë në pozicion lateral. Qengji ishte konstatuar një ditë më parë nga fermeri, si i verbër dhe që ecte kuturu. Qengji mban qëndrim të dukshëm me fleksion dorsal të qafës (epistotonus). Qengji është tepër sensitiv ndaj ngacmuesve të prekjes dhe dëgjimit, të cilat parapaprijnë aktivitetet e krizave gati epileptike. Strabismi dorsomedial dhe nistagmusi horizontal spontan, janë të pranishëm. Nuk ka reagime reflektore ndaj ngacmuesve në asnjë nga sytë. Në kontrollin klinik nuk konstatohet asnjë shenjë tjetër jo normale.

Në gjykimin tuaj, qengji mundet të vuajë nga:

- A) Meningoencefaliti listerial
- B) Malacia vatrore simetrike e trurit
- C) Meningiti bakterial
- D) Poliencefalomalacia (PEM)

Pyetja 72.

Një viç me moshë 2-muajsh paraqet oreks të dobët dhe shtesë të ulët ditore të peshës, që nga lindja. Viçi është në gjendje depressive dhe gati letargjik. Temperatura në rektumit është normale, 38.4 °C. Mukozat e syve dhe të gojës janë me ngjyrë rozë. Ritmi i punës së zemrës është 90 rrahje në minutë. Auskultimi i toraksit zbulon zhurma “murmuritëse” të ashpra pansistolike në pukta optima të valvulës trikuspidale. Zhurma është më e fortë në anën e djathtë sesa nga ana e majtë. Në palpimin e zemrës dallohen mirë goditjet kardiake mbi murin e toraksit. Denduria e frymëmarrjes është e rritur në 44 akte frymëmarrëse në minutë dhe tipi i saj duket qartësisht abdominal.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Ductus arteriosus
- B) Defekte të septumit ventrikular
- C) Hydropsi i ventrikulit të djathtë
- D) Ectopia cordis

Pyetja 73.

Gjatë verës së vonë, një lopë me moshë 7 vjeçe, e cila ka pjelle pa ndihmë 12 orë më parë, paraqitet me qëndrim në gjendje të shtrirë. Lopa qëndron shtrirë në pozicion sternal, është në gjendje të deboluar, ka temperaturën e trupit 38.2 °C dhe mukozat pa ndryshime të dukshme. Tonet e zembrës dëgjohen mirë dhe ajo punon me ritëm prej 76 rrahje në minutë. Denduria e frymëmarrjes është në normë (20 akte frymëmarrëse në minutë). Në pamje duket një zmadhim i lehtë i rumenit. Asnjë anomali nuk zbulohet nga palpimi i gjirit, në të katër çerekët e tij. Lopa bën disa përpjekje të dobëta për t'u ngritur, por nuk është në gjendje t'a ngrëjë trupin e saj nga toka.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Mastitet mjedisore
- B) Tetania hipomagnezemike
- C) Hipokalcemia akute (pareza e paspjelljes)
- D) Ruptura e mitrës

Pyetja 74.

Në fillim të stinës së verës një lopë me moshë 8-vjeçe, e cila ka pjellë 6 muaj më parë paraqitet me gjendje të rëndë shëndetësore. Lopa ka qenë në kullotë për 2 javë me një grup lopësh të cilat pjellin në vjeshtë që nuk marrin asnjë ushqim plotësues në stallë. Lopa u gjet e ndarë nga lopët e tjera duke shkumbëzuar dhe në gjendje të paqëndrueshme. Lopa kishte shëtitur për afërsisht 400 m përgjatë vathës së bagëtive dhe më pas ishte shembur në tokë, e shtrirë në pozicion sternal. Vlerësimi vizual tregon se nuk ka timpani. Lopa shfaqet hiperestezike dhe herë pas here bën lëvizje të shpejta të kokës së saj. Lopa bën përpjekje të shumta për t'u ngritur dhe për të qëndruar në këmbë. Përfundimisht lopa arrin të ngrihet në këmbë, por te ajo dallohet mirë ataksia dinamike. Ajo ecën me lëkundje dhe me gjymtyrët si të ngrira. Lopa është agresive dhe bën lëvizje të befta duke e kthyer kokën me forcë nga çdo person apo burim zhurme.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Tetania hipomagnezemike
- B) Tërbimi
- C) Helmimi nga plumbi
- D) Ethe katarale malinje

Pyetja 75.

Një viç me moshë 5-ditësh ka qenë jo i gjallë dhe nuk dëshiron të thithë qumësht tek lopa për 6 orët e fundit. Temperatura në rektum është 39.2 °C. Viçi është në gjendje të deboluar dhe qëndron me këmbët e hapura (qëndrim me bazë të gjerë) me qafën dhe kokën të zgjatur përpara. Përgjigja ndaj ngacmimeve është e dobët. Në episklera ka kongestion të theksuar të enëve të gjakut dhe strabizëm të dukshëm dorsomedial. Denduria e frymëmarrjes është rritur në 60 akte frymëmarrëse për minutë. Kërthiza ishte trajtuar me tretësirë të fortë të jodit dhe duket normale. Nuk ka prova të diarresë. Nyjet limfatike nuk janë të zmadhuara.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Defekte të lindura të zembrës
- B) Gjendje septicemike (Kolisepticemia)
- C) Meningoencefaliti bakterial
- D) Avitamina A

Pyetja 76.

Një dele paraqitet me histori të humbjes kronike në peshë (kondicioni trupor i vlerësuar 1.5; shkalla 1 - 5) kur pjesa tjetër e tufës është me kondicion trupor 3 – 3.5. Temperatura rektale është 40.0 °C. Në qetësi delja ka takipne (40 akte frymëmarrëse për minutë). Auskultimi i toraksit në anën e majtë nuk tregon për zhurma jonormale nga mushkëria, por zhurmat e

frymëmarrjes dhe tonet e zemrës dëgjoen me intensitet të ulët. Në anën e djathtë zhurmat normale të mushkërisë dhe tonet e zemrës dëgjoen me intensitet shumë më të lartë. Delja ka vuajtur nga mastiti kronik dhe aktualisht evidentohet një absces me përmasa 2 x 4 cm në pjesën e poshtme të gjirit. Qengjat binjakë janë shkëputur 1 muaj më parë.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Pleuriti akut eksudativ
- B) Pleuriti kronik fibrinoz
- C) Perikarditi qelbëzor
- D) Endokarditi bakterial

Pyetja 77.

Në mes të pranverës një dele me moshë 5 vjeçe prezantohet me një status si “e hutuar”. Temperatura rektale ishte 38.5 °C. Delja kishte reflekse të dobëta kundër ngacmuesve në të dy sytë. Mukozat e kontrollueshme ishin të zverdhura (ikterike). Kontraksionet peristaltike të rumenit ishin të ulura në numër dhe në forcë. Abdomeni ishte i zvogëluar dhe kjo mesa duket e lidhur me mungesën e oreksit ditët e fundit. Gjiri i deles ishte pak i zhvilluar. Nga vulva nuk konstatohen rrjedhje. Delja është ushqyer përveç kullotës dhe me 0.25 kg koncentratë në ditë për 4 javët e fundit.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Helmimi nga bakri
- B) Fascioliaza akute
- C) Hipokalcemia akute
- D) Poliencefalomalacia

Pyetja 78.

Një dash me moshë 1-vjeçar paraqitet me kolika që shfaqen me periudha 6 orëshe. Dashi tregon sforcim abdominal por vetëm disa pika urine arrin të nxjerrë, në vend të një rrjedhje të vazhdueshme të urinës. Urina është pak me përmbajtje gjaku. Nuk evidentohen gurëza apo rërë në qimet prepuciale. Dashi manifeston kërcitje frekvente të dhëmbëve (brucizëm). Temperatura rektale është normale (39.5 °C). Ritmi i punës së zemrës është 90 rrahje për minutë. Mukozat e kontrollueshme paraqiten me pamje normale. Askultimi në kraharor nuk dëshmon për praninë e ndonjë anomalie klinike. Lëvizjet peristaltike të rumenit dëgjoen të rralla dhe të dobëta.

Në gjykimin tuaj, dashi mundet të vuajë nga:

- A) Balanopustiti
- B) Cistiti kataral
- C) Urolithiaza (bllokuese)
- D) Invaginacioni i zorrëve

Pyetja 79.

Një viç me moshë 10-ditësh i ushqyer me qumësht në kovë paraqet një zonë me ënjtje të madhe (me diametër afro 4 cm) në faqen e tij të djathtë. Ekzaminimi klinik zbulon se lezioni shtrihet midis mukozës së faqes dhe shtresës së muskujve. Nyja limfatike submandibulare e djathtë është e zmadhuar. Viçi është i gjallë dhe vigjilent dhe pi mirë të gjithë sasinë e qumështit. Temperatura në rektum është 39.1 °C. Mukozat në dukje janë me pamje normale. Ekzaminimi i brendshëm gojës zbulon një lezion të madh me formë rumbullake, me një qendër nekrotike në mesin e faqes së djathtë që shtrihet në shtresën e muskujve të faqes.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Aktinobaciloza
- B) Trauma nga trupa të huaj
- C) Aktinomikoza

D) Difteria e viçave

Pyetja 80.

3 ditë pas pjelljes së asistuar të binjakëve të gjallë, një lopë me moshë 5-vjeçe, paraqet probleme shëndetësore. Lopa po prodhon pak qumësht (rendimenti ditor i qumështit vetëm 12 litra). Në ekzaminimin klinik lopa është jo e gjalle dhe në gjendje të deboluar, nuk ka oreks dhe kalon shumë kohë në gjendje të shtrirë. Lopa është me temperaturë rektale 40.2 °C. Lopa ka diarre të ujshme por në feçe nuk ka prani të gjakut ose të mukusit. Mukozat e kontrollueshme duken të kongestionuara. Vulva është pak e fryrë dhe nga ajo ka rrjedhje të një lëngu me ngjyrë kafe në të kuqe. Nga fermeri tregohet se lopa ka nxjerrë vetëm një placentë.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Endometriti septik
- B) Metriti dhe zhvendosja në të majtë e abomazit
- C) Ruptura e mitrës dhe peritoniti pasues
- D) Endotoksemi (toksemi) nga septicemia

Pyetja 81.

Dy mëshqerra me moshë 15 muajshe, janë mbajtur brenda për 2 javë dhe janë ushqyer me mbetjet e silazhit të vitit të kaluar para se të hapej gropa e re. Mëshqerrat paraqiten shumë të dobëta dhe të paafta për t'u ngritur në këmbë. Fermeri kishte vërejtur se njëra nga mëshqerrat ishte me qëndrim shtrirë që në mbrëmjen e kaluar. Të dy mëshqerrat janë indiferente ndaj ngacmimeve dhe duken të deboluara. Ato nuk janë në gjendje të ngrihen dhe manifestojnë dobësi të muskujve të gjymtyrëve të pasme. Temperatura në rektum është normale. Mëshqerrat nuk hanë ushqim (anoreksi), por mund të gëlltiten. Te ato ndihen lëvizje peristaltike të rumenit. Ato defekojnë. Feçet janë të pakta në sasi dhe të veshura me mukus.

Në gjykimin tuaj, mëshqerrat mundet të vuajnë nga:

- A) Enterotoksemia e shoqëruar me septicemi
- B) Botulizmi
- C) Listerioza
- D) Këmbëzeza

Pyetja 82.

Një lopë me moshë 6-vjeçe paraqet histori 10 ditore të mungesës së oreksit dhe humbjes së shpejtë të peshës trupore. Lopa është trajtuar nga fermeri për nekrobacilozë interdigitale me injeksion oxytetracycline me veprim të gjatë, 1 javë më parë. Temperatura në rektum është normale, 38.6 °C. Lopa është e ngadaltë kur ecën dhe në kontrollin klinik konstatohet një zonë e ënjtur rreth artikulationit metatarsofalangeal në gjymtyrën e pasme të majtë. Zona lehtësisht të ënjtura vërehen dhe në artikulationet tarsale të të dy gjymtyrëve të pasme. Zona e ënjtur në artikulationin metatarsofalangeal është e madhe, e nxehtë dhe e dhimbshme. Ajo shtrihet në pozicionin lateral të gjymtyrës, menjëherë proximalisht artikulationit falangeal. Ekzaminimi rutinë hematologjik zbulon gjendje të lehtë anemie (numër i përgjithshëm i qelizave të kuqe të gjakut 4.8×10^6 / ml, nga norma $5 - 9 \times 10^6$ /ml; hemoglobina 7.6 g /dl nga norma 8 – 14 g /dl). Rezultatet treguan edhe për gjendje me leukocitozë të moderuar (11.2×10^3 /ml), që rezulton nga rritja e numrit të neutrofilëve. Ndryshime domethënëse rezultuan në përqëndrimin e albuminës dhe globinës në serum (përkatesisht 1.68 g /dl dhe 6.63 g /dl, nga diapazoni normal > 3 g /dl dhe 3.5 - 4.5 g /dl).

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Hematoma nga traumat
- B) Celuliti (me abscese të mëdha)
- C) Endokarditi bakterial

D) Bursite septike

Pyetja 83.

Në fund të stinës së verës, një grup prej 20 mëshqerrash me moshë rreth 1 vjeçe paraqiten me kondicion të dobët trupor dhe me diarre. Gjatë javës së kaluar te ato është dëgjuar kollitja e shpeshtë, por pa sekrecione. Mëshqerrat mbahen në kullota të përhershme me dendësi tre mëshqerra për hektar. Ekzaminimi klinik zbulon temperaturë normale në rektum, mungesë të sekrecioneve nga sytë ose hunda dhe zhurma kërcitëse rastësore gjatë auskultimit të toraksit.

Në gjykimin tuaj, mëshqerrat mundet të vuajnë nga:

- A) Infeksione virale të frymëmarrjes (përfshirë BVD/MD, parainfluenza-3 dhe BRSV)
- B) Hipokuproza (deficienca e bakrit)
- C) Parazitozat e mushkërisë
- D) Menaxhimi i dobët i kullotave

Pyetja 84.

Një lopë me moshë 3-vjeçe paraqitet me 2 javë histori të rendimentit të dobët në prodhimin e qumështit, me ulje të oreksit dhe me humbje të theksuar të peshës së trupit. Lopa është jo e gjallë dhe në gjendje të deboluar. Ajo qëndron me shpinë të harkuar nga sipër, me bërryla të larguar nga trupi dhe tregon një shprehje të dhimbshme në mimikë. Temperatura në rektum është, 39.1 °C. Në kontrollin klinik dallohen ënjtje të artikulacioneve të pengojës në të katër gjymtyrët dhe ënjtje në artikulacionet karpal në të dy gjymtyrët e para. Ritmi i punës së zemrës është 90 rrahje në minutë. Në auskultimin e zemrës në anën e majtë, pak mbi zonën e valvulës mitrale (punkta optima e bikuspidalit) dëgjohen zhurma sistolike “murmurritëse”. Denduria e frymëmarrjes është 24 akte frymëmarrëse në minutë.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Bursite septikë
- B) Poliartiriti septik
- C) Endokarditi bakterial
- D) Miokarditi

Pyetja 85.

Në fillim të verës, një viç 2-muajsh paraqitet me rritje jo të mirë dhe me përlyrje fekalesh te zonat e pasme në dallim nga viçat e tjerë në grup. Viçi ka diarre me ngjyrë të verdhë të zbehtë, pak mukoidë dhe me përmbajtje të copëzave të gjakut të freskët. Viçi është në gjendje të deboluar, i dobët në kondicion, ka lëkurë si të thatë (i dehidratuar) dhe abdomeni duket i zmadhuar. Në dukje manifeston tenesma të shpeshta me prolaps të pjesshëm të rektumit. Viçi është me temperaturë 40.2 °C dhe ka rrjedhje të pakta mukopurulente nga hunda. Nyjet limfatike submandibulare dhe ato preskapulare janë të zmadhuara.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Salmoneloza
- B) Infeksione kronike me BVD/MD
- C) Invaginacioni i zorrëve
- D) Enteriti nekrotik

Pyetja 86.

Një viç i vogël me moshë 4-ditësh, nga një tufë lopësh qumështi praqitet për ndihmë urgjente. Viçi duket jo vital dhe nuk dëshiron të thithë qumësht që në mëngjes herët. Viçi është përkeqësuar me shpejtësi dhe ndodhet në gjendje shumë të deboluar. Ai paraqitet në pozicion qëndrimi shtrirë mbi sternum dhe nuk është në gjendje të qëndrojë në këmbë edhe kur ndihmohet. Viçi ka sy të futur në orbita dhe lëkura gjatë provës së dehidratimit kërkon 4

sekonda per t'u kthyer në gjendjen normale. Temperatura në rektum është 37.2 °C. Përgjigja ndaj ngacmimeve është dukshëm e zvogëluar (megjithëse kjo është e vështirë të gjykohet pasi viçi është në gjendje të deboluar). Mukozat janë të kongestionuara dhe ka kongestion të dukshëm episkleral. Denduria e frymëmarrjes është rritur me 40 akte frymëmarrëse në minutë. Abdomeni është i tkurrur dhe ka pak përmbajtje në sektorin abomaz/zorrë, pavarësisht administrimit të sasisë prej 2 litra të solucionit rehidruës të dhënë me ndihmën e sondës ezofagale, 4 orë më parë. Në zonën e kërthizës lëkura duket e trashur dhe ka prani të një plage të infektuar. Gjurmët e ndotjeve në zonën e bishtit dhe të perineumit dëshmojnë për praninë e diarësë, megjithëse fermeri shprehet se nuk kishte konstatuar praninë e diarësë më herët në mëngjes. Nyjet limfatike të karkasës nuk duken të zmadhuara. Fermeri nuk është i sigurt nëse viçi ka pirë kullosh të brenda 6 orëve të para pas lindjes. Përcaktimi i totalit të proteinave duke përdorur refraktometër zbulon një përqendrim prej 4.2 g /dl kundrejt > 6.5 g/dl që duhet në normë.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Acidozë metabolike
- B) Gjendje septicemike (pasoje e dështimit në transferimin pasiv të antitropave)
- C) Infeksion nga E. coli enterotoksigen
- D) Infeksion nga E. coli enteropatogen

Pyetja 87.

Një mëshqerrë, është vërejtur të jetë jo e gjallë (me gjendje të deboluar) dhe e çorientuar që 4 ditë më parë. Mëshqerra është lehtësisht e fiksueshme dhe shumë e qetë apo e përmbajtur. Temperatura në rektum është 39.2 °C. Në kontrollin klinik evidentohet se ajo e mban kokën në një pjerrësi të dukshme në të majtë. Palpebra e majtë e sipërme dhe veshi i majtë duken të rënë dhe ka mungesë të tonusit në muskujt e fytyrës në anën e majtë duke shkaktuar kështu devijim të fytyrës në anën e djathtë. Mëshqerra ka vështirësi në gëlltitje dhe vazhdimisht ka rrjedhje të pështymës nga goja (salivacion i shtuar). Në brendi të gojës ka një sasi të madhe ushqimi (silazh) të mbetur në faqen e majtë.

Në gjykimin tuaj, mëshqerra mundet të vuajë nga:

- A) Lezione të njëanshme të trurit
- B) Listerioza
- C) Lezione të nervit vestibular
- D) Botulizëm

Pyetja 88.

Një lopë paraqitet me 5 ditë histori të mungesës së oreksit. Lopa është jo e gjallë, në gjendje të deboluar dhe lëviz ngadalë rreth stallës. Lopa qëndron me kurriz të harkuar nga sipër, me qafë të zgjatur përpara dhe kokën të ulur poshtë. Lopa i mban veshët mbrapa, ka një vështrim të fiksuar (të qelqtë) dhe në mimikë ka shprehje të dhimbshme. Në ekzaminimin klinik, temperatura rektale është, 39.2 °C. Zemra punon me 80 rrahje në minutë. Asnjë anomali nuk dëgjohet gjatë auskultimit të toraksit. Lëvizjet peristaltike të rumenit janë të dobëta në forcë dhe ndodhin një herë në 2 - 3 minuta. Lopa shfaqet në siklet kur ushtrohet presion mbi xhidavi, por ajo as nuk rënkon dhe as nuk e ul kurrizin. Në kontrollin rektal konstatohen feçe të pakta dhe të thata, por nuk ka gjetje të tjera anormale.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga;

- A) Endokarditi
- B) Peritoniti i lokalizuar
- C) Retikuliti traumatik
- D) Absceset e mëlçisë

Pyetja 89.

Në mes të stinës së vjeshtës, një fermer raporton një lopë të vetme e cila është me temperaturë 40.0 °C. Lopa mban qëndrim të deboluar, duket si e ngurtë dhe jo e gatshme për të lëvizur për shkak dhe të ënjtjes në zonën e kurorës së thundrave. Lopa ka rrjedhje seroze deri në mukopurulente nga hunda. Në pasqyrën e hundës evidentohen erozione dhe mukoza duket e zbehtë. Nga sytë ka prani të lotimit por nuk ka leziona të dukshme.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Ethe katarale malinje
- B) Gjuha blu
- C) Mastiti kronik
- D) Endokarditi bakterial

Pyetja 90.

Një viç me moshë 3 javësh vazhdon të mos jetë i aftë të ngrihet në këmbë. Viçi ka lindur me prezantim të përpamë dhe u nxorr i ndihmuar nga fermeri duke përdorur forcë tërheqëse. Forca e tërheqjes u shtua në mënyrë të konsiderueshme (dhe me dy persona të tjerë) kur u gjykua e nevojshme për shkak të madhësisë së trupit të viçit. Për 2 javët e para, viçi ishte në gjendje të mbante peshë vetëm me gjymtyrët e para dhe shpesh u vu re qëndrimi tipik si i qenit mbi bisht. Tani (pas 3 javësh), viçi është në gjendje të mbajë peshë edhe në gjymtyrën e pasme të djathtë.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Dëmtime traumatike në palcën e shpinës
- B) Fraktura e femurit (epifiza proksimale)
- C) Paraliza e nervit femoral
- D) Fraktura e kockave të legenit

Pyetja 91.

Në fillimin e vjeshtës një dash me moshë 3 vjeçare paraqitet me kokë të fryrë edematoze. Dashi është me gjendje të deboluar dhe duket si i fjetur. Temperaturën rektale e ka 41.1°C. Mukozat e kontrollueshme duken të kongjestiura. Nyjet limfatike submandibulare nuk mund të palpohen nga edema.

Në gjykimin tuaj, dashi mundet të vuajë nga:

- A) Sëmundja koka e madhe (infeksion nga Clostridium chauveoi)
- B) Fotosensitizimi
- C) Gjuha blu
- D) Pickimi nga gjarpëri

Pyetja 92.

Një lopë me moshë 4-vjeçe, paraqitet me një ënjtje të madhe që shtrihet menjëherë kranialisht gjendrës së gjirit deri në procesin ksifoidal dhe ngrihet në gjysmën e sipërme të murit të majtë të abdomenit. Në palpimin me gishta ndihet grumbullimi i lëngjeve. Lopa ka pjellë para 5 muajve dhe ënjtja u vërejt fillimisht 4 ditë më parë. Lopa aktualisht është e gjallë, vigjilente dhe ka kondicion të mirë të trupit të vlerësuar me 2.5 (shkalla 1 – 5). Lopa shfaqet me këmbën e pasme të majtë si të ngurtësuar dhe ka vështirësi në ecje në momentin e zgjatjes së këmbës. Temperatura në rektum është normale, 38.6 °C. Mukozat në konjuktiva dhe ato të gojës duken të zbehta. Ritmi i punës së zemrës është 82 rrahje në minutë dhe denduria e frymëmarrjes 22 akte frymëmarrëse në minutë.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Ashiti
- B) Abscese (celulitis)
- C) Këputja e tendinit prepubik

D) Hematoma masive (rupturë e arteries pudendale të majtë)

Pyetja 93.

Një lopë nuk ka qenë në gjendje të mbajë peshë në gjymtyrën e parme të djathtë që nga përplasja me një gardh gjatë futjes së bagëtive në stallë, 2 javë më parë. Temperatura në rektum është 38.5 °C. Mbi shpatullën e djathtë dhe sidomos në kufirin e sipërm të lidhjes së shpatullës me shpinën, ka filluar të evidentohet atrofia e muskujve. Artikulacioni i bërrylit duket i rënë dhe njëkohësisht të gjithë artikulacionet distale të gjymtyrës mbahen në pozicion të fleksuar. Lopa në ecje e tërheq këmbë zvarë (në momentin kur e zhvendos atë përpara). Kur lopa është në qëndrim (pa lëvizur) këmba mbahet në pozicion të afruar me trupin. Nyja limfatike preskapulare e djathtë nuk duket e interesuar. Tonusi i muskujve të gjymtyrës është i dobësuar, por është e vështirë të testohen harqet reflektore.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Infesioni i artikulacionit skapulohumeral
- B) Infeksioni i artikulacionit brachial
- C) Paraliza e nervit radial (pas traumës)
- D) Absceset e tabanit të thundrës

Pyetja 94.

Një dele me moshë 7 vjeçare paraqitet me kondicion të dobët trupor (vlerësimi 1.5; shkalla 1 – 5), ndërsa delet e tjera kanë kondicion trupor të vlerësuar 3 – 4. Temperatura rektale është normale 39.4 °C. Delja ka oreks të mirë por përtpypja e ushqimit shoqërohet me lëvizje të vogla të nofullës. Në faqen e majtë evidentohet një ënjtje e fortë dhe e dhimshme. Nyjet limfatike submandibulare duken pak më të zmadhuara.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Humbja e dhëmbëve nga sëmundje periodontale
- B) Osteomieliti i degës së majtë të mandibulës
- C) Aktinobaciloza
- D) Aktinomikoza

Pyetja 95.

Një lopë me moshë 6- vjeçare nuk ka qenë në gjendje të ngrihet në këmbë që pas pjelljes së asistuar gjatë së cilës viçi u ndihmua me tërheqje nga 3 persona. Fermeri e ka transportuar lopën në një vend të veçuar për të siguruar një sipërfaqe jo rrëshkitëse. Lopa është në pozicion qëndrimi shtrirë e mbështetur mbi sternum. Ajo është e gjalle dhe vigjilente. Nuk ka temperaturë (38.5 °C). Mukozat janë në dukje normale. Puna e zemrës vlerësohet normale, puls i është 82 pulsacione në minutë dhe denduria e frymëmarrjes është normale (20 akte frymëmarrëse në minutë). Lopa ka bërë një numër përpjekjesh për t'u ngritur, por të pasukesëshme pasi "gjymtyret e saj të pasme shkojnë anash". Në traktin riprodhues nuk zbulohet asnjë anomali gjatë ekzaminimit vaginal.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Thyerja e femurit
- B) Ruptura e kockave të legenit
- C) Paraliza e nervit obturator (trauma gjatë lindjes)
- D) Mastiti koliform

Pyetja 96.

Gjatë motit të nxehtë të verës në një grup viçash qumështi, me moshë 3 muaj që kanë kullotur në një fushë prej 25 hektarësh, po shfaqen shqetësime shëndetësore. Kullota nuk është e kultivuar dhe furnizimi i vetëm me ujë është një përrua me rrjedhë të vogël që pothuajse është

tharë. Në skajet e përroit ka shumë ndotje dhe fekale nga të tokës që e rrethon. Disa viça kanë diarre profuze, me përmbajtje mukusi dhe copëza të vogla të gjakut të freskët dhe për pasojë i kanë të përlyera me njolla të dallueshme zonat e perineumit dhe të bishtit. Në dy viça vërehen tenesma me dalje të pjesëshme të rektumit. Shenjat të tilla klinike janë më pak të shprehura në viçat e mbetur, por dhe te ata dobësimi kronik dhe oreksi i dobët janë shenja të pranishme. Temperatura rektale është normale.

- A) Salmoneloza
- B) Invazionet parazitare (kokcidioza, ostertagioza e tipi I, etj.)
- C) Helmimi nga plumbi
- D) Helmimi nga bimët e kullotës

Pyetja 97.

Një mëshqerrë, me moshë 30 muajshe paraqet histori 10 ditore për oreks të dobët dhe humbje peshe. Mëshqerra lindi normalisht një viç të gjallë (pa ndihmë) para 3 javësh dhe jep rreth 16 litra qumësht në ditë. Mëshqerra paraqitet me gjendje të deboluar. Temperatura e rektumit është 39.2 ° C. Mukozat e konjuktivave dhe të gojës shfaqen pak të kongjestionuara. Ritmi i punës së zemrës është 86 rrahje në minutë. Denduria e frymëmarrjes është 38 akte frymëmarrëse në minutë. Auskultimi i toraksit zbulon zhurma fërkimi “gërrje” në rajonet oroventralë të mushkërisë. Mëshqerra ka kollë të butë dhe të njomë (me sekrecione). Tkurrjet ruminale janë me forcë normale dhe ndodhin një herë në minutë. Ekzaminimi rutinë hematologjik zbulon si më poshtë:

Numri total i qelizave të kuqe të gjakut $4.1 \times 10^6 /\mu\text{l}$ (norma 5 - 9 $10^6 /\mu\text{l}$),

Leukocitet $12.4 \times 10^3 /\mu\text{l}$. (norma 4 – 10 $\times 10^3 /\mu\text{l}$) me 65 % neutrofile.

Përqendrimi i albuminës në serum 2.48 g/dl) (norma 3 - 4 g /dl).

Përqendrimi i globinës në serum 2.48 g/dl) (norma 3 - 4 g /dl).

Në gjykimin tuaj, mëshqerra mundet të vuajë nga:

- A) Bronkiti kronik parazitarr
- B) Absceset e mëlçisë
- C) Endokarditi
- D) Pneumonia qelbëzore kronike

Pyetja 98.

Një dele me moshë 18 muajshe është paraqitur me një histori të humbjes kronike në peshë (kondicioni i vlerësuar 1.5; shkalla 1 - 5) ndërsa pjesa tjetër e deleve në tufë variojnë me kondicion nga 3 - 3.5. Temperatura rektale është 39.0 °C. Delja ka oreks të ulur. Nuk ka diarre. Në qetësi delja është me takipnoe (40 akte frymëmarrëse në minutë). Askultimi i toraksit nuk tregon për ndonjë anormali përveç rritjes në ritmin e punës (99 rrahje për minutë) dhe paqartësisë në dëgjimin e toneve të zemrës. Evidentohet një zmadhim i konsiderueshëm i abdomenit me prani të dukshme të grumbullimit të lëngjeve.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Endokarditi bakterial (me prekjen e valvulës trikuspidale)
- B) Infestimi i rëndë nga stongilatët pulmonarë
- C) Adenokarcinoma intestinale
- D) Peritoniti kronik

Pyetja 99.

Në fillim të pranverës, shumica e deleve në një tufë me 120 krerë, duket se nuk kanë rehati, kafshojnë gjymtyrët e tyre dhe kruhen me ristelat e ndarjeve të vathës. Disa dele duken sikur janë në gjendje stresi të madh dhe shqelmojnë veten me këmbët e pasme. Gëzofi i tyre është i lagësht, i ngjithshëm dhe i verdhë nga eksudimi i serumit.

Në gjykimin tuaj, delet mundet të vuajnë nga:

- A) Dermatofiloza e formës së rëndë
- B) Infestimi nga morrat
- C) Anafilaksia
- D) Infestimi nga zgjebet (*Psoroptes ovis*)

Pyetja 100.

Njëri nga viçat binjakë me moshë 5-ditësh dhe me peshë 30 kg, nga një tufë viçash, është me gjendje të deboluar dhe nuk dëshiron të thithë e të pijë qumësht. Viçi nuk ka dëshirë të ngrihet, por mund të qëndrojë në këmbë vetëm kur ndihmohet. Viçi ka sytë e futur thellë në orbita dhe gjatë provës së hidratimit, lëkura shkon në pozicion normal për afro 4 sekonda. Temperatura në rektum është 39.6 °C. Mukozat e kontrollueshme janë të kongjestionuara dhe ka kongjestion të dukshëm episkleral. Denduria e frymëmarrjes është e rritur me 30 akte frymëmarrjeje në minutë. Ritmi i punës së zemrës është 120 rrahje në minutë. Abdomeni duket i zvogëluar me pak përmbajtje në sektorin abomaz/zorrë dhe ka diarre të lehtë. Në rajonin umbelikal evidentohet trashje e lehtë e lëkurës. Nyjet limfatike nuk janë të zmadhuara. Viçi tjetër binjak duket normal. Lopa vuan nga mastiti kronik në dy nga çerekët e një ane të cilat aktualisht nuk janë funksionale.

Në gjykimin tuaj, viçi mundet të vuajë nga:

- A) Gjendje urie e zgjatur
- B) Meningoencefaliti bakterial
- C) Gjendje septisemike
- D) Infeksione nga *E. coli* (forma enterike)

Pyetja 101.

Një dash me moshë 18 muaj, i rritur në shtëpi paraqitet me një enjtje të madhe dhe të fortë nënlëkurore, poshtë këndit të mandibulës së djathtë e cila është parë nga fermeri 2 javët e fundit. Ënjtja nuk është zvogëluar në masë pavarësisht trajtimeve 4 ditore me prokain penicilin. Kontrollat klinike nuk kanë zbuluar leziona të tilla në lëkurë në deshët e tjerë të grupit.

Në gjykimin tuaj, dashi mundet të vuajë nga:

- A) Limfadeniti kazeoz (CLA)
- B) Aktinobaciloza
- C) Flebiti perivaskular
- D) Parotiti parenkimatoz

Pyetja 102.

Në mes të stinës së pranverës, një dele me moshë 2 vjeçe, po shfaq aktivitete krizash. Delja ka veshin dhe kapakun e sipërme të syrit (ptosis) të majtë të ulur. Delja dukej normale mbrëmjen e kaluar. Sot ajo manifeston mungesë të refleksit ndaj ngacmimit në syrin e majtë dhe faqen e majtë e ka të lëshuar.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga;

- A) Cenuroza akute
- B) Poliencefalomalacia
- C) Dëmtime të nervit vestibular periferik
- D) Menngoencefaliti akut listerial

Pyetja 103.

Një dele me moshë 4 vjeçare prezantohet me kondicion trupor të dobët (vlerësuar me 1.5; shkalla 1 – 5) krahasuar me tufën (kondicioni mesatar i vlerësuar me 3.0). Delja është e gjallë, vigjilente dhe ka oreks normal. Delja ka temperaturë normale, 39.4 °C, por paraqet takipnoea

(48 akte frymëmarrëse në minutë). Frymëmarrja është e dukshme e tipit abdominal. Askultimi i toraksit lejon të dëgjohen zhurma kërcitëse dhe fishkëllyese sidomos të sektorët oroventrale, në dy anët e kraharorit. Ritmi i punës së zemrës është 88 rrahje për minutë.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Adenomatosa pulmonare e deleve (SPA)
- B) Pneumonia supurative kronike
- C) Pleuropneumonia
- D) Abscese pleurale

Pyetja 104.

Në mes të sezonit të dimrit një fermer delesh merr një raportim për “pneumoni” në një tufë qengjash të dërguar në thertore. Kur pyetet më shumë fermeri raporton për kollitje të shumta të qengjave të ngelur në fermë. Qengjat janë blerë në treg 8 javë më parë dhe janë ushqyer me koncentratë adlibitum. Qengjat janë vaksinuar kundër sëmundjeve klostridiale në moshën 4 dhe 5 muajshe, por jo për pneumoninë nga pasteurrella. Qengjat janë trajtuar së fundmi me antihelmintikë herët në vjeshtë, një muaj para blerjes. Një shtim i kollitjes vërehet në çdo rast që qengjat shqetësohen, por megjithatë ata duken vigjilentë. Kontrolli klinik i tre qengjave që ishin me denduri të rritur të frymëmarrjes (mbi 60 akte frymëmarrëse për minutë) tregoi se temperatura rektale e tyre ishte, 39.2 – 39.6 °C. Mukozat në konjunktiva duken hiperemike dhe enët episklerale të injektuara. Asnjë nga qengjat nuk ka rrjedhje mukopurulente nga hunda.

Në gjykimin tuaj dukuria e raportuar si pneumoni lidhet me:

- A) Pneumonia parazitare (*Dictiocaulus filaria*)
- B) Pneumonia bakteriale (*Mannheimia haemolytica*)
- C) Pneumonia virale (parainfluenca-3)
- D) Pneumoninë atipike (nga myloplazmat)

Pyetja 105.

Një mëshqerrë me moshë 2-vjeçe, me pamje vigjilente, paraqitet me histori prej 2 muaj të humbjes së peshës dhe të pakësimit të oreksit. Gjatë 2 javëve të fundit ka zhvilluar edemë të dukshme në zonën submandibulare, në pjesën ventrale të gjoksit dhe të gjymtyrëve të përparme. Temperatura në rektum është normale. Mëshqerra ka denduri të rritur të frymëmarrjes (30 akte frymëmarrëse në minutë) dhe vërehet se gromësin shpesh. Auskultimi i toraksit nuk dëshmon praninë e ndonjë tingull jonormal të mushkërive, por ka rezonancë të zvogëluar të tingujve në perkutimin e një të tretës ventrale të gjoksit, në të dy anët. Zemra është me tone qartësisht të dëgjueshëm dhe ka ritëm prej 72 rrahjesh në minutë. Lëvizshmëria e rumenit është normale dhe mëshqerra ka defekuar feçe normale.

Në gjykimin tuaj, mëshqerra mundet të vuajë nga:

- A) Limfosarkoma e timusit
- B) Pamjaftueshmëri e anës së djathtë të zemrës
- C) Kardiomiopatia dilatative
- D) Perikarditi septik

Pyetja 106.

Një dele barrsë e moshës 4 vjeçe është parë dy ditë më parë e veçuar nga tufa. Delet e tufës ushqehen në kullotë dhe u shtohet dhe afro 200 g/kokë/ditë ushqim i koncentruar me përmbajtje 18 % proteina. Tufa pritet të fillojë pjelljet pas afro dy javësh. Delja problematike është në kondicion më të dobët e vlerësuar me 1.5 (shkalla 1 – 5) krahasuar me delet e tjera në stad të ngjashëm të barsërrisë (kondicion i vlerësuar 2.5 – 3.0). Delja duket e lodhur dhe në gjendje të deboluar, madje shpesh qëndron dhe me kokën e mbështetur në objekte të ndryshme. Gjatë kontrollit klinik konstatohet se delja nuk ka mungesë të reflekseve të përgjigjes ndaj ngacmuesve.

Delja është e mbindjeshme ndaj ngacmuesve të prekjes apo dëgjimit të zhurmave, ndërsa reflekset pupilare ndaj dritës janë normale. Temperatura rektale është normale.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Listerioza
- B) Poliencefalomalacia (PEM)
- C) Toksemia e barrës në dele (OPT)
- D) Acidoza klinike laktike e rumenit

Pyetja 107.

Një dem me moshë 9-muajsh (340 kg), i cili ka qenë në gjendje të deboluar dhe me mungesë të oreksit për 2 ditët e fundit, paraqet një ënjtje të madhe të pjesës ventrale të abdomenit, e cila shtrihet nga skrotumi deri në prepucium. Demi shpesh adopton një qëndrim me bazë të gjerë, me gjymtyrët e pasme të vendosura më larguar sesa normalisht. Temperatura në rektum është normale, 38.5 °C, megjithatë shpesh herë dëgjohet kërcitja e dhëmbëve. Demi qëndron në këmbë me bishtin të ngritur dhe bën lëvizje të shpeshta anësore të bishtit. Është konstatuar se urinimi realizohet pika pika, në vend të një rrjedhjeje të vazhdueshme. Pikat e urinës shpesh janë të përzjera me pak gjak. Në qimet e prepuciumit ka shumë depozitime rëre (calculi). Enjtja e murit ventral të barkut provohet (nëpërmjet palpimit me presionin e ushtruar) se është e shkaktuar nga grumbullime të lëngjeve.

Në gjykimin tuaj, demi mundet të vuajë nga:

- A) Celuliti i shkaktuar nga plagë në murin ventral të barkut
- B) Balanopustiti infektiv
- C) Ruptura e penisit dhe formimi i hematomës
- D) Urolithiazis obstruktiv (i pjesshëm)

Pyetja 108.

Një dele nga tufa prej 200 krerë, paraqitet me një histori 2 ditore me qëndrim të shtrirë në pozicion lateral dhe pamundësi për t'u ngritur edhe kur ndihmohet. Delja ka oreks normal por është e pamundur që ajo të mbajë qëndrimin në pozicion sternal. Delja është e gjallë dhe vigjilente. Ajo e mban kokën në pozicion normal dhe nuk tregon prani të dhimbjes apo rritje të tonusit muskular në rajonin e qafës, gjatë manipulimeve të lehta të vertebrave cervikale. Harqet reflektore lokale që përfshijnë gjymtyrët e para dhe të pasme (prova e tërheqjes dhe reflekset e tendineve) duken në nivel të rritur.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Trauma apo fraktura të (një a më shumë) vertebrave cervikale
- B) Keqformime të vertebrave cervikale
- C) Empiema të vertebrave cervikale
- D) Injeksionet jo normale në rajonin e qafës

Pyetja 109.

Një dash me moshë 4 vjet paraqitet me çalim të shkallës 8 nga 10 për tre ditët e fundit dhe me një ënjtje të madhe fluktuante në pozicionin kranial të artikulationit karpal të majtë. Nyjet limfatike preskapulare janë normale. Nuk evidentohet pabarazi në masën muskulare që mbulon shpatullat. Në manipulimet e lehta të artikulationit karpal, dashi nuk reagon me dhimbje. Temperatura rektale është normale dhe dashi ka oreks të mirë.

Në gjykimin tuaj, dashi mundet të vuajë nga:

- A) Abscesi (ose higroma) e artikulationit karpal
- B) Artrit septik i artikulationit të brrylit
- C) Tendovaginiti
- D) Fraktura e kockës karpale

Pyetja 110.

Në fund të vjeshtës 6 nga 140 qengjat e pavaksinuar me moshë 7 muajsh të mbyllur për dy javë, janë gjetur të ngordhur në 4 ditët e fundit. Disa nga qengjat janë parë të kenë qënë me qëndrim të topitur dhe në gjendje të rëndë debolese. Ata ishin me diarre me aromë të keqe për 24 - 36 orë dhe ngordhën pavarësisht trajtimeve me antihelmentikë. Dieta në dy javët që u mbajtën mbyllur qengjat, bazohej në peletat e barit dhe 30 % elb i bluar në javën e parë dhe më pas në javën e dytë, sasia e elbit u rrit deri në 90 % të racionit që u bë ad libitum.

Në gjykimin tuaj, qengjat mundet të kenë ngordhur nga:

- A) Pasterelozja septikemike
- B) Acidoza laktike klinike e rumenit
- C) Enterotoksemia (veshka e zbutur)
- D) Fascioliaza subklinike

Pyetja 111.

Një fermer ankohet për leziona të rënda në fytyrë dhe në buzë të afërsisht 25 % të 120 qengjave me moshë 6 muajsh. Lezionet u shfaqën te qengjat 10 - 14 ditë pas lëvizjes së tyre në kullota që përmbanin numër të lartë bimësh gjëmbaçe. Gjatë kontrollit u kanstatua se lëkura e fytyrës dhe e buzëve ishte edematoze me eksudat seroz dhe me grumbullime qelbi në sipërfaqe. Vende vende qelbi ishte tharë dhe kishte formuar kore të forta që ndaheshin nga fisura të thella. Largimi i kujdesshëm i koreve tregon një shtrat të pasur me ind granulomatoz. Në disa qengja materiali nga koret ngushton flegrat e hundës duke shkaktuar dispnoe dhe frymëmarrje të rënduar të tipit abdominal.

Në gjykimin tuaj, qengjat mundet të vuajnë nga:

- A) Gjuha blu
- B) Dermatofiloza e rënduar (*Dermatophilus congolensis*)
- C) Dermatiti pustuloz ngjites (CPD)
- D) Ektima kontagioza

Pyetja 112.

Një qengj me moshë 2 javësh paraqitet shumë i lodhur, i dobët dhe në kondicionin trupor më të keq se binjaku i tij. Qengji qëndron me kokën e ulur dhe mban kurrizin të harkuar nga lart. Temperatura rektale është nën normë (38.0 °C). Ritmi i punës së zemrës është i rritur në 90 rrahje për minutë. Mukozat e kontrollueshme duken të kongjestuara. Denduria e frymëmarrjes është 40 akte frymëmarrëse për minutë. Gjatë askultimit të kraharorit nuk dëgjohen zhurma jo normale. Palpimi i kujdesshëm abdominal mbi kërthizë dhe kaudalisht procesit ksifoidal të sternumit jep përgjigje me dhimbje. Nuk vërehen shenja për prani diarrije.

Në gjykimin tuaj, qengji mundet të vuajë nga:

- A) Heria umbelikale
- B) Peritoniti i lokalizuar
- C) Pneumonia supurative
- D) Nekrobaciloza e mëlçisë

Pyetja 113.

Një lopë me moshë 6-vjeçe, paraqitet shumë e plogësht dhe në gjendje të rëndë debolese. Lopa jep vetëm 18 litra qumësht në ditë kur normalisht pritej të jepte 40 – 45 litra, pasi është 3 javë paspjelljes. Ekzaminimi klinik zbulon temperaturë rektale normale. Lopa ka konstipacion të lehtë. Një aromë acetoni është e dukshme në frymën e nxjerrë. Lëvizjet e rumenit janë normale dhe mund të dëgjohen më kaudalisht në gropën e urisë. Në perkutim të pjesës kraniale të gropës së urisë dëgjohen tinguj metalikë të lartë (ping). Tinguj të tillë mund të dëgjohen dhe lart në

anën e majtë nën brinjë. Ekzaminimi rektal nuk zbulon ndonjë anomali. Nuk ka asnjë provë të pranishme të mastitit.

Në gjykimin tuaj, lopa mundet të vuajë nga:

- A) Gjendja ketonike klinike (Acetonemia e gjedhit)
- B) Gjendja ketonike subklinike (Gjendja SARA)
- C) Zhvendosja e abomazit në të majtë
- D) Indigestioni vagal

Pyetja 114.

Në fund të stinës së dimrit një grup delesh që mbahen mbyllur gjithë kohën manifestojnë kruarje të forta. Ato fërkohen gjithmonë me forcë me ndarjet e vathës dhe ndalojnë direkt marrjen e ushqimit. Shumë nga to kafshojnë gëzofin e tyre në mesin e shpinës, apo kruhen me këmbët e pasme duke shkaktuar dëmtime të lëkurës dhe humbje të leshit.

Në gjykimin tuaj, delet mundet të vuajnë nga:

- A) Infestimi i madh nga morrat
- B) Infestimi nga zgjeba psoroptike
- C) Skrapi
- D) Miaza e lëkurës

Pyetja 115.

Në fillim të vjeshtës paraqitet një mëshqerrë e moshës 18 muajshe, e cila është shumë më e vogël në trup se mëshqerrat e tjera të grupit (pesha 220 kg përkundërt 370 kg të mesatares së grupit). Të gjitha meshqerrat janë të pa vaksinuara dhe të blera nga burime të shumta. Me grupin e mëshqerave ka qenë dhe një dem për më shumë se 4 muaj. Kohët e fundit, mëshqerra ka shfaqur diarre të ujshme, dukuri e cila është vërejtur dhe në disa meshqerra të tjerë në grup. Kontrolli klinik zbulon gjendjen me temperaturë 39.1 °C, me rrjedhje të lehta mukopurulente nga sytë dhe hunda, si dhe limfadenopati në nyjet periferike.

Në gjykimin tuaj, mëshqera mundet të vuajë nga:

- A) Pneumoni kronike supurative
- B) Invazione parazitare
- C) Rhinotrakeiti infektiv i gjedhit (IBR)
- D) Infeksioni persistent me virusin BVD

Pyetja 116.

Gjatë fillimit të muajit Prill, një dele me moshë 6 vjeçe dhe që ka lindur së fundi 1 javë më parë dy qengja, po manifeston probleme shëndetësore. Delja mbahet në kullotë së bashku me 60 dele të tjera që sapo kanë lindur. Përveç kullotës deleve u jepet dhe nga 1 kg ushqim i koncentruar me 18 % proteinë për kokë në ditë plus që kanë qajse dhe në një piring silazhi. Delja paciente duket në gjendje të deboluar dhe nuk reagon ndaj afrimit tuaj. Reflektet ndaj ngacmuesve janë të pranishme por të ngadalësuara. Delja ka salivacion të vazhduar. Temperatura rektale është 38.5 °C. Rektumi është i lëshuar dhe përmban feçe në formë paste. Mukozat e kontrollueshme janë me pamje normale. Ritmi i punës së zemrës është 60 rrahje për minutë dhe denduria e frymëmarrjes është 18 akte frymëmarrëse për minutë. Rumeni ka mbushje të pakët dhe në auskultim dëgjohen lëvizje të reduktuara peristaltike në numër dhe në forcë. Delja nuk ka mastit dhe nuk duket të ketë ënjtje apo rrjedhje nga vulva.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Hipokalcemia akute
- B) Acidoza klinike e rumenit
- C) Hipomagnezemia
- D) Listerioza

Pyetja 117.

Pas një moti të keq me erë dhe borë një bari ankohet se shumë dele barrse në kodër janë verbuar papritur. Delet janë shumë fotofobike me blefarospazma, lagie të syve dhe njolla lagështie nga lotët në faqe. Ekzaminimet klinike tregojnë për konjunktivit dhe keratit. Në sytë e disa deleve dallohen ulçerime korneale të cilat bëhen më të dukshme pas stripeve me bojë fluoreshente të vendosura në kontakt me syrin.

Në gjykimin tuaj, delet mundet të vuajnë nga:

- A) Keratokonjunktiviti infektiv (IKC)
- B) Ekzema periorbitale
- C) Ethe katarale malinje
- D) Trupa të huaj në sy

Pyetja 118.

Një fermer ankohet për shfaqjen e fillesave të papritura gjendjes së deboluar dhe të verbimit në 12 nga 300 qengjat e tij, me moshë 6 muajsh. Kur u izoluan, qengjat u panë se filluan të godasin njëri tjetrin me kokë dhe kanë kërcitje të vazhdueshme të dhëmbëve. Qengjat janë rritur keq (janë me peshë të vogël 18 – 24 kg) dhe me gëzof të pisët. Qengjat kanë bark të zvogëluar dhe mbushje të dobët të rumenit me ushqim. Në pjesët e bishtit dhe në zonën e prineumit janë të ndotur me mbetje fekalesh. Qengjat zakonisht kullotin në kullota të varfra dhe publike të cilat përdoren dhe për shëtitjen e qenve. Në analizat koprologjike u gjetën rreth 400 v/p/g të strongilatëve intestinalë. Përqendrimet e enzimave të mëlçisë (AST, GLDH dhe GGT) ishin 4 deri në 6 herë mbi normë, në 4 qengjat e testuar. Përqendrimet e vitaminës B në serumit e 6 qengjave të testuar treguan për nivele shumë të ulëta të saj (mesatare < 120 pg/mL).

Në gjykimin tuaj, qengjat mundet të vuajnë nga:

- A) Fascioliaza subakute
- B) Poliencefalomalacia (PEM)
- C) Deficienca e theksuar e kobaltit (sëmundja mëlçia e bardhë)
- D) Cenuroza akute

Pyetja 119.

Në fillim të pranverës një dele e racës Bardhoka paraqitet me një ënjtje të madhe në rajonin ventro kaudal të abdomenit, e vënë re dy ditë më parë. Delja ishte ndarë nga kafshët e tjera të tufës dhe ishte me oreks të ulët. Në kontrollin klinik konstatohet se delja ka kondicion të vlerësuar 2.0 (shkalla 1 – 5) dhe temperatura rektale ishte normale. Gjiri i deles nuk ishte i zhvilluar mirë. Muri i barkut ndihet me palpim më i hollë se normalisht me cipën e peritoneumit menjëherë poshtë indit edematoz të nënlëkurës. Delja u kalua në kontroll ekografik (EKO) dhe u pa se kishte tre qengja. Ajo pritet të lindë për 2 javë.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Ruptura e tendinit prepubik
- B) Hernia abdominale
- C) Pickim nga gjarpëri
- D) Edema hipoproteinemike

Pyetja 120.

Një dele me moshë 3 vjeçare që mbahet në kullotë dhe ka pjellë para një muaji qengja binjakë, është gjetur e izoluar nga pjesa tjetër e tufës. Delja duket e ngurtë dhe tërheq zvarë këmbën e pasme të majtë. Delja është në gjendje shumë të deboluar dhe ka mukozat e kontrollueshme me pamje hiperemikë të theksuar. Temperatura rektale është rritur në 40.6 °C. Ritmi i punës së zemrës është i rritur në 120 rrahje për minutë dhe denduria e frymëmarrjes është gjithashtu e

rritur në 45 akte frymëmarrjese për minutë. Në rumen nuk dëgjohen zhurma peristaltike (atoni). Kontrolli i gjirit tregon mastit të përhapur. Ana e majtë e gjirit duket e ënjtur, e dhimbshme dhe me ngjyrë lehtësisht mavi. Përgjatë murit ventral abdominal ka prani të edemës subkutane që zgjatet deri në krahavor.

Në gjykimin tuaj, delja mundet të vuajë nga:

- A) Mastiti gangrenoz
- B) Mastiti i verës në dele
- C) Lezione traumatike në gji
- D) Edemë malinje

19. Sëmundjet e Kafshëve të Shoqërimit

Pyetja 1

Cili është pleshti më i zakonshëm i maceve dhe qenve?

- A) Pulex irritans
- B) Spilopsyllus cuniculi
- C) Ctenocephalides canis
- D) Ctenocephalides felis

Pyetja 2

Cila është koha e kryerjes së vaksinës së parë në qen?

- A) 2 - 4 javë
- B) 6 - 8 javë
- C) 12 - 14 javë
- D) 1 vjeç

Pyetja 3

Cili nga parazitët e mëposhtëm infekton këlyshët e qenit në jetën embrionale?

- A) Ancylostoma caninum
- B) Toxocara canis
- C) Trichuris vulpis
- D) Uncinaria stenocephala

Pyetja 4

Cili nga organizmat e mëposhtëm është shkaku më i zakonshëm i Rinotracheitit viral të maceve?

- A) Chlamydia felis
- B) Herpesvirusi felin tipi 1
- C) Calicivirusi felin
- D) Mycoplasma felis

Pyetja 5

Cila nga alternativat tregon më bindshëm se një qen vuan nga otiti?

- A) Temperatura
- B) Shkundja e kokës

- C) Prani e shumë bakterieve në citologji
- D) Letargji

Pyetja 6

Cila nga shenjat klinike të mëposhtme nuk shfaqet gjatë diabetit mellitus në kafshët e shoqërimit?

- A) Polidipsia
- B) Polifagia
- C) Polipnea
- D) Poliuria

Pyetja 7

Cila nga vaksinat e mëposhtme nuk është vaksinë për qen?

- A) Rabies
- B) Parvo
- C) Distemper
- D) FeLV

Pyetja 8

Cila nga alternativat e mëposhtme është mënyra më e mirë për të mbajtur të shëndetshëm dhëmbët dhe mishrat e dhëmbëve në qen?

- A) Dieta për mënjanimin e gurzave
- B) Dhënia e ushqimeve të lëngshme
- C) Larja e dhëmbëve me furçat përkatëse
- D) Dhënia e lodrave përtypëse

Pyetja 9

Cila është mënyra më e mirë për të trajtuar dhimbjet e kyçeve tek një qen adult?

- A) Tylenol
- B) Aspirin
- C) Antibiotik
- D) Antiinflamator

Pyetja 10

Një mace me *Otodectes cynotis* do të ketë rrjedhje nga veshi me ngjyrë?

- A) Të kuqe (gjak)
- B) Kafe/zezë
- C) Verdhë/jeshile
- D) Ngjyrë krem (qelb)

Pyetja 11

Cila nga patologjite e mëposhtme të veshkave është më e rëndë në mace?

- A) Insuficenca kronike e veshkave
- B) Gurët e veshkave

- C) Infeksionet urinare
- D) Sindromi urologjik felin

Pyetja 12

Cilët nga gurët që zhvillohen në aparatën urinar janë më të zakonshëm në qen?

- A) Struvitët
- B) Oksalatet e kalçiumit
- C) Uratët
- D) Silikatët

Pyetja 13

Cila është mënyra e infektimit të një qeni me *Dipilidium caninum*?

- A) Kontakti direkt me një qen të infektuar me *D.caninum*
- B) Gëlltitja e pleshtave të infektuar me *D.caninum*
- C) Koprofagia
- D) Larja në ujra të infektuar me *D.caninum*

Pyetja 14

Cila nga rracat e mëposhtme ka predispozicion për t'u prekur nga epilepsia?

- A) Collie
- B) Chihuahua
- C) Poodle
- D) Akita

Pyetja 15

Epilepsia mjekohet me:

- A) Antiinflamatore
- B) Antikonvulsiv
- C) Antibiotik
- D) Antialergjik

Pyetja 16

Patologjia gjatë së cilës gjëndrat e yndyrës së lëkurës prodhojnë yndyrë të shtuar quhet:

- A) Folikulit
- B) Dermatit
- C) Seborrhea
- D) Impetigo

Pyetja 17

Cili nga shkaktarët e mëposhtëm shkakton kolitin infektiv në qen?

- A) Salmonella
- B) E.coli
- C) Proteus
- D) Vibrio

Pyetja 18

Cili nga llojet e kolitit në qen ka prognozë të mirë?

- A) Koliti infektiv
- B) Koliti idipatik
- C) Koliti granulomatoz
- D) Koliti ulçerativ

Pyetja 19

Sa zgjat stadi i paralizës në një qen me sëmundjen e Tërbimit?

- A) 1-3 ditë
- B) 1-7 ditë
- C) 2-4 ditë
- D) 4-6 ditë

Pyetja 20

Leishmanioza prek më shumë qentë e moshës:

- A) 0-3 vjeç
- B) 3-8 vjeç
- C) 8-10 vjeç
- D) 10-12 vjeç

Pyetja 21

Cilin nga parazitët e mëposhtëm trasmeton mushkonja Culex në qen?

- A) Dirofilaria immitis
- B) Toxocara canis
- C) Uncinaria stenocephala
- D) Aelurostrongylus abstrusus

Pyetja 22

Cili është termi veterinar për dhënien e një medikamenti nga goja?

- A) Sc
- B) Per os
- C) Per ops
- D) Infusion

Pyetja 23

Cila është mosha e qenve që preket më shumë nga diabeti?

- A) Nën 1 vjeç
- B) 1-3 vjeç
- C) Mbi 7 vjeç
- D) Mbi 11 vjeç

Pyetja 24

Termi mjekësor për sterilizimin e kafshëve femra është?

- A) Vazoektomi
- B) Ovariohisterektomi
- C) Kastrim
- D) Ndërhyrje cezariane

Pyetja 25

Cili është kampioni i duhur për të kryer testin e Dirofliariozës?

- A) Gjak
- B) Feçe
- C) Urinë
- D) Lëng cerebrospinal

Pyetja 26

Cila është temperature normale në mace?

- A) 37
- B) 38
- C) 38-39
- D) 39.5

Pyetja 27

Llamba Wood përdoret për të zbuluar cilin nga shkaktarët e mëposhtëm?

- A) *Microsporum canis*
- B) *Sarcoptes*
- C) *Demodex spp*
- D) *Cheyletiella yasguri*

Pyetja 28

Cili nga krimbat e shtypur të mëposhtëm infekton qentë?

- A) *Dipylidium*
- B) *Hymenolepis*
- C) *Taenia*
- D) *Capillaria*

Pyetja 29

Në cilën nga rracat e mëposhtme të qenve shfaqet më shumë dermatiti i palave të lëkurës?

- A) Shar Pei
- B) Chow Chow
- C) German Shepherd
- D) St. Bernard

Pyetja 30

Cila nga patologjitë e mëposhtme është zoonoze?

- A) Bronkiti akut
- B) Dermatiti alergjik
- C) Sëmundja autoimune e lëkurës
- D) Mykoza e lëkurës

Pyetja 31

Infeksioni bakterial akut që prek valvulat e zemrës quhet:

- A) Endokardit
- B) Perikardit
- C) Fibrozë e valvulave
- D) Insufiçencë e valvulave

Pyetja 32

Hematuria në fillim të urinimit në një qen mashkull tregon për probleme dhe hemoragji në:

- A) Prepuçium
- B) Fshikëz
- C) Ureter
- D) Veshka

Pyetja 33

Termi mjekësor për “urinim me dhimbje” është?

- A) Oliguri
- B) Stranguri
- C) Polakiuri
- D) Anuri

Pyetja 34

Sa është pesha specifike normale e urinës në qen?

- A) 1,030
- B) 1,050
- C) 2,030
- D) 2,050

Pyetja 35

Cila nga alternativat konsiderohet rrisht kryesor për infektimin e qenit me Leptospirozë?

- A) Shëtitjet
- B) Vizitat në zona rurale
- C) Ekzpozimi ndaj urinës së infektuar
- D) Larja në ujra të infektuara

Pyetja 36

Si quhet anemia me RBC me përqëndrim të reduktuar të hemoglobinës?

- A) Makrocitike
- B) Mikrocitike

- C) Hipokromike
- D) Normokromike

Pyetja 37

Një qen Jack Rusell Terrier 12 vjeç paraqitet në klinikë pasi ka lindur 4 këlyshë nga 9 që pritëshin. Ka kaluar afërsisht 5 orë nga lindja e këlyshit e të fundit.

Cili është hapi që duhet të ndërmerret?

- A) Ndërrhyrje Çezariane
- B) Injektivim i Oksitocinës
- C) Lëngje intravenoz
- D) Kryerja e radiografisë

Pyetja 38

Cila është teknika më e mirë për diagnostikimin përfundimtar të gastritit?

- A) Vetëm gastroskopia
- B) Hematologjia dhe biokimia
- C) Radiografia abdominale me kontrast
- D) Biopsia e stomakut

Pyetja 39

Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me infektimin me Parvovirus tipi 2 në këlyshë?

- A) Forma enterike e sëmundjes ka mortalitet të lartë
- B) Forma kardiake është më e zakonshme në këlysha mbi 8 javësh
- C) Këlyshat nën 3 javësh infektohen rrallë
- D) Është fatale në këlysha

Pyetja 40

Cila është forma më e zakonshme e neoplazisë në qen dhe mace?

- A) Osteosarcoma
- B) Haemangiosarcoma
- C) Fibrosarcoma
- D) Fibroma osifikuese

Pyetja 41

Një qen Maltez 4 vjeç, femër e pa sterilizuar ka anoreksi, temperaturë, dridhje dhe ngurtësim të gjymtyrëve 3 javë pas lindjes së këlyshëve.

Cila nga alternativat e mëposhtme është ndërhyrja urgjente që duhet të ndërmerret?

- A) Klorur kalçiumi intramuskular
- B) Glukonat kalçiumi intravenoz
- C) Glukozë 50% intravenoz
- D) Laktat kalçiumi oral

Pyetja 42

Kur shfaqet më shpesh “incontinentia urinae” (mos mbajtja e urinës) në mace?

- A) Në dëmtime të palcës shpinore
- B) Në bllokime të fshikëzës urinare
- C) Në rupturë të fshikëzës urinare
- D) Në cistite

Pyetja 43

Një qen mashkull Terrier, 9 vjeç, në dukje i shëndetshëm, me konstipacion u evidentua me zmadhim simetrik të gjëndrës së prostatës. Gjatë ekzaminimit fizik, palpimi i prostatës nuk prodhoi dhimbje tek qeni, prostata paraqitet e zmadhuar dyfish dhe e lëvizshme në kanalin pelvik.

Cila nga alternativat është diagnoza më e mundshme?

- A) Infeksion akut
- B) Hiperplazi beninje
- C) Abces
- D) Cist

Pyetja 44

Një kotele 6 muajshe paraqitet me disa zona alopecie rrethore. Edhe vajza e pronarit të maces ka një lezion në dorën e saj. Ekzaminimi me dritë Wood nuk evidentoi fluoreshencë.

Cili është testi më i përshtatshëm diagnostik që duhet të kryhet në këtë kotele?

- A) Kulturë bakteriale nga qimet rreth lezionit
- B) Kulturë mykotike nga qimet rreth lezionit
- C) Serologji mykotike
- D) Ekzaminim histopatologjik dhe citologjik i biopsisë nga lezioni

Pyetja 45

Cili është shkaku më i mundshëm i kardiomiopatisë dilatative në macet adulte?

- A) Hipertiroidizmi
- B) Neoplazia
- C) Toksoplazmoza
- D) Mungesa e taurinës

Pyetja 46

Një orë pas vaksinimit, një këlysh zhvillon edemë të papritur dhe kruajtje të buzëve, qepallave të syrit dhe hundës.

Cili është shkaku i këtyre shenjave?

- A) Hipersensitiviteti i ndërmjetësuar qelizor
- B) Hipersensitiviteti citotoksik
- C) Hipersensitiviteti i menjëhershëm
- D) Hipersensitiviteti i ndërmjetësuar nga kompleksi imunitar

Pyetja 47

Një maçok i kastruar 6 vjeç është sjellë në klinikë për shkak të letargjisë dhe depresionit. Në ekzaminimin kardiak, zbulohet një zhurmë e gradës III/VI dhe një ritëm galopi. Madhësia e zemrës në radiografi paraqitet normale.

Cili nga testet e mëposhtëm do të sigurojë informacionin më të saktë mbi problemin anatomik kardiak?

- A) Angiografia e aortës
- B) Ekokardiografia
- C) Elektrokardiografia
- D) Perikardiografia

Pyetja 48

Cili nga testet e mëposhtme është testi më i mirë për të evidentuar krimbin e zemrës në qentë asimptomatikë?

- A) Testi i shpejtë
- B) Testimi antigenit
- C) Knot teknik
- D) Grafia e toraksit

Pyetja 49

Cila nga shenjat klinike të mëposhtme ka më shumë gjasa të jetë e pranishme në një mace me patologji të zemrës?

- A) Anoreksi
- B) Kollë
- C) Rritje e urinimit
- D) Edemë subkutane

Pyetja 50

Cili është shkaktari kryesor i zhvillimit të insuficiencës renale kronike në qen dhe mace?

- A) Glomerulopatia
- B) Sëmundja policistike e veshkave
- C) Tumoret renale
- D) Pielonefriti

Pyetja 51

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për diabetin mellitus tek qentë?

- A) Është i nevojshëm kalimi në një dietë të pasur me karbohidrate dhe yndyrna dhe të varfër në fibra
- B) Meshkujt preken dy herë më shumë se femrat
- C) Prognoza është e mirë deri në 90% të rasteve
- D) Trajtimi përfshin insulin 2x ditë dhe ndryshim të dietës

Pyetja 52

Në cilin nga rastet e mëposhtme përdoret testi intrakutan për konfirmimin e diagnozës?

- A) Zgjebe
- B) Urtikarie
- C) Demodekozë
- D) Dermatit atopik

Pyetja 53

Cili është shkaktari kryesor i infeksioneve mykotike të lëkurës në qen?

- A) *Mikrosporum gypseum*
- B) *Mikrosporum canis*
- C) *Trichophyton spp*
- D) *Microsporum audouini*

Pyetja 54

Në cilën pjesë të zemrës lokalizohet *Dirofilaria immitis* në zemrën e qenit të infektuar?

- A) V. pulmonare
- B) Aortë
- C) Anën e majtë të zemrës dhe a.coronare
- D) Anën e djathtë të zemrës dhe a.pulmonare

Pyetja 55

Cila nga racat e mëposhtme preket më shumë nga Limfosarkoma?

- A) Siameze
- B) Ragdoll
- C) Sphynx
- D) Bengal

Pyetja 56

Cila nga rracat e mëposhtme është më e predispozuar për të zhvilluar hernien hiatale?

- A) Maltese
- B) Poodle
- C) Shar Pei
- D) Border Collie

Pyetja 57

Cila është strategjia më e rëndësishme që ka zhvilluar *Toxocara canis* për të mbijetuar në popullatën e qenve?

- A) Formimi i vezëve shumë rezistente
- B) Migrimi hepato-trakeal
- C) Migrimi nëpërmjet plaçentës
- D) Formimi i granulomave të stadii II

Pyetja 58

Cila nga keto simptoma është më e sigurta në diagnozën e edemës pulmonare?

- A) Rrjedhje me gjurmë gjaku si jargë nga goja ose hunda

- B) Kollë e fortë
- C) Frymëmarje e vështirësuar
- D) Dispne dhe takipnoe

Pyetja 59

Diagnoza diferenciale e sëmundjes së Tërbimit bëhet me:

- A) Parvovirozën
- B) Sëmundjen e Lisë
- C) Trakeobronkitin infektiv
- D) Leptospirozën

Pyetja 60

Përveç bakterieve miokarditi infektiv shkaktohet dhe nga viruse.

Cilët janë viruset kryesore që shkaktojnë miokarditin në kafshët e shoqërimin?

- A) Calciviruset
- B) Parvoviruset
- C) Adeniviruset
- D) Coronaviruset

Pyetja 61

Cilat raca prekin më shumë kardiomiopatitë në qen?

- A) Racat e vogla
- B) Racat mix
- C) Racat e mëdha
- D) Racat mesatare

Pyetja 62

Cili është shkak i formimit të fekaleve të bardha në qen dhe mace?

- A) Bllokimi total i kanalit biliar
- B) Përqëndrimi i kolesterolit në serum
- C) Përqëndrimi i acidit biliar në serum
- D) Ikteri

Pyetja 63

Cili nga medikamentet e mëposhtme është një nga shkaqet më të zakonshme në zhvillimin e lipidozës së mëlçisë në qen nëse përdoret për një kohë të gjatë?

- A) Antiparazitarët
- B) Antikonvulsivët
- C) Kortizonikët
- D) Glukokortikoidët

Pyetja 64

Kur duhet të hiqet tek një qen një dhëmb me sëmundje periodontale?

- A) Sa më shpejt që diagnostikohet

- B) Kur në radiografi evidentohet 5% humbje e lidhjes së dhëmbit
- C) Kur xhepat periodontalë janë 4mm ose më të thellë
- D) Kur dhëmbi lëviz

Pyetja 65

Një infeksion veshi me bakterie gram-negative (*Pseudomonas* spp, *E coli*, *Proteus* spp) tek një qen ose mace shoqërohet me eksudat me ngjyrë?

- A) Të verdhë
- B) Jeshil
- C) Kaf
- D) Të kuq

Pyetja 66

Cila nga këto faza të sëmundjes nuk i përket Lisë?

- A) Forma bronkiale
- B) Forma gastrointestinale
- C) Stadi i eksitimit
- D) Forma e lëkurës

Pyetja 67

Tek cila nga racat e mëposhtme të maceve shfaqet “Sindromi brakiocefalik i rrugëve ajrore”

- A) Himalayan
- B) Persiane
- C) Norwegian Forest
- D) Siberiane

Pyetja 68

Gjatë auskultimit të një qeni me bronkit kronik janë karakteristike?

- A) Ronket
- B) Zhurmat stenozyke
- C) Krepitacionet
- D) Zhurmat vezikulare

Pyetja 69

Cila nga teknikat e mëposhtme është më pak e përdorshme për të diagnostikuar një infeksion parazitar në praktikën rutinë të kafshëve të vogla?

- A) Flotacioni pasiv
- B) Flotacioni me centrifugim
- C) Baermann
- D) Shtrirja direkte

Pyetja 70

Cila nga racat e mëposhtme është më e predispozuar nga Ivermectina

- A) Pug

- B) Collie
- C) Yorkshire
- D) Cavalier

Pyetja 71

Azotemia në kafshët e shoqërimit shfaqet kur mbi:

- A) 60% e nefroneve janë jo funksionale
- B) 75% e nefroneve janë jo funksionale
- C) 80% e nefroneve janë jo funksionale
- D) 90% e nefroneve janë jo funksionale

Pyetja 72

Në cilën nga racat e mëposhtme zhvillohet ektropioni?

- A) St. Bernard
- B) Maltese
- C) Dachshund
- D) Chow-Chow

Pyetja 73

Cila është zona më e zakonshme ku ngecin e trupat e huaj në qen?

- A) Hyrja torakale; ezofagu cervical; para diafragmës
- B) Hyrja torakale; baza e zemrës; para diafragmës
- C) Baza e zemrës; ezofagu cervical; para diafragmës
- D) Baza e zemrës, hyrja torakale; kaudalisht laringut

Pyetja 74

Në një qen mashkull Boston Terrier 9 vjeç u zbulua një masë 5 cm në rajonin inguinal të majtë, lateralisht prepuciumit. Ekzaminimi citologjik i aspiratit zbuloi qeliza granulare të shumta me ngjyrë të kuqe/lejla. Nyja limfatike e majtë është e zmadhuar. Të njëjtat qeliza u evidentuan në aspiratin e nyjes limfatike dhe strishon e gjakut.

Cili është hapi që duhet të merret në këtë rast?

- A) Administrim i Cisplatinës dhe Alumin hidroksid
- B) Administrim i Levamisolit dhe Aspirinës
- C) Administrim i Prednizonit dhe Cimetidinës
- D) Largim kirurgjikal i masës

Pyetja 75

Një mace 10 vjeçe, e sterilizuar paraqitet në klinikë me humbje peshe, polifagi, poliuri, polidipsi dhe egërsim. Gjatë auskultimit u evidentua aritmi e zemrës.

Cila nga alternativat e mëposhtme është diagnoza më e mundur?

- A) Insufiçencë pankreatike kronike
- B) Sëmundje kronike e veshkave
- C) Diabet mellitus
- D) Hipertiroidizëm

Pyetja 76

Një kotele 6 muajshe po vlerësohet për shkak të krruarjeve të forta rreth veshëve dhe tundjes së shpeshtë të kokës. Ekzaminimi evidentoi rrjedhje bilaterale të trashë kafe/ kuqe nga veshët dhe kruste.

Cili është testi diagnostik më i përshtatshëm?

- A) Mbjellje bakteriale të eksudatit të veshit
- B) Mbjellje mykotike të eksudatit të veshit
- C) Ekzaminim mikroskopik të eksudatit të veshit
- D) Ekzaminim me llampën Wood

Pyetja 77

Një qen 5 vjeç ka prodhim urine shumë të përqëndruar dhe azotemi të moderuar.

Cila nga gjetjet e mëposhtme shoqëruese të këtyre shenjave është treguesi më i besueshëm se qeni ka insuficiencë renale kronike?

- A) Hiperkalemia
- B) Hiperfosfatemia
- C) Hipokalcemia
- D) Anemi joregjenerative

Pyetja 78

Një qen, 10-vjeç Pastor Gjerman ka disa kohë që në mëngjes mezi ngrihet me këmbët e prapme. Gjatë ditës gjendja e tij përmirësohet por ka urinim të shpeshtë.

Cila është diagnoza më e mundshme?

- A) Probleme të veshkave
- B) Dëmtim i shtyllës kurrizore.
- C) Osteokondrozë
- D) Dispazia koksofemorale

Pyetja 79

Në ekzaminimin fizik, një qen mashkull 12-vjeç evidentohet me alopeci simetrike bilaterale, zmadhim të gjëndrave mamare dhe prepucium të lëshuar.

Cili është shkaku i këtyre gjetjeve?

- A) Adenoma adrenokortikale
- B) Adenokarcinoma e qeses anale
- C) Adenokarcinoma e prostatës
- D) Tumor i qelizave Sertoli të testikujve

Pyetja 80

Një qen Pomeranian obez, 13-vjeç, i sterilizuar paraqitet në klinikë për shkak të një kolle që është përkeqësuar gjatë 3 - 4 muajt e fundit. Pronari i tij tregon se kolla ndodh kur qeni është i ngazëllyer (p.sh., kur bie zilja e derës) dhe ngjan me “gagarisjen e patave”, kolla nuk është me sputum. Pas përfundimit të kollës qeni ka probleme me frymëmarrjen. Në ekzaminimin fizik,

auskultimi i zemrës dhe mushkërive është normal, dhe veterineri nuk është në gjendje të stimulojë kollën. Pronari refuzon të kryejë grafinë.

Cila është diagnoza më e mundshme?

- A) Influenca kanine
- B) Insufiçenca e zemrës
- C) Trakeobronkiti infektiv
- D) Kolapsi i trakesë

Pyetja 81

Anemia hemolitike është zakonisht një anemi rigjenerative që rezulton nga humbja e eritrociteve jo për shkak të gjakderdhjes por për shkak të faktorëve që përshpejtojnë shkatërrimin e RBC.

Cila nga alternativat është mekanizmi parësor më i zakonshëm i anemisë hemolitike në qen?

- A) Ndërmjetësimi nga imuniteti
- B) Infeksioni
- C) Neoplazi
- D) Toxina

Pyetja 82

Me cilën patologji duhet bërë diagnozë diferenciale me kardiomiopatinë dilatative në qen?

- A) Inufiçencën kronike e zemrës
- B) Difektin e septumit të valvulave
- C) Stenozën e arteries pulmonare
- D) Stenozën e aortës

Pyetja 83

Një qen i konfirmuar pozitiv me Babesia gipsoni duhet të trajtohet me:

- A) Imidocarb dipropionate
- B) Azithromycin dhe Atovaquone
- C) Clindamycin dhe Metrodinazole
- D) Meglumine antimoniate

Pyetja 84

Cili është trajtimi i duhur për një qen me ezofagit?

- A) Ranitidine dhe Omeprazol
- B) Sucralfate dhe Omeprazol
- C) Vetëm Sucralfate
- D) Vetëm Ranitidine

Pyetja 85

Cila nga alternativat e mëposhtme në lidhje me melanomën është e saktë?

- A) Melanoma malinje është tumori oral më i diagnostikuar në mace
- B) Gati gjysma e qenve me melanomë malinje në kohën e diagnostikimit kanë zhvilluar metastaza

- C) Mushkëritë rrallë janë zona metastatike gjatë melanomës malinje
- D) Melanocitet kanë gjithmonë pamje të rrumbullakët në citologji

Pyetja 86

Një Labrador Retriever, 9 muajsh, i sterilizuar u paraqit në klinikë për një kollë kronike të lehtë. Gjatë flotacionit fekal me centrifugim u evidentuan prani vezësh parazit.

Cili është paraziti që u evidentua?

- A) Ancylostoma caninum
- B) Eucoleus aerophilus
- C) Toxocara canis
- D) Trichuris vulpis

Pyetja 87

Një qen, mashkull, Labrador Retriever, 4 muajsh u paraqit në klinikë për ekzaminim fizik dhe vaksinim. Tre ditë më parë, qeni duke luajtur me lodër përtypëse kishte klithur me dhimbje dhe kishte rifilluar lojën pa shenja të tjera shqetësimi. Qeni ushqehet me ushqim të thatë komercial me cilësi të lartë. Ekzaminimi klinik rezulton normal me përjashtim të një dhëmbi qumështi të sipërm në anën e djathtë të thyer, një kanal rrënje të hapur dhe mishra të gjakosura.

Cili është protokoli i trajtimit për këtë pacient?

- A) Trajtim me antibiotikë për 14 ditë për të parandaluar infeksionin
- B) Asgjë. Qeni do e humbi dhëmbin e përkohshëm për 8-10 javë.
- C) Fillohet ushqim i lëngshëm dhe nuk lejohet qeni të luajë me lodra për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të dhëmbit.
- D) Hiqet dhëmbi i dëmtuar sa më shpejt të jëtë e mundur dhe trajtohet me antibiotik

Pyetja 88

Një mace siameze 5 vjeç, e sterilizuar paraqitet me leziona akute në fytyrë, veshë dhe putra, të cilat u vunë re 5-7 ditë më parë dhe sipas pronarit u shfaqën gjatë natës. Pacienti nuk ka histori të problemeve të lëkurës, nuk ka kruarje, është letargjik dhe me rënie të oreksit. Në familje ka dhe 2 mace të tjera pa probleme të lëkurës; të gjitha macet mbahen rreptësisht brenda dhe kanë jetuar së bashku për 4 vitet e fundit. Ekzaminimi rezultoi normal përveç lezioneve simetrike me kruste dhe pustula në fytyrë në zonën rreth syve, hundë dhe sipërfaqet konkave të veshit. Kruste u evidentuan gjithashtu midis gishtave dhe në këmbët e pasme kishte dhe eksudat purulent.

Cila është diagnoza më e mundshme bazuar në të dhënat e mësipërme.

- A) Pemphigus foliaceus
- B) Hipersensitivitet nga pickimi i mushkonjave
- C) Piodermë sipërfaqësore
- D) Dermatofitozë

Pyetja 89

Një qen Terrier 2 vjeç, 6,8 kg, i sterilizuar u paraqit në klinikë pasi kishte konsumuar një sasi të konsiderueshme çokollate rreth 1.5 orë më parë. Gjatë ekzaminimit qeni është vigjilent me shenja vitale normale.

Bazuar në informacionin e dhënë nga pronari, cilat nga shenjat klinike të mëposhtme mund të priten nga konsumimi i çokollatës?

- A) Pankreatitis
- B) Vjellje e lehtë, diare, hiperaktivitet
- C) Vjellje, diare, hiperaktivitet, dridhje të trupit
- D) Vjellje, diare, hiperaktivitet, kriza epileptike, artimi

Pyetja 90

Një mace, 2 vjeç, e sterilizuar u paraqit në klinikë si pasojë e dridhjeve akute të trupit. Tek macja ishte aplikuar një spot-on antiparazitar për qen. Macja filloi të dridhej dhe të humbte koordinimin 30 minuta pas aplikimit. Pronari e lau macen me sapun të lëngshëm, por 90 minuta më vonë shenjat vazhduan pa përmirësim dhe e solli në klinikë. Në ekzaminim macja kishte tremor, hipersalivim dhe kaloi krizë epileptike, temperatura e saj rektale ishte 39.6 ° C.

Cili është protokollin e trajtimit për këtë pacient?

- A) Macja lahet urgjent dhe jepet Atropine IM dhe Charcoal i aktivizuar nga goja
- B) Macja lahet urgjent, jepet Diazepam IV
- C) Jepet Methocarbamol IV, pastaj macja lahet
- D) Jepet Atropine IM dhe Charcoal i aktivizuar nga goja, pastaj lahet macja

Pyetja 91

Cila është Vaksina e parë në qen?

- A) Vaksina e Tërbimit
- B) Vaksina e Parvovirozës
- C) Hepatiti kontagioz
- D) Vaksina e Lise

Pyetja 92

Cila nga shenjat e mëposhtme nuk i përket sëmundjes së lisë ?

- A) Diareja
- B) Vjellja
- C) Humbja e ekuilibrit
- D) Urinim me gjak

Pyetja 93

Çfarë është simptoma epistaksis ?

- A) Rjedhje e lengut nga hundët
- B) Rjedhje gjaku nga hunda
- C) Rjedhje qelbi nga hunda
- D) Rjedhje pështyme nga goja

Pyetja 94

Kur rekomandohet përdorimi i Kortizonit?

- A) Në bronkitin me natyrë virusale
- B) Në bronkitin me natyrë bakteriale

- C) Në bronkitin me natyrë parazitare
- D) Në bronkitin me natyrë alergjike

Pyetja 95

Në insuficencën kronike të veshkave?

- A) Në bronkitin me natyrë virusale
- B) Në bronkitin me natyrë bakteriale
- C) Në bronkitin me natyrë parazitare
- D) Në bronkitin me natyrë alergjike

Pyetja 96

Lloji i lëngut abdominal gjatë ashitit konstatohet me ?

- A) Me anë të punksionit
- B) Me anë të grafisë
- C) Me anë të palpimit
- D) Me anë të Auskultimit

Pyetja 97

Per menazhimin e krizave epileptike ne qen mund të përdoren ?

- A) Antibiotik
- B) Antikoagulantë
- C) Antikonvulsiv
- D) Kortizonik

Pyetja 98

Era e rëndë që vjen nga kanali i veshit në kafshët e shoqërimit tregon për ?

- A) Dyll në vesh
- B) Hemoragji
- C) Infeksion
- D) Trup të huaj

Pyetja 99

Gjatë vjelljeve hemoragjike në qen mendohet për ?

- A) Gastrit akut
- B) Gastrit kronik
- C) Trup të huaj
- D) Ulcer të stomakut

Pyetja 100

Hipermotiliteti i zorrëve jep ?

- A) Kapsllëk
- B) Diarre
- C) Alternime të diaresë dhe kapsllëku
- D) Bllokim të zorrëve

Pyetja 101

Kontrulli i maceve për pleshtat kryhet ?

- A) Me metodën scin scrapings
- B) Me krehje
- C) Me Wood lamp
- D) Me analiza hematologjike

Pyetja 102

Ulja e numrit të ruazave të bardha në qen tregon ?

- A) Anemi
- B) Infeksion bakterial
- C) Infeksion viral
- D) Alergji

Pyetje 103

Cili është medikamenti që përdoret në rastet e kardiomiopative në qen?

- A) Vetmedin
- B) Tramadol
- C) Sucralfate
- D) Doxepin

Pyetje 104

Cili nga testet e mëposhtme nuk përdoret në kontrollin diagnostik të lëkurës?

- A) Testi me llampën Wood's
- B) Testi intradermal
- C) Trikograma
- D) Amniocenteza

Pyetje 105

Në cilat raste rekomandohet kryerja e biopsisë së lëkurës në qen dhe mace?

- A) Kur mjekimi nuk jep rezultat
- B) Kur lezionet e lëkurës janë të thella
- C) Kur lezionet janë të gjeneralizuara
- D) Gjithmonë pas ndërhyrjeve kirurgjikale

Pyetje 106

Cila nga llojet e kardiomiopative të mëposhtme shkaktohet si pasojë e defiçencës së taurinës sidomos në mace dhe Cocker Spaniels?

- A) Kardiomiopatia dilatative
- B) Kardiomiopatia hipertrofike
- C) Kardiomiopatia e ventrikulit të djathtë
- D) Kardiomiopatia e ventrikulit të majtë

Pyetje 107

Cili është lloji më i zakonshëm i pemfigus-it në qen?

- A) Pemfigus erythematosus
- B) Pemfigus vulgaris
- C) Pemfigus vegetans
- D) Pemfigus foliaceus

Pyetje 108

Cili është shkaku kryesor i hipotiroidizmit në qen?

- A) Dëmtimi i gjëndrës tiroide
- B) Kequshqyerja
- C) Tumori i tiroides
- D) Sëmundje të tjera bashkëshoqëruese

Pyetje 109

Në cilat vënde lokalizohen lezionet e granulomës eozinoflike në mace?

- A) Në qafë
- B) Në pjesën ventrale të bishtit
- C) Në kokë
- D) Në buzën e sipërme

Pyetje 110

Cila nga shkaqet mëposhtme nuk shkakton pielonefrit në qen?

- A) Ureterët ektopik
- B) Gurë në rrugët urinare
- C) Dieta e pabalancuar
- D) Infeksionet bakteriale

Pyetje 111

Cili term përshkruan një reaksion hipersensitiv që përfshin pruritit dhe dermatit sekondar?

- A) Abrazion
- B) Abses
- C) Alopeci
- D) Atopi

Pyetje 112

Cila nga pohimet e mëposhtme nuk është e saktë në lidhje me rrjedhjen e pavullnetshme të urinës në qen?

- A) Femrat kanë incidencë të lartë
- B) Trajtohet mirë me estrogjen
- C) Ndodh më shpesh në gjumë
- D) Qentë e kastruar kanë incidencë më të lartë

Pyetje 113

Cila nga shenjat klinike të mëposhtme është gjithashtu shkak i diabetit mellitus?

- A) Etja e shtuar
- B) Shtim në peshë
- C) Urinim i shpeshtë
- D) Infeksioni i traktit urinar

Pyetje 114

Presioni i rritur intraokular është i lidhur me cilin nga sindromat e mëposhtme?

- A) Glakukomën
- B) Entropion
- C) Blefaritis
- D) Ulçera korneale

Pyetja 115

Në cilin nga stadet e zhvillimit të sëmundjes së Tërbimit te kafsha shfaqet refuzimi total i ujit?

- A) Në stadin prodromal
- B) Në stadin e eksitimit
- C) Në stadin e paralizës.
- D) Në momente para ngordhjes

Pyetja 116

Në cilin nga stadet e zhvillimit të sëmundjes së Tërbimit te kafsha shfaqet refuzimi total i ujit?

- A) Në stadin prodromal
- B) Në stadin e eksitimit
- C) Në stadin e paralizës.
- D) Në momente para ngordhjes

Pyetja 117

Qen Rottëviler, mashkull 3 vjec, është sjellë në klinik nga pronari pasi kohët e fundit ka pasur gjakderdhje të nëdha nga hunda. Ka kaluar dy gjakderdhje dhe I është bërë transfusion gjaku. Afërsisht para 6 muajsh pacienti ka pasur episode me tështima të forta që janë përmirësuar mbasi është trajtuar me antibiotik dhe kortikosteroid. Kohët e fundit tështimat janë rikthyer dhe gjatë tështimave del gjak. Cili nga egzaminimet e mëposhtme nuk justifikohet nga të dhenat ?

- A) Ekzaminimi i lëkurës dhe membranave mukoze për të vlerësuar koagulopatinë.
- B) Vlerësimi i simetrisë faciale
- C) Egzaminimi oral
- D) Egzaminimi neurologjik dhe reflekseve

Pyetja 118

Në cilin nga stadet e zhvillimit të sëmundjes së Tërbimit te kafsha shfaqet refuzimi total i ujit?

- A) Në stadin prodromal
- B) Në stadin e eksitimit
- C) Në stadin e paralizës.

D) Në momente para ngordhjes

Pyetja 119

Në një qen të races Labrador i konfirmuar me kontrollin parasitologjik me Demodekoze cili nga mjekimet do të jetë i kundërlinduar?

- A) Antibiotik
- B) Ivomek
- C) Prednizon
- D) Bravekto

Pyetja 120

Cilët nga keto lloje gurësh janë më të shpeshte në qen?

- A) Oksalati i kalciumit
- B) Struvitet
- C) Silikatet.
- D) Gurët e cisteinës